


EDUKATA ISLAME

REVISTË SHKENCORE, KULTURORE, ISLAME



VITI XXXI NR. 68-69

PRISHTINË
2002

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXI nr. 68-69 / 2002

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXI nr. 68-69 – 2002

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr.Pajazit Nushi,
Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahim, i,
Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

*Sekretar i redaksisë: **Hajrullah Hoxha***

Lektor: Isa Bajçinca

Korrektor: Skender Rashiti

*Realizimi: **Shtëpia Botuese***



Redaktor teknik: Bashkim Mehani

Operator kompjuterik: Nuhi Simnica

*Shtyp: **Koha** - Prishtinë*

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXI nr. 68-69 / 2002

Prishtinë
2002

Qemajl Morina

PËR MËSIMIN E FESË NË SHKOLLA

**“Çdo person ka të drejtën e lirisë së mendimit,
të ndërgjegjes dhe të fesë”.**

Neni 18 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut

E drejta e lirisë, e ndërgjegjes dhe e fesë është nëse jo më e vjetra, atëherë pa dyshim një nga të drejtat më të hershme të pranuara ndërkombëtarisht. Për këtë arsye një prej masave për demokratizimin e një shoqërie, është sa u siguron ajo qytetarëve të vet lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë si dhe praktimin e saj individualisht dhe bashkërisht në jetën e përditshme.

Shoqëria kosovare për shkak të okupimit serb si dhe sundimit komunist për dekada të tëra kishte qenë e privuar nga kjo e drejtë elementare. Çështja e fesë ishte thjesht private e çdo individi dhe vetëm në këtë mënyrë ajo kishte mbijetuar.

Me ndryshimet e mëdha pozitive që u bënë në shoqërinë kosovare në periudhën e pasluftës, është pritur që, krahas ndryshimeve tjera të avancohej edhe çështja e fesë sin një segment me rëndësi i shoqërisë sonë, duke u mbështetur në përvojat e popujve të tjerë, kur dihet se Kosova pas luftës qeveriset nga Administrata e Organizatës së Kombëve të Bashkura (UNMIKU). Natyrisht është pritur që ky avancim të

bëhej në dispozitat ligjore të Kosovës si dhe të definohej pozita e fesë në shoqërinë tonë. Për fat të keq, kjo çështje deri më tash nuk është shqyrtuar fare nga organet kompetente, qofshin ato ndërkombëtare apo vendore, ndërsa çështja e fesë ka mbetur e padefinuar në aktet ligjore, siç është rasti i Kornizës Kushtetuese, e cila përkohësisht është akti më i lartë ligjor i Kosovës.

Kuvendi i Kosovës nuk e përkrah amandamentin për mësimbesimin

Se çështja e fesë është ende në margjina, u vërtetua edhe me rastin e miratimit të ligjeve për arsimin kosovar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, Amendamenti në të cilin kërkohet të sigurohej mësimi i lëndëve fetare në shkolla, nuk u aprovua. Ministri i Arsimit e arsyeoi këtë me mungesën e buxhetit. Ndërsa kryetari i Kuvendit në vend që të kërkonte që për amandamentin në fjalë të hapej diskutimi dhe të shqyrtohej më gjerësisht dhe në aspekte të ndryshme, u mjaftua që të bëjë disa korrigjime, në vend të versioneve shqip e serbisht të rregullimit të kësaj çështjeje, ku thuhej: “ky lloj mësimi ndalohej”, ai propozoi që të votohej për versionin anglisht, ku shprehja ndalohej mësimi i fesë në institucionet e arsimit të zëvendësohej me “të përmbahen nga mësimi i lëndëve fetare”. Për këtë amendament votuan vetëm 18 deputetët, thuhet se asnjë deputet shqiptar nuk kishte votuar për këtë amendament.

Shtrohet pyetja se sa i përfaqësonin deputetët e Kuvendit të Kosovës aspiratat dhe vullnetin e zgjedhësve të tyre me rastin e aktit të votimit të tyre. Ndërsa arsyetimi i Ministrisë të Arsimit ishte i pajustificueshëm dhe i paqëndrueshëm. Populli i Kosovës, i cili për një dekadë të tërë e ndihmoi arsimin e Kosovës, do të ishte në gjendje të ndihmonte atë edhe në këtë kohë. Mirëpo një qëndrim i tillë i Ministrisë të Arsimit për njohësit e mirë të rrethanave në Kosovë nuk paraqet befasi. Ish-ministri i arsimit, Naim Rrustemi, në një anketë të organizuar nga e përjavshmja “Zëri” nr. 1771 (24 mars 2001), se a duhet të mësohet feja në shkolla, kishte deklaruar: “Feja larg shkollave!” Ndërsa për një përpjekje për një bisedë të tillë nga e njëjta e përjavshme (“Zëri nr. 1818, 25 maj 2002), Ministri aktual i Arsimit, Rexhep Osmani as që kishte dashur të bisedonte.

Legalizimi dhe futja e mësimit të fesë në shkollat tona, duke programuar njohurit e domosdoshme fetare e duke respektuar njëkohësisht edhe besimet e tjera tradicionale fetare që keqzistojnë në Kosovë do ta çonte përpara edukimin dhe arsimimin e gjithmbarshëm në Kosovë dhe do ta begatonte atë. Nëse dikush mendon se në pamjen e parë kjo duket se shkon, ndesh me të ashtuquajturin shtet laik, e kundërta, mohimi aprioristik me pretekstin e laicitetit do të binte në ndeshje të hapet me sistemin e shtetit demokratik, të cilin kosovarët me tërë qenien e tyre dëshirojnë ta ndërtojnë.

Mësimbesimi hyn në grupin e të drejtave të patjetërsueshme njerëzore të garantuara me dokumente ndërkombëtare, të cilat e obligojnë UNMIK-un, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës.

Përvojat e vendeve të tjera me mësimin e fesë

Për opinionin e përgjithshëm kosovar do të ishte me rëndësi të njihet se si aplikohet lënda e mësimbesimit në vende të tjerë të Evropës, me qëllim që të përfitohet nga përvoja e atyre vendeve. Meqenëse dëshirë e të gjithë nesh është që Kosova sa më parë t'i bashkohet familjes së madhe evropiane, do të ishte mirë që të shohim si është rregulluar kjo çështje në ato vende. Pothuaj në të gjitha vendet evropiane, mësimbesimi është pjesë përbërëse e programit shkollor në shkollat fillore dhe të mesme.

Në **Austri** mësimbesimi u mundësohet të gjitha bashkësive fetare të pranuar, me kusht që të kenë një numër të caktuar nxënësish. Bashkësia Islame në Austri është bashkësia e dytë për nga numri i besimtarëve, menjëherë pas asaj katolike. Mësimbesimi zhvillohet atje për vite të tëra. Ministria e Arsimit i paguan të ardhurat personale për arsimtarët e mësimbesimit. Nxënësit, të cilët vendosin të mos ndjekin asnjë lloj mësimbesimi nga ato që mësohen në shkollat e tyre prej vitit 1997, kanë mundësi të ndjekin lëndën e etikës.

Në **Gjermani**, Kushtetuta garanton mësimbesimin në shkollat shtetërore si lëndë "normale", do të thotë se është lëndë obligative për të gjithë, me mundësinë e tërheqjes me lejen e nenit 7, paragrafit 2 dhe 3 të Kushtetutës Federale).

Në **Angli** mësimbesimi është po ashtu pjesë e planprogramit mësimor me të drejtë që prindërit të cilët kanë rezerva për këtë lëndë, t'i largojë fëmijët e tyre nga orët e kësaj lënde.

Në **Spanjë** mësimbesimi në radhë të parë ai katolik, është lëndë fakultative në shkollat shtetërore. Arsimtarët e mësimbesimit katolik i paguan shteti dhe ata i gëzojnë të njëjtat të drejta, që i gëzojnë kolegët e tyre, të cilët japin lëndë laike.

Neni 10 i Marrëveshjes shtetërore të nënshkruar me prijësit e Bashkësive evangjeliste, hebraike dhe islame që nga viti 1992 parasheh mundësinë e mbajtjes së mësimbesimit dhe për nxënësit e tyre në shkolla publike, nëse në shkollë ka 10 e më shumë nxënës të njërit prej besimeve të tyre.

Në **Greqi**, e cila dallohet se si anëtare e BE ende i zbaton ligjet e vitit 1930, të cilat favorizojnë ortodoksizmin dhe në mënyrë flagrante mohojnë liritë dhe të drejtat e bashkësive të tjera fetare, mësimbesimi është i obligueshëm për nxënësit, të cilët deklarohen si ortodoksë. Kleri i Kishës Ortodokse, përfshirë edhe arsimtarët e mësimbesimit, paguhet nga buxheti i shtetit sikurse edhe nëpunësit fetarë.

Në **Irlandë** ligji u lejon prindërve të drejtën që fëmijët e tyre jo vetëm të ndjekin mësimin fetar, por edhe edukatën fetare. Shumica e shkollave në Irlandë janë pronë e njëres prej bashkësive fetare dhe ato kanë të drejtë ligjore që të vendosin mësimin e fesë, të cilin e cakton organi përkatës fetar. Mësuesi i fesë është anëtar i barabartë i Këshillit Mësimor dhe ka të njëjtën pagë sikurse anëtarët e tjerë të kolektivit.

Në **Finlandë** mësimbesimi është i obligueshëm;; vlen të përmendet se ajo ka dy kisha nacionale, si edhe Danimarka, e cila ka kishën e vet nacionale. Fëmijëve, prindërit e të cilëve janë ateistë u është dhënë mundësia obligative që ata të ndjekin orë në historinë e fesë dhe me etikë.

Norvegjia po ashtu është me kishën e vet nacionale. Mësimbesimi është i obliguar në shkolla. Fëmijët e besimeve të tjera mund të mos marrin pjesë në orët e mësimbesimit me pëlqimin e prindërve. Në disa shkolla, varësisht nga numri i nxënësve, shteti siguron arsimtarët për mbajtjen e mësimbesimit për pakicat e besimeve të tjera.

Në **Itali**, që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së re me Vatikanin më 1985, mësimbesimi është lëndë fakultative.

Mësimbesimi në disa shtete të ish-sistemit komunist

Edhe në shtetet e ish-sistemit komunist, mësimbesimi është bërë pjesë përbërëse e mësimin shkollor.

Në **Hungari** mësimbesimi është lëndë fakultative, meqenëse në parlament nuk kaloi propozimi i qeverisë që mësimbesimi të bëhej i obligueshëm.

Në **Poloni** mësimbesimi i fesë katolike është i obligueshëm dhe është pjesë përbërëse e planprogramit mësimor. Vetëm nxënësit, që marrin lejen dhe pëlqimin e prindërve, mund të mos marrin pjesë në orët e mësimbesimit. Njëzet mijë arsimtarë të mësimbesimit që nga viti 1997 kanë statusin e arsimtarëve të rregullt, edhe pse ata i cakton ipeshkvi. Për të ardhurat personale të tyre shteti jep një shumë prej 58 milionë dollarësh amerikanë. Për ata nuk është kusht që t'i plotësojnë kushtet e arsimtarit. Të gjithë nxënësit, të cilët ndjekin mësimbesimin, janë të liruar nga mësimi gjatë festave fetare. Lutjet e përbashkëta mund të organizohen në shkollat shtetërore dhe kryqi mund të vendoset në vendet në të cilat organizohet mësimbesimi, edhe nëse ato shfrytëzohen për mbajtjen e mësimin për lëndë laike.

Në **Lituani** mësimbesimi është po ashtu lëndë fakultative për të gjitha bashkësitë fetare të pranuar nga shteti, dhe ai mund të organizohet në shkollat shtetërore. Lënda alternative e mësimbesimit është edukimi qytetar-moral. Si arsimtarët e mësimbesimit nëpër shkollat shtetërore, po ashtu edhe mësuesit e fesë nëpër shkolla fetare paguhet si kolegët e tyre të lëndëve laike.

Mësimbesimi në ish-republikat jugosllave

Edhe në ish-republikat e ish-Federatës Jugosllave, mësimbesimi është organizuar menjëherë pas pavarësimin të tyre, secila sipas kushteve dhe në kuadër të normave të caktuara.

Në **Kroaci** mësimbesimi është lëndë e detyrueshme në të gjitha shkollat dhe në pajtim me rregullat e Marrëveshjes ndërmjet Vatikanit dhe Kroacisë rreth bashkëpunimit në lëmin e edukimit dhe kulturës, nënshkruar në Zagreb më 28 dhjetor 1896.

Në **Bosnjë-Hercegovinë** mësimbesimin e ndjekin mbi 250.000 nxënës, ku janë të angazhuar 745 arsimtarë. Mësimbesimi është i detyrueshëm.

Në **Serbi** ky është viti i dytë që po aplikohet lënda e mësimbesimit në shkollat publike. Meqenëse shkollat serbe edhe në Kosovë punojnë sipas sistemit paralel të Serbisë, mësimbesimi aplikohet edhe në shkollat serbe në Kosovë.

Maqedonia është shteti i fundit nga ish-republikat e dalura nga ish-Federata Jugosllave që këtë vit e ka aplikuar lëndën e mësimbesimit në sistemin shkollor.

Përmbyllje

Nga tërë kjo që pamë, mund të përfundojmë:

1. Institucionet tona arsimore lypset të kenë një qasje të drejtë, reale dhe pa paragjykime paraprake rreth çështjes së inkorporimit të mësimbesimit në planprogramet shkollore.

2. Në bazë të standardeve evropiane dhe botërore, mësimbesimi është një prej të drejtave elementare njerëzore të çdo shoqërie demokratike.

3. Mësimet nga feja duhet të hyjnë gjithsesi nëpër shkollat tona, sepse faza në të cilën jemi, është faza e një transicioni, jo vetëm ekonomik, po edhe kulturor, dhe kjo do të na jepte një ndihmesë të mirë në synimin tonë për ndërtimin e një shoqërie të re demokratike, tolnate dhe stabile.

4. Mësimbesimi fetar do të jetë një begatim i programeve edukative dhe arsimore, në funksion të njeriut të ri, të karakterit të ri të njeriut, i cili do t'ju rezistojë me sukses ideologjive të ndryshme, të cilat synojnë ta manipulojnë dhe ta keqpërdorim atë.

5. Shqiptarët nuk duhet të lejojnë që edhe një herë ta përsëritin gabimin e flakjes së vlerave fetare, siç vepruan gjatë sundimit komunist, pasojat e të cilit po i vuajmë edhe sot.

Sabri Bajgora

TEFSIRI NË KOHËN E SAHABËVE

Allahu xh.sh. i zbriti Kur'anin famëlartë të Dërguarit të Tij, udhëzim të qartë dhe dritë e cila do t'i ndriçojë rrugët e njerëzimit deri në Ditën e Gjykimit.

I Plotfuqishmi e urdhëroi të dërguarin e Tij që këtë Kur'an t'ua sqaronte shokëve dhe ymetit të tij, kur i thotë:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

“...Ty ta zbritëm këtë Kur'an, t'ua shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë”. (En-Nahl, 44), dhe

يَا أَيُّهَا الرَّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ وَإِنْ لَمْ تَفْعَلْ

فَمَا بَلَّغْتَ رِسَالَتَهُ وَاللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ ۗ

“O ti i dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer misi-onin (revelatën). Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve).” (El Maide, 67)

Dhe vërtet i Dërguari i Allahut e zbatoi në praktikë dhe iu përmbajt besnikërisht këtij urdhri hyjnor. Ai e pranoi shpalljen hyjnore për plot 23 vjet, dhe ishte shumë i vëmendshëm që, çdo paqartësi që

paraqitej aty-këtu rreth kuptimit të drejtë të ndonjë fjale a ajeti, t'ua sqaronte ashabëve të tij menjëherë. Ashabëve ua sqaroi kuptimet e Kur'anit aq sa ata kishin nevojë, në të shumtën e rasteve disa paqartësi rreth kuptimit të ndonjë ajeti. Kjo pra nuk nënkupton se Muhammedi a.s. e sqaroi dhe e komentoi tërë Kur'anin, por e sqaroi vetëm atë që ishte e nevojshme për t'u kuptuar, dispozita të cilat pastaj ashabët i jetësonin në praktikën e tyre të përditshme.

Ashabët e Resulullahit ishin njerëzit më të privilegjuar e më të zgjedhur të këtij Ymeti, meqenëse patën rastin ta shoqëronin njeriun më të madh të njerëzimit- Muhammedin a.s., të cilin Allahu xh.sh. e dërgoi udhëzues dhe mëshirë për botën mbarë.

I Lartmadhërishti, i ka lavdëruar ashabët e Resulullahut s.a.v.s. në Kur'an kur thotë:

مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ وَالَّذِينَ مَعَهُ أَشِدَّاءُ عَلَى الْكُفَّارِ رُحَمَاءُ بَيْنَهُمْ

“Muhammedi është i dërguar i Allahut, e ata që janë me të (ashabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete...” (El-Fet-h, 29), dhe:

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ
وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَتُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni Allahun.” (Ali Imran, 110)

Kurse i Dërguari i Allahut për shokët e vet ka thënë: *“Mos i shani ashabët e mi, mos i shani ashabët e mi, se për Atë në Dorën e të Cilit është jeta ime, nëse ndonjë prej jush do të jepte (shpenzonte) sasi të arit sa kodra e Uhudit, nuk do të arrinte mirësinë e ndonjërit prej tyre, madje as sa gysmën e tyre.”*¹

S'ka dyshim që ashabët e Pejgamberit a.s. përgjithësisht i kuptonin të shumtën e ajeteve kuranore dhe dispozitat që dilnin nga këto ajete, megjithëse kur është fjala për kuptimin e përpiktë të disa çështjeve të fshehta kuptimore, ata kishin nevojë për sqarime shitesë dhe

¹ Transmeton Muslimi në kapitullin *“Fedailus-Sahabeh”* Kreu: *“Ndalimi i sharjes së ashabëve”* 4/1964.

më të hollësishme, për se drejtoheshin menjëherë tek i Dërguari i Allahut. Atyre nuk u mjaftonte vetëm të kuptonin fjalët e Kur'anit, sepse, siç dihet, fjalët kuranore në kontekste të ndryshme, po ashtu japin shpjegime dhe kuptime të ndryshme.

Madje në lidhje me këtë, librat e tefsirit dhe ata të shkencave kuranore, kanë regjistruar mospajtime në mendimet e dijetarëve.

Kështu shohim se Ibni Halduni në **“Mukaddimen”** e tij thotë: *“Kur’ani zbriti në gjuhën e arabëve, në formën e retorikës së tyre, kështu që të gjithë ata i kuptonin dhe i dinin kuptimet e fjalëve dhe mënyrat e konstruksionit të tyre”*²

Ky mendim i Ibni Haldunit mendojmë që është vlerësim tepër i lirë dhe i papeshuar mirë, sepse nuk ishin të gjithë ashabët në të njëjtin nivel të dijes dhe të të kuptuarit të gjuhës së Kur'anit. A nuk i kanë regjistruar librat fjalët e Omerit r.a., të cilat i transmeton Ebu Abide në *“El-Fedail”* nga Enesi r.a. tek thotë: Një ditë, derisa Omeri r.a. ishte në minber duke lexuar ajetin e **31** të kaptinës **Abese**: **“Ve fakiheten ve ebba”** – *“Dhe pemë e kullosa”*, tha: fjalën **“fakiheten”**- *“pemë”* po e kuptojmë, po a thua ç’kuptim ka fjala **“ebba”**?!

Atëherë Omeri iu kthye vetvetes duke thënë: *“Vërtet kjo është ngarkesë për ty, o Omer.”*³

Pastaj është edhe në një rast tjetër, të cilin e ka regjistruar po ashtu Ebu Abide nëpërmjet Muxhahidit e ky nga Ibni Abbasi, të ketë thënë: *“Nuk e dija kuptimin e fjalës **“Fatir”** në ajetin (**Fatiru-s-semavati vel erd...**) - (*Esh-Shura, 11*), derisa nuk erdhën dy beduinë tek unë për t’ua dhënë një fetva, të cilët po grindeshin rreth pronësisë së një pusi me ujë. Njëri prej tyre thoshte: *“Ene fetartuha”*- *“Unë ia kam filluar i pari”*, ndërsa tjetri thoshte: *“Ene ibtede’tuha”*- *“Unë ia kam filluar i pari”*”*.⁴

Nëse Omeri r.a. nuk e dinte kuptimin e fjalës **“ebba”**, kurse komentatori më i famshëm i Kur'anit, Ibni Abbasi, nuk e dinte kuptimin e fjalës **“Fatir”**, atëherë ashabët e tjerë sigurisht që kanë pasur edhe më shumë paqartësi të tilla, prandaj mund të themi edhe një herë se

² Shih *“Mukaddime li Ibni Haldun”*, fq. 489, Kajro 1327 h.

³ Dr. Muhammed Husejn edh-Dhehebi *“Et-Tefsiru vel Mufessirune”*, vëll. I, fq. 84, Kajro 1985.

⁴ Po aty, fq. 113.

fjalët e Ibni Haldunit, duken pa vend dhe mendime tepër të lira, në lidhje me të kuptuarit e Kur'anit nga ashabët.

Ja se ç' mendim të kundërt me Ibni Haldunin ka dhënë Ibni Kutejbe, i cili jetoi me shekuj para Ibni Haldunit: *“Arabët nuk janë të njëjtë në të kuptuarit e fjalëve të paqarta dhe me kuptime të shumta të Kur'anit, por dikush prej tyre është më i ngritur se tjetri, dhe si të tillë e plotësojnë njëri-tjetrin”*

Burimet e tefsirit në kohën e sahabëve

Në kohën e ashabëve, me të cilën nënkuptohet koha pas vdekjes së Resulullahut s.a.v.s., burime të Tefsirit ishin:

1. Kur'ani fisnik
2. Syneti (Hadithi) i Pejgamberit a.s.
3. Fjalët e ashabëve nga ixhtihadi i tyre personal, dhe
4. Transmetimet nga pjesëtarë të “Ehli Kitab-it” që kishin pranuar

Islamin

Veçoritë e tefsirit në kohën e sahabëve

Tefsiri në kohën e ashabëve dallohej me disa veçori ndër të cilat dijetarët kanë numëruar:

- Në kohën e ashabëve, Kur'ani nuk është komentuar në tërësi, por është komentuar vetëm ajo që ishte më e vështirë për t'u kuptuar. Atyre u mjaftonte kuptimi i përgjithësuar rreth ndonjë dispozite pa hyrë në detaje më të hollësishme. Shembull të tillë kemi rastin e Omerit r.a. të cilin e kemi cekur më parë rreth kuptimit të fjalës *“ebba”-“kullosa”*. Ai konsideroi se të zgjeruarit në njohjen më të thellë të kuptimit të kësaj fjale ishte ngarkesë për të, prandaj i mjaftoi të kuptonte se fjala ishte për një mirësi prej mirësive të shumta të Allahut xh.sh. ndaj njeriut.

- Në mesin e sahabëve kishte shumë pak mospajtime në të kuptuarit e domethënive të Kur'anit, sepse shumica prej tyre ishin njohës shumë të mirë të gjuhës së pastër arabe. Po ashtu në mesin e tyre nuk kishte kurrfarë zilie a xhelozie nëse ndonjëri ishte më i ditur se tjetri

në ndonjë çështje të caktuar fetare. Ata mendimin e tjetrit e praninin pa hezitim, kur u flente në zemër

- Tefsiri si shkencë e veçantë, nuk ishte mbledhur e as shkruar, por përcillej në formë gojore si në formë të haditheve nga Resulullahu s.a.v.s.

- Ashabët shumë pak u drejtoheshin pjesëtarëve të “Ehli Kitab-it” për ndonjë sqarim nga librat e tyre të shenjtë⁵, por, edhe kur merrnin diçka prej tyre, ishin shumë të vëmendshëm që ai transmetim të ishte në përputhshmëri me Kur’anin dhe Synetin.

Ata gjithmonë në mendje kishin fjalët e Resulullahut s.a.v.s. rreth këtyre tregimeve israilite, kur i kishte porositur ashabët: “*Mos u besoni e as mos i përgënjeshtroi çifutët, por thoni Ne besojmë në Allahun dhe në atë që na është zbritur.*”

- Mendimet e sahabëve rreth ndonjë dispozite juridike ishin më tepër mendime kolektive (*ixhma’ë*) të dala nga konsultimi i ndërsjellë sesa mendime individuale. Bejhekiu në Sunenin e tij ka regjistruar fjalët e Mejmun bin Mehranit të ketë thënë: “Nëse Ebu Bekrit i paraqitej ndonjë çështje për ta zgjedhur, shikonte së pari në mos gjente zgjidhje në Kur’an, nëse jo, atëherë shikonte në hadithet e Resulullahut s.a.v.s., e nëse as këtu nuk gjente atë përgjigje, atëherë i konsultonte ashabët e tjerë dhe i pyeste: A mos dini nëse i Dërguari a.s. e ka zgjidhur ndonjëherë këtë çështje? Ndodhte që dikush t’i thoshte po, se i Dërguari i Allahut ka vepruar në këtë rast kështu e kështu, dhe ai menjëherë e pranonte atë zgjedhje si të kryer, e nëse përgjigjja ishte negative, atëherë ai mblidhte sahabët më të mëdhenj e më të ditur dhe i konsultonte lidhur me atë çështje. Vetëm pasi e merrnin vendimin së bashku, gjykonte.

Të njëjtin veprim e bënte edhe Omeri r.a. në kohën e sundimit të tij. Shikonte së pari Librin e Allahut, nëse në të nuk gjente atë që kërkonte, atëherë shikonte në Synetin e Pejgamberit a.s. se si kishte vepruar ai, e nëse edhe këtu nuk gjente atëherë shikonte në mos kishte gjykuar diçka të ngjashme parardhësi i tij Ebu Bekri, e nëse ai edhe te ky, nuk gjente atë që kërkonte, atëherë tubonte të gjithë ashabët dhe

⁵ Dr. Abdullah Shehate. “*Ulumu-t-Tefsir*”, fq. 17, Kajro 2001.

konsultohet me ta, dhe vetëm pasi ta kishin marrur vendimin së bashku, gjykonte.⁶

Vlefshmëria dispozitive e transmetimeve nga ashabët

Dijetarët islam, pa dallim, pajtohen rreth faktit se pas Resulullahut s.a.v.s, më meritoret dhe më të denjët për të komentuar Kur'anin fisnik ishin ashabët e tij. Kjo nga shkaku se ata ishin dëshmitarë të drejtëpërdrejtë të Shpalljes hyjnore, dhe në të shumtën e rasteve dinin edhe shkaku e zbritjes së ajeteve kuranore. Arsyeja tjetër e besueshmërisë së transmetimeve nga ata ishte se ata, kurrë nuk jepnin ndonjë komentim pa pasur ndonjë mbështetje në Kur'an ose Sunnet. Janë të njohura mendimet e tyre të shprehura rreth komentimeve të ajeteve kuranore, në çka ishin shumë të kujdesshëm, që sa më shumë t'i iknin mendimeve të tyre personale. Një gjë e tillë erdhi në shprehje, vetëm pasi tokat islame u zgjeruan në atë masë, që sahabët u desh të shpërnguleshin gjithandej, që njerëzve t'ua shpjegonin Islamin burimor.

Megjithatë, në mesin e dijetarëve hasim mospajtime dhe mendime të ndryshme rreth hukmit të transmetimit nga sahabiu, të nxjerrë nga ixhtihadi i tyre personal.

Grupi i parë shkon nga ajo se transmetimet e sahabiut nga ixhtihadi i tyre personal e kanë gradën: "*Mevkuf*", që do të thotë se ai është mendim i lirë i tij, dhe meqenëse nuk është fjalë e dëgjuar nga Resulullahu s.a.v.s., ai mendim mund të jetë i saktë ose jo i saktë.

Kurse **grupi i dytë** shkojnë nga fakti se komentimet personale të ashabëve janë argumente të pakontestueshme, duke u mbështetur në atë se ata ishin njerëzit më të afërt me Pejgamberin a.s., ishin njerëzit më të dashur tek Allahu xh.sh., por në të njëjtën kohë, mendjet e tyre ishin të ndritura dhe shumë herë të inspiruara nga nektari hyjnor, siç ishte rasti i Omerit r.a., propozimet e të cilit, Allahu i Plotfuqishëm i dëshmonte me ajete dhe dispozita kuranore, siç ishte rasti i robërve të Bedrit, i mbulesës së grave të Resulullahut s.a.v.s, dhe të konsideruarit e "*Mekamu Ibrahim*", si vendfalje.

⁶ Dr. Xhemal Mustafa Abdulhamid en-Nexh-xhar "*Menahixh tefsirijje*", fq. 155-158, Kajro, 2000.

Në lidhje me këtë Hakimi në “*Mestedrekun*” e tij thotë: “Le ta dijë çdo studiues i hadithit se tefsiri (komentimi) i sahabiut, i cili ka qenë dëshmitar i Shpalljes, sipas kritereve të dy dijetarët (aludon në Buhariun dhe Muslimin) e ka gradën (shkallën) e hadithit “*musned.*”⁷

Për të qartësuar këto pozicione mund të konkludojmë se:

- Komentimi i sahabiut e ka gradën “*merfu’ë*” vetëm nëse ai transmetim ndërlidhet me ndonjë shkak të zbritjes së ndonjë ajeti të caktuar, ose ai komentim në të cilin komenti i lirë nuk zë vend, ndërsa në atë komentim që shfaqet edhe mendimi i tij, bazuar në ixhtihad, pa e mbështetur atë mendim në ndonjë nga thëniet e Pejgamberit a.s., atëherë ai komentim i tij i nënshtrohet mundësisë së të qenit mendim i saktë ose jo.

- Komentimi personal i ndonjë sahabiut, ka një gradë të veçantë respekti, nëse ai nuk del jashtë kornizave kuranore ose të Syneetit, sidomos nëse ka të bëjë me ndonjë komentim gjuhësor, sepse ashabët vërtet ishin njerëzit më të aftë për gjuhën në të cilën kishte zbritur Kur’ani. Shembull më të mirë për këtë kemi Ibn Abbasin, i cili shquhej me diturinë e tij të thellë, kur shumë fjalëve kuranore, u gjente mbështetje edhe në poezinë arabe.

- Ndërsa sa i përket vlerës së tefsirit të sahabiut do të sjellim mendimin e Ibn Tejmijes i cili thotë: “*Nëse dikush pyet se cila mënyrë e komentimit është më e mira, atëherë përgjigjja është: Rruga dhe mënyra më e saktë është të komentuarit e Kur’anit me Kur’an, sepse çka ka mbetur e paqartë në ndonjë ajet, është sqaruar në një ajet tjetër, çka ka mbetur sqarim i shkurtër në një vend, është sqaruar më gjerësisht në një vend tjetër. Nëse në Kur’an nuk gjen më ajete të tilla sqaruese, atëherë ktheju Syneetit (hadithit) sepse ai është sqaruesi më i mirë i Kur’anit. Madje në lidhje me këtë, imam Shafiu ka thënë: “Çdo gjë me të cilën ka gjykuar i Dërguari a.s., është nga ajo që ai e ka kuptuar prej Kur’anit”. Pastaj nëse në Kur’an dhe Syneetit nuk gjejmë komentim në lidhje me ndonjë çështje, atëherë kthehemi tek fjalët e ashabëve, sepse këta, pas dy burimeve të para, ishin njohësit më të mirë të Librit të Allahut, sidomos dijetarët dhe më të mëdhenjtë prej tyre.”⁸*

⁷ Shih “*El Mustedrek*” të Hakimit, vëll. I-rë, fq. 13.

⁸ Ibn Tejmije “*Mukaddime fi Usuli-t-Tefsir*”, fq. 93.

Mufesirët më të njohur nga ashabët

Pa dyshim, ashabët ishin njerëzit më fatlum të këtij ymeti, sepse patën rastin të shoqëroheshin me të Dërguarin e Allahut dhe të merrnin për çdo ditë nga burimi i nektarit profetik, kështu që në mesin e tyre disa u shquan për aftësitë dhe afinitetet e tyre të pashoqe, në lidhje me disa nga komentimet e Librit të Allahut.

Imam Sujuti në lidhje me këtë, thotë: *“Për afinitetin për tefsir u shquan dhjetë prej ashabëve: 4 hulefai rrashidinët: Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu, pastaj Abdullah ibn Abbasi, Abdullah ibn Mes’udi, Ubejj bin Ka’bi, Zejd bin Thabiti, Ebu Musa el-Esh’ariu dhe Abdullah ibn Zubejri.”*⁹

Sa u përket transmetimeve nga këta të dhjetë, shohim se transmetimet nga Ebu Bekri, Omeri dhe Othmani r.a., janë më të pakta në krahasim me të tjerët, kjo sigurisht për shkak të vdekjes së tyre më të hershme, d.t.th. jo aq shumë vjet pas vdekjes së Resulullahut s.a.v.s.. Transmetimet e pakta nga këta të tre lidhen edhe me faktin se njerëzit në kohën e tyre ishin në përgjithësi njohës të mirë të dispozitave të Librit të Allahut, po edhe për faktin se këta të tre patën barrën më të madhe të përgjegjësisë shtetërore mbi supet e tyre, pasi atyre iu besua udhëheqja e muslimanëve, kështu që nuk kishin kohë aq të mjaftueshme të merreshin me këto transmetime.

Prej hulefai rrashidinëve, në këtë mes, përjashtim bën vetëm Aliu r.a., sepse gjatë kohës së hilafetit të tij, njerëzit që përqaфонin Islamin, ishin të shumtë dhe tokat islame ishin në zgjerim e sipër, kështu që ndihej nevojë e madhe që i pari i muslimanëve t’u jepte sqarime rreth disa komenteve të Librit të Allahut.

Është karakteristikë e kohës së sundimit të tij se tashmë po rritej edhe brezi i ri i fëmijëve të ashabëve, të cilët ishin të etshëm për njohuri të reja rreth Kur’anit famëlartë, kurse të kthyerit tek Aliu r.a. për këto sqarime ishte i arsyeshëm kur dihet se ai ishte rritur në shtëpinë e Pejgamberit a.s. dhe në shumë raste kishte qenë dëshmitar i drejtpërdrejtë i shpalljes që i zbriste Muhammedit a.s. .

⁹ Imam Xhelaluddin Es-Sujuti *“El Itkanu fi Ulumil Kur’an”*, vëll. 2, fq. 412, Bejrut 1987.

Sa u përket të tjerëve nga këta të dhjetë, lirisht mund të konstatohet se më të njohurit për transmetime janë Abdullah ibn Abbasi, Abdullah ibn Mes'udi dhe Ubejj bin Ka'bi, të cilët, nëse ua bashkojmë edhe Aliun r.a., kanë më së shumti transmetime nga lëmi i tefsirit.

Tre të tjerët, Zejd bin Thabiti, Ebi Musa el-Esh'ariu dhe Abdullah ibn Zubejri, kanë më pak transmetime se katërshi i madh i lartpërmendur, kështu që do të përqendrohemi në ndriçimin e biografisë së këtyre katër më të njohurve, që njihen për më së shumti transmetime: Ibn Abbasit, Ibni Mes'udit, Aliut r.a. dhe Ubejj bin Ka'bit.

Abdullah ibn Abbas r.a. – (vdiq 68 h.)

Biografi e shkurtër

Emri i tij i plotë është Abdullah ibn Abbas bin Abdul Muttalib bin Hashim el Kureshij el Hashimij.

U lind në Mekë 3 vjet para hixhretit. Që nga fëmijëria e tij e hershme ishte pranë ngrohtësisë së prehrit të Pejgamberit a.s., sigurisht nga fakti i lidhjes së ngushtë familjare, sepse ishin djem axhallarësh mes vete.

Kur vdiq i Dërguari i Allahut, Ibni Abbasi kishte 13 vjet. Në kohën e hilafetit të Aliut r.a., mori postin e mëkëmbësit të Basrës, kurse pas vrasjes së tij, u kthye në Hixhaz. Vdiq në Taif në vitin 68. Ky vit i vdekjes merret si më i sigurt, ndonëse ka edhe historianë që mendojnë se ai vdiq në vitin 65 e disa në vitin 67.

Vlera dhe pozita e tij në dije

Abdullah ibn Abbasi njihet me ofiqin *“Terxhumanul Kur’an”-Komentator i Kur’anit*, pastaj me *“Hibrul Ummeh”- “Ngjyra e Ymetit”* dhe me tjetrin *“Bahrul Ilmi”-“Det i diturisë”*¹⁰.

Pa dyshim ishte më i dijsmi dhe më i famshmi ndër ashabët sa i përket komentimit të Kur’anit, poezisë arabe dhe shkencave të tjera fetare.

¹⁰ Dr. Hasen Junis Hasen Abidu *“Dirasat ve mebahith fi tarihi-t-tefsir ve menahixhi-l-mufessirin”*, fq. 35, Kajro 1992.

U shoqërua me ashabët më të mëdhenj, prej të cilëve mësoi shumë nga hadithet e Pejgamberit, të cilat nuk kishte pasur rastin t'i dëgjonte prej tij.

Fjala e tij në komentim ishte fjala e fundit, sepse ishte vërtet një oqean i pafund i dijes në shumë lëmenj. E si të mos ishte kur i Dërguari i Allahut kishte bërë dua për të: “*O Zot, bëje të dijshtëm në çështjet e fesë dhe mësoja komentimin*”, kurse në një rivajet tjetër: “...*mësoja Librin*”, e në një tjetër: “...*dhuroji urtësinë*”.¹¹ Në këtë drejtim, vërtet mbeti i pakrahasueshëm dhe i paarritshëm.

Ishte i dashur dhe tepër i respektuar nga të gjithë ashabët. Madje Omeri r.a. e mbante përherë pranë vetes dhe kishte besim të madh në dijen e tij të thellë në fe. Ai shpesh i thoshte: “*Ti je më fytyrëndrituri prej të rinjve tanë, më i moralshmi prej tyre dhe më i dituri për librin e Allahut*”, kurse ashabëve të mëdhenj për të u thoshte: “*Ky është djalosh i pjekur, vërtet ka një gjuhë kureshtare, stil të të pyeturit dhe mendje të zgjuar*”

Dëshmitë e ashabëve dhe të tabiinjve për dijen e tij

Aliu r.a. për Ibni Abbasin dhe tefsirin e tij ka thënë: “*Ibni Abbasi, sikur të vështronte në të fshehtën nëpërmjet një perdeje të tejdukshme*”

Ibni Mes’udi për të ka thënë: “*Ibni Abbasi është komentuesi më i mirë i Kur’anit*”¹²

Ibni Abbasi rrëfen se si një ditë Omeri r.a. e kishte marrë pranë vetes në një tubim ku ishin veteranët e luftës së Bedrit, dhe, kur disa prej tyre e panë Ibni Abbasin aq të ri në mesin e tyre, u prekën dhe i thanë Omerit: Përse gjithnjë e merr këtë djalosh pranë vetes në tubimet tona, kur edhe ne kemi djem të moshës së tij, por ata nuk i lejon të marrin pjesë me ne?” Atëherë Omeri ua ktheu: “*Sepse ky djalosh është ai që e njihni se çfarë është*” (duke aluduar dijen dhe zgjuarsinë e tij).” Dhe kur një ditë tjetër, Omeri r.a. më ftoi në një tubim të tyre, e kuptova se më kishte ftuar vetëm që para tyre t'i demonstroja njohuritë e mia. Omeri r.a. u ngrit dhe i pyeti veteranët e luftës së

¹¹ Transmeton Buhariu në kapitullin “*Mbi biografinë e Ibni Abbasit*” (2/306)

¹² Transmeton Bejhekiu në “*Ed-Delail*”

Bedrit: “Ç’thoni për fjalët e Allahut **“Idha xhae nasrullahi vel fet’h...”**”? deri në fund të kaptinës “*En-Nasr*”.

Disa prej tyre thanë: “Allahu na ka urdhëruar ta falënderojmë Atë dhe të kërkojmë falje prej tij (istigfar), pasi na mundësoi të ngadhënjëm dhe ta çlirojmë Mekën”, kurse të tjerët heshtën. Atëherë Omeri r.a. m’u drejtua me fjalët:

- A mendon kështu edhe ti, Ibni Abbas?

- Jo, - ia ktheva unë.

- Po atëherë ç’thoni ju për këto fjalë të Allahut? – m’u drejtua prapë Omeri r.a.

- Ky është paralajmërim i vdekjes së Resulullahut s.a.v.s., ia ktheva unë, sepse pas fitores dhe ngadhënjimit, ai urdhërohej ta madhëronte Zotin xh.sh. dhe të kërkonte falje prej Tij (në prag të vdekjes).

Atëherë Omeri u ngrit e tha: - As unë nuk di për komentim tjetër përveç këtij që thua ti, o Ibni Abbas”.

Tërë kjo tregon se vërtet Ibni Abbasi ishte i zgjuar, i mençur, por mbi të gjitha zemrën, shpirtin dhe mendjen e tij e kishte përfshirë mirësia e duasë së Pejgamberit a.s. kur ishte lutur për të: “*O Zot, bëje të dijshtëm në çështjet e fesë dhe mësoja komentimin.*”

Nxënësi i tij, Muxhahidi, po ashtu njëri prej komentatorëve më të mëdhenj të Kur’anit nga gjenerata e tabiinëve, për të ka thënë: “*Kur komentonte diçka ai në fytyrën e tij do të shihje vetëm dritë*”.

Muxhahidi thotë po ashtu: “*Ibni Abbasi quhej “Bahrul Ilmi-Det i diturisë”, për shkak të diturisë së madhe e të thellë që posedonte*”.

I është thënë Tavusit: Je dhënë pas shoqërimit të këtij djaloshi (d.t.th. pas Ibn Abbasit) dhe i ke lënë ashabët më të mëdhenj, kurse ai është përgjigjur: “*Vërtet unë i kam parë me sytë e mi mbi 70 ashabë të Resulullahut s.a.v.s. kur në një ndenje të tyre nuk kanë rënë në ujdi rreth një çështjeje, atëherë janë kthyer dhe e kanë pranuar mendimin e Ibn Abbasit.*”¹³

¹³ “*Ulumu-t-Tefsir*”, fq. 153, Kajro 2001

Disa nga komentimet e Ibn Abbasi në tefsir

- Është pyetur Ibn Abbasi rreth ajeteve 27-29 të kaptinës “**El-Kasas**”:

قَالَ إِنِّي أُرِيدُ أَنْ أَنْكِحَكَ إِحْدَى ابْنَتَيَّ هَاتَيْنِ عَلَى أَنْ تَأْجُرَنِي ثَمَانِيَةَ حِجَجٍ فَإِنْ
أَتَمَمْتَ عَشْرًا فَمِنْ عِنْدِكَ وَمَا أُرِيدُ أَنْ أَشُقَّ عَلَيْكَ سَتَجِدُنِي إِنْ شَاءَ اللَّهُ مِنَ
الصَّالِحِينَ. قَالَ ذَلِكَ بَنِي وَبَيْنَكَ أَيَّمَا الْأَجْلَيْنِ فَضَيْتُ فَلَا عُدْوَانَ عَلَيَّ وَاللَّهُ
عَلَى مَا نَقُولُ وَكِيلٌ. فَلَمَّا قَضَى مُوسَى الْأَجَلَ وَسَارَ بِأَهْلِهِ...

“Ai (Shuajbi) tha: “Unë dëshiroj të të martoj ty me njërën prej kë-
tyre dy vajzave të mia, me kusht që të më shërbesh tetë vjet, e nëse i
plotëson dhjetë, ai është vullneti yt, e unë nuk dëshiroj të të rëndo, e
në dashtë Allahu, ti do të gjesh tek unë mirëkuptim. Ai (Musai) tha:
“Kjo le të mbetet mes meje e teje, e cilindo prej afateve që do ta
kryej, nuk do të ketë përgjegjësi për mua. Për këtë që po themi,
Allahu është garantues. E kur Musai e kreu afatin dhe udhëtoi me
familjen e vet...”, se cilin prej dy premtimeve e ka mbajtur Musai a.s.
kur Shuajbi a.s. i propozoi atij që të qëndronte e t’i shërbente, Ibn
Abbasi qe përgjigjur: “E ka mbajtur premtimin më të madh dhe më të
mirë (dhjetvjetëshin, shënim yni), sepse kur i Dërguari i Allahut pre-
mtton, edhe e mban premtimin.”

- Transmeton Taberiu nga Ibn Abbasi të ketë thënë në lidhje me
ajetin 59 të kaptinës “**El-Bekare**”:

فَأَنْزَلْنَا عَلَى الَّذِينَ ظَلَمُوا رِجْزًا مِنَ السَّمَاءِ بِمَا كَانُوا يَفْسُقُونَ

“...E Ne, për shkak se ata kundërshtuan, lëshuam nga qielli një
dënim kundër atyre që ishin mizorë”,

“Sa herë është përmendur në Kur’an, fjala “**Er-Rrixhsu**” nënkup-
ton ndëshkimin.”

- Po ashtu transmeton Taberiu nga Ibn Abbasi të ketë thënë në
lidhje me ajetin 268 të kaptinës “**El-Bekare**”:

الشَّيْطَانُ يَعِدُكُمُ الْفَقْرَ وَيَأْمُرُكُم بِالْفَحْشَاءِ وَاللَّهُ يَعِدُكُم مَغْفِرَةً مِنْهُ وَفَضْلًا

“Djali ju frikëson nga varfëria dhe ju urdhëron për të këqija, e Allahu ju premtion falje (të mëkateve) e begati...”

“Në këtë ajet, dy gjëra janë prej Allahut e dy prej shejtanit. Shejtani ju frikëson me varfëri dhe ju thotë: Mos e shpenzo pasurinë tënde, por mbaje se ajo të duhet, dhe njëkohësisht ju urdhëron për punë të ndyra e të këqija, kurse Allahu ju premtion falje (magfired) pas këtyre mëkateve, dhe si shtesë të fisnikërisë së Tij, ju premtion furnizim të përhershëm”.¹⁴

Rrugët e transmetimit nga Ibni Abbasi

Meqenëse Ibni Abbasi ishte më i famshmi ndër ashabët në lëmin e Tefsirit, edhe transmetimet prej tij ishin të shumta, por me kalimin e kohës nën emrin e tij u trilluan aq shumë gjëra, saqë dijetarët u desh që të marrin masa të rrepta sigurie kur transmetonin diçka nga emri i Ibni Abbasit, sepse u përzien transmetimet e vërteta me ato të dobëta dhe të trilluara.

Dijetarët që u morën me shkencën e “*Ilmul Xherhi vet’adili*”, klasifikuan shumë qartë rrugën e transmetimeve nga Ibni Abbasi; disa prej të cilave janë të forta dhe të vërteta e disa të dobëta e të papranueshme.

Rrugët e pranueshme të transmetimeve nga Ibni Abbasi:

1. Rruga e transmetimit nëpërmjet Muavije bin Salihut nga Ali bin Ebi Talha e ky nga Ibn Abbasi.

Ka thënë Imam Ahmed ibn Hanbeli: “*Në Egjipt gjendet një fletë e tefsirit të cilën e ka transmetuar Ali bin Ebi Talha, saqë, po të shkonte ndokush në Egjipt për të, nuk do të ishte e tepërt.*”¹⁵

Në këtë rrugë transmetimi nga Ibni Abbasi është mbështetur edhe Buhariu në Sahihun e tij.

Po ashtu edhe Ibn Xheri et Taberiu ka shfrytëzuar me të madhe transmetimet nga Ibni Abbasi nëpërmjet kësaj vije transmetimi.

¹⁴ Në lidhje me këta shembuj të komenteve të Ibn Abbasit shih: “*Ulumu-t-Tefsir*”, fq. 155-156

¹⁵ “*El Itkanu fi Ulumul Kur’an*” vëll. II, fq. 415.

Me një fjalë, rruga më e saktë dhe më e pranuar nga Ibni Abbasi është kjo. Mjafton që dijetarët më eminentë, si Buhariu, Taberiu, Ibni Haxheri, Imam Ahmedi etj. janë mbështetur në transmetimet e kësaj rruge deri tek Ibni Abbasi.

2. Transmetimet nëpërmjet Kajs bin Muslimit nga Ata'ë bin Saibi, ky nga Seid bin Xhubejri e ky nga Ibn Abbasi.

Edhe kjo rrugë për nga saktësia e isnadeve është e pranuar sipas kriterëve të Buhariut dhe të Muslimit.

3. Transmetimet nëpërmjet Ibn Is'hakut nga Muhammed bin Ebi Muhammed, shërbëtor i familjes së Zejd bin Thabitit, ky nga Ikrime ose nga Seid bin Xhubejri e ky nga Ibn Abasi.

Edhe kjo rrugë transmetimi, vargun e transmetuesve e ka të shëndoshë, dhe e kanë shfrytëzuar Taberiu dhe Ibn Ebi Hatemi.

Rrugët e dobëta dhe ato të papranueshme të transmetimit nga Ibn Abbasi:

1. Rruga e transmetimit nëpërmjet Abdullah bin Xhurejxhit e ky nga Ibn Abbasi. Në të ka transmetime të shëndosha, po edhe të dobëta, pa kurrfarë klasifikimi.

2. Transmetimet nga Dahhak bin Mezahimi e ky nga Ibni Abbasi. Edhe kjo rrugë ka shkëputje në isnad dhe është e papranueshme.

3. Transmetimet nga Atije el Avfi e ky nga Ibn Abbasi. Edhe kjo rrugë konsiderohet e dobët dhe e papranueshme.

4. Rruga e transmetimit nëpërmjet Muhammed bin Saib el Kelbiut nga Ebi Salihu e ky nga Ibni Abbasi, është padyshim vija më e dobëta dhe më e papranueshmja.

Zaten edhe tefsiri që i është mveshur Ibni Abbasit e të cilin e ka mbledhur Fejruz Abadi, autori i *“Kamusul Muhit”* dhe e ka quajtur *“Tenvirul mikbas fi tefsiri Ibni Abbas”*, është vetëm nga kjo rrugë transmetimi, nëpërmjet Muhammed bin Mervanit (Es-Suddi-s-Sagir), ky nga Kelbiu e ky nga Ebi Salihu. Për këtë rrugë transmetimi imam Sujuti ka thënë: *“Nëse rrugës së transmetimit të Kelbiut, i bashkëngjiten edhe transmetimet e Suddiut, atëherë ajo është seri e gënjeshtreve.”*¹⁶

¹⁶ *“El Itkanu fi Ulumil Kur'an”*, vëll. II fq. 416

Shkaqet pse ky tefsir dhe shumë transmetime të tjera i janë mveshur emrit të Ibni Abbasit

Ibni Abbasit iu mveshën pa të drejtë shumë prej thënieve në tefsir, mu nga fakti që disa njerëz të dobët nga karakteri dhe nga mungesa e një ndërgjegjeje të pastër, dëshironin të përfitonin famë nga emri i madh i Ibn Abbasit.

Këtu nuk duhet harruar as fakti se dinastia abasite ishte prej lozës së Ibni Abbasit, kështu që shumë prej njerëzve servilë, duke dëshiruar të afroreshin pranë sundimtarëve abasinj, shpifnin e trillonin thënie, gjoja të transmetuara nga Ibni Abbasi¹⁷, andaj imam Shafiu me plot të drejtë konstaton: *“Nga Ibni Abbasi në lëmin e tefsirit nuk mund të merren si të vërteta më shumë se 100 transmetime”*¹⁸

Kjo do të thotë se shumë prej transmetimeve që iu mveshën Ibni Abbasit, në realitet as që kanë të bëjnë fare me të.

Abdullah ibn Mes’ud r.a. – (vdiq 32 h.)

Biografi e shkurtër

Ky është Abdullah ibn Mes’ud bin Gafil bin Habib el Hudhelij r.a.

Ishte ndër të parët që përqaftuan Islamin. Transmeton A’ëmeshi nga Kasim Abdurrahmani e ky nga babai i tij, të ketë thënë: *“Ka thënë Abdullahu, d.m.th. Ibni Mes’udi: “Më ke parë mua të gjashtin që e kam pranuar Islamin. Nuk kishte në fytyrën e tokës muslimanë të tjerë pos nesh”*.

Ishte më i dijsmhi ndër ashabët në dispozitat e Librit të Allahut; muhkem-muteshabih, hallall-haram, shkaqet e zbritjes, tregimet dhe shembujt kuranorë, etj.

Ishte si një hije e pandashme e Resulullahut, duke qenë në shërbimin e tij ditë e natë, dhe për këtë arsye llogaritet si njëri ndër më njohurit me shpalljen në mesin e ashabëve.

Është i pari që këndoi Kur’an haptazi para kurejshëve në Mekë pas të Dërguarit të Allahut, dhe për këtë shkak përjetoj tortura të rënda prej tyre.

¹⁷ Dr. Abdul Mun’im en-Nimr, *“Ilmu-t-Tefsir”*, fq.26, Kajro-Bejrut 1985.

¹⁸ Dr. Xhum’ah Ali Abdulkadir *“Zadu-r-Rragibin fi menahixhil mufesirin”*, fq. 22 , Kajro 1986.

Ishte aq i afërt me Pejgamberin a.s., sa që shumëkush mendonte se edhe ky ishte një prej anëtarëve të familjes së Pejgamberit - “*Ehli Bejt*”.

Emigroi në Abisini, pastaj në Medinë, ishte pjesëmarrës i luftës së Bedrit, Uhudit, Hendekut, i Bej’atu Rridvan, ndërsa pas vdekjes së Resulullahut s.a.v.s., edhe i luftës së Jermukut.

Ky qe ai që vrau përfundimisht Ebu Xhehlin.

Është në mesin e atyre të dhjetëve, të cilët i Dërguari a.s. i ka përgëzuar me Xhennet.

Në kohën e hilafetit të Omerit dhe të Osmanit ishte përgjegjës i Arkës shtetërore në Kufë, pastaj u kthye në Medinë dhe në vitin 32 hixhri vdiq. Është varrosur në Xhennetul bekijj. Kur vdiq, ishte në moshën 60 vjeç.

Vlera dhe pozita e tij në dije

Siç cekëm më lart, Ibni Mes’udi ishte ndër më të dijshmit prej ashabëve për Kur’anin. I Dërguari i Allahut kishte dëshirë të dëgjonte prej tij këndimin e Kur’anit, kështu që një ditë kishte kërkuar nga ai që t’i lexonte diçka nga kaptina *En-Nisa’ë*.

- Si të të lexoj ty, o i Dërguar, kur ty të ka zbritur, - i kishte thënë Ibni Mes’udi.

- *Po, por kam dëshirë ta dëgjoj prej të tjerëve*, - ia ktheu Resulullahu.

Dhe fillova të këndoj, thotë Ibni Mes’udi - derisa arrita tek fjalët e Allahut : “*Dhe si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan), kur Ne do të sjellim dëshmitarë për çdo popull, e ty do të të sjellim si dëshmitar për ata (që nuk besuan) ?*”. (*En-Nisa’ë*, 41), atëherë pashë se të Dërguarit të Allahut iu mbushën sytë me lot.

I Dërguari i Allahut thoshte: “*Kush dëshiron të lexojë (mësojë) Kur’anin ashtu siç është zbritur, le të marrë këndimin nga Ibn Ummu Abdi (d.t.th. Ibni Mes’udi)*”¹⁹

I Dërguari i Allahut për të kishte thënë: “*Abdullah Ibn Mes’udi është më i rëndë në Mizan sesa kodra e Uhudit*”²⁰

¹⁹ “*Et-Tefsir vel Mufessirune*”, vëll. I, fq. 84, Kajro 1985.

Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Merreni Kur’anin prej 4 vetave: prej Abdullah Ibn Mes’udit, Muadh bin Xhebelit, Ubejj bin Ka’bit dhe prej Salimit”*.²¹

Kur Omeri r.a. e dërgoi në Kufë, u shkroi popullit të saj: *“Unë jua dërgova Ammar bin Jasirin udhëheqës, kurse Abdullah Ibn Mes’udin mësues dhe këshilltar. Këta të dy janë më të zgjedhurit prej ashabëve të Pejgamberit a.s., janë pjesëmarrës të luftës së Bedrit dhe kërkoj nga ju që t’i pasoni, t’u bindeni fjalëve dhe këshillave të tyre.”*²²

Dhe Abdullah ibn Mes’udi, sapo arriti në Kufë, filloi të mësonte banorët e saj në shkencën e Hadithit, Tefsirit dhe Fikh. Ishte njëkohësisht edhe gjykatës i tyre dhe themelues i shkollës së mendimit racional për ndonjë çështje juridike, nëse për të nuk ekzistonte tekst i prerë as në Kur’an e as në Synet.

Në kohën e hilafetit të Aliut, kur ky arriti në Kufë, banorët e saj u tubuan rreth tij, ia përmendën disa thënie të Ibni Mes’udit dhe i thanë: *“O i pari i muslimanëve. Nuk kemi parë njeri më të moralshëm, më të butë për këshillim, më të mirë për bashkëbisedues e as më të devotshëm se Ibni Mes’udi.”* Atëherë Aliu u tha: *“Ju përbej në Allahun, a janë këto fjalë që ju burojnë nga zemra”*, Po, - ia kthyen ata. Atëherë Aliu r.a. tha: *“O Allah, dëshmo se edhe unë them ashtu siç thanë këta, madje edhe më shumë”*.²³

Dëshmitë e ashabëve për Ibni Mes’udin janë të shumta dhe është e pamundur të cekën të gjitha, sepse vërtet Abdullahu ishte një det i pafund i dijes rreth Librit të Allahut.

Transmeton Ibën Xherir et Taberiu nga Abdullah bin Mes’udi të ketë thënë: *“Për Zotin, nuk ka ajet në Kur’an që ka zbritur e të mos e di se për kë ka zbritur dhe ku ka zbritur. Dhe, po të dija se dikush është më i dijsëm se unë për Librin e Allahut dhe po të ekzistonte mundësia për të arritur tek ai, do të shkoja pa hezituar”*.²⁴

²⁰ Muhammed bin Ahmed edh-Dhehebi *“Ma’rifetul Kurra’ë el Kibar ala et- Tabekati vel A’ësar”*, vëll. I, fq. 34, Bejrut 1404 h.

²¹ *“Dirasat ve mebahith...”*, fq. 41, (Buhariu 2/307) dhe (Muslimi (16/18)

²² *“Ulumu-t-Tefsir”*, fq. 155-156

²³ *“Et-Tefsir vel Mufessirune”*, vëll. I, fq. 85.

²⁴ Muhammed Abduladhim Ez-Zerkani *“Menahilil Irfan fi Ulumul Kur’an”*, vëll. II, fq. 18. Kajro-Bejrut 1980.

Disa nga komentimet e Ibn Mes'udit në tefsir

Njohuria e Abdullah ibn Mes'udit rreth Librit të Allahut ishte e gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse, për se dëshmojnë edhe vetë ashabët më të mëdhenj, në mesin e tyre edhe Omeri r.a.

Për të parë këtë dituri kaq të madhe që i qe dhuruar Ibn Mes'udit nga ana e Allahut xh.sh., shkurtimisht do të sjellim disa shembuj të komenteve të tij.

Një natë të errët, Omeri r.a. e ndalon një karvan që ia kishte mësy-rë Mekës, pa ditur se në mesin e udhëtarëve ishte edhe Ibn Mes'udi. Ai nëpërmjet këshilltarit të tij ua kishte bërë disa pyetje udhëtarëve të këtij karvani, për të testuar aftësitë e tyre në Islam. Pyetja e parë e Omerit ishte:

- Cili ajet kuranor është më madhështori?

Ibn Mes'udi qe përgjigjur:

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ ...

“Allahu është Një, nuk ka zot tjetër përveç Tij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përvetshëm. Atë nuk e kap as kotje e as gjumë...” deri në fund të ajetit 255 të kaptinës “El-Bekare”.

Pyetja e dytë ishte:

- Cili ajet kuranor është më i përsosuri?

Ibn Mes'udi qe përgjigjur:

إِنَّ اللَّهَ يُأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ
وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ

“Vërtet Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.” (El-Nahl, 90)

Pyetja e tretë e Omerit ishte:

- Cili ajet i Kur'anit është më gjithëpërfshirësi?

Ibn Mes'udi qe përgjigjur:

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ. وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ

“E kush bën ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush bën ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.” (Ez-Zelzele, 7-8)

Pyetja e katërt e Omerit ishte:

- Cili ajet i Kur’anit është më frikësuesi?

Ibn Mes’udi qe përgjigjur:

لَيْسَ بِأَمَانِيكُمْ وَ لَا أَمَانِي أَهْلِ الْكِتَابِ مَنْ يَعْمَلْ سُوءًا يُجْزَى بِهِ
وَلَا يَجِدُ لَهُ مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا

“Nuk është (shpëtim) sipas shpresave tuaja e as sipas shpresave të ithtarëve të Librit. Kushdo që bën keq, do të ndëshkohet me të dhe nuk do të gjejë pos Allahut, as mik e as ndihmës.” (En-Nisa’ë, 123)

Pyetja e pestë e Omerit ishte:

- Cili ajet i Kur’anit është më shpresëdhënësi?

Ndërsa Ibn Mes’udi qe përgjigjur:

قُلْ يَا عِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِن رَّحْمَةِ اللَّهِ
إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ

“Thuaj: O robët e Mi, që e keni ngarkuar veten me shumë gabime, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, sepse vërtet Allahu i fal të gjitha mëkatet. Ai njëmend fal shumë dhe është mëshirues.” (Ez-Zumer, 53)

Këto përgjigje aq të shpejta dhe aq të mprehta zgjuan kureshtjen e Omerit r.a. dhe pa një pa dy iu drejtua delegacionit të karvanit: Në mesin tuaj sigurisht gjendet Abdullah ibn Mes’udi, dhe këtë ata ia pohuan.²⁵

Omeri r.a. nga këto përgjigje kishte kuptuar se ishin përgjigje të një alimi të madh, dhe e diti mirë se ai mund të ishte vetëm Abdullah ibn Mes’udi.

²⁵ Abdurrahman Rafet el Basha “Fragmente nga jeta e sahabëve”, pjesa II, fq. 24-25, Prishtinë, 1996.

Rrugët e transmetimit nga Abdullah Ibn Mes'udi

Abdullah Ibn Mes'udi pas Ibni Abbasit, vjen i dyti në radhë prej ashabëve të Pejgamberit a.s. për transmetimet e tij në tefsir. Nga Ibni Mes'udi ka më shumë transmetime sesa nga Aliu r.a..

Banorët e Kufës patën fatin më të madh të merrnin njohuri prej tij, pasi një kohë të gjatë qëndroi në mesin e tyre. Shumë prej nxënësve të tij përhapën dijen e Ibni Mes'udit anekënd Botës Islame, madje në histori janë të njohur nxënësit e shkollës së Ibni Mes'udit.

Meqenëse transmetimet prej tij në lëmin e tefsirit janë të shumta, është e natyrshme që edhe rrugët e transmetimit deri tek ai të jenë po ashtu të shumta. Disa prej tyre janë të shëndosha dhe besnikërisht të transmetuara, e disa prej tyre janë pak më të dobëta.

Rrugët e pranueshme të transmetimeve nga Ibn Mes'udi:

1. Rruga e transmetimit nëpërmjet Sulejman el A'ëmeshit nga Ebi Duha, ky nga Mesruku e ky nga Ibni Mes'udi. Kjo është rruga më e saktë e transmetimit nga Ibni Mes'udi. Imam Buhariu është mbështetur në të më së shumti në Sahihun e tij.

2. Rruga nëpërmjet Muxhahidit, nga Ebi Muameri e ky nga Ibni Mes'udi, dhe kjo po ashtu është prej rrugëve të pranuar ku nuk ka dobësi. Buhariu është mbështetur po ashtu edhe në këtë rrugë të transmetimit nga ai.

3. Rruga nëpërmjet A'ëmeshit nga Ebi Vaili, e ky nga Ibni Mes'udi. Edhe kjo është një prej rrugëve të shëndosha në transmetim nga Ibni Mes'udi. Buhariu e ka shfrytëzuar edhe këtë rrugë transmetimi nga ai.

4. Rruga e transmetimit nëpërmjet Ismail bin Abdullahut (Es-Suddi el Kebir), ky nga Murre el Hemdani e ky nga Ibni Mes'udi.

Nëpërmjet kësaj vije kanë transmetuar Hakimi në Mustedrekun e tij si dhe Ibn Xherir et Taberiu në tefsirin e tij.

Rrugët jo të preferuara të transmetimit nga Ibn Mes'udi:

1. Rruga e transmetimit që shkon nëpërmjet Ebi Rrevkit nga Dah-haku e ky nga Ibni Mes'udi, nuk është e preferueshme, sepse Dah-haku nuk e ka takuar Ibni Mes'udin, kështu që ka shkëputje në mes

tyre, ani pse Ibni Xheriri transmeton edhe nëpërmjet kësaj vije transmetimi.

Ali ibn Ebi Talib r.a. – (vdiq 40 h.)

Biografi e shkurtër

Ky është Ali ibn Ebi Talib bin Abdul Muttalib. Është njëri prej dhjetë të përgëzuarve me Xhennet, dhe është halifi i katërt prej hulefai rrashidinëve. Është djalë axhe i Pejgamberit a.s.. Njihet edhe me ofiqin “*Ebul Hasen*”.

Islamin e pranoi qysh kur ishte fëmijë, dhe, meqenëse u rrit në shtëpinë e Pejgamberit a.s., ishte shumë e natyrshme që të brumosej me idealet më të larta. Edukimi i tij ishte në frymën e Kur’anit dhe pranë ngrohtësisë së familjes së Pejgamberit a.s.. Mori pjesë në të gjitha betejat që zhvilloi i Dërguari i Allahut përveç asaj të Tebukut, kur Pejgamberi a.s. e la zëvendës të tij në Medinë.

Afërsia farefisnore me të Dërguarin a.s., si dhe edukimi në shtëpinë e tij, i mundësuan Aliut r.a. që të arrinte dituri të madhe, saqë të konsiderohet si një oqean i pafund i dijes, i guximit dhe i trimërisë. Ishte autoritet i pakontestueshëm në nxjerrjen e dispozitave nga Libri i Allahut.

I Dërguari a.s., kur ia besoi punën e kadiut në Jemen, u lut për të me fjalët: “*O Zot, dhuroji urtësi në oratori dhe udhëzoje zemrën e tij*”.

Vlera dhe pozita e tij në dije

I Dërguari i Allahut e donte së tepërmi Aliun r.a., saqë i kishte thënë: “*Ti për mua je sikurse Haruni për Musanë, përveçqë pas meje nuk ka më pejgamber (të dërguar)*”²⁶

Kur Pejgamberi a.s. i vëllazëroi ashabët në mes tyre, i tha atij: “*Ti je vëllai im në këtë botë dhe në Ahiret.*”²⁷

Aliu r.a. ishte njeri i guximshëm dhe luftëtar i paepur e syptrembur. Në ditën e çlirimit të Hajberit, kur të gjithë ashabët po pritnin

²⁶ Muttefekun alejhi; (Buhariu 2/299 dhe Muslimi 15/176).

²⁷ “*Et-Tefsir vel mufessirune*”, vëll. I, fq. 88

pa durim se kujt do t'i jepej flamuri udhëheqës, pasi që Pejgamberi a.s. kishte thënë: “*Flamurin do t'ia jap një njeriu që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij, po edhe Allahu dhe i Dërguari i Tij e duan atë, dhe nëpërmjet duarve të tij Allahu do t'ua mundësojë fitoren muslimanëve*”, dhe të gjithë ashabët po pritnin pa durim se kush do të ishte ky fatlum, kur i Dërguari i Allahut tha: “*Ma thirrni Aliun*”, dhe atij ia dorëzoi flamurin...”²⁸

Allahu xh.sh. i dhuroi Aliut r.a. zgjuarsi të paparë, kështu që vendimi i tij për ndonjë çështje të fesë përherë merrej në konsideratë. Ishte burim i dijes edhe për shumicën e ashabëve të Pejgamberit a.s.

Ja dëshmitë e disa prej tyre për të:

Transmetohet nga Ibni Abbasi të ketë thënë: “*Këto njohuri të tefsirit që i kam për Librin e Allahut, i kam marrë nga Aliu*”.

Rrëfen Abdullah ibn Mes'udi dhe thotë: “*Bisedonim ndërmjet nesh me ashabët dhe përfunduar se gjykuesi më i mirë i çështjeve të fesë në Medinë, është Aliu r.a.*”.

Transmeton Muameri nga Vehbe bin Abdil-lah bin ebi Tufejl të ketë thënë: “*Kam qenë dëshmitar në një ligjëratë të Aliut, kur ai ka thënë: “Për Zotin, nuk ka pyetje që të ma parashtroni, e të mos ju përgjigjem. Më pyetni për Librin e Allahut, se për Zotin nuk ka ajet në Kur'an që ka zbritur e të mos e di se a ka zbritur natën apo ditën, në tokë apo në det.*”²⁹

U vra në Kufë nga dora e havarixhit Abdurrahman bin Melxhem, në vitin 40 pas hixhretit, në moshën 63 vjeç.

Disa nga komentimet e Ali Ibn Ebi Talibit në tefsir

Në lidhje me komentimin e ajetit 67 të kaptinës “*Ez-Zuhruf*”:

الْأَخِلَاءُ يَوْمَئِذٍ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ إِلَّا الْمُتَّقِينَ

“*Atë ditë shokët e ngushtë do të jenë armiq të njëri-tjetrit, përveç atyre që ishin të sinqertë në miqësi*”

²⁸ Muttefekun alejhi; (Buhariu 2/299 kreu mbi biografinë e Aliut r.a.), dhe (Muslimi 15/176, kreu mbi vlerën e Aliut r.a.)

²⁹ “*Dîrasat ve mebahith fi tarihi-t-tefsir ve menahixhi-l-mufessirin*”, fq. 45

transmetohet nga Aliu r.a. të ketë thënë: *“Janë dy besimtarë shokë të ngushtë mes vete dhe dy pabesimtarë po ashtu shokë të ngushtë mes vete. Njëri prej dy shokëve besimtarë vdes dhe përgëzohet me Xhen-net. Ai në ato çaste të përgëzimit e kujton shokun e vet në këtë dunja dhe thotë: O Zot! Vërtet shoku im, filani, më ka urdhëruar (këshilluar) që të të respektoj Ty dhe të Dërguarin Tënd. Më urdhëronte në punë të mira dhe më ndalonte nga të këqijat. Më përkujtonte vazhdimisht se unë do të të takoja Ty. Prandaj, o Allah, mos e humb atë dhe mundësoja ta shohë këtë që mua ma mundësove ta shohë. Jij i kënaqur ndaj tij ashtu siç ishte i kënaqur ndaj meje. Atëherë i thuhet atij: Shko, sepse po ta dije se çfarë mirësish ka ai shok i yti tek Unë, do të gëzoheshe shumë dhe do të qaje pak. Pastaj pas një kohe vdes edhe ai shoku i mirë besimtar që ishte në dunja, dhe Allahu i bashkon shpirtrat e të dyve e u thuhet: Le ta përshëndesë secili prej jush njëri-tjetrit, dhe këta të dy i thonë njëri-tjetrit: Vërtet ishte vëlla, shok dhe mik i mirë!*

Ndërsa kur të vdes njëri prej atyre dy shokëve pabesimtarë dhe i dëftohet se është banor i Xhehennemit, atëherë e kujton shokun e Tij dhe thotë: O Zot, shoku im, filani, më urdhëronte (këshillonte) në mëkate ndaj Teje, dhe ndaj të Dërguarit Tënd. Më urdhëronte në punë të këqija dhe më ndalonte nga punët e mira. Gjithnjë më thoshte se unë nuk do të të takojë Ty. Prandaj o Zot, të lutem mos e udhëzo atë pas meje, derisa t’ia dëftosh atë që mua ma dëftove, dhe të hidhërohesh ndaj tij ashtu siç u hidhërove ndaj meje. Ndërkohë, vdes edhe ai pabesimtari që ende ishte në jetën e dunjasë, dhe Allahu i bashkon shpirtrat e të dyve dhe u thuhet: Tash drejtojuni njëri-tjetrit se çfarë keni për t’i thënë, dhe secili prej tyre i thotë tjetrit. Vërtet ishte vëlla, shok dhe mik i keq”³⁰

Rrugët e transmetimit nga Aliu r.a.

Meqenëse Aliu r.a. ishte njeri me peshë dhe i rëndësishëm, sepse ishte edhe anëtar i familjes profetike, pastaj halife i muslimanëve e në anën tjetër edhe komandant i shquar ushtarak, dhe, mbi të gjitha këto, ishte dëshmitar i zbritjes së Kur’anit në shtëpinë e Pejgamberit a.s.,

³⁰ Dr. Muhammed Abdurrahim “*Tefsiru-s-Sahabeti*”, fq, 17, Kajro 1991

prandaj është shumë e natyrshme që shumë transmetime në tefsir t'i mvishen emrit të tij.

Në anën tjetër, “*Gulatu Shiah*”- Shiinjtë ekstrem, përpiqeshin të përfitonin në emër të tij, dhe për këtë trilluan aq shumë gjëra në llogari të Aliut, saqë dijetarët patën një detyrë mjaft delikate dhe të vështirë të sqaronin rrugët e shëndosha të transmetimeve nga ai.

Kjo ishte arsyeja që dijetarët me të shumtën e rasteve i hodhën poshtë transmetimet nga Aliu, përveç nëse transmetimet ishin nëpërmjet rrugëve të shëndosha nga aspekti i vargut të isnadit deri tek Aliu.

Rrugët e besueshme të transmetimit nga Aliu r.a.

1. Rruga e transmetimit nëpërmjet Hishamit nga Muhammed bin Sirini, ky nga Abide e Selmani e ky nga Aliu.

Nga ky varg transmetuesish ka marrë Buhariu në Sahihun e tij.

2. Rruga nëpërmjet Ibni e bil Husejn, nga Ebi Tufejli e ky nga Aliu.

Edhe kjo rrugë transmetimi është e saktë dhe këtë e ka shfrytëzuar Ibni Ujejne në tefsirin e tij.

3. Rruga nëpërmjet Zuhriut nga Ali Zejnul Abidin, ky nga babai i tij Husejni e ky nga babai i tij Aliu r.a.

Kjo rrugë transmetimi është shumë e saktë dhe e sigurt, por nuk është aq e afirmuar për shkak të trillimeve që i janë mveshur Ali Zejnul Abidinit, sepse ishte pasardhës i Ehli Bejtit dhe shiinjtë e keqpërdorën tej mase emrin e tij duke trilluar gjëra të paqena për Aliun. Kjo ka ndikuar që dijetarët të jenë më të rezervuar kur është fjala për këtë rrugë transmetimi deri tek Aliu r.a.

Ubejj bin Ka’bi r.a. – (vdiq 32 h.)

Biografi e shkurtër

Ky është Ubejj bin Ka’b bin Kajs el Ensarij el Hazrexhij.

Me prejardhje ishte hebre nga Jethribi (Medina e ardhshme) dhe ishte njëri ndër priftërinjtë e hebrenjve të Jethribit. Megjithëkëtë, zemra e tij kurrsesi të prehej në besimin e devijuar nga hebrenjtë, prandaj me net të tëra meditonte si të gjente rrugëdalje nga ky lëmsh i anktheve që e kishin kapluar. Një natë derisa endej rrugëve të Jethri-

bit, fshehurazi dëgjoi një dialog në shtëpinë e Sa'd bin Rrebiut, se një i dërguar i Zotit ishte shfaqur në Mekë dhe thërriste në Islam. Dhe kjo ishte e mjaftueshme që Ubejji menjëherë ta shfaqte Islamin e tij, t'i bashkëngjitej delegacionit të medinasve që të merrte pjesë në Beslidhjen e parë të Akabës, me Resulullahun s.a.v.s. Tashmë kontaktet ishin të vazhdueshme dhe, pas emigrimit të Resulullahut në Medinë, ai ishte si një hije e pandashme e tij. Kjo zaten ishte shkak që ai të ishte shumë i afërt dhe i dashur tek Muhammedi a.s., meqenëse i Dërguari i Allahut kishte parë tek ai zgjuarsinë dhe sinqeritetin e një besimtarit të devotshëm. Ai madje ia besoi të ishte edhe njëri prej shkruesve të Vahjit. Mori pjesë në të gjitha luftërat që zhvilloi i Dërguari i Allahut, në Bedër, Uhud, në luftën e Hendekut, në çlirimin e Mekës etj.

Në lidhje me vitin e vdekjes së tij, ka mospajtime ndër historianët. Disa thonë se ai vdiq në vitin 22 h., por është më i saktë mendimi se ai ka vdekur në vitin 32 h. në kohën e sundimit të Osmanit r.a.. Në lidhje me vdekjen e tij kemi një transmetim nga Ibn Damureh, i cili thotë: “I kam parë banorët e Medinës duke shkuar turma-turma nëpër rrugë, dhe pyeta: Ç’është puna e këtyre njerëzve, nga shkojnë këta? Atëherë njëri më pyeti:

- A nuk je banor i Medinës?

- Jo, - ia ktheva unë, - thotë Ibn Damureh. Atëherë ai person më tha: Sot ka vdekur “*zotëria i muslimanëve, Ubejj bin Ka’bi*”.

Vlera dhe pozita e tij në dije

Pejgamberi a.s. e quajti me ofiqin “*Ebul Mundhir*”, kurse Omeri r.a. me ofiqin “*Ebu Tufejl*”.

Pejgamberi a.s. për të ka thënë: “*Më i miri prej jush në lexim të Kur’anit është Ubejji*”, kurse Omeri r.a. e lavdëroi me fjalët: “*Ubejji është zotëria i muslimanëve*”, sepse ai vërtet ishte zotëri i lexuesve të Kur’anit.

Në hadithin të cilin e kemi përmendur edhe tek Abdullah ibn Mes’udi, i Dërguari i Allahut ka thënë: “*Merreni Kur’anin prej 4 vetave: prej Abdullah Ibn Mes’udit, Salimit, Zejd bin Thabitit dhe Ubejj bin Ka’bit*”.

Një ditë i Dërguari i Allahut iu drejtua Ubejjit me fjalët: “*Allahu më ka urdhëruar që të t a lexoj ty kaptinën “El-Bejjineh” – (Lem je-kuni lledhine keferu min ehilil kitabi hatta te’etihumul bejjineh...)*. Atëherë Ubejji, i emocionuar, i tha: A të ka urdhëruar Allahu xh.sh. që personalisht të ma lexosh mua? Dhe, kur i Dërguari i Allahut ia pohoi një gjë të tillë, ai qau nga gëzimi për këtë nder dhe privilegj të madh.³¹

-Një ditë tjetër, derisa i Dërguari i Allahut ishte duke falur namaz, iu ngatërrua një ajet, dhe pas përfundimit të namazit, iu drejtua Ubejjit: “*A u fale me ne?*” – Po, - ia ktheu Ubejji.

-“*Atëherë ç’të pengoi që të reagoje (me përmirësim)*”, ia ktheu i Dërguari i Allahut.³²

Kjo mbase është dëshmia më e fortë për respektin e madh që gëzonte ky tek Resulullahu s.a.v.s..

- Derisa ishin duke ndenjur në një tubim, i Dërguari i Allahut iu drejtua Ubejjit: “*Cili është ajeti më madhështor në Kur’an, o Ubejj?*” Ky pa hamendje i tha:

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ...

“*Allahu është Një, nuk ka zot tjetër përveç Tij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotje e as gjumë...*” deri në fund të ajetit 255 të kaptinës “*El-Bekare*” (Teshbih dova, shënim yni). Atëherë i Dërguari i Allahut i kënaqur nga një përgjigje e tij, u lut për të dhe tha: “*Ty do të të lehtësohet dituria, o Eba Mundhir*”.³³

Gjatë kohës së hilafetit të Omerit r.a. dhe me propozimin e tij, meqenëse ishte më i dijshti i këtij Ymeti në leximin e Kur’anit, për ç’gjë kishte dëshmuar edhe vetë Pejgamberi a.s., ishte imami i parë që u priu muslimanëve në faljen e namazit të teravive me xhemat.

Ishte po ashtu njohës i thellë i dispozitave të Sheriatit. Transmeto- het nga Sha’biu të ketë thënë: “Prej ashabëve të Pejgamberit a.s., që merreshin me gjykimin e çështjeve, ishin 6 veta: Omeri, Aliu, Abdu-

³¹ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi

³² Transmeton Ebu Davudi

³³ Transmeton Muslimi

Ilah ibn Mes'udi, Ubejj bin Ka'bi, Zejd bin Thabiti dhe Ebi Musa el-Esh'ariu”.

Ubejji, si theksuam më parë, para se të hynte në Islam, ushtronte detyrën e priftit-murgut çifut dhe ishte në dijeni të plotë për përmbajtjen e librave të vjetër, si Tevrat, Inxhili etj.

Njohuritë e mëparshme për librat e mëhershëm i zgjeroi pastaj edhe me njohuritë rreth Kur'anit, kështu që ishte njohës i përpiktë i ajeteve *nasih* dhe *mensuh*, pastaj për shkaqet e zbritjes së ajeteve ose sureve, radhitjen e kaptinave kuranore etj.

Disa nga komentimet e Ubejj bin Ka'bit në tefsir

- Në lidhje me ajetin kuranor:

كَانَ النَّاسُ أُمَّةً وَاحِدَةً فَبَعَثَ اللَّهُ النَّبِيِّنَ مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ
وَأَنْزَلَ مَعَهُمُ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِيَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ فِي مَا اخْتَلَفُوا فِيهِ

“Njerëzit ishin një popull (të fesë së natyrshme islame-fitres) e (kur u përçanë) Allahu dërgoi pejgamberë përgëzues dhe qortues, dhe atyre Ai u zbriti edhe librin me fakte të sakta, për të gjykuar për atë që u kundërshtuan ndërmjet veti...” (El-Bekare, 213)

Ubejji ka thënë: *“I gjithë njerëzimi ishte një Ymet i vetëm kur shpirtrat u paraqitën para Allahut dhe iu bindën vetëm Atij se e njohin për Zot. Mirëpo, pas Ademit a.s., ata u ndanë në shumë grupe dhe shumë prej tyre devijuan nga e vërteta. Kjo ishte arsyeja që Allahu xh.sh. të dërgonte vazhdimisht pejgamberë për t’ua tërhequr atyre vërejtjen.”*

- Në lidhje me ajetin 77 të kaptinës “El-Furkan”:

قُلْ مَا يَعْجَبُ بِكُمْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ

“Thuaj: “Zoti im as nuk do të kujdesej për ju, sikur të mos ishte lutja juaj (kur gjendeni në vështirësi...)”. Ubejji ka thënë (komentuar): *“Kjo është lufta në Ditën e Bedrit.”*

Ndërsa në lidhje me komentimin e ajetit 164 të kaptinës “El-Bekare”

وَتَصْرِيفِ الرِّيَاحِ

“... në qarkullimin e erërave...”.

transmetohet nga Ubejji të ketë thënë: “Sa herë që është përdorur fjala “**Err-Rrijah**” në Kur’an, nënkupton mëshirën, kurse sa herë që është përdorur “**Err-Rrihu**” nënkupton ndëshkimin.”³⁴

Rrugët e besueshme të transmetimit nga Ubejj bin Ka’bi

Sikur edhe tek tre të parët, po ashtu edhe emrit të Ubejjit iu mveshën shumë transmetime të paqena në tefsir, kështu që dijetarët me anë të hulumtimeve serioze, disa prej këtyre rrugëve të transmetimit i konstatuan si të shëndosha dhe të besueshme.

1. Rruga e transmetimit nëpërmjet Ebi Xha’fer err-Rraziut nga Rrebi’ë bin Enesi, ky nga Ebu Alijete e ky nga Ubejj bin Ka’bi.

Kjo rrugë është shumë e saktë në vargun e transmetuesve, dhe e kanë shfrytëzuar Hakimi në Mustedrekun e tij si dhe imam Ahmed ibn Hanbeli në Musnedin e tij. Shumë prej transmetimeve të tij, janë nxjerrë mu nga kjo rrugë.

2. Rruga e transmetimit nëpërmjet Vekiut nga Sufjani, ky nga Abdullah bin Muhammed bin Akili, ky nga Tufejl bin Ubejji e ky nga babai i tij Ubejj bin Ka’bi.

Këtë rrugë e ka shfrytëzuar po ashtu Imam Ahmed ibn Hanbeli në Musnedin e tij, ani pse për njërin prej transmetuesve në këtë varg, më saktësisht për Abdullah bin Muhamed bin Akilin, fliten disa fjalë për saktësinë e hifzit (memories) së tij, edhe pse nga dijetarët konsiderohet si i besueshëm.

Këta janë 4 nga ashabët më të njohur për rivajete nga tefsiri, megjithëse edhe të tjerët kanë transmetime, por më të pakta.

Nuk mund të mos përmenden me këtë rast emrat e Enes bin Malikut, Abdullah ibn Omerit, Ebu Hurejres, Xhabir bin Abdullahut, Abdullah bin Amr ibnul Asit, Muadh bin Xhebelit, Aishes r.a. etj., të cilët kanë po ashtu disa transmetime shumë të vlefshme në lëmin e tefsirit.

³⁴ “Tefsiru-s-Sahabeti”, fq, 19.

Nexhat Ibrahim

PLANPROGRAMI I PËRGJITHSHËM PËR PËRHAPJEN E MËSIMIT ISLAM

Hyrje

Maksima e njohur e Pejgamberit a.s. “*Transmetoni prej meje qoftë edhe një ajet*” prej kohësh ka preokupuar shumë dijetarë muslimanë. Janë shkruar vepra të shumta për këtë qëllim. Në kohën bashkëkohore maksima e cituar, pos individëve, preokupon edhe institucione të shumta muslimane. Mirëpo, gjatë historisë është krijuar konfuzion didaktik i llojit të vet, meqë teksti i cekur është perceptuar dhe konceptuar parcialisht, mekanikisht e tautologjikisht, që solli ‘*monotoninë informatike*’. ...

Ku shihet rrugëdalja!?!

1. Mësimi islam në shkolla - planprogrami i mësim-besimit dhe i kulturës së religjioneve

Historia e *mësim-besimit* në trojet shqiptare është e lashtë (N. Ibrahim, Islami dhe muslimanët në Ballkanin dhe tokat shqiptare mesjetare, etj.). Kurse, në shekullin XX mësim-besimi u bë aktiv me largimin e Perandorisë Osmane nga Ballkani, pas vitit 1912. Në atë kohë mësim-besimi u përgjigjej nevojave dhe kërkesave të kohës,

andaj edhe sot qasja duhet të jetë ekuivalente me nevojat dhe kërkesat e kohës. Për këtë arsye është e domosdoshme që çdo kohë t'i përkufizojë:

- **synimet e mësim-besimit** (mësimi, aftësimi dhe arsimimi fetar..),
- **programin e mësim-besimit** (t'i jepet rëndësi traditës didaktike apo kurrikulumit),
- **burimet, mënyrat, format e prezantimit të përmbajtjes së mësim-besimit** (më herët praktikoheshin kryesisht burimet direkte, kurse sot më shumë burimet indirekte, mediale),
- **situatën e gjendjes aktuale** (cilësinë dhe sasinë e mësim, mundësitë tekniko-ekonomike të formimit të shkathtësive, kushtet natyrore-sociologjike të kultivimit dhe zhvillimit të aftësive).

a. Zvogëlimi i vëllimit të planprogramit mësimor të mësim-besimit

Planprogrami aktual, pa farë dyshimi, është larg planprogramit ideal, andaj transformimi i tij në cilësi dhe sasi, është domosdoshmëri. Gjendja e tanishme jo vetëm që është barrë psiko-fizike për nxënësit, por nga viti në vit po kalon në një sindrom aversioni, anakronizmi, varësisht nga diktati politiko-social dhe arsimor-shkencor. Në këtë situatë rrugëdaljen e shohim në zvogëlimin sasior të vëllimit të planprogramit arsimor. Ky zvogëlim nuk duhet të bëhet *ad-hoc*, po të inkorporohet me aspektet e tjera të prezantimit të mësimit islam, gjithnjë duke mbajtur parasysh trekëndëshin: *shkolla – mektebi – mediumet*. Të gjitha këto, nëse mësim-besimin e marrim si çështje që do të futet në sistemin arsimor në Kosovë.

Konsiderojmë se në bankat shkollore do të duhej të shtroheshin çështjet që mund të shpjegohen burimisht dhe racionalisht, duke përdorur metodat verbale, vizuale dhe praktike, duke eliminuar përsëritjet dhe monotoninë. Rituatet islame do të mësoheshin si tërësi, kurse Islami do të kuptohej edhe si *shkollë* edhe si *xhami*. Mediumet do të merreshin më tepër me prezantimin e personaliteteve historike dikur dhe sot, dhe të arriturave kulturo-historike dikur dhe sot.

b. Motivimi i zhvillimit më të madh të intelektit dhe kultivimi i origjinalitetit tek nxënësi

Përmbajtja e mësim-besimit, ku motivohet dhe zhvillohet intelekti dhe kultivohet puna origjinale, krahas shkarkimit esencial mental të nxënësit, do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin intelektual të tij. Sidomos janë të rëndësishme:

- metodat e mendimtarëve klasikë muslimanë
- të El-Gazaliut, Zernuxhit, Ibn Maskujes etj.. por edhe të Gulifordit, I. Maltzmanit etj.:
- futja e situatës jo të rëndomtë si stimulim për të cilën nuk vlejné metodat jo të rëndomta;
- nxitja e përgjigjeve të ndryshme në të njëjtën situatë;
- nxitja e përgjigjeve jo të rëndomta si përgjigje tekstuale.

Aplikimi i metodës së këtyllë kërkon kohë, prandaj nuk mund të realizohet pa reduktimin sasior të planprogramit mësimor. Po ashtu, kjo metodë do të eliminonte monotoninë dhe do ta afronte nxënësin në jetësimin e islamit real.

c. Mbi ligjëruesit e mësim-besimit

Problemi i kuadrit të mësim-besimit është shumë i madh. Realizimin e mësim-besimit do të duhej ta bënte kuadri me kualifikime universitare islame - drejtimi pedagogjik. Mirëpo, praktika dhe realiteti kosovar, po edhe përreth, do të dëshmojë se planprogramin e mësim-besimit do ta realizojnë imamët me kualifikime të mesme të cilësisë gjithfare.

Sipas mendimit tonë, zbatimin e mësim-besimit nëpër shkolla të mesme do të duhej ta realizonin mësuesit me fakultet, kurse nëpër shkolla fillore, në mungesë të shkollave të larta islame (akademive dyvjeçare islame), atë do ta bënin po ata me fakultet dhe, vetëm në raste të rralla, nxënësit e diplomuar të medreseve, me certifikata dhe trajtime të veçanta se janë të aftë ta kryejnë këtë punë, ose studentët e aftë pas përfundimit të vitit të dytë të studimeve.

ç) Kontraverset rreth futjes së lëndës “mësim-besimi” nëpër shkolla?!

Nuk do ta shtrojmë pyetjen se a do të futet mësim-besimi nëpër shkolla, por kur do të futet, si do të quhej lënda fetare (mësim-besim, kultura fetare, kultura e religjioneve etj.), kush do ta hartojë planprogramin, kush do ta caktojë kuadrin arsimor për këtë lëndë, - kjo është tema kontraverse me shumë dilema, tani për tani ende jashtë bisedave zyrtare. Për këtë çështje Bashkësia Islame do të duhej të përgatitej mirë si në aspektin e brendshëm, ashtu edhe të jashtëm, politik, medial etj..

d) Përmbajtja e lëndës së “mësim-besimit”

Lënda që do të ligjërohej, duhet të jetë në raport me vetveten dhe me të tjerat. Me vetveten do të praktikohet një qasje teorike teologjike me theks polemik ndaj të tjerëve, ku nënkuptohet toleranca, mirëkuptimi dhe ekumeniteti. D.m.th. prezantimi i Islamit para të tjerëve dhe i të tjerëve para muslimanëve.

2. Mësimi islam në mektebe

Pjesëmarrja e nxënësve në mësim-besim në mektebe është jo e kënaqshme. Kjo është manifestim i pranisë së vogël të besimtarëve nëpër xhami. Si të afrohen, si të tërhiqen dhe si të mbahen besimtarët nëpër xhami është çështje që meriton shumë kujdes, por duhet theksuar se planprogrami i mektebit duhet të revidohet dhe të ndërrohet.

a. Mësimi i praktikës së jetës islame dhe domosdoshmëria e themelimit të Institutit pëdagogjik të Bashkësisë Islame

Tashmë kemi theksuar se nëpër shkolla duhet të mësohet teoria islame. Në mësim-besim, ndërkaq, duhet mësuar jeta praktike islame, do të thotë të gjitha çështjet, që për arsye objektive janë lëshuar nëpër shkolla, duhen plotësuar në mësim-besim (si p.sh. shkrim-leximi arabisht nga sufara, kiraeti i Kur'anit, texhvidi, kryerja e namazit, e abdestit e kështu me radhë). Nëse planprogrami i mësim-besimit në mektebe do të harmonizohet me atë në shkolla dhe medime, s' do të ketë nevojë për shumë orë në mekteb. Koha tjetër do të duhej shfrytëzuar për të krijuar atmosferë tërheqëse për kandidatët e tjerë potencialë.

Për këtë qëllim, Bashkësia Islame do të duhej të mendonte seriozisht për formimin e një Instituti Islam e në kuadër të tij të një Instituti pedagogjik islam, në kuadër të Bashkësisë Islame. Kështu është edhe çështja e sigurimit të mjeteve financiare, por për këtë çështje duhet të angazhohen ekspertë financiarë, të cilët sigurisht do të angazhoheshin për gjetjen e mënyrave për mbarëvajtjen e punëve.

b. Inicimi i mektebit për të rritur

Hapja e mësim-besimit nëpër mektebe për të rritur është domosdoshmëri e kohës. Të gjithë ata që nuk kanë mësuar për Islamin më herët, e kanë dëshirë ta bëjnë këtë tani (mosha prej 15 vjeç e deri në pleqëri), këtë do të mund ta bënin në objekte të veçanta me plan-program të veçantë. Nocioni ‘i veçantë’ nënkupton hapësirën jashtë mektebit, sepse shumë njerëz, për shkak se nuk dinë gjë për Islamin, ‘turpërohen’. Po ashtu, disa prej tyre mektebin mund ta shohin si joadekuat për ‘pjekurinë’ e tyre. Ky është realiteti, prandaj duhen bërë përpjekje për kapërcimin e këtij problemi. Duhet vepruar njësoj siç po veprojnë me kurset e mësimi të gjuhës angleze, me kursit e kompjuterëve, me trajnime të ndryshme etj. Qasja ndaj të rriturve duhet të dallojë nga qasja ndaj të vegjëlve.

c. Vendet e veçanta për mësimin e islamit për të rritur

Procesi i mësimi të të rriturve do të zhvillohej në tri shkallë:

- *Shkalla fillestare* do të zhvillohej në ndonjë ambient jashtë Bashkësisë Islame (si p.sh. në Prishtinë: Instituti Albanologjik, i Historisë, Biblioteka Kombëtare apo edhe në ambiente të tjera të këtij lloji etj., me lejen e tyre);
- *Shkalla e mesme* do të zhvillohej në ambiente të medresesë, të Fakultetit të Studimeve Islame, ose në amfiteatrin e Bashkësisë Islame (nëse ekziston). Ambienti është i afërt me xhaminë, kurse vijuesit do të ambientoheshin me traditën shpirtërore-materiale islame, me traditën islame, do të njiheshin edhe me pikat konstruktive të tesa-wufit, shiizmit, selefizmit / vehabizmit dhe me traditën vendore;
- *Shkalla e lartë* do të zhvillohej nëpër xhami, ku vijuesit do të ambientoheshin tërësisht me Islamin dhe vlerat e tij

ç) **Kuadri për mësimin e të rriturve**

Kuadri do të ndahej në dy tërësi: drejtoria dhe arsimtarët. Drejtorinë do ta udhëhiqnin pedagogët me përgatitje të lartë dhe me përvojë, të cilët do t'i caktonte Instituti Pedagogjik Islam i Bashkësisë Islame. Arsimtarë do të ishin studentët e viteve III e IV të Fakultetit të Studimeve Islame, studentë të diplomuar të Akademisë pedagogjike dyvjeçare, nëse do të hapeshin, dhe s'prish punë, edhe profesorë të diplomuar. Këta studentë do t'i caktonte një Komision i Bashkësisë Islame apo fakulteti dhe kjo do të ishte edhe praktika e tyre, por edhe stimulimi material shumë i nevojshëm. Në këtë proces bën të inkuadrohen edhe profesorë të diplomuar të paangazhuar.

3. Mësimi islam në medime

Mediumet janë mjet me rëndësi të madhe në përhapjen e idesë. Me zhvillimin e teknologjisë u krijuan disa lloje mediumesh. Momentalisht televizioni dhe gazeta janë mjetet më ndikuese. Sa i përket radios dhe internetit, ato nuk e kanë fuqinë e TV-së; e para, sepse dëgjohet pak, dhe e dyta, sepse tek ne ende nuk ka rrjet të gjerë dhe eksploatim të madh të internetit.

a. Mediumet botuese

1. Prezantimi i Islamit në pajtim me doktrinën redaktuese të shkollës së mendimit që ndjek revista, çon në kufizimin e revistës tek disa persona e në pajtim me këtë, edhe në pak lexues. Ekskluziviteti doktrinar dhe grupimi ideor pamundëson lexuesin të fitojë një pasqyrë reale për Islamin.

2. Mungesa e teksteve bashkëkohore cilësore, po edhe origjinale, ka bërë që të shkaktojë indiferencë tek lexuesi.

3. Mungesa e mjeteve materialo-teknike po edhe joprofesionaliteti i autorëve, gazetarëve dhe redaktorëve.

Këto dhe mangësi të tjera, tek lexuesi krijojnë 'vakum informativo-edukues' që ndikon me të madhe në gjendjen e përgjithshme të besimtarëve.

b. Radio dhe televizioni

Të gjitha shpresat se në Kosovë do të kemi RTV me interes të mirëfilltë për popullin, po zbehen dhe po treten. Qendrat e ndikimit drejtpërdrejt apo nëpërmjet satelitëve vendorë, po hapin RTV për qëllimet e tyre ideologjike dhe komerciale. Islami si fe, besim dhe traditë shumëshekullore, në to nuk është i pranishëm. Për të flitet nga këndi i terrorizmit, jotolerancës, thjesht nga këndi i politikës së imponuar ditore, respektivisht Islami në to prezantohet me konotacion negativ.

b. Web-i

Web prezantimi i Islamit në gjuhën shqipe është tejet i vogël dhe tejet joprofesionalist. Edhe web-i ndjek rrugën e publikimeve, d.m.th. ndjek rrugën e donatorit, duke krijuar rrëmujë doktrinare me qasjet e tyre kundër vlerave vendore islame.

Po ashtu, web-i kërkon aftësi, koncizitet, qartësi, shpejtësi, fluksion të ideve, dinamikë, masivitet, çiltëri etj. Disa gabime që ndodhin në mediumet e shkruara, këtu nuk bën të ndodhin.

Në anën tjetër, interneti në Kosovë ende është luks, sepse ekzistojnë disa klube, Caffe-internete me çmime të larta edhe për shtresën e lartë. Rrjeti i lirë ende nuk ekziston, prandaj populli nuk ka para dhe nuk është i arsimuar të eksploatojë e të plasojë materiale të nevojshme.

ç. Përmbajtja e përhapjes së mësimit islam nëpërmjet mediumeve

Për prezantimin e përmbajtjes së mësimit islam në medime duhet të formohet një organ koordinativ-këshillues, i cili të përcaktonte përmbajtjen, prioritetin dhe distribuimin e përmbajtjes. Gazetarët do të aftësoheshin në kurse mbi bazat e zhurnalistikës dhe të pedagogjisë së mediumeve. Ky organ do të ndihmonte të gjitha mediumet islame me materiale, këshilla etj. Në këtë përmbajtje do të gjenin vend: historia islame e botës dhe ajo islame vendore, kultura dhe qytetërimi islam, lajmet mbi gjendjen, problemet, kërkesat dhe nevojat e muslimanëve në gjithë botën. Kjo do të realizohej me emisione të tipit popullarizues: kuize, seri popullarizuese, lojëra me shpërblime të lejuara, filma dokumentarë dhe artistikë etj.

Fjala përfundimtare

Në sendërtimin e projekteve të theksuara më herët, duhet të inkua-drohen të gjithë: teologët, juristët, ekonomistët. Studimet pasuniversi-tare duhet të orientohen në të gjitha drejtimet me prioritet: teologji, ekonomi, jurisprudencë, kulturë, histori, filozofi etj. Disa kushte ekzistojnë: objektet e medreseve, të këshillave të BI-së, por edhe ato shoqërore. Kemi edhe një pjesë të kuadrit. Pra, të fillojmë të mendoj-më për të ardhmen duke bashkërenditur mendimet dhe veprimet.

(P.S. Bazë për këtë shkrim është teksti i botuar në revistën boshnjake
“Novi Mual-lim”, nr. 9/2002)

Muhidin Ahmeti

EDUKIMI DHE ARSIMIMI NË ISLAM

Koncepti mbi edukatën

Të flasësh për edukimin, do të thotë të gjendesh përballë kuptimeve të ndryshme, pasi vetë fjala "edukim" është shumëkuptimëshe. Kjo do të thotë që të ndodhesh në rrafshin e synimeve, në fushën e veprimit në atë të kushteve për të realizuar këtë veprim, ose në rrafshin e efekteve dhe produkteve të këtij veprimi.

Në edukim qëllimet janë pakufishëm të ndryshme sipas kohës dhe vendit, varësisht nga idealet që dëshirohet të arrihen. Në qytetet e Greqisë dhe të Romës qëllimi i edukimit ishte stërvitja e individit që t'i nënshtrohej verbërisht kolektivit, që të bëhej rob i shoqërisë. Në Athinë donin të formonin një shpirt kultivues, që ishte i informuar, i butë, i matur dhe në harmoni, i aftë për t'u kënaqur me bukurinë e mendimit të pastër; në Romë, dëshironin që fëmijët e tyre të bëheshin mbi të gjitha njerëz të aksionit, të përkushtuar ndaj lavdisë ushtarake, indiferentë ndaj literaturës dhe artit. Në Evropën mesjetare edukimi ishte ekskluzivisht i krishterë; me paraqitjen e Renesansës në Evropë, favorizohen vlerat e shekullarizmit si përgjigje ndaj edukimit ekskluziv kishtar; sot shkenca përpiqet ta zërë në edukim vendin që dikur formalisht i takonte artit. Kanti theksonte që "qëllimi i edukimit është të zhvillojë tek çdo individ përkryerjen e plotë që mund të arrijë.

"Xhejms (James) Mill prej edukimit pret "që nga individi të bëjë një instrument lumturie për veten dhe për bashkëpatriotët e tij." Xhon Stjuart (John Stuart Mill) në edukim përfshin: "çdo gjë që e bëjmë ne vetë dhe çdo gjë që e bëjnë të tjerët për ne me qëllim që të na afrojnë tek perkryerja e natyrës sonë". Në kuptimin më të gjerë të pranuar, edukimi përfshin, madje edhe ndikimet indirekte në karakterin dhe aftësitë e njeriut, të shkaktuara nga gjërat që kanë ndonjë qëllim krejtësisht tjetër: nga e drejta, forma e sundimit, arti industrial, e madje edhe nga dukuritë natyrore të pavarura nga vullneti i njeriut, sikur janë klima, trualli dhe ambienti".

Nga sa u tha më lart, kuptojmë se "edukimi është një proces i gjërë i formimit tërësor të personalitetit të njeriut, i zhvillimit të tij gjatë gjithë jetës. Një formim dhe zhvillim i tillë përcaktohet nga një tërësi e ndërlikuar faktorësh shoqërorë, objektivë dhe subjektivë, të trashëguar e të organizuar, që nga mjedisi shoqëror në nivelet e tij të mëdha e të vogla, edukata e organizuar si dhe vetë praktika vetjake e kolektive e jetës së njeriut.

Edukimi është një veprimtari e organizuar, e vetëdijshme, për të ndikuar mbi njerëzit, sidomos mbi brezat e rinj, për t'i formuar ata sipas një synimi të caktuar.

Duke u marrë me këtë problem, ndeshim nocionin e edukimit, edukatën. Si rregull në teori dhe në praktikë, ato përdoren si nocione të barasvlefshme. Megjithatë ndodh që të përdoren edhe me ndonjë ngjyrim të veçantë.

Në kuptimin e ngushtë, fjala "edukatë" përdoret edhe në kuptimin "mirësjellje, njeri me edukatë, njeri i edukuar", ose në të kundërtën, "njeri i paedukatë", etj. Pra, nocionet "edukim" dhe "edukatë" përdoren edhe në vështrime të ndryshme, si në atë antropologjik, kur edukimi barazohet me formimin e personalitetit, i cili si faktor krijimi ka trashëgiminë, mjedisin, praktikën; në vështrimin sociologjik, kur edukimi shihet si funksion i institucioneve të shumta të shoqërisë, si vështrim pedagogjik, në veprimtarinë e shkollës, të mësuesve, të teksteve, të vetë nxënësve.

Profesor Gatston Mialaret sjell dy përkufizime tepër të ndryshme që lidhen me veprimin që përbën tërë edukimin, atë të Durkheimit dhe atë të Ligës Ndërkombëtare për edukimin e Ri (LIEN).

Durkheim: "Edukimi është veprimi që kryhet nga brezat e rritur ndaj atyre që nuk janë pjekur ende për jetën shoqërore. Ai ka për objekt të shkaktojë tek fëmija një numër gjendjesh fizike, intelektuale e morale në përputhje me kërkesat e shoqërisë në përgjithësi dhe të mjedisit shoqëror në të cilin bën pjesë."

LIEN: "Edukimi konsiston në favorizimin e zhvillimit sa më të plotë të sjelljeve tek çdo njeri, njëherësh si qenie individuale dhe si pjesëtar i një shoqërie ku mbretëron solidariteti. Edukimi është i pandashëm nga zhvillimi shoqëror, ai përbën një nga forcat përcaktuese të këtij zhvillimi.

Qëllimi i edukimit dhe metodat e tij duhet të rishikohen vazhdimisht në përputhje me masën që shkenca dhe përvoja rrisin njohjen tonë për fëmijën, për njeriun dhe për shoqërinë."

Në përgjithësi, qëllimi kryesor i edukimit qëndron në transmetimin e përvojave të mëhershme fetare dhe kulturore, shkencore dhe civilizuese të njerëzimit tek brezat e rinj. Në këtë mënyrë krijohet një kontinuitet midis gjeneratash duke transmetuar përvojat e mëhershme të dijes, shkathtësive e shprehive, si dhe përvojat fetare, morale, filozofike, ideologjike dhe pikëpamjet e tjera tek brezat e rinj. Ky transmetim i përvojave është i domosdoshëm për zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë njerëzore. Përndryshe do të duhej çdo individ a gjeneratë të fillonte nga zeroja.

Koncepti fetar mbi edukatën

Edukimi është pjesë përbërëse e jetës. Për aq sa një shoqëri i kush-ton rëndësi edukimit, po aq ajo respekton dinjitetin e personalitetit njerëzor. Nga edukimi varet e ardhmja e individit, e ardhmja e çdo bashkësie shoqërore a fetare, por edhe e tërë njerëzimit. Prandaj, është e qartë që edukimit i duhet kushtuar shumë më tepër rëndësi në çdo bashkësi familjare dhe në përgjithësi në çdo bashkësi njerëzore. Çdo gjë e thënë mbi edukimin në përgjithësi, me siguri vlen edhe për edukimin fetar, sepse ai i jep qetësi qenies njerëzore, ngjall tek ajo vlera dhe realitete të reja. Jeta praktike e edukatorit, sipas parimeve fetare, është më bindëse dhe më e pranuar për brezat e rinj sesa ligjerimet teorie.

Nga mënyra e interpretimit të njeriut dhe nga konceptimi i rolit të tij në botë, përkatësisht nga përcaktimi i tij kozmik, përkufizohen edhe modelet e edukimit. Nga ndryshimet e të kuptuarit të këtyre aspekteve, janë përkufizuar dy modele themelore të praktikës edukative:

1. modeli shoqëror, ose më saktë, modeli me qendrën shoqëror,
2. modeli personal, përkatësisht modeli me qendrën tek personaliteti.

S'ka dyshim se modeli i parë, historikisht është zbatuar në një shkallë shumë më të gjerë. Qëllimet e tij janë që të krijojë (të arsimojë, të formojë, të edukojë) para së gjithash anëtarin e një bashkësie të caktuar, d.m.th. të prodhojë qytetarë në masë, si një lloj instrumenti për realizimin e planeve vetjake, shoqërore, shtetërore. Horizonti i trajtimit të këtyre është reduktuar në suazat e programit politik dhe shablloneve ideologjike të mjedisit konkret social. Raporti i njeriut ndaj fatit vetjak, obligimi i tij ndaj Krijuesit, janë marginalizuar, shpesh edhe janë injoruar krejtësisht.

Qëllimet e koncepteve edukative të përkufizuara në këtë mënyrë, kuptohet nuk mund të bashkëjetojnë njëkohësisht në të njëjtën shoqëri, përkundrazi, orientimi i tyre divergjent i konfronton ato si paradigma parimisht konfliktuale.

Të krijosh, d.m.th. të arsimosh, të edukosh qytetarin e mirë, si detyrë themelore e procesit edukativ shoqërisht të centralizuar, do të thotë ta formosh atë në pajtim me planet e drejtpërdrejta të shoqërisë dhe me sistemin e themeluar mbi premisat ideologjike dhe vlerat sociale.

T'i udhëzosh njerëzit për obligimin e tyre që të arrijnë lumturinë dhe aspektin shpirtëror vetjak, të arrijnë ekuilibrin, paqen; t'i mësosh që të jetojnë në këtë botë me një jetë të plotë, të ndershme dhe të denjë, në mënyrë që shpirtërisht të përgatiten për botën e përtejme, -ja kjo është detyra e procesit edukativ me qendrën tek personaliteti. Udhëzimi për formimin, edukimin e njeriut të mirë, ky është, pra qëllimi i modelit të dytë të edukimit.

Qytetari është funksion i vlerësimit shoqëror; njeriu është projekt i strukturës pereniale të botës. Qytetari është instrument - njeriu është bartës i kuptimit. Qytetari - është më pak se njeri; njeriu - është më tepër se qytetar. Të jesh qytetar, nuk është kusht i mjaftueshëm për të

qenë njeri - të jesh njeri është kusht edhe i mjaftueshëm edhe i domosdoshëm për të justifikuar qëllimin më të lartë të çdo gjëje të krijuar: të lavdërohet Krijuesi!

Kuptimi i edukimit të njeriut varet nga kuptimi i jetës së njeriut, e kuptimi i jetës së njeriut varet nga themelet mbi të cilat mbështetet dhe nga qëllimet finale drejt të cilave ai synon.

Edukimi dhe mësimi fetar bën pjesë në modelin e dytë të edukimit që për qëllim ka të ndihmojë çdo njeri, në mënyrë të veçantë çdo të ri "që të mund të jetojë me kuptim, e për këtë atij i duhet një orientues dhe një komentues i jetës". Kjo pikërisht e bën atë njeri që nga jeta e vet të bëjë diçka. Dhe ajo që ai duhet ta bëjë, është të planifikojë, të formojë dhe të organizojë jetën e vet. Jeta bëhet e kuptimshme, nëse me kuptim planifikohet, zhvillohet dhe komentohet. Bëhet e kuptimshme nëse ka botëkuptim të kuptimshëm jetësor. Me botëkuptimin jetësor mendohen të gjitha ato dije të urta që janë të rëndësishme për jetën, të cilat na ndihmojnë të jetojmë me kuptim dhe tërë jetën ta frymëzojmë me atë.

Duke shqyrtuar nga pikëpamja islame, detyra e edukimit fetar është që me metoda të përshtatshme të mësimin si dhe me shembullin personal të mësuesit, të bëhen përpjekje për formimin e personalitetit etik dhe fetar shembullor. Qëllimi tokësor i edukimit është formimi i njeriut të harmonizuar me vetveten, me njerëzit e tjerë dhe me Zotin. Qëllimi i tij i asaj bote është të fituarit e kënaqësisë së Zotit, përkatësisht hyrja në atë gjendje që në leksikun fetar quhet "shpëtimi i shpirtit". Nga kjo kuptojmë se edukimin islam duhet t'ua besojmë edukatorëve muslimanë, të cilët e jetojnë dhe e përjetojnë Islamin.

Koncepti i edukatës në Islam

Po të vështrojmë aspektin gjuhësor të fjalës *et-terbijeh*, do të shohim që rrënja e kësaj fjale në gjuhën arabe reba, jerbu, do të thotë, rris, zhvilloj, rebije - jerba - kultivoj, zhvilloj dhe rabb - jerubbu do të thotë rris në kuptimin "përmirësoj diçka", kujdesem për diçkan, drejtoj dhe mbikëqyr diçka".

Disa dijetarë në bazë të këtyre kuptimeve gjuhësore, nxorën përkufizimin e pedagogjisë. Kështu Bejdaviu (vdiq më 586 h.) thotë: "Err-Rabb në themel ka kuptimin e edukimit (et-terbijeh), e kjo do të

thotë ta shpjerë dikë, pak nga pak tek përsosmëria e tij. Pastaj kjo fjalë mori një kuptim më intensiv (mubalaga) si cilësi e All-llahut (xh.sh.)”.

Ragib Asfahani (vdiq më 502 h.) edukimin e përkufizon kështu: "Err-Rrabb në esencë ka kuptimin e edukimit, që është të shpënët e një gjëje nga një gjendje në tjetrën derisa të arrijë shkallën e plotsh-mërisë".

Nga këto dy përkufizime shohim se pedagogjia është mënyra dhe rruga që e shpie njeriun drejt përsosmërisë së tij. Mirëpo, ajo nuk është arritje e përsosmërisë, sepse ajo i takon vetëm All-llahut të lartësuar, e sukcesi i edukimit matet me masën sa i është afruar asaj përsosmërie.*

Ndërsa një prej përkufizimeve të mundshme të pedagogjisë islame, do të ishte si vijon:

"Pedagogjia islame është formimi dhe krijimi i personalitetit të plotë të njeriut musliman, përkatësisht formimi i të gjitha aspekteve të personalitetit të tij: të shëndetit, mendjes, bindjes, shpirtit, etikës, vullnetit dhe kreativitetit nëpër të gjitha periudhat e zhvillimit të tij në dritën e parimeve dhe vlerave që i solli Islami dhe në dritën e metodeve e mjeteve pedagogjike që i përcaktoi ai."

Mirëpo, me këtë nuk shteron trajtimi i plotë i konceptit të edukatës në Islam, sepse në doktrinën islame koncepti është i pandashëm prej teksteve ligjvënëse, vlerave etike dhe ideve e mendimeve pozitive botërore. Prandaj, çështja e konceptit islam mbi edukatën është e lidhur ngushtë me botëkuptimin islam mbi njeriun, universin dhe jetën.

Duke marrë parasysh se Shpallja islame është vendosur në kontinuitet shpirtëror të shpalljeve të mëparshme dhe meqë sjell porosinë e tyre monoteiste universale, por në kushte dhe forma të reja, ajo përfshin tërësinë e botës e të njeriut. Prandaj, në të do të hasim patjetër nocione që janë thelbësore për atë tërësi, sikurse: Zoti, gjithësia, jeta, shpirti, njeriu etj. Së këndejmi, Kur'ani, si Fjala e fundit e All-llahut (xh.sh.) për njerëzimin, do të frymëzojë një vizion thelbësisht të ri e burimor të Zotit, botës, jetës dhe njeriut. Karakteristikë e rëndësishme e këtij vizioni është fakti që të gjitha këto ai i koncepton si një tërësi harmonike dhe e pandashme. Në terminologjinë kuranore ky quhet

parimi i tewhidit, që do të thotë mësimi dhe besimi se All-llahu është një Zot i vetëm dhe në pajtim me këtë që Zoti, bota, jeta dhe njeriu përbëjnë një tërësi koherente në kuptimin: një Burim i madh manifestimesh i një qenësie dhe një caku.

Ky edukim është i veçantë, sepse, në dallim nga të tjerët, karakterizohet nga gjerësia dhe universaliteti si i qëllimeve, ashtu edhe i mjeteve. Ai nuk lejon që njeriu të shpërmdajë e të humbë energjinë nga mjetet e shumëllojta prej të cilave secili ka qëllimin e vet të veçantë. Islami ka vetëm një rrugë, atë kuranore, ku bashkohen edhe mjetet edhe qëllimet. Ai përfshin të gjitha aspektet e ekzistencës njerëzore, që dëshiron t'i bashkojë në një dhe nga ai të bëjë një personalitet të kompletuar. Qëllimi dhe synimi i tij themelor është zhvillimi i drejtë i trupit, mendjes dhe shpirtit, krijimi i një harmonie ekuilibruese në mes tyre. Një personalitet i formuar dhe i zhvilluar në këtë mënyrë do të gjejë prehjen dhe qetësinë në kontakt me natyrën, me njerëzit dhe me jetën në përgjithësi.

Që nga shfaqja e parë e Shpalljes së Zotit (xh.sh) në Mekë dhe në kohën kur muslimanët ishin në numër të vogël dhe të persekutuar, shprehet mësimi kozmopolit i Kur'anit:

"Kur'ani është paralajmërim dhe këshillë për gjithë botën". (Furkan; 1) Me këtë ai i drejtohet tërë botës e jo fisit Kurejsh, arabëve ose një gjenerate.

Këtu nuk bëhet dallimi i njerëzve nga asnjë pikëpamje përveçse nga aspekti i respektimit të normave dhe ligjeve të vendosura të Zotit.

"... ju kemi ndarë në fise dhe popuj që të njiheni mes vetes, vërtet, më i miri tek Zoti është ai më i devotshmi." (Huxhurat, 13).

Kjo është thirrje e qartë për njerëzit që të mos trillojnë dhe të mos krijojnë dallime në mes tyre dhe kështu t'i thellojnë edhe më tepër mosmarrëveshjet, por t'u kujtojë se diversiteti mes tyre duhet të jetë fushë njohjeje dhe bashkëpunimi.

Kjo thirrje nuk paraqet as që di për kufij farefisnorë, nacionalë, regionalë etj., nuk di për pengesa të tilla që për shekuj njerëzit i kanë vendosur njëri-tjetrit. Kjo është një thirrje që futet në thellësitë e zemrës e të shpirtit, aty ku pikërisht fshihet njeriu. Ai depërton dhe kërkon thelbin e njeriut e jo konstitucionin e tij fizik (lëvozhgën)-çfarë ngjyre ka, pozitën shoqërore, origjinën etj.

Islami si sistem i jetës dhe i moralit, dallon nga të gjitha sistemet e tjera për faktin që respekton të gjitha nevojat themelore të njeriut. Ai kënaq në mënyrë të barabartë çdo aspekt të personalitetit njerëzor, plotëson nevojat e tij pa i dhënë prioritet njërit ndaj tjetrit.

Islami e shikon qenien njerëzore në mënyrë integrale; njeriu në vete ka tri aftësi: trupore, shpirtërore dhe mendore. Të gjitha këto kërkojnë përmbushjen e nevojave të tyre. Pedagogjia islame përpiket t'i kënaqë në mënyrë të barabartë që të trij këto aftësi në mënyrë që të mos ndodhë çrregullimi i personalitetit njerëzor dhe edukimi i keq. Të gjitha këto së bashku përbëjnë natyrën njerëzore, *fitre*-n, në bazë të së cilës Zoti i krijoi të gjithë njerëzit (30, 30). Kjo do të thotë se trupi ka nevojat e veta për ushqim, pije, rroba, martesë, riprodhim... dhe ato mund të jenë të plotësuara vetëm në atë mënyrë që të mos i prishin nevojat e shpirtit e të mendjes, por edhe që të mos asfiksohen nga kërkesat e shpirtit a të mendjes, si p.sh. nga asketizmi i tepruar apo nga ndonjë ideologji që kërkon martirizimin a pengimin e nevojave të natyrshme trupore; shpirti ka nevojë për udhëzim, butësi, qetësi... dhe Islami ia hapi dyert e ibadetit (riteve të veçanta fetare) me të cilat i kënaq nevojat e veta; mendja ka nevojë për mësim, dije dhe njohje, përsiatje, ashtu që (me anë të mendjes) t'i hulumtojë botët dhe porositë e librit të All-llahut (xh. sh.), të hulumtojë "atë Gjithësi që i flet shpirtit dhe shoqërisë" dhe "atë Kur'an që hesht" në botën fenomenale të universit.

Në këtë vështrim mund të përcaktohet qëllimi themelor i pedagogjisë islame: të edukohet muslimani, i cili do të veprojë në pajtim me ajetin kuranor: "***Dhe ju bëmë ju një bashkësi të rrugës së mesme (ummeten vesaten)***" (2, 143), që do të thotë të edukohet personaliteti i ri që t'i shmanget çdo teprimi në të gjitha sferat e jetës dhe të mbajë gjithmonë mesin..

Në Islam çdo gjë përbën një tërësi. Ritet fetare, për nga forma e tyre e jashtme, materiale, shprehin kohezion. Pesë herë në ditë, muslimanët janë në lutje (namaz) gati në të njëjtën kohë, falen në të njëjtin drejtim, në drejtim të Mekës. Qëllimi fetar, i lidhur me ritin fizik, shpreh unitetin shpirtëror dhe material të njeriut. Përveç të tjerash, besimi përmendet shpesh në Kur'an bashkë me lëmoshën e caktuar që është obligim fetar dhe e drejtë reciproke që e bashkon popullin e

besimtarëve. Po ashtu edhe agjërimi i Ramazanit, në mënyrë simbolike i lidh të gjithë besimtarët që privojnë veten nga ushqimet dhe pijet, sipas një rendi identik kohor. Agjërimi është një nga parimet e barazisë muslimane, sepse kërkon vetëmohim si nga të pasurit ashtu edhe nga të varfrit. Lëmosha përputhet me konceptin e unitetit dhe të harmonisë së bashkësisë. Pjesëmarrja në bamirësinë e obligueshme, nxit bashkëpunimin. Dhe, më në fund, haxhillëku është manifestimi më i qartë i unitetit të një bashkësie, që përbën të njëjtin besim. Si besimi ashtu edhe ritet fetare që e lidhin njeriun drejtpërdrejt me Zotin, marrin pjesë në solidaritetin dhe homogjenitetin e bashkësisë dhe paralelisht gravitojnë nga universalizmi i saj...

Në përgjithësi procesi edukativ dhe edukimi fetar në Islam konceptohen si një tërësi, një unitet i domosdoshëm parësor. Në bazë të këtij edukimi Imam Gazaliu vë parimin e mosshkëputjes së teorisë nga praktika. Përvetësimi i diturive dhe namazi bëjnë pjesë në "ibadet". I pari është ibadet që imponohet nga bindja, nga vokacioni, kurse i dyti ibadet i trupit. Njëri vjen nga pjesa e brendshme, kur truri i njeriut, zemra e tij, e cila e shtyn edhe në pastrimin e anës së jashtme. Të dyja këto anë përbëjnë një të vetme dhe i nënshtrohen procesit edukativ, pra edukimit fetar, që është pjesë e pandarë e përmbajtjes së shkollës. Edukimi në thelb, përvetësimi i njohurive vlerësohet si një adhurim ndaj Zotit, sepse, duke njohur botën dhe ligjet e natyrës, i afroresh më tepër Atij.

Në të vërtetë, nëse e vështrojmë në kuptimin më të gjerë, tërë jeta e muslimanit, me të gjitha parimet, rregullat e normat, moralin, filozofinë dhe praktikën në përgjithësi, janë në funksion të edukimit. Ky qëndrim universal i Islamit ndaj jetës, që në terminologjinë islame kuptohet me nocionin "ibadet", ka ndikim të madh tek besimtari, sepse ia bekon çdo vepër pozitive, të dobishme të tij, e motivon të qëndrojë i pathyeshëm në të mirën.

"Mos bëni rrëmujë në tokë sepse tashmë është vendosur rendi në të." (El-A'raf, 56)

Këtu na imponohet një gjë që çdo veprim me qëllim të mirë, tani merr një formë më të lartë hyjnore, që motivon edhe më tej përsosmërinë e së mirës. ***"Që t'ju sprovovjmë se cili prej jush punon më mirë."*** (Mulk, 2)

Muhammed Esed thotë: “Të kuptuarit e nocionit të ibadetit në Islam dallon nga cilado fe tjetër. Ibadeti në Islam nuk reduktohet vetëm në devotshmëritë e pastra, sikurse janë psh. namazi apo agjërimi. Po, ibadeti përfshin tërë jetën praktike njerëzore. Prandaj, marrë në përgjithësi, qëllimi i jetës sonë është ibadeti ndaj All-llahut (xh. sh.). Jemi të obliguar ta shikojmë jetën tonë, doemos në shfaqjen e saj të përgjithshme. Ky qëllim do të jetë i pamundur të realizohet nëse do ta ndanim jetën tonë në: jetë shpirtërore dhe jetë materiale, përkatësisht trupore”.

Që të dyja ato bëjnë një tërësi unike. Mendimi ynë mbi njësinë e Zotit duhet të shprehet pikërisht në përpjekjen që të vendosim unitetin dhe sinkronizimin e manifestimeve të ndryshme të jetës sonë. Të kuptuarit e këtyllë të unitetit na tregon mundësinë e njeriut që të arrijë përsosmërinë në kuadër të jetës së vet individuale. Ndër të gjitha sistemet religjioze, shohim se i vetmi Islami deklaroi që përsosmëria individuale është e mundur edhe në këtë botë. Islami nuk e sponstion këtë përsosmëri pas shuarjes së tekave trupore, sikurse e bënë këtë mësimi i krishterë, as nuk e kthen atë në rrahët koncentrikë të riinkarnimit "me ngritjet shkallë-shkallë", sikurse është në hinduizëm, dhe as nuk pajtohet me budizmin, sipas të cilit përsosmëria dhe shpëtimi mund të arrihen vetëm me asgjësimin e Un-it individual dhe shkëputjes së lidhjeve emocionale me këtë botë. Jo, Islami është i qartë kur thotë se njeriu mund të arrijë përsosmërinë në jetën e tij individuale, tokësore duke shfrytëzuar plotësisht të gjitha dhuntitë e veta natyrore dhe mundësitë e kësaj bote.

Ibadeti ndaj All-llahut (xh. sh), sikurse e shpjeguam më parë, në kuptimin e tij më të gjerë përfshin tërë jetën njerëzore. Ibadeti, që është qëllimi i edukimit të mirë, është njëkohësisht edhe mjet i edukimit të shpirtit njerëzor. Islami me këtë dëshiron të angazhojë njeriun e kompletuar, edhe anën e tij shpirtërore, edhe trupore, edhe intelektuale, duke zhvilluar secilën prej tyre si instrumente, tërësia e të cilave do të krijonte një melodi harmonike të jetës së lumtur të njeriut.

Ekuilibri në mes fuqisë trupore, mendore dhe shpirtërore, ai është ekuilibër në mes ekzistencës fizike dhe shpirtërore të njeriut, mes dëshirave dhe mundësive, realitetit dhe imagjinatës. Pastaj, ky është

ekuilibër mes ndjenjave të frikës e shpresës, mes ndjenjave të së kuptueshmes e të fshehtës, mes individuale e kolektives, me një fjalë, ekuilibri në jetën e gjithmbarshme njerëzore.

Nga sa u tha më lart, mund të përfundojmë se qëllimi themelor i qenësisë njerëzore në këtë botë është nënshtrimi (ibadeh) ndaj All-llahut të Lartësuar dhe organizimi e përparimi i jetës në tokë duke e jetësuar ligjin e All-llahut (Shariah). Këtë qëllim na e përcaktoi vetë All-llahu (xh. sh.) në ajetin vijues:

"Unë nuk i krijova xhinnët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë." (51, 56)

Nëse ky është qëllimi i jetës së kësaj bote, atëherë edhe edukimi i njeriut duhet të ketë të njëjtin qëllim, sepse pedagogjia islame është edukim i gjithanshëm i personalitetit njerëzor në dritën e parimeve dhe vlerave të Islamit. Prandaj, mund të themi se qëllimi i pedagogjisë islame është realizimi i nënshtrimit ndaj All-llahut të Lartësuar, si në jetën individuale ashtu edhe në atë shoqërore.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Abdurrahman en-Nihlawi, Usulu et-terbijeti'l-islamijje, Damask, 1994.
2. Durkheim, Education, cituar sipas Dr. Musrafa Cerić, "Spas je u odgoju i obrazovanju", Muallim, nr. 1, Sarajevë, 2000.
3. Gaston Mialaret, Pedagogjia e përgjithshme, Tiranë, 1995.
4. Hasan Cengic, Temat islame, Shkup, 1993.
5. Marcel A. Baisard, Humanizam islama, Sarajevë, 2002.
6. Musa Kraja, Pedagogjia, Tiranë, 1998.
7. Shefik Osmani, Panteoni iranian dhe iranologët shqiptarë, Tiranë, 1998.
8. Etika u islamu, Zbornik radova treceg simpozija, Zagreb, 1990.

Periodiku:

1. Dituria islame, revistë mujore fetare kulturore shkencore, nr. 121-122/ Prishtinë, 2000.
2. Nur – casopis za kulturu i islamske teme, nr. 3, Beograd, 1993.
3. Muallim, casopis za odgoj i obrazovanje, nr. 5/ 2001; nr.7/2002, Sarajevë.
4. Glasnik – VISA – BiH, nr. 34/ 1998/ Sarajevë.
5. Religijski pogledi, revistë për çështje të religjionit dhe të drejtave të njeriut, nr.4 / 2000, Sarajevë.

Dr. Abdullah Hamiti

Nezim Frakulla - jeta dhe divanet e tij – (2)

Motivi shoqëror dhe social në poezitë e Nezim Frakullës

Me gjithë faktin se interesimi dhe preokupimi parësor i Nezimit, i shfaqur në poezitë e tij, del të jetë ai i përsosjes shpirtërore, pra tematika e misticizmit islam, dhe edhe pse ai vetë, si duket, ka qëndruar larg jetës konkrete dhe larg problemeve sociale, në gamën e poezive të tij nuk mungon as motivi shoqëror e social. Tekefundit, dihet fare mirë se mistikët, rrjedhimisht edhe poezia mistike, më pak përqendrohen në rrjedhat e kësaj jete, prandaj edhe gjendja shoqërore e sidomos ajo sociale nuk është sferë aq e preferuar e botëkuptimeve të tyre, ngase ata vuajtjet dhe dhembjet tokësore, varfërinë e skamjen i shpjegojnë sipas filozofisë së mendimit mistik, si të natyrshme, me të cilat të sprovon Zoti, dhe si diçka që duhet pranuar si e tillë, sepse ajo ka rolin e pastrimit shpëtimtar nga mëkatet. Nezimi krijon në kohën kur letërsia orientale-islame, pra letërsia e Divanit, krijohej për elitën dhe qëndronte larg çështjeve sociale; temë kryesore kishte çështjet lirike, filozofike dhe mistike. Dhe dihet se Nezimi ishte i ndikuar shumë nga kjo letërsi dhe krijoi duke ndjekur tiparet kryesore të saj. Ai e paraqet veten edhe si njohës të shkëlqyeshëm të kësaj poezie dhe si mjeshtër të nivelit të lartë, e jo të nivelit lokal, siç i konsideron poetët me të cilët polemizon. Po ashtu edhe për faktin se ky, si edhe shumë bejte-

xhinj të tjerë, në planin shpirtëror dhe kulturor, ishte i formuar nën ndikimin e filozofisë islame-mistike, prandaj, edhe kur është marrë me probleme shoqërore, ka mbetur në kuadrin e kësaj filozofie. Ndërsa kjo filozofi, siç dihet mëton që kundërthëniet shoqërore t'i shohë dhe t'i shtrojë për t'i ndrequr, në shpirtin dhe arsyen e njeriut, e i kësaj natyre është mendimi i tyre për jetën në tërësi. Kjo filozofi kërkon që e keqja, e cilësdo natyrë qoftë ajo, të mos depërtojë tek njeriu, pra të luftohet burimi i së keqes, ngase e keqja vjen nga njeriu.

Megjithatë, Nezimi në poezitë e tij nuk la pa prekur tematikën shoqërore e sociale. Në poezitë e tij është shkruar edhe për hallet dhe problemet e popullit, nga i cili rrjedh vetë. Kështu, ai këtë tematikë e shtron qoftë me ndonjë poezi të tërë, qoftë edhe me vargje dhe strofa (në të cilat jepet jeta shoqërore dhe gjendja sociale), që dalin të gërshetuara me përmbajtjet të tjera në kuadër të poezisë si tërësi.

Poezia shoqërore dhe sociale e Nezimit pasqyrohet në kritikën e klasës feudale të kohës. Kështu, në poezinë e parë të divanit të Nezimit "Teferici në Bilçë", kemi një kritikë, më tepër deskriptive, sesa një kritikë konfrontuese. Këtu, pra vetëm përshkruhet një tablo e jetës shoqërore me një humor të butë e të matur, me një gjuhë të lehtë, por që shpreh qartë qëllimin, dhe poezia si tërësi del e realizuar mirë artistikisht dhe me një përmbajtje të këndshme.

Mbase kur e shkroi këtë poezi, Nezimi kishte për qëllim të paraqiste kundërthëniet shoqërore; në një anë kemi shtresën feudale që organizon pikniqe, ku shtrohen sofrat me bollëk, ku hahet e pihet deri në ngopje, ngase aty ishin shtruar gjellëra të ndryshme si në xhenet, gjellëra të mira e të shijshme duke i përmendur edhe me emra, dhe gjithë kjo gosti e organizuar bukur, shoqërohet me këngë e me saze, që i përtërin edhe pleqtë. Natyrisht, ironia qëndron në faktin se të gjitha këto gjellëra e pije sigurohen nga shtresat e varfra e të shtypura dhe siç shihet në të marrin pjesë figurat më të shquara të klasës sunduese si dhe dijetarët dhe shtresat e varfra. Poeti thotë:

Hëngërë e pinë dynjaja
Ulema e sylehaja,
Zotërinj' e fukaraja
Veçë t'u bëjmë duanë.

Po ashtu në këtë poezi poeti ironizon edhe bejlerët e autoritetet e tjera të klasës sunduese, ngase këto pikniqe organizoheshin për t'u bërë qejfin shtresave të tilla e për t'u dëfryer në natyrë të bukur. Ironizimi vazhdon edhe me vargjet ku thuhet se argëtimin e këtillë "Kalemi s'e bën isharet", pra me laps nuk mund ta përshkruajmë, por vetëm ata që patën fatin të merrnin pjesë në atë gosti, mund ta bëjnë këtë. Ngjarja ndodhte në vitin 1731, prandaj poeti porositi të mbahet mend Teferixhi dhe nami i tij të mos vdesë kurrë, për ta kujtuar anembanë:

*Seneja bin juz kërk dort*¹⁹

Teferiçnë banje ment fort

Të mos ketë nami ti mort

Ta kujtojnë anë mbanë.

Jeta shoqërore, herë më pak e herë më shumë, përshkruhet edhe në poezitë e shumta shpirtërore-fetare të Nezimit. Natyrisht që në poezitë e tilla flitet për përsosjen e jetës shpirtërore, prandaj, edhe kur përshkrimi i jetës bëhet me tone emocionale, plot vuajtje, vaje shpirtërore, këto janë gjithnjë në funksion të mësimi mistik, e rrallë mund të ndodhë që të përshkruajnë tonin dhe qëndrimin real ndaj gjendjes shoqërore e sociale të kohës. Kështu, edhe fryma shoqërore e sociale po edhe patriotike te poezitë e Nezimit, do të jetë pra në kuadrin e poezisë fetare, ngase edhe tërësia e poezive të Nezimit është si komunikim i autorit me auditorin në rrafshin fetar. Dhe kjo mbase mund të kuptohet, sepse ai me poezitë e tij i drejtohej masës me bindje të qarta fetare, e cila mbase si të këtilla do t'i pranonte më lehtë, në një anë, dhe, në anën tjetër, kjo ishte mënyra më e lehtë që të thuhet diçka pa u hetuar dhe mënyra më e lehtë që të komunikohet me masën. Kështu, poezitë panegjirike (lavdithurëse) që Nezimi u kushton Ismail pashë Velebishtit dhe Sulejman pashë Elbasanit, mund të futen në kuadër të angazhimit patriotik, shoqëror e social, sepse përshkruajnë, qoftë edhe tërthorazi, situatat politike të kohës në ato anë dhe, përmes vargjeve që u kushton këtyre figurave, Nezimi përshkruan gjendjen shoqërore të njerëzve të thjeshtë.

¹⁹ Viti 1144.

Kështu Nezimi, Ibrahim pashën në kasiden që i kushton me rastin e festës së bajramit, e përshkruan dhe e lavdëron si pasha të mirë në kohën e tij duke thënë se nuk ka vargje më tepër të përshkruaj, sepse kanë dëgjuar gjithë të dijshtmit kush është ky njeri me nam, dhe shton se, pushteti që ka, është për t'u lavdëruar dhe se nuk ka kesi njeriu mirëbërës, për të vazhduar pastaj se lavdërimi për të nuk mund të përfundojë, sepse është një pasha famlartë që s'ka shoq në kohën e tij dhe i cili qëllimet i plotëson:

*Ashtu një veli-i niam²⁰
Që më s'le te fukaratë gam²¹,
Që me sabah e aksham
Se hiqte sofrë taam²².*

Sigurisht që vjersha më e mirë panegjirike është një vjershë tjetër lavdithurëse që ai i kushton Ismail pashës, të cilin në strofën e tretë me dy bejte që i shkruan turqisht, e portretizon në mënyrë të mrekullueshme. Pasi i dëshiron nga Zoti i Madhërishëm jetë të gjatë, atë e përshkruan si person të njohur në botë për drejtësi e të qetë në pushtetin qiellor dhe për të lutën gjithë bota, zotërinjtë e fukaraja dhe gjithmonë e përmendin dijetarët. Përshkrimi i karakterit të Ismail pashës bëhet deri në detaje; ai përshkruhet si i ditur e i shkathët, përshkrimi i të cilit s'është e mundur të bëhet me poezi e gazel.

Pas gjithë atij përshkrimi lavdithurës, poeti tashmë thotë se ai s'di si ta mburrë dhe se çfarëdo të ketë folur, është plot me mangësi, prandaj lutet ta falë, sepse mendt i janë bërë pikepesë. Kështu ai thërret:

*Ej Nezim margaritar i vetëm
Dil nga deti i lavdërimit
Hyr në fushë të lutjes
Se nuk i gjendet skaj²³.*

Natyrisht që poezitë që u kushton këtyre dy udhëheqësve lokalë, nuk mund të merren si përshkrim serioz i jetës shoqërore, i organizimit shoqëror, sepse këto janë poezi lavdithurëse që nuk paraqesin edhe anën tjetër të medaljes, që s'ka dyshim se do të ishte krejt ndry-

²⁰ veli-i niam = posedues i mirësive e begative.

²¹ gam = mundim, vuajtje.

²² taam = ushqimin.

²³ Këtë strofë e kemi përshtatur duke i përkthyer fjalët orientale.

she nga ajo që na del në poezitë që Nezimi u kushton këtyre dy figurave politike vendore. Dhe në njëfarë mënyre, këta dy pashallarë do të mund t'i konsideronim si mecenë, pra mbrojtës e përkrahës të poetit, apo së paku përpjekje të poetit për të fituar mbështetjen e tyre. Tekefundit dihet se çdo poet në periudhën osmane, duke marrë mësim nga poetët iranianë, shkruanin panegjirikë për t'i lavdëruar udhëheqësit e lartë shtetëror, me qëllim që të fitonin përkrahje morale e materiale prej tyre.

Pavarësisht nga poezitë që Nezimi u thurte Ibrahim pashës e Ismail pashës duke i lavdëruar, ai nuk pat jetë të rehatshme e të pabringa. Përkundrazi, ai e kaloi jetën në varfëri e me peripeci të shumta dhe gati në të gjitha poezitë e tij të përfshira në dy divanet e tij, shohim të qahet e të ankohet për hallet që kishte. Kështu në një poezi të divanit të parë Nezimi përshkruan gjendjen e tij të vështirë materiale dhe zhgënjimin nga miqtë, për shkak se nuk i doli kush në ndihmë e s'e kuptoi atë e hallet e tij, sepse ankimin e tij e quanin përrallë dhe nuk ia dinin vlerën këtij feniksi që në poezi del me simbolin Tuti, që domethënë feniks i Xhennetit, papagall. Pastaj shton se mirëqenia e mori botën e s'e kujtojnë fare Tutin, dhe përderisa jeta është përplot mirëqenie, ai është në një kafaz pa ushqim:

*Unë pa gida²⁴ në kafes
Jeta mbushur në shyqyr²⁵,
Më shohënë se njëmend vdes
Bëjnë sikur s'kanë haber²⁶.*

dhe pyet si nuk u gjet ndonjë mëshirues e të pyesë për hallin e tij dhe kërkon shpëtim nga Zoti:

*Se s'u gjend një ehli insaf²⁷
Të më pyesë hallë tim!*

Ndërsa në poezinë "*Derbejani jaran bisadakat ve bivefa ve bihakat*" (Përshkrimi i mikut jo të sinqertë, jobesnik dhe jo të vërtetë) përshkruan karakteristikat njerëzore. Struktura e poezisë ndërtohet mbi dy njësi të lëndës poetike, të cilat paraqesin pastaj një tërësi. Në

²⁴ gida = ushqim.

²⁵ shyqyr = mirëqenie, begati.

²⁶ haber = dije, njohuri.

²⁷ ehli insaf = mëshirues.

pjesën e parë të poezisë në dymbëdhjetë vargje poeti përshkruan miqtë e jaranët besnikë, të cilët, sapo e panë në zindan, e qanë atë dhe vuajtën bashkë me të:

*Disa miq disa jaranë
Që rrëfeninë vefanë²⁸,
Në zindan poqë më panë
Sicili zuri më qanë.*

Në pjesën e dytë tematike, tashti përshkruan miqtë e interesit, të cilët të duan vetëm për të ngrënë e për të pirë, prandaj thërret të hiqemi prej tyre. Gjithë ky pezm i Nezimit, ankim e qarje që shihet edhe në poezi të tjera, më së miri shpjegohet në strofën e fundit të kësaj vjershe, ku Nezimi shpjegon se nuk qan pse vuan, por që në këtë botë kalimtare të mos i thotë askujt aman:

*Hajde le të jem si të jem,
Nuk qanj pse të heq elem²⁹,
Veç në këtë fani alem³⁰,
Aman, kujdo të mos t'i them.*

Nezimi thotë se miqtë i do, se nuk ka hile, se dëshiron të ketë shumë miq dhe se, kur bienë gjumë, lutet për ata, porse që të gjithë miqtë i ka sprovuar dhe asnjë s'e ka ndihmuar:

*Gahado që paçë nonjë mik
Të gjithë bëra imtihan³¹,
S'qe i zoti nonjë sadik³²
Të më bënë mua derman³³.*

Poezia patriotike e shoqërore me karakteristika të romantizmit është edhe ajo që flet për vendlindjen, për mallin e atdheut, ajo e kurbetit etj. Mallin për atdhe e gjejmë të shtruar edhe në poezinë e Nezimit. Siç e dimë, ky tip i poezisë do të jetë shumë i përhapur në poezinë me përmbajtje patriotike të romantizmit. Këtë motiv të mallit për atdhe Nezimi e ka realizuar bukur në poezinë "Nezimi niset për Stamboll", sepse fati jetësor i shqiptarëve, si duket shumë herët ishte i

²⁸ vefanë = bes=n, besnikërinë.

²⁹ elem = vuajtje, dhembje.

³⁰ fani alem = botë kalimtare, botë e rrejtshme.

³¹ imtihan = sprovim.

³² sadik = shok, i vërtetë.

³³ derman = ndihmoj, t'i zgjidh problemin.

lidhur me kurbetin, e këtë fat të rëndë e kishte përjetuar edhe Nezimi. Kështu, Nezimi, pasi përshëndetet me Beratin, që aty e quan Gjylis-tan, kërkon nga shokët të mos i harrojnë atë dhe shokët me të cilët shkon në kurbet:

*O shokë mos na harroni
Se vemi në dhe të huaj,
Një selam të na dërgoni
Bari në tre-katër muaj.*

Pra edhe shkuarjen në Stamboll, Nezimi me të drejtë e konsideron shkuarje në dhe të huaj dhe këtu shihet vetëdija e tij kombëtare. Kurse fushat e malet e përmendura në këtë poezi, për të cilat i porosit shokët e tij që t'i shikojnë, do të jenë më vonë, në letërsinë romantike, përfytyrimet më të shpeshta që do të qarkullojnë më së shumti në poezi:

*Do të ju ap një emanet
Të të shihni fusha e male,
Të ju faleni me shëndet
Prej meje, me shumë halle.*

Edhe në një poezi tjetër në divanin e dytë, Nezimi trajton motivin e kurbetit. Kështu poezinë e fillon me ajetin e Kur'anit: *Inne meal usri jusren* "Pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi", që e përdor si ngushëllim e mbështetje këtë urdhër të Zotit për të duruar e për të përballuar vështirësitë e vuajtjet dhe pastaj në një strofë tjetër na njofton se do të shkojë në atdhe dhe për këtë arsye edhe i përshëndet miqtë që kishte në kurbet:

*Miqtë që paç në gyrbet
Ju falni me shëndet,
Do të vete në vilajet,
Më s'më duhet shiqari.*

Polemikat letrare të Nezim Frakullës

Si poetët e tjerë orientale që ai adhuronte, edhe si bashkëkohësit e tij, edhe Nezimi, në kasidet e tij lavdërohet dhe mburret me shkathësitë e talentin e tij poetik. Kjo shihet qartë në disa vargje të tij, si kur polemizon me poetët e kohës në mjedisin e tij, kur e konsideron veten më të mirin dhe mjeshtër të poezisë, si në panegjiret që i kushton Ibrahim pashës e Ismail pashës. Këtë manir poetët turq e kanë trashëguar

nga modelet e tyre persiane, këto të gjitha pra janë elemente të ndikimit të poezisë orientale-islame, apo të themi më mirë, poezinë e tij e karakterizojnë poezi shqipe islame.

Polemikat, apo garat poetike në Botën Islame ishin me traditë të zhvilluar, dhe kjo traditë kultivohej edhe në letërsinë me grafi arabe, sidomos në qendrat ku ishin krijuar qarqe intelektualësh dhe ishte krijuar edhe traditë e mirë krijuese, siç ishte Berati. Kështu, me të kthyer në Berat, më 1731, Nezimi gjen një atmosferë të këndshme krijuese ku mbaheshin garat për të shpallur poetin më të mirë të qytetit, pra ku gjente shprehjen sistemi i vlerave. Natyrisht ky ishte një rast i mirë që Nezimi të shfrytëzonte këtë nxitje, dhe si njeri me përvojë të mirë të krijesit të dëshmohej edhe si njohës i mirë i poezisë popullore. Dhe Nezimi, pa ngurruar fare, hyri në rivalitet poetik pa kompromis dhe u dëshmuua si një poet me përvojë, një poet i kalitur, i cili njihte shumë mirë artin poetik dhe si një poet që dinte të zgjidhte motivin e pëlqyer për masat dhe kishte qëndrim kritik ndaj disa dukurive jo të mira shoqërore. Natyrisht, ai në kritikën e tij nuk kursente as klasat e larta të shoqërisë së atëhershme. Kështu ai shkroi e polemizoi, pos të tjerash, edhe për çështje teorike poetike letrare, çështje për të cilat mendon se kundërshtarët, apo rivalët e tij ishin laikë e të papërgatitur fare. Kështu Nezimi u përgjigjet:

*Le mananë³⁴ që s'e dëgjon
Ç'kam thënë dot s'e kupton,
Po edhe rri më kuvendon
Ç'është të bërët shair!³⁵*

Rivalët e Nezimit janë njerëz autoritativë, njerëz pushtetar, - Mulla Aliu myftiu i Beratit, tregtari çifut - Sollomoni, një tjetër jahudi me emrin Islam, e ndonjë tjetër që deshën të garonin a të polemizonin, me poezi me mjeshtrin e poezisë, siç e konsideron veten Nezimi kur thotë "*Në shi're un jam ustad*", apo "*Në shairët shok nuk kam*". Por, Nezimi del ngadhënjyes ndaj tyre pikërisht me gjallërinë dhe aktualitetin që shpreh poezia e tij. Natyrisht, në një masë poezitë e Nezimit ishin të këndshme dhe të mirëpritura edhe për shkak të karakterit mistik islam që përmbanin e që ishte shprehje edhe e koncepteve të

³⁴ manan = kuptimin.

³⁵ shair = poet.

tyre të të besuarit. Këto polemika të Nezimit, herë-herë na dalin shumë transparente, dhe poeti sulmon pa pardon me sharje e fyerje rivalin kundërshtar duke dashur ta demaskojë e ta shtrijë përtokë, si njeri të dështuar dhe analfabet për të krijuar poezi, si njeri armik të tij e të Islamit, si gjaur e qafir. Këto poezi Nezimi i shkruan me ëndje e me zell për t'i nxjerrë në shesh bëmat e atyre njerëzve të marrë e hajvana, siç i quan ai, që dashkan të shkruajnë bejte pa ditur ç'është poezia. Ndërsa për Nezimin poezia është frymëzim, dhunti e Zotit dhe nuk mund të bëhet me pahir:

*Shi'ri hidajeti hak,
Se si të ngrënë të kajmak,
Mos u loth o erë zambak,
Se nuk bëhetë pahir.*

Këto polemika të nxehta që nxorën edhe satirën e bukur shqipe si gjini poetike, pos fitores së Nezimit, shkaktuan polemika e polarizime në mesin e ithtarëve të poezisë. Kështu, edhe opinioni u nda në dysh: në ata që simpatizonin Nezimin dhe në ata që simpatizonin palën tjetër, pra rivalët e tij. Natyrisht që poezia e Nezimit, si poezi mistike, kishte ithtarët e vet në shtresat e gjera. Prandaj, polemika merr edhe përmasa politike, për shkak se në të qenë inkuadruar autoritetet e qytetit dhe konflikti u acarua deri në atë masë, sa që nxiti shkarkimin e Mulla Aliut nga posti i myftiut të Beratit, pasi kishte intervenuar Shehu-1 Islami nga Stambolli, i cili e pushoi myftiun nga detyra me këtë urdhër: "I nderuari z. Gjykatës i Beligradit shqiptar!³⁶ Pas lajmit ju bëjmë me dije se myftiu i Beligradit shqiptar, Aliu, është shkarkuar nga detyra e fetfajes pasi jemi lajmëruar që me sjelljet e këqija është përzierë duke shkaktuar anarshinë e qytetit. Duhet ta porositni me përsëritje që pas sodit të rrijë në punë të vet e të mos përziet më në çështjet e fetfajes, vesselam - 28 Rebiul - Ahir 1151"³⁷. Nga kjo shkresë e shkruar më 19 korrik 1738, kuptohet se polemika mes tyre pati vazhduar gjatë dhe qe krijuar një anarki në qytetin e Beratit. Kjo pole-

³⁶ Berati në burimet e periudhës osmane përmendet si Arnaut Beligrad = Beograd shqiptar. Edhe Nezimi në divanin e tij në turqishte e përdor Beligrad, ndërsa në atë shqip Berat.

³⁷ Kultura Islame, pun. i cituar; Rebiul-Ahir është muaji i katërt sipas muajve të hënës; Rebiul-Ahir 1151 - 19 korrik 1738.

mikë arriti kulmin kur Mulla Aliu akuzoi Nezimin si shpifës për këtë situatë të krijuar dhe Nezimi i përgjigjet me mjeshtri poetike:

*Vetë ju thotë fakiri
Në ju paça faj, më mviri
O zemëra ime mos qaj
Se Nezimi nuk pat faj.*

Natyrisht që polemikën më të ashpër Nezimi e zhvillon me një jahudi, që në njërën poezi thotë se e quajnë Islam e në tjetrën me një jahudi që e quanin Sollomon. Në poezitë me të cilat polemizon me këta persona që shkruajnë poezi, Nezimi është përplot mllef dhe nuk zgjedh fjalë e shprehje për t'i njollosur e sharë ata. Kështu, poezinë "Bir munkir mel'un ixhad ..." e fillon me këto vargje për të demaskuar rivalin:

*U bë pejda një imansëz
Një gjidi qafir duasëz,
Një domuz e një xhansëz
I daltë shpirti në halet (në vështirësi).*

pastaj vazhdon ta shpalosë edhe më fytyrën e vërtetë të tij duke treguar se e quajnë Islam, porse është tërësisht pabesimtar dhe se ia kanë parë haptazi kryqin:

*Me emër i thonë Islam
Gjaurllëknë e ka tamam,
Ashiqare kryqnë ja pam
I daltë shpirti në halet*

kurse më tutje e vazhdon me sharjet e ofendimet pa pardon, duke e quajtur një gomar që "Goja daim po i ha mut / kush ka parë kështu çifut?", i cili "si gomari rri e pëllet / zënka edhe bejte flet" dhe duke vazhduar me këtë fjalor, poeti tregon arsyen e mllefrit:

*Tepër qeni më ka ngarë
Si lipsetë s'e kam sharë,
Një qitap kam për të bërë
Që hiç vend të mos t'i lërë.*

Ndërsa në poezinë tjetër "Ve lehu der hakkani mulhid" (Edhe kjo është e merituar për një pabesimtar), nga vetë titulli shohim se kemi të bëjmë me një poezi polemizuese me një pabesimtar. Në këtë poezi Nezimi përdor një fjalor vërtet shumë ofendues, por që ai e konside-

ron të zakonshëm, sepse kemi të bëjmë me poezi, dhe mbase i provokuar rëndë nga një poet të cilin Nezimi nuk e çmon si poet, por si armik të tij e të fesë, qysh në bejten e parë e cilëson si qen dhe pastaj na tregon se e quajnë Sollomon:

Vallë një qen pse se mendoj

Bythën e ti vate e zbuloj,

Me emër i thonë Sollomon

Një çifut bythë palarë.

Por, Nezimi nuk mjaftohet vetëm me kaq dhe tani në vazhdim të poezisë e quan derr progrek të cilit Zoti "faqenë ja nxiu", dhe shton:

Hiç bëhet shair³⁸ ai derr

Fjalë ati kush ja merr,

Do ta bënjë greknë birader³⁹

Është një zagar i marrë.

Këtij farë Islami, Nezimi me të njëjtin fjalor të ashpër i përgjigjet edhe me një poezi tjetër "*Ve lehu der hakkan-i mulhid*" (Edhe kjo është e merituar për një pabesimtar) me gjashtë strofa, në të cilën nuk kursen fjalë për ta njollosur e sharë. E nis me vargun "O Islam, o more gjaur", pastaj e quan të mallkuar, mendjemadh, gomar, i pafe etj., dhe shton:

Maskara u bëre fare

Prej meje nuk gjen çare,

Do e leh posi zagarë

More i biri çaparit.

Ndërsa në një poezi që e shkruan si përgjigje Zejnel Agasë, një poet nga Vlora, Nezimi veten e quan bylbyl i poezisë dhe, pasi na tregon se zemra e tij mendonte se si t'i dhuronte disa bejte për t'iu përgjigjur poetit të Vlorës, në vijim mësojmë se ashku Nezimit i paskësh sjellë një trëndafil dhe e paskësh quajtur bylbyl, i cili është i dhënë e i prirur për poezi, duke i urdhëruar të merrte lapsin e të shkruante:

Më pru ashku një trëndafil

Më tha merri erë o bylbyl,

E ti që je shi're mail

Merr kalemnë, e rri në tenha.

³⁸ shair = poet.

³⁹ birader = vëlla.

dhe në strofën tjetër mësojmë se, sapo ka dëgjuar Nezimi këtë fjalë, vargjet kanë filluar të dalin nga zemra dhe të bëjë adetin që ka:

*Si dëgjova këtë fjalë
Nazmi⁴⁰ nisi palë palë,
Gaha zemra që të dalë
Të bënjë adetnë që ka.*

Nezimi në këtë përgjigje bën me dije se vargjet e tij janë frymëzim i Zotit, prandaj edhe s'është e udhës që t'ia shajnë poezitë atij, kështuqë, ai shkruan, kushdo ia shan poezitë, është një kafshë:

*Shi'retë kush na i shan
Gati se është hajvan.*

Ndërsa, me gjithë dëshirën për t'u përmbajtur, Nezimi i kushton edhe një kaside tjetër Zejnel Agasë dhe qysh në strofën e parë e pyet:

*Më shastisi kjo sevda
Si të bënj s'e di,
Ç'të kam bërë o Zejnel Aga
Që më mban mëri!*

Se Nezimi gjithnjë preokupohej nga krijime poetike dhe polemikat që i zhvillonte me rivalët e tij, mësojmë edhe nga këto vargje:

*Pa dëgjo ej Zejnel Çelepi
Ti sevdanë time s'e di,
Në fle, në rri, në ha, në pi,
Këtë hall kam unë evvela⁴¹.*

Si duket edhe këto polemika e kishin lodhur Nezimin dhe tash shohim se ai i ankohet krijuesit të tij, se të tillët i kanë hipur në qafë dhe e provokojnë dhe e akuzojnë me poezi; duke kërkuar ta lënë me hallet e veta që ka, dhe të mos e bezdisin, shprehet se nuk është musliman ai që me të polemizon e ngatërrohet:

*S'më lënë në hall që kam
Po më bëjnë kaq ibram⁴²,
Nuk është në dini islam⁴³
Ai që zë me mua dava⁴⁴.*

⁴⁰ nazmi = vargnimi, poezia.

⁴¹ evvela = piksëpari.

⁴² ibram = mërzis, bezdis.

⁴³ dini islam = feja islame.

⁴⁴ dava = ngatërrim.

Sado që Nezimi në disa vargje na duket shumë i ashpër kur polemizon me krijues të kohës së tij rivalë, ai është i bindur se as armiqtë nuk i shan, sepse vetëm të vërtetën thotë, dhe se ai e mban rrugën e vërtetë, e s'i hyn në punë pse s'e mban ahmaku:

*As armiknë tim nuk e shanj
Veçë flas si është haku,
Unë hakikatnë e mbanj
Ç'haxhet pse s'e mban ahmaku.*

Duke e përmbyllur, do të themi se edhe poezitë e zhanrit të panegjirikut, satirës e elegjitë dëshmojnë se Nezimi ishte njohës i shkëlqyeshëm i letërsisë orientale-islame dhe se e çmonte shumë atë krijimtari letrare. Si njohës i mirë i saj, ai kishte arritur një kulturë të begatshme letrare dhe veten e konsideronte si një poet të dalluar të kohës, duke e konsideruar edhe më të mirin në atdheun e tij nga i cili merrnin "yrrnek" poetët e tjerë.

Pikërisht për faktin se e njihte mirë letërsinë orientale-islame, në krijimtarinë e tij defilojnë personazhe -figura të shquara të letërsisë orientale-islame dhe kjo dëshmon për ndikimin e kësaj letërsie tek Nezimi. Këto ndikime janë edhe të karakterit thjesht artistik, ku mund të vërehen shprehjet e tyre, stili i tyre, figuracioni poetik e të tjera. Siç janë figurat e poemave të njohura të letërsisë orientale "Lejla dhe Mexhnuni", "Jusufi dhe Zylehaja", "Ferhad dhe Shirin" e të tjera. Mirëpo që këto personazhe ishin të pashmangshme për një krijues të provinencës islame, dëshmon edhe poezia e Nezimit, sepse, sado që ai nuk krijon poema të njohura me këto figura, ai jo rrallë në mënyrë simbolike i përmend këto figura në poezitë e tij, sepse këto ishin personazhe që për lexuesit e poezisë orientale-islame ishin të njohura dhe kishin simbolikën e tyre. Për shembull, në shumë poezi në kontekst të ndryshëm Nezimi përdor figurat Lejla e Mexhnun që janë personazhe të njohura të letërsisë orientale, ku përshkruhet dashuria e Mexhnunit ndaj Lejlasë, për të cilën ai ishte çmendur, pra simbol i vuajtjes dhe dhimbjes për dashurinë që është marrë si një model i dashurisë mistike, sepse është marrë si shembull i dashurisë dhe është bërë manifestim i bukurisë hyjnore të shikuar me sy të dashurisë. Ndërsa Nezimi i përdor me qëllim të misticizmit, ku Mexhnun do të

thotë i dashuruar në Zotin, i cili me dashuri hyjnore kalon në trans dhe e çrregullon baraspeshën mendore. Për shembull te Nezimi kemi:

Kujt i thonë ashik në dynja

Që të bënj kryetë fida⁴⁵,

Mentë i përcjell në sahra⁴⁶

Si Mexhnuni për Lejlanë.

Natyrisht që në poezitë e Nezimit, krahas këtyre personazheve të lartpërmendura, defilojnë edhe figura të tjera, që janë të pranishme në poezinë orientale-islame, të cilat zënë vend gjatë përshkrimit të akteve të ndryshme fetare-islame, të historisë e ndodhive të Botës islame etj. Ndër to dallohen figurat, si: profetët Muhamed, Ibrahim, Zekerja, Isa, pastaj es-habi kiramët (shokët e ndershëm të profetit Muhamed), - Ebu Bekër, Omer, Osman, Ali, Hasan, Husejn, Jezid; Kiameti, Xheneti, Xhehenemi, Ahireti, iman e Islam, dini, ymeti etj. Pa dyshim, që të gjitha këto figura paraqesin, e në to simbolizojnë pamje, situata të ndryshme, përfytyrime e përshkrime të jetës fetare islame.

Po, kur kemi të bëjmë me ndërtimin e vargut, do theksuar se Nezimi ka krijuar në bejte, pra në dyvargësh, por zakonisht lidhja kuptimore e vargjeve përbëhet ndërmjet dy bejteve, të cilat ne i kemi shndërruar në strofë katërvargëshe. Por, si në traditën orientale, autori pa bërë ndarje në strofa i rendit bejtet nga e para deri tek e fundit. Ngjashmëria apo ndikimi oriental-islam vërehet edhe në laramaninë ritmike dhe të rimave të përdorura. Megjithatë, mund të thuhet se këtu ndikimi është më i vogël. Arsyeja qëndron në faktin se Nezimi, po siç e dimë edhe shumë shkrimtar të tjerë shqiptarë që shkruan shqip me grafi arabe, nuk i pranuan në tërësi masat ritmike arabe-islame, siç i pranuan format letrare dhe temat.

Nezim Frakulla në poezitë e tij ka përdorur tetërokëshin dhe strofat katërshe, siç thamë, me dy bejte që përbëjnë një strofë, me rimë të alternuar, i cili pra ishte njëri nga vargjet më të zakonshëm të poezisë popullore dhe artistike shqipe, po edhe me rimë të domosdoshme.

Në poezinë e Lindjes kujdes i veçantë i kushtohej rimës, ngase ata krijojnë poezi të këndshme për vesh, që duhej të harmonizohej e të

⁴⁵ fida = flijim, sakrificë.

⁴⁶ sahra = fushë, bota shpirtërore.

ndiqej me besnikëri. Nga ky rregull, natyrisht nuk kishte dalë as Nezimi, i cili veçanërisht ishte kujdesur që në vjershat e tij të përdorte rimë të begatshme. Kjo bën që jo rrallë, ndoshta edhe për ta përshtatur rimën, të detyrohej të përdorte fjalë orientale, e ishte edhe ritmi që i diktonte autorit përdorimin e fjalëve që nuk do të tejkalonin numrin e duhur të rrokjeve në varg. Kështu, ndër poezitë e tij kemi rimë të skemës AB AB, po në disa poezi kemi rimën e alternuar dhe të puthur me skemën AAAB, CCCB, DDDDB, d.m.th. rimojnë vargjet e katërta nga secila strofë. Dhe në bazë të asaj shkronje që rimon në secilën strofë, shpesh edhe poezia është titulluar si, poezia që rimon me S, me H, me A etj. Gjithashtu te një numër i poezive vargu i katërt na del si refren i përsëritur në çdo strofë.

Pavarësisht nga ndikimet e theksuara në formë e stil, që ishin modele artistike të orientit islam, mund të thuhet se Nezimi ishte poet origjinal dhe njohës i mirë si i letërsisë orientale-islame, ashtu edhe i traditës popullore shqiptare. Ai krijoi poezi për ambientin dhe popullin e vet, prandaj edhe zgjoi interesim të madh tek lexuesit e dëgjuesit e tij. Interesimi për poezitë e tij ishte dhe për shkak të temës fetare mistike që e trajtoi me mjaft mjeshtëri, por edhe për temat e tjera shoqërore, sociale, didaktike, për cilësinë e krijimtarisë së tij, për tipologjinë e krijimtarisë së tij fetare e cila u çmua shumë sidomos nga dervishët udhëheqës të rendeve fetare, sidomos të atyre bektashinj (besohet se edhe Nezimi i përkiste këtij rendi - tarikati islam). Dhe kjo poezi e tij mistike vërtet kishte ushtruar ndikim dhe ishte e dashur shumë për lexuesit, sidomos e preferonin prijësit e tarikateve, prandaj edhe nuk është e rastit që shumë poezi të tij dorëshkrim, të përshkruara, janë gjetur e gjenden nëpër teqetë e ndryshme anekënd trojeve shqiptare. Ai në këtë drejtim kishte ushtruar ndikim të madh dhe ishte bërë edhe model për krijuesit e tjerë. Prandaj mund të thuhet se me krijimtarinë e tij poetike, Nezimi ngriti dhe pasuroi kulturën shqiptare për një kohë të gjatë, e pse jo edhe për kohën tonë, sepse ato poezi kanë vlerë historike-letrare, dhe vlerë kulturore. Sigurisht, krijimtaria poetike e Nezimit do të ushtrojë ndikim te krijuesit të tjerë shqiptarë që shkruanin me grafi arabe. Sepse, me sa dimë, edhe krijuesit e tjerë kanë trajtuar tema të njëjta letrare, kanë kultivuar forma të njëjta letrare e kanë përdorur masa të njëjta metrike letrare që ka përdorur Nezimi, e ndoshta edhe ndonjë shkrimtar që mund të ketë krijuar para

Nezimit me grafi arabe. Dhe natyrisht që shumë nga temat, motivet e simbolet në poezinë e poetëve shqiptarë që kanë krijuar me grafi arabe, pra edhe në poezinë e Nezimit, janë trashëguar nga letërsia orientale-islame, pra nga letërsia arabe, persiane e turke. Sado që nuk kemi njohuri për krijime letrare shqipe me grafi arabe para Nezimit, konsiderojmë se ato do të mund të kenë ekzistuar edhe para Nezimit, sepse duhet të ketë pasur Nezimi një traditë të poezisë së tillë, siç ka vazhduar traditën letrare popullore dhe traditën poetike shqiptare të shkruar me alfabetin latin, sado që Nezimi mendon se është i pari që shkruan shqip:

*Divan kush pat folurë shqip
Ajan e bëri Nezimi,
Kjo gjuhë qe bërë harap
Me qeder, me shumë hixhap.*

Ne mendojmë se Nezimi do të ketë ditur se shqipja ishte shkruar edhe para tij, sepse pos asaj të proviniençës së krishterë, mendojmë që edhe ajo e proviniençës islame, pra poezia e bejtexhinjve, të jetë shkruar edhe para tij. Njihet poezia për kafën, që konsiderohet të jetë shkruar në vitin 1725⁴⁷ e Muçi Zades, por mbase do të ketë krijime edhe më të hershme. Po ashtu, mendojmë që Nezimi i nxitur nga polemikat që i zhvillon me poetë të tjerë, shkruan kështu për t'i deklaruar ata. Po ashtu do theksuar se ai ka një vetëdije mbase më të lartë gjuhësore sesa bashkëkohanikët e tij, si për gjuhën e folur e sidomos për gjuhën e krijimtarisë poetike. Për veçoritë e saj shihet se ka njohuri shumë të përparuar, që dëshmon edhe për përgatitjen dhe njohjen nga ana e tij të gjuhës poetike në përgjithësi, pra kishte njohuri të mrekullueshme teorike për shkrimin artistik si shkrim specifik gjuhësor:

*Ju Nezimit ej ehiba
I bëni shumë dua,
Fola në shqip këtë eda
U zbukurua lisani.*

Por, Nezimi gjithsesi është poeti më serioz dhe më i hershëm, për krijimtarinë e të cilit dimë sot dhe divanet e të cilit i kemi në dorë, divane këto që ishin një traditë e mirë që u vazhdua nga shumë poetë të shquar shqiptarë që shkruan me grafi arabe.

⁴⁷ Osman Myderrizi, *Letërsia shqipe me alfabetin arab*, **Buletini i shkencave shoqërore**, 2 / 1995, fq. 151.

Hasan Hasani

DY FIGURA TË SHQUARA LETRARE DHE KOMBËTARE

Në vend të hyrjes

Historia e letërsisë dhe e kulturës kombëtare për gjysmë shekulli u tregua e padrejtë ndaj shumë figurave të shquara të letërsisë, kulturës, historisë, etnografisë etj. që ishin, janë dhe do të mbeten ndër pinjojtë e parë, më interesantë dhe më të dashur për lexuesit shqiptarë në përgjithësi. Në të vërtetë, këto figura për gjysmë shekulli u anatemuan si “nacionaliste”, “tradhëtare”, “të dyshimta” nga regjimi monist, atyre iu mohuan vlerat kulmore që lanë trashëgim Këta krijues “të harruar”. Numri i këtyre krijuesve dhe i veprave të tyre nuk është i vogël në kulturën, letërsinë dhe shkencën shqiptare. Për habinë e të gjithëve, këto figura u gjetën në mesin e dy konfesioneve fetare, në atë katolik dhe musliman, në njërën anë, dhe ata që u shkolluan kryesisht në Përndim, përkatësisht në Lindje, në anën tjetër. Ndër shumë figura të shquara letrare dhe kombëtare, ne kësaj radhe do të bëjmë fjalë për dy sosh, që janë Hafiz Ali Korça dhe Vexhi Buharaja.

1. Hafiz Ali Korça

Në margjinat e jetës

Hafiz Ali Korça (1873-1956) u lind në Korçë dhe vdiq në Kavajë. Rrjedh nga një familje intelektuale fetare. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa ato të mesmet dhe studimet e larta i mbaroi në Fakultetin e Filozofisë dhe në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Stambollit. Në moshën 9-vjeçare mori titullin hafëz. Është i njohur si filozof, teolog, enciklopedist, gjuhëtar, pedagog, atdhetar. Mori pjesë në Kongresin e Manastirit, të Dibrës, të Elbasanit dhe të Lushnjës, ku gjithnjë, krahas çështjes kombëtare, ngriti edhe atë gjuhësore. Ishte edhe anëtar i Komisionit Letrar të Shkodrës. Punoi si mësues dhe ishte themelues i Medresesë në Shkodër e në Tiranë, ku punoi si pedagog teologjie. Ndërsa vetëm në atë të Tiranës punoi 25 vjet (1924-1949), ku ligjëroi gjuhën arabe dhe logjikën. Nga të gjitha regjimet ishte i përndjekur, i dënuar, i internuar, i arrestuar, i burgosur, që nga pushteti osman e regjimi i Zogut dhe deri tek diktatura komuniste. Kjo e fundit i pushkatoi një djalë dhe njëherësh i mohoi edhe pensionin. Hafiz Ali Korça ishte njohës i shumë gjuhëve të huaja, qofshin ato të Lindjes a të Perëndimit. U mor me shumë fusha të veprimtarisë. Botoi shumë artikuj nëpër gazeta dhe revista të ndryshme, fetare e jofetare, si në Shqipëri, Turqi, SHBA, Iran etj. Një pjesë e krijimeve të tij ngelën dorëshkrim. Veprimtaria e tij e gjerë përfshin 26 vepra letrare, fetare e shoqërore, 14 prej të cilave arriti t'i botonte, sa qe gjallë, ndërsa 12 i ngelën dorëshkrim. Veprat e botuara: *"Histori e shenjtë dhe katër Helifetë"* 1900, *"Mevludi"* 1900, *"Treqind e tri fjalët e imam Aliut"* 1900, *"Abetare"* 1910, *"Alfabeti arabisht"* 1914, *"Gramatika. Syntaksa shqip-arabisht dhe fjalime"* 1916, *"Gjylistani (Trëndafilishtja e Sadiut)"* 1918, *"Jusufi me Zelianë"* 1923, *"Shtatë ëndrrat e Shqipërisë"* 1924, *"Myslimanja"* (pa vit botimi), *"Bolshevizma, çkatrrimi i njerëzimit"* 1925, *"Kurani i madhnueshëm e thelbi i tij"* 1926, *"Rubaijjati i Umer Khajjamit"* 1930, botuar në Tiranë, Shkodër, Korçë, Elbasan. Vepra të pabotuara: *"Besimet islame dhe filozofitë e fjalëve të ndryshme dhe*

partitë në fenë islame" 1900, *"Dameneja dhe kalileja prej Sankristes"* 1900, *"Fjalë t'arta prej mendjeshtë larta e prej gjuhësh të zjarrta"* 1910, *"Përhapje e fesë Islame"* 1914, *Fërëfenjësi, morali*" 1914, *"Ilmi Bejan (Retorika)"* 1917, *"Tefsiri i Kur'anit"* 1920, *"Vjershërimi"* 1920, *"Logjika"* 1924, *Proverbët shqipe*" 1924, *"Vuajtjet dhe dënimet e mija me vdekje"* 1889-1938 dhe *"Muhammed Hanefiu me Gjylnarin"* 1939. Vitet në fund të veprave dorëshkrim shënojnë kohën kur u shkruan. Kjo veprimtari përfshin 5400 faqe të shkruara. Në to ka vjersha, prozë, proverba, artikuj, studime.

Hafiz Ali Korça vdiq në Kavajë më 1956, i zhytur në një mjerim të thellë, që është karakteristikë e njerëzve të mëdhenj, e njerëzve përparimtarë kudo nën diktaturën komuniste.

Hafiz Ali Korça dhe tri kongreset

I inkuadruar qysh në rini në Lëvizjen Kombëtare, Hafiz Ali Korça u dallua si një intelektual me horizonte të gjera, me bindje dhe koncepte universale për diturinë, mësimin dhe emancipimin kombëtar. Pjesëmarrja e tij në Kongresin e Manastirit, ose, siç jemi mësuar ta quajmë, në Kongresin e Alfabetit, ishte një ndihmesë e denjë për Lëvizjen Kombëtare në përgjithësi. Kontributi i Hafiz Ali Korçës në këtë ngjarje historike për kombin tonë, pa dyshim ishte shumë i madh. Në vazhden e këtyre lëvizjeve, veprimtaria e intelektualëve shqiptarë vazhdoi edhe në Kongresin e Dibrës, që u bë më 1909, ku kërkesa e Hafiz Ali Korçës ishte hapja e shkollave shqipe. Për atë kohë kërkesa ishte shumë e guximshme. Ai thekson, në mes të tjerash,: "...fqinjet tona nga ana e arsimit kanë arrirë shkallën më të lartë, na për fat të keq kemi mbetur si populli i Afrikës së mesme". Po në këtë vit Hafiz Ali Korça merr pjesë edhe në Kongresin e Elbasanit, ku vendi i merituar iu kushtua arsimit shqiptar në gjuhën shqipe. Kontributi që dha ky intelektual, ishte shumë i madh, sidomos në mbrojtjen e gjuhës shqipe, për se qe ngritur një fushatë e madhe kundër tij nga klerikë myslimanë, mu sepse mbrojti gjuhën dhe drejtshkrimin shqip. Sido që të jetë, për pikëpamjet dhe guximin e tij në mbrojtje të drejtshkrimit dhe të gjuhës shqipe, shkruan njerëz eminentë të kohës në gazeta të ndryshme. Vlen të përmendim vetëm Hil Mosin, i cili me fjalë të zgjedhura dha portretin e Hafiz Ali Korçës si veprimtar, atdhetar dhe

arsimdashës. Pikërisht nisur nga kjo, emri i Hafiz Ali Korçës u gjend edhe në mesin e emrave të shquar të kulturës sonë kombëtare, si anëtar i Komisionit Letrar të Shkodrës, bashkë me Gjergj Fishtën, Luigj Gurakuqin, Mati Logorecin dhe Sali Nivicën.

Emancipimi fetar përmes gjuhës shqipe

Një kaptinë të jetës dhe veprës së Hafiz Ali Korçës e përbën veprimtaria arsimore dhe edukative në dy drejtime, në atë kombëtar dhe atë relegjioz. Lëvizja për arsimin dhe shkollën shqipe ishte moto e jetës dhe e veprës që nga rilindësit, në fillim nëpërmjet artikujve të ndryshëm botuar në gazeta dhe revista, e më vonë edhe nëpërmjet botimit të teksteve shkollore. Në këtë drejtim edhe kontributi i Hafiz Ali Korçës ishte i madh. Më 1910 botoi në Korçë "*Abetare*", një tekst shkollor që ishte ndihmesë në përhapjen e arsimit shqip, u mor vesh, për nxënësit e konfesionit islam që merrnin mësimet e para të fesë. Më 1914 botoi në Shkodër librin "*Alfabeti arebisht*", që konsiderohet abetare e parë për mësimin fetar, përkatësisht në gjuhën amtare. Më 1916 po ashtu ai botoi gramatikën e parë të gjuhës arabe në gjuhën shqipe. Krahas këtyre librave Hafiz Ali Korça botoi edhe doracakun shkollor dedikuar mësimin të besimit islam për shkollat fillore. Andaj këto vepra fetare kishin për qëllim emancipimin e nxënësve të konfesionit islam në gjuhën shqipe. Mu për këtë arsye këto tekste shkollore kanë rëndësi të madhe historike, meqë dallonin nga ato të mëparshmet të sistemit osman.

Publicistika dhe çështja shqiptare

Hafiz Ali Korça, si njeri i pajisur me dituri të gjerë, si intelektual i madh, si njohës i kulturës dhe i gjuhëve të Lindjes dhe Perëndimit, dha një kontribut të çmuar edhe nëpërmjet shkrimeve publicistike rreth çështjes shqiptare. Shkrimet e tij i botoi në një hapësirë gjeografike, ku dihej pak ose shumë pak rreth çështjes shqiptare, siç janë Persia (Irani) dhe Egjipti. Më 1927 Hafiz Ali Korça botoi në një gazetë në Teheran një artikull, ku, në mes të tjerash, shkruante: "...pata dhënë këtë artikull në të cilin i kallxonja gjendjen e Ballkanit edhe padrejtësinë europiane q'ishite bërë Shqipërisë duke u pjestuar copa

më e madhe midis fqinjvet". Përveç këtyre, ai mbajti një letërkëmbim me figura të shquara të botës në Lindje, nëpërmjet të cilave i njihte ata me gjendjen e shqiptarëve. Duhet përmendur letërkëmbimi me Osman Nazmiun, mbretin e Hajdarabadit, me mbretin Faruk të Egjiptit e me shumë të tjerë. Edhe këtu, si në fusha të tjera të krijimtarisë së tij, Hafiz Ali Korça me një guxim të pashoq trajtonte probleme të çështjes shqiptare.

Shtatë ëndrrat e Shqipërisë

Shikuar veprat që shkroi dhe botoi Hafiz Ali Korça, si dhe ato që i ngelën në dorëshkrim (jepen shënime se cilës gjini i përkasin), një vend të merituar zë edhe poezia. Ky krijues, poet e atdhetar, shkroi shumë vjersha, ku spikat talenti i tij, mënyra e të shkruarit, frymëzimi që e mbërthen. Që në fillim të viteve '20 emri i tij del sheshazi nëpër periodikun e kohës. Madje, si rezultat i gjithë këtyre përpjekjeve, vjen botimi i librit *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, që pa dyshim ishte një ngjarje e kohës me një rëndësi të posaçme letrare e kulturore, e sidomos patriotike, për momentin kur u botua. Ishte ky një libër që pasqyronte rrezikun që po i kanosej Shqipërisë nga politikanët e dështuar. Madje, forca e këtyre vargjeve të mprehta, ballafaqimi me të vërtetën, bëri që Hafiz Ali Korçën ta largonin nga posti i kryetarit të Këshillit të Naltë të Sheriatit të Tiranës. Prandaj, motivi patriotik ishte burimi kryesor i frymëzimeve të tij. Duhet përmendur këtu edhe një poezi me titull "*Vajtimet e atdheut*", botuar në revistën "*Zani i Naltë*", nr. 11, gusht 1924, që i kushtohej bombardimit të Drenicës nga serbët, bërë në qershor të po atij viti, pra 75 vjet më parë; ngjarje kjo analoge me gjithë ato që ndodhën në muajt prill-maj-qershor 1999, një poezi kjo që mbyll librin "*Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*". Sidoqoftë, Hafiz Ali Korça shkroi dhe botoi edhe vëllime të tjera në vargje, që i përshkon fryma fetare e besimit islam. Por, mbi të gjitha, duhet pohuar se Hafiz Ali Korça ishte mjeshtër i vargut, i strofës, i rimës, që ishte karakteristike e kohës kur shkroi.

Hafiz Ali Korça dhe tragjedia familjare

Hafiz Ali Korça pati 5 djem dhe 2 vajza. Dy djem i vdiqën aksidentalisht qysh herët, në moshë të re. I tretë, Iljazi, që kishte kryer Mëdresenë e Tiranës, u dënua nga regjimi komunist me 25 vjet burg, si propagandues zogist. Pas burgut, vdiq. I katërti, Salahudini, kreu akademinë ushtarake në Itali. Shërbeu në ushtrinë shqiptare si pedagog. Pas Luftës së Dytë Botërore u tërhoq nga jeta ushtarake, por më 1944 regjimi komunist e pushkatoi. I pesti dhe i fundit, Alajdini, po ashtu kreu akademinë ushtarake në Itali. Më 1943 kthehet në Shqipëri si gjithë studentët për të ndihmuar atdheun dhe radhitet në aradhet partizane. Pas çlirimit punoi si pedagog në ushtrinë shqiptare. Mirëpo, për shkaqe të panjohura, atë e gjejmë si mësues në vise të ndryshme të Shqipërisë, në fshatra të thella e të largëta malore. Më vonë e arrestojnë dhe e dënojnë me 4 vjet burg. Pas daljes nga burgu, më 1982 vdes. Njëra nga vajzat e Hafiz Ali Korçës ka jetuar në Tiranë, ndërsa tjetra jeton në Durrës. Të gjitha këto tregojnë qartë se ky intelektual i madh ka jetuar në varfëri, në mjerim, shpesh i mungonte edhe buka e gojës. Por, populli i Kavajës, e çmoi shumë, e respektoi, edhe e ndihmoi të jetonte. Në Kavajë ai jetoi me gruan dhe me dy nuset e djemve, meqë djemtë i kishte të burgosur. Vitet e fundit të jetës i kaloi në dëshpërim, i braktisur. Vdiq më 1956 në Kavajë. Varrimi i tij ishte madhështor. Në përcjellje të tij për në jetën e amshueshme morën pjesë mijëra njerëz. Kjo flet se kush ishte dhe sa çmohej personaliteti i Hafiz Ali Korçës.

Në vend të përfundimit

Duke përfunduar këtë shkrim për intelektualin, patriotin, publicistin, islamologun, përkthyesin, pedagogun Hafiz Ali Korça, i cili qysh herët bashkëpunoi me veteranët e Rilindjes Kombëtare - Mihal Grameno, Luigj Gurakuqi, Gjergj Fishta e shumë të tjerë, pa dyshim duhet pohuar se angazhimi i tij krijues dhe intelektual ishte aq i madh, sa t'i siguronin një vend nderi në altarin e figurave të shquara që nuk kursyen asgjë për çështjen kombëtare shqiptare. Të gjitha angazhimet e tij në poste të larta, pjesëmarrja në tri kongrese, puna si pedagog në Korçë, Shkodër e Tiranë, shkrimet revyale dhe artikujt që botoi nëpër

të përkohshme të ndryshme në vend dhe jashtë, gjithnjë me theks të veçuar rreth çështjes kombëtare, kohë kjo që zgjati deri në ditën e internimit të tij më 1949, kur me çdo kusht u munduan ta njollosnin personalitetin e tij prej intelektualit, flasin për pathyeshmërinë dhe qëndresën e tij deri në frymën e fundit. Këtë shkrim do ta mbyll me një mendim të dr. Ismail Ahmedit, njohësit dhe studiuesit më të mirë të jetës dhe veprës së Hafiz Ali Korçës, i cili studimin monografik për këtë figurë e përfundon kështu: "Hafiz Ali Korça dhe vepra e tij janë dy pjesë organikisht të pandara. Midis tyre nuk ka kurrfarë plasaritjeje. Hafiz Aliu radhitet midis luftëtarëve, shkrimtarëve e islamologëve të Rilindjes, vepra dhe jeta e të cilit hap shtigje të reja në rrugën e zhvillimit fetar dhe kombëtar".

2. Vexhi Buharaja

Në margjinat e jetës

Vexhi Buharaja (1920-1987) lindi dhe vdiq në qytetin e bukur të Beratit. Mësimet e para i mori në vendlindje. Gjuhën persiane dhe atë turke i mësoi nga i ati qysh në moshë të re. Mësimet e mesme i vazhdoi në Medresenë e Lartë të Tiranës, e cila ishte në rang gjimnazi. Këtu gjatë nëntë vjetësh mësimi, Vexhi Buharaja mësoi gjuhë të huaja. Pas kryerjes së medresesë, Vexhi Buharaja propozohet nga ministri i atëhershëm i kulturës, Ernest Koliqi, që të vazhdonte mësimet e larta për orientalistikë në Itali me bursë të shtetit shqiptar. Por, rrethanat e rënda të familjes e detyruan Vexhi Buharanë ta refuzonte këtë ofertë, përkatësisht ai u detyrua të inkuadrohej në revistën "*Kultura islame*" që asokohe botohej në Tiranë. Që nga vitet e 40-ta Vexhi Buharaja dallohet midis të rinjve si poet, si përkthyes nga gjuhët e orientit në gjuhën shqipe, si studiues dhe si publicist. Pas Luftës së Dytë Botërore kthehet nga Tirana në Berat. Këtu, pushteti i ri komunist e dënoi me pretext se po e propagandonte fenë islame, dhe ai u burgos. Gjatë qëndrimit në burg Vexhi Buharaja mësoi edhe gjuhën ruse. Pas lirimit nga burgu, u inkuadrua në qytetin e lindjes, në Berat, si referent pranë Shtëpisë së kulturës. Po përsëri regjimi komunist e burgosi. Pas kryerjes së burgut të dytë, Vexhi Buharaja u

detyrua të merrej me punë të rënda krahu. Dhe në të njëjtën kohë, ai u dha me të madhe pas përkthimeve letrare nga gjuha perse në gjuhën shqipe. Këtu duhet përmendur vepra madhore e Saadiut me titull “*Gjylistani dhe bostani*”. Mirëpo, në vitin 1965, duke parë talentin e madh të tij si letrar dhe si përkthyes, Vexhi Buharanë e kthejnë në punë, kësaj radhe në Institutin e Historisë, ku qëndroi deri më 1975, kur u flak përsëri nga puna me mospërfillje si njeri i “padëshirueshëm”. Nga kjo kohë e deri më 6 korrik 1987, kur edhe vdiq, Vexhi Buharaja punoi kokulur për të siguruar ekzistencën për veten dhe familjen e tij. Pavarësisht nga këto mynxyra, Vexhi Buharaja shkroi dhe botoi studime me karakter filozofik, historik dhe fetar. Në të njëjtën kohë përktheu në gjuhën shqipe shumë poetë të njohur të Lindjes.

Fillet poetike të Vexhi Buharasë

Fillet poetike të Vexhi Buharasë datojnë që nga fillimi i viteve dyzet dhe përfundojnë në vitet dyzet e tre, përkatësisht këto krijime u botuan deri në vitin 1945. Pjesën më të madhe të këtyre 20 vjershave dhe 2 skicave letrare, Vexhi Buharaja i botoi në revistën “*Tomorri*”, të cilën e drejtonte poeti Nexhat Hakiu, e më vonë botoi edhe në revistën “*Kultura islame*”, ku punoi edhe vetë, dhe në revistën “*Koha e re*”. Krijimet letrare Vexhi Buharaja i botoi me pseudonimet si “*Audens*”, “*Valater Çokdari*”, dhe ato zgjuan interesim te lexuesit shqiptarë të asaj kohe. Në konkurse të ndryshme letrare Vexhi Buharaja shpesh edhe u shpërblye me çmime të ndryshme. Duhet përmendur këtu, kur me poezinë “*Përpara Tomorrit*” Vexhi Buharaja zuri vendin e parë në konkursin letrar të revistës “*Tomorri i vogël*” në vitin 1942. Poezia ishte shumë e bukur. Duke i kënduar malit legjendar, Tomorrit, poeti na jep imazhin e gjallë të natyrës shekullore që kjo i fali këtij mali. Njohësi i shkëlqyeshëm i veprës së Vexhi Buharasë, studiuesi Ahmet Kondo, për poezinë e këtij poeti, ndër të tjera, thotë: “Poezia e Vexhiut, e ndërtuar sipas vargut klasik, bie në sy për fjalorin e pasur poetik, për sintezat dhe krahasimet e bukura, për figurën e bukur letrare, për bukurinë e vërtetë panoramike të natyrës përshkruar me ndjenjë e vërtetësi. Ajo përshkohet nga mendime filozofike përparimtare dhe shoqërore. Kështu, psh. Në poezinë “*Manushaqja*”, ai ka personifikuar femrën shqiptare të robëruar, që kërkonte të

shpërthente me fuqinë e saj për të dalë nga errësira në dritë, kur shkruan në vargun e parë të saj: “Të mbiu zjarr i jetës në tokën e mbërdhirë”. Më fjalët “zjarr i jetës” ai personifikon diellin në kuptimin figurativ, që i jep forcë manushaqes për të dalë me shpërthim nga toka e fortë në sipërfaqen e saj të ngrohur prej tij. Por kjo e re, sipas mendimit të poetit, shpërtheu në kushtet e zhvillimit të mendimit përparimtar të viteve 30-të e më pas gjatë luftës çlirimtare, kur edhe femra luftoi si burrë kundër sundimit fashist italian. Një ndër to që edhe Margarita Tutulani, që poeti ia ngriti lart figurën, dhe, i mbushur me frymëzim për të, shkruan:

*Zbardhi shpata u nxi dita,
Ra një trup u ngrit një emër,
Ra dëshmore Margarita,
Doli burri nga një femër”.*

Edhe pse e paktë në numër, poezia e Vexhi Buharasë, në letërsinë shqipe të viteve dyzet la gjurmën e vet të pashlyeshme si një kandil që ndriçon në dhomën e errët të kasolles shqiptare. Kjo krijimtari shpjegohet me tronditjet shpirtërore që pësoi poeti gjatë regjimit monist në Shqipëri derisa kaloi në jetën e amshueshme.

Vexhi Buharaja studiues i pasionuar

Veprimtaria shkencore e Vexhi Buharasë përbën një kaptinë më vete, pra një kaptinë të veçantë. Kjo periudhë e frytshme vihet brenda kornizave të viteve 1965-1975, derisa punonte në Institutin e Historisë të Tiranës. Gjatë këtyre dhjetë vjetve Vexhi Buharaja shkroi dhe botoi shumë studime shkencore, të cilat për vlerat e tyre lanë gjurmë të pashlyeshme në fushën e studimeve historike shqiptare. Janë me shumë vlerë mbishkrimet turko-arabe që ky studiues i mblodhi, i traskriboi dhe i përktheu në gjuhën shqipe, si rezultat i punës së tij të palodhshme kërkimore nëpër vendet e kulteve islame, si në Berat, Tiranë, Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Tepelenë, Përmet, Gjirokastër etj. Pikërisht për këtë arsye, Vexhi Buharaja shkroi dhe botoi shumë studime shkencore gjatë kësaj periudhe. Një pjesë prej tyre u botuan në periodikun shkencor të kohës, një pjesë tjetër i

lexoi nëpër simpoziume dhe konferenca shkencore, dhe një pjesë tjetër ruhen si dorëshkrime në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë. Këtu vlen të përmenden disa prej tyre, si: “*Mbishkrimet turko-arabe të vendit tonë si dëshmi historike*”, “*Rreth mbishkrimeve të fortesës së Elbasanit*”, “*Vështrim historik mbi lagjën Murat-Çelebi*”, “*Lufta e shqiptarëve kundër forcave osmane në shekujt XIV-XVI sipas kronistëve osmanë*”, “*Kuptimi i Hixhretit*”, “*Tragjedia e Qerbelasë*”, “*Aspekte të filozofisë myslimane*” etj. Këto studime japin qartë portretin kompleks të studiuesit Vexhi Buharaja si studiues i mirëfilltë, si orientalist i rryer dhe veçanërisht si osmanist i spikatur. Mjafton të përmendim vetëm studimin e lartëshënuar “*Rreth mbishkrimeve të fortesës së Elbasanit*”, i cili zgjoi interes të madh në qarqet shkencore në Shqipëri dhe jashtë saj. Madje, siç pohon studiuesi Dhimitër S. Shutëriqi “Vexhi Buharaja vuri vulën në përcaktimin e kuptimit të emrit Elbasan dhe bëri që kjo çështje njëherë e përgjithmonë të përfundojë duke i vënë pikë kësaj çështjeje aq shumë të diskutueshme deri atëherë”

Saadiu foli shqip përmes Vexhi Buharasë

Si orientalist i njohur Vexhi Buharaja një pjesë të mirë të jetës ia kushtoi përkthimit të letërsisë orientale në gjuhën shqipe, apo më mirë të themi, i bëri të flasin shqip shkrimtarët më të njohur të Orientit të madh. Mbi të gjitha duhet përmendur vepra me vlera universale e shkrimtarit të njohur persian, Saadiut, njërit ndër përfaqësuesit më të njohur të kësaj letërsie, me veprën “*Gjylistani dhe bostani*”, e cila u botua në Tiranë dhe në Prishtinë. Botimi i kësaj vepre zgjoi interesim të madh në qarqet letrare në Shqipëri. Eqrem Çabej e vlerësoi lart këtë veper, jo vetëm si tekst të shqipëruar, por edhe studimin hyrës dhe fjalorin përkatës enciklopedik, duke pohuar: “Vexhi Buharaja meriton një gradë shkencore”. Skënder Luarasi, lidhur me këtë veper, pohon: “Vexhi Buharaja dëshmon se e folura e toskërishtes është në gjendje të përkthejë më së miri vepra madhore poetike të letërsisë klasike persiane”. Lasgush Poradeci, më një rast, duke folur për Vexhi Buharanë si përkthyes, ka thënë: “Për mua dy janë të mëdhaj në fushën e përkthimit nga gjuha perse në gjuhën shqipe, i madhi Noli në Amerikë, dhe i madhi Buharaja këtu”. Ja pra, ky është Vexhi Buharaja si përkthyes. As më shumë, as më pak nuk ke ç’ të shtosh. Megjithatë,

Vexhi Buharaja i kishte vënë vetes edhe një detyrë madhore, të cilën nuk arriti ta kryente. Kishte vendosur ta detyronte të fliste në gjuhën shqipe, pra ta përkthente edhe Homerin e Lindjes, Firdusin. Nga vepra monumentale e tij - "*Shahnameja*", e përbërë prej 60.000 vargësh dyshe, Vexhi Buharaja përktheu 7000 vargje. Por, nuk gjeti mirëkuptim nga shtëpitë botuese të kohës për t'i botuar. U thye shpirtërisht dhe, si duket, nuk vazhdoi më tutje. Ngeli e papërfunduar kjo vepër, të cilën popujt e ndryshëm të botës e kanë përkthyer dhe e njohin në detaje.

Përveç këtyre dy veprave kolosale në të cilat punoi Vexhi Buharaja, nga pena e tij ngelën të përkthyer, dhe të botuara në gjuhën shqipe, edhe veprat e vëllezërve Frashëri, Samiut dhe Naimit. Përktheu dramën e Sami Frashërit "*Besa*" nga gjuha perse në atë shqipe, pastaj "*Tehajlat*" dhe "*Katër stinët*" e poetit Naim Frashëri, si dhe veprat shkencore të rilindasit, rektorit të parë të Universitetit të Stambollit, Hasan Tahsinit. Po ashtu Vexhi Buharaja përktheu edhe shumë shkrime të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, siç janë aktet dhe memorandumet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, manifesti "*Ujanallëm*" ("*Të zgjohemi*") i Dervish Himës, pastaj letërkëmbimi i Dervish Himës me Dr. Ibrahim Temon, "*Vakëfnamenë*" e arkitektit beratas Minar Kasëmi, letërkëmbimet e Ismail Qemalit e shumë të tjera. Të gjitha këto ngërthejnë në vete vlera të çmueshme për kulturën, historinë dhe letërsinë shqiptare.

Në vend të përfundimit

Këtë shkrim për poetin, përkthyesin dhe studiuesin Vexhi Buharaja, për orientalistin dhe osmanistin e spikatur, do ta përmbylim me disa mendime të poetit tonë të madh kombëtar, Lasgush Poradeci. "Është i madh Buharaja. Nuk e kam fjalën për poezinë që më ka kushtuar mua, por se ka personalitetin e vet. Për mua kanë shkruar edhe të tjerë, por vjershën e Vexhi Buharasë e ruaj në dosjen e veçantë të kujtimeve të mia".

Ja pra, ky është Vexhi Buharaja.

Përmbyllje

Hafiz Ali Korça dhe Vexhi Buharaja janë dy figura të shquara jo vetëm letrare dhe kombëtare, por edhe kulturore e shkencore, e mbi të gjitha atdhetare dhe fetare. Vepra e tyre e gjerë i bëri këta dy krijues emra të shquar në letërsi dhe shkencë, në kulturë dhe teologji. Kontributi i tyre bëri që emra të njohur të kulturës, letërsisë dhe shkencës shqiptare, të cilët i zumë ngojet më lart, të mos kursejnë epitetet më të mëdha për këta dy pinjoj të kombit tonë. Këtë këta dy krijues e arritën me fjalën e tyre të artë të shkruar që lanë trashëgim brez pas brezi, edhe pse për gjysmë shekulli mbetën si “të harruar”, të injoruar e të etiketuar nga pushteti komunist në Shqipëri, deri në frymën e fundit, kur edhe vdiqën në mjerim të plotë. Megjithatë, vlera e njëmendtë krijuese nuk shuhet kurrë, por del në shesh herët a vonë, thyen gjithë barrierat e kohës që paraqiten para tyre, sikur qenë këta dy korifenj të kulturës sonë letrare, pinjoj të kombit shqiptar. Dhe këtë e arritën vetëm në saje të punës së palodhshme të tyre, vlerave të njëmendta letrare e shkencore që lanë trashëgim, për të cilat, ne gjeneratat e mëvonshme krenohemi përherë.

Shevki Ebu Halil

ORIENTALISTJA LAURA VECCIA VAGLIERI NË MBROJTJE TË ISLAMIT

Numri i orientalistëve italianë është i madh. Ndër më të njohurit janë:

Kalestino Shaporrelli (Calestino Schiaparelli) (1841-1919), i cili e transkriptoi dhe e botoi divanin Ibnu Hamdisit, poet i njohur sicilian, si dhe përktheu udhëpërshkrimin e ibnu Xhubejrit.

Mishel Amari (Michele Amari): (1806-1889), kryetar i Kongresit të Dytë të Orientalistëve më 1876. Është autor i librit “Historia e muslimanëve të Sicilisë”.

Oxhnitsjo Xhujedi (1844-1935) është hartues i katalogut të dorëshkrimeve orientale në disa biblioteka italiane.

Hartving Derenbur (1844-1908), botoi divanin e Nabiga Dhubjanit, këshillat e Usame ibnu Munkidh, si dhe pjesë të zgjedhura letrare të ibnu Tabatabes.

Giorgio Levi Della Vida (Giorgio Levi Della Vida): (1880-1967), i cili tregoi interesim për librin “El-Xhemheretu fin-nesebi” të ibnu El-Kelbit.

Karlo Alfonso Nallinio (Carlo Alfonso Neillino): (1872-1938), i cili tregoi interesim të madh për astronomët arabë.

Leone Kajtani (Leone Caetani): 1869-1926, është autor i librit “Historia e Islamit” në gjuhën italiane, prej të cilit botoi tetë vëllime

të mëdha të ilustruara me vizatime dhe harta. Arriti deri në vitin e 40 të hixhretit. Ai shpresonte ta përfundonte shekullin e parë të hixhretit në 25 vëllime. Ai po ashtu botoi në gjuhën arabe librin e Ibnu Muskuejhut “Përvojat e popujve”.

Ndër orientalistët italianë pa dyshim vend të veçantë zë Dr. Laura Valieri (Vaglieri) në fillim të shekullit njëzet. Të shohim se kush është Laura?

Laura Vecia Vaglieri është profesoreshë e gjuhës arabe dhe e historisë së qytetërimit islam në Universitetin e Napolit në Itali. Ajo u bë e njohur në mesin e kolegëve të saj që merreshin me studime islame, për librin e saj objektiv rreth Islamit, i cili u botua në gjuhën italiane me titullin: “Apologia dell Islamismo” (Mbrojtja e Islamit), në Romë në vitin 1925. Librin në fjalë e përktheu Aldo Kaselli (Aldo Caselli), i cili u doktorua në lëmin e filozofisë në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Napolit, i cili i kaloi disa vjet në Lindje duke studiuar gjendjen e popujve arabë. Ky përktheu librin e Laura Vaglierit “Mbrojtja e Islamit” në gjuhën angleze, dhe ai u botua me titullin “An Interpretation of Islam” (Interpretimi i Islamit).

Përhapja e Islamit nuk ishte një gjë e papritur, mirëpo ishte një dukuri që dallohej nga fuqia dhe vazhdimësia.

Mirëpo, cila është fshehtësia e kësaj fuqie dhe kësaj vazhdimësie? Kjo është pyetje së cilës i përgjigjet Dr. Laura Valieri në librin e saj tejet të vlefshëm “Mbrojtja e Islamit”. Në studimin e saj ajo u mbështet në një literaturë të bollshme, në sinqeritetin e në mirëkuptimin e thellë. Të gjitha këto përparësi bënë që libri i saj të shquhet për një objektivizëm të rrallë.

“Mbrojtja e Islamit” është një rrafsh i gjerë të studimit të Islamit. Dr. Valieri prezantoi me sukses disa nga pamjet kryesore të Islamit me një pasqyrë të shkurtër por të mrekullueshme. Ajo ia prezantoi Islamit Perëndimit ashtu siç është ai në të vërtetë, por në të njëjtën kohë ajo krijoi respektin dhe admirimin e Botës Islame.

Laura Valieri, në kohën kur shpreh admirimin e saj për mësimet islame, jetën e të dërguarit të Islamit dhe personalitetit të tij, në të njëjtën kohë ajo i bën një vështrim shkakut kryesor të prapambetjes së muslimanëve si dhe rënies së shoqërisë islame në shekujt e tashëm. Ajo nuk u mjaftua vetëm me gjetjen e pikave të dobëta, por përshkroi

edhe diagnozën e rimëkëmbjes së shoqërisë islame: “Kur’ani libri i shenjtë i muslimanëve, është ai në të cilin nuk mund të bëjnë ndryshime as miqtë e as armiqtë e tij, as intelektualët e as analfabetët. Ai është Libër që nuk e prish dhëmbi i kohës. Ai është po në atë gjendje që ishte në momentin kur Allahu xh.sh. ia shpall të Dërguarit të Tij analfabet e modest, Pejgamberit të fundit, bartësit të Sheriatit hyjnor. Ky është burim i pastër dhe i vetëm në të cilin duhet të mbështeten muslimanët. Atëherë kur ata t’i kthehen burimit të Librit të shenjtë të tyre, vetëm atëherë ata mund ta kthejnë fuqinë e tyre të mëparshme”.

Dr. Valieri është studiuesja dhe hulumtuesja më e dalluar nga dijetarët perëndimorët; ajo jep këtë diagnozë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme me të cilat ballafaqohen muslimanët në kohën e tashme. Ajo arriti në këtë përfundim pas një studimi të gjatë dhe të arsyeshëm. Mendimi i saj kryesor është që Kur’ani i madhërishtëm lypset të zbatohet në tërësi, sepse ai është udhëzuesi i përgjithshëm dhe i përhershëm i muslimanëve. Në të thuhet:

”و قال الرسول يا رب ان قومی اتخذوا هذا القرآن مهجوراً” (الفرقان، ۳).

“Dhe Pejgamberi tha: O Zoti im, populli im vërtet e ka lënë këtë Kur’an pas dore”. (25: 30).

Mospërfillja e udhëzimeve të Kur’anit dhe moszbatimi i tyre nga ana e muslimanëve, është shkak, prandaj kthimi në ato parime është zgjidhje e problemeve të tyre.

Një numër i konsiderueshëm i hulumtuesve dhe studiuesve perëndimorë, vitet e fundit kanë treguar një mirëkuptim ndaj Islamit dhe muslimanëve. Kjo më së miri shihet në disa libra që janë botuar kohët e fundit, si: “Të dërguarit e Allahut, shembulli më i mirë” i autorit Hoxha Kemalud-din, parathënien e të cilit e shkroi Lordi Hedli; libri “Studimi i librave të shenjtë në dritën e shkencave bashkëkohore”, i autorit Moris Bikaj; libri: “Rreze të veçanta për dritën e Islamit” i Itan Dine; libri “Ndjesë Muhamedit dhe Kur’anit” i Zhan Danportit; libri “Islami: ide dhe ndodhi” i Kontit Henri Di Kastrii; libri “Heronjtë” i Tomas Karlaj; libri “Muhamedi paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të” i filozofit të njohur Bernard Shou, i cili u konfiskua sepse nuk u qe përmbajtur traditave angleze.

Megjithatë shpifjet dhe propaganda kundër Islamit, e cila ishte përkrahur për shekuj me radhë, nuk ishte lehtë që të tejkalohet për një kohë të shkurtër e në mënyrë të veçantë, kur dihet se një numër i shkencëtarëve perëndimorë e kishte marrë përsipër si detyrë të shenjtë. Prandaj, për tejkalimin e saj lypset një mund shumë i madh dhe i vazhdueshëm, që gjërat të vijnë në vendin e vet.

Një vështirësi tjetër është se Perëndimi ka qenë i interesuar vazhdimisht për t'i vënë në shënjestër gabimet e muslimanëve bashkëkohorë si dhe pikat e dobëta të tyre e mësimet islame dhe ndikimin e tyre tek ata e jo mosnjohjen e masave të muslimanëve të vlerave islame të vërteta dhe lënien pas dore të tyre.

Në këto aspekte shquhet libri i autores Dr. Laura Valieri “Mbrotjtja e Islamit”, e cila ua paraqet Islamin evropianëve të thjeshtë, ashtu si është ai me parimet e tij si fe për mbarë njerëzimin, e përgjithshme dhe fe e humanizmit. Po ashtu libri në fjalë u bën me dije atyre se cilat janë parimet mbi të cilat mbështetet Islami, dhe ato me siguri do të gjejnë mbështetje tek ata studiues dhe hulumtues që angazhohen për ta gjetur të vërtetën.

Mbrojtja e Islamit

Libri në fjalë përbëhet prej shtatë kapitujve që janë:

Kapitulli i parë: Shpejtësia e përhapjes së Islamit

“Islami u shfaq sikurse një burim i ujit të pastër, në mes të një populli injorant, i cili jetonte në një vend të izoluar dhe të varfër, larg pikëtakimeve të civilizimit dhe mendimit njerëzor. Ky burim ishte shumë i pasur, deri në atë shkallë, sa që e bëri atë të shndërrohej në një përroshkë e pastaj në një lumë, që rrjedh dhe prej tij të formoheshin menjëherë kanale që rrjedhin në ato vende ku populli i tyre e shijoi shijen e atyre ujërave të mahnitshme, të cilat bënë që të rregullohen mosmarrëveshjet, si dhe u bë bashkimi i fiseve që ishin të përçara dhe në konflikte të përhershme”.

Islami, i cili në periudhën mekase të misionit të Muhamedit a.s. para së gjithash ishte i përqendruar në thirrjen e popullit për besimin

në një Zot të vetëm, pas shpërnguljes së Pejgamberit a.s. në Medinë, u shndërrua në një fuqi të fortë politike. Kështu u detyrua Muhamedi a.s. – i cili i duronte deri atëherë përbuzjet dhe maltretimet e Kurejshitëve – të përgatitej për vetëmbrojtje pasi Allahu i Madhërishëm ia kishte lejuar atë. Kështu ai prej atij momenti nuk iu dha rast armiqve të tij që ata ta sulmonin atë.

“Ndoshta dikush mund të thotë: njëra prej mrekullive të para të fesë së re ishte kjo: se vendi, i cili për shekuj dhe shekuj ishte shesh i betejave dhe luftërave të vazhdueshme në të cilat mbyteshin vëllezërit, më në fund gjeti prehje në paqe dhe qetësi”.

Autorja e librit pastaj i përmend dy ajetet kuranore:

لا اكراه في الدين قد تبين الرشد من الغي

"و قل الحق من ربكم فمن شاء فليؤمن و من شاء فليكفر"

“E ti thuaj: E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë”. (10: 29).

“Muhamedi a.s. u përmbahej vazhdimisht këtyre parimeve hyjnore, ishte shumë tolerant, në mënyrë të veçantë ndaj pasuesve të besimeve monoteiste. Të gjitha marrëveshjet që muslimanët i bënin me popujt e tjerë, i linin të lirë ata në çështjet e besimit të tyre, dhe askënd nuk e detyronin të hynte në fenë e re. Ndërsa ushtritë islame nuk kishin në mesin e tyre misionarë fanatikë, të cilët ua impononin fenë e re atyre popujve”.

Islami e bëri luftën – atë domosdoshmëri të tmerrshme në jetën njerëzore – shumë më pak të ashpër atëherë kur i porositi ushtarët e vet:

لا تقتلوا طفلاً صغيراً، و لا شيخاً كبيراً، و لا امرأةً، و لا تغدروا

و لا تعقروا نخلاً و لا تحرقوه، و لا تقطعوا شجرة مثمرة

“Mos mbytni fëmijë të vegjël, e as plak të shtyrë në moshë, dhe as grua. Mos tradhtoni. Mos pritni palma dhe as mos i digjni ato, e as mos pritni ndonjë pemë që jep fruta”. (Këto janë disa nga këshillat që Ebu Bekr Es-Sidiku që ia dha ushtrisë së udhëhequr nga Usame ibnu Zejdi).

“Shtrohet pyetja si mund të komentohet përparimi i vazhdueshëm i Islamit në Azi dhe në Afrikë me gjithë dekadencën e përgjithshme që ka goditur mendimin fetar në vitet e fundit? Askush sot nuk mund të pohojë se shpata e çliruesve është ajo që po përgatit rrugën për Islamin. Në të kundërtën, në shumë vende, të cilat dikur ishin shtete islame, janë në pushtet qeveri të reja, të cilat u përkasin feve të tjera. Ndër muslimanët kanë vepruar për periudha të gjata organizata misionare të fuqishme. Megjithatë, ato qeveri si dhe ato organizata, nuk patën sukses në luhatjen e besimit si dhe në eliminimin e tij nga jeta e popujve muslimanë.

Cila është ajo forcë magjepsë që gjendet në këtë fe?

Cila është ajo forcë e brendshme bindëse që e mbështet atë?

Nga cili burim i thellë i thellësive njerëzore vjen thirrja e tij?

Kapitulli i dytë: Thjeshtësia e besimit islam

Islami i drejtohet individit me thirrje të dyfishtë: të besojë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe që Muhamedi a.s. është i dërguari i Tij. Islami ka mënjanuar çfarëdo lloj misterioziteti, që praktikuan të tjerët për studimin e librave të shenjtë. Mrekullia më e madhe e Islamit është Kur’ani, i cili arriti tek ne me anë të transmetimit të besueshëm dhe pa farë ndërprerjeje. Ai është libër, niveli i të cilit nuk mund të arrihet në asnjë mënyrë; lajmet e tij janë të sakta dhe të besueshme plotësisht. Atëherë, si mund të jetë ky libër vepër e Muhamedit, kur dihet se ai ishte një arab që nuk dinte shkrim-lexim.

“Nëse të gjitha fetë e tjera u ofrojnë besimtarëve të tyre një barrë të rëndë të besimeve, të cilat ata nuk janë në gjendje t’i bartin dhe t’i kuptojnë, e shohim se Islami është i lehtë dhe shumë i thjeshtë. Ky ishte edhe shkaku kryesor i përhapjes së tij të shpejtë gjatë luftërave të para ndër njerëzit që ishin zhytur në një dyshim të thellë shpirtëror, për shkak të paqartësisë së besimeve të tyre. Ky është shkaku i përhapjes së tij të vazhdueshme edhe sot në mesin e popujve primitivë në Azi dhe Afrikë. Islami është në gjendje të depërtojë në thellësinë e shpirtit të tyre pa pasur nevojë për shpjegime të stërzgjatura, apo këshillime të komplikuara”.

Kapitulli i tretë: Kuptimi i ceremonive islame

Bazat e Islamit, përveç shqiptimit të fjalës së dëshmisë, janë: namazi, agjërimi, zeqati dhe haxhi. Të gjitha këto ceremoni duhen vështruar në shumë aspekte, sepse në vetvete ato kanë kuptime të shumta, e jo të vështrohen vetëm në aspektin sipërfaqësor dhe ritual”.

Drejtimi i muslimanit nga Mekja gjatë faljes së tij, i kujton muslimanit atë vend të shenjtë, i cili dëshmoi lindjen e kësaj feje të ripërtëritur. Mekja është qendër e shenjtë nga e cila drejtohen në të gjitha kohët ndjenjat fetare të besimtarëve dhe të gjithë ata janë të bashkuar në adhurimin e një Allahu të vetëm.

Allahut të madhërishëm nuk i intereson kryerja formale e ceremonive fetare, veçse Ai prej besimtarit kërkon adhurim të sinqert të dalë nga zemra. Këtë ide Kur’ani e përmend në mënyrë shumë të qartë me fjalën e Tij:

لن ينال الله لحومها و لا دماؤها و لكن يناله التقوى منكم

“Tek Allahu nuk arrin as mishin e as gjakun e tyre, por tek Ai arrin bindja juaj”. (22:37).

Muslimani nuk ka nevojë për fallxhi, për sakrifica e as për liturgji për t’u ngritur me zemrën e tij tek Krijuesi i tij.

Agjërimi e mëson muslimanin t’i frenojë epshet e tij, dhe ai nëpërmjet urisë së besimtarit, duke i dhënë atij të kuptojë për dhembjen që pëson nga uria, në shpirtin e tij shpërthen ndjenja e dhembjes dhe e solidaritetit ndaj të varfrit; në të njëjtën kohë, ai duke parë gjendjen e mirë të veten, thëllon njohjen e tij ndaj të mirave dhe begative, të cilat ia ka dhuruar atij Allahu i madhërishëm.

Kryerja e haxhit në Mekë, një herë në jetën e muslimanit. Në këtë ceremoni, përqendrohen fuqi shpirtërore të thella, domethënien e të cilave është shumë vështirë ta kuptojë mendja njerëzore. Ky është tubimi i muslimanëve në një vend. Aty shkojnë muslimanët nga të gjitha anët e botës dhe kur takohen në atë vend, ata formojnë lidhje të reja, të mbështetura në respektin dhe dashurinë e ndërsjellë.

Islami nuk ia obligoi njeriut një grup ligjesh, të cilat ai nuk është në gjendje t’i përballojë. Po ashtu ai nuk i obligoi në asnjë ritual, rregulla të ngurta e të vrazhda, sepse Ai dëshiron për njerëzit lehtësim:

"... يريد الله بكم اليسر و لا يريد بكم العسر"

"Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju". (2: 185).

"لا يكلف الله نفسا الى وسعها"

"Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij". (2: 286).

Kapitulli i katërt:

Morali islam

Islami rëndësi të veçantë i jep punës së mirë, e cila është rezultat i mëshirës së njeriut ndaj njeriut. Po ashtu ai potencon mëshirën:

"ادفع بالتي هي احسن السيئة"

"Ti të keqen ktheje me të mirën". (23: 96).

Islami ndaloi verën dhe bixhozin. Kjo është një urtësi shumë e madhe. Sot në Botën Perëndimore ndaj pijeve alkoolike zhvillohet një luftë pa kompromis, e në anën tjetër bëhen përpjekje për ndalimin e bixhozit duke vënë ligje të ndryshme. Neve na kujtohet Islami, i cili ndaloi pijet alkoolike dhe bixhozin para më shumë se katërmëdhjetë shekujsh.

Nuk ka dyshim se njerëzit kanë nevojë për fe. Mirëpo, ata dëshirojnë prej fesë që ajo t'u plotësojë nevojat e tyre, se përndryshe ajo do të jetë vetëm afër emocioneve të tyre. Edhe më shumë ajo duhet t'u ofrojë atyre qetësi dhe siguri në këtë botë si dhe në botën tjetër. Me këtë rast duhet të potencoj se Islami i plotëson të gjitha këto kërkesa në mënyrën më të përsosur, sepse Islami nuk është vetëm besim, por ai, në të njëjtën kohë, është filozofi jete. Ai e mëson të menduarit e drejtë, punën e mirë, fjalën e sinqertë. Për këtë arsye ai depërton në mendjen dhe zemrën e njeriut pa farë vështirësie.

Kapitulli i pestë:

Pushteti dhe qytetërimi islam

Ne duhet të shprehim mirënjohjen tonë të thellë ndaj një feje, e cila u përgjigjet të gjitha kërkesave njerëzore. Islami sendërtoi Sheriatin, i cili mbështetet në ligjet e nivelit më të lartë në të cilat njeriu mund të jetojë një jetë dinjitoze. Por, ai shkon edhe më larg duke

thirrur për një filozofi jete. Islami është fe, i cili i sendërtoi parimet themelore të moralit mbi një bazë të sistemit pozitiv. Është fe që vendosi obligimet e njeriut ndaj vetvetes, por edhe ndaj të tjerëve sipas rregullave tejet të përpikta, të cilat mund të ndryshojnë me zhvillimin e mendimit njerëzor dhe rrethanat e jetës së tij.

Andaj ndikimi i kësaj feje në jetët e njerëzve, është ndikim i vazhdueshëm dhe i shëndoshë në të njëjtën kohë. Tekstet e tij janë të hapura, të përpikta dhe ato kanë vendosur dënime të qarta, të caktuara në mënyrë të përpiktë.

Islami e realizon këtë shembull të lartë në mesin e të gjitha feve, si dhe Sheriati i tij nuk është i mbështetur mbi parulla dhe ceremoni, mirëpo të gjitha pamjet e jetës kolektive dhe individuale u nënshtrohen ligjeve të tij.

Islami dëshiron çdo vepër prej veprave të individit të lidhen me obligimet e tij fetare, ashtu sikurse të gjitha degët e ligjit të mbështetshin në Sheriatin islam.

Islami asnjëherë gjatë historisë së tij nuk bëri dallim ndërmjet njeriut të bardhë dhe të zi, ndërmjet fshatarit dhe qytetarit, sundimtarit dhe të sunduarit. Të gjithë janë të barabartë praktikisht e jo vetëm teorikisht. Ata janë së bashku në xhami, në treg dhe çdokund tjetër pa dallim.

Autorja pastaj i bën një komentim dënimeve në Islam, duke filluar me ajetin e Kur'anit.

و لكم في القصاص حياة يا اولى الالباب لعلكم تتقون

“O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, kështu që të ruheni”. (2:179).

Pastaj thotë: Frika nga dënimi i ashpër, është e njëjtë me krimin, sepse ajo ia lë kriminelit duart të lira që ai të trokasë në dyert e krimit. Nëse u bëjmë një vështrim në aspektin e ndalimit të krimit, dënimet e ashpra të obliguara ndaj atij që vret, që bën mizori, që pi pije alkoolike, që vjedh etj., do të shohim se pas tyre fshihet një urtësi e madhe, në mënyrë të veçantë kur ato shkojnë paralelisht me madhësitinë e Kur'anit, i cili vazhdimisht thërret për pajtim dhe falje, si gjë shumë e preferuar tek Allahu xh.sh. Po ashtu me maturi për të kërkuar gjakmarrjen si çmim të krimit dhe dhënie të kompensimeve.

Kapitulli i gjashtë: Kuptimi i tesavufit (misticizmit) në Islam

Në këtë kapitull Dr. Laura Valieri, përveç të tjerash, thotë: “Në vitet e para të Islamit, atëherë kur kryerja e obligimeve të jetës ditore kishte përparësi ndaj meditimit fetar, nuk ishte e mundur që të themelohej tesavufi (misticizmi). Në realitet dëshira për t’iu afruar Allahut xh.sh. në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë, si dhe fitimi i lidhjes me Allahun xh.sh. ishte baza kryesore për çdo adhurim të vërtetë.

Në tekstet e vjetra se nuk hasim idenë e dritës së brendshme, e cila mbështet teorinë që thotë: Pejgamberi a.s. ose trashëgimtarët e mësimëve të tij shpirtërore të drejtpërdrejtë i kanë ftuar njerëzit që të merren me problemet e jetës së kësaj bote dhe që ata të ushqejnë besimin e tyre dhe të realizojnë kuptimin e brendshëm të veprimit fetar. Pejgamberi a.s. kishte kritikuar monarkizmin dhe të gjitha pamjet e tij.

Dr. Laura Valieri thotë se për fat të mirë, është paraqitja e imam Gazaliut, i cili bëri ripërtëritjen e kësaj feje në shpirtrat e njerëzve, atëherë kur ajo ishte keqkuptuar, duke ringjallur në të vitalitetin dhe një jetë të re, sepse thirrja e tij ishte për një jetë mistike të mbështetur mbi bazat e shëndosha të synetit, duke u mbështetur tek shembujt e ashabëve të Pejgamberit a.s., duke i shtuar me këto Islamit një bukuri të re si dhe duke ringjallur në të vitalitetin e vjetër.

Kapitulli i shtatë: Islami dhe lidhja e tij me shkencën

Vendet islame kanë qenë qendra të kulturës dhe shkencës për Evropën, kur ajo ishte e zhytur në errësirën e thellë të mesjetës. Mendimet e filozofëve arabë, në atë kohë, kishin arritur një nivel shumë të lartë, gjë që i kishte bërë dijetarët e Perëndimit të shkonin pas gjurmëve të tyre.

A nuk ishin arabët ata që zbuluan metodat eksperimentale një kohë të gjatë para se atë ta bënte Roxher Bikon. Zhvillimi i kimisë, astronomisë, përhapja e shkencave greke, përforcimi i shkencave të mjekësisë, si dhe zbulimi i shumë ligjeve të fizikës, - a nuk ishin të gjitha ato prej zbulimeve të arabëve dhe muslimanëve.

Përfundim

Dr. Laura Valieri në fund përmend plogështinë, e cila i ka kapluar muslimanët në shekujt e fundit. Mirëpo, ajo thotë se plogështia është një sëmundje që duhet të zhduket patjetër, por ka shumë shenja se ajo tashmë ka filluar të shërohet. Pastaj vazhdon e thotë: “Po t’i bëjmë një vështrim librit të shenjtë, i cili nuk ka pësuar asnjë devijim, as nga miqtë e as nga armiqtë e tij, as nga intelektualët e as nga analfabetët, ai është një libër në të cilin nuk mund të ndikojë dhëmbi i kohës. Ai është në të njëjtën gjendje, ashtu si ishte ditën kur zbriti Allahu xh.sh. të Dërguarit të Tij, Pejgamberit të fundit prej bartësve të shariateve. Në këtë burim të pastër, e jo në ndonjë tjetër, do të mbështeten muslimanët. Kur ata të inspirohen prej këtij Libri të shenjtë, vetëm atëherë ata do ta kthejnë fuqinë e tyre të mëparshme. Ekzistojnë shumë parajlmërimë të fuqishme se ky proces ka filluar”.

Në Mekë ishte ngritur – me urdhrin e Zotit – një zë i vetëm, i cili i ftonte njerëzit për besimin në Zot të vetëm. Ky zë ishte një britmë në një luginë, që ishte pritur me përbuzje dhe nënçmim. Vetëm aty-këtu ishte një numër i të dobtëve që i ishte përgjigjur thirrjes, duke thënë “të përgjigjem” me plot trimëri dhe guxim. Pastaj me një ngadalësi të madhe filluan njerëzit të përgjigjeshin, që më vonë përbuzja e nënçmimi të ktheheshin në maltretim dhe mundim të paparë.

Dhe pastaj, vetëm pas pak vjetësh dhe me dëme minimale, u ngrit një sistem moral i nivelit shumë të lartë, i cili depërtoi, valoi në të gjitha anët në Gadishullin Arabik, për t’u përhapur më vonë në pjesët më të civilizuar të botës së atëhershme, me një fuqi gjigante të vazhdimësisë dhe përhapjes.

Ja, pra, një orientaliste italiane objektive në shekullin e njëzetë, e kuptoi Islamin nga burimi i tij, larg nga fanatizmi i urrejtur dhe orientalizmi i përdorur për falsifikimin e Islamit. Ajo u paraqet një libër të shkëlqyer për Islamin dhe muslimanët, librin “Mbrojtja e Islamit”, atyre që u përpoqën të prishnin imazhin e tij në Evropë.

*Marrë nga revista “Risalat Al-Xhihad”
Nr. 94, dhjetor 1990, Tripoli (Libi)*

*Përktheu nga arabishtja:
Q. Morina*

Tahir Ben Jellun

SI UA SHPJEGOVA ISLAMIN FËMIJËVE

Njëmbëdhjetë shtatori shpjeguar fëmijëve

Pamjet e tragjedisë amerikane të 11 shtatorit 2001 nuk i kursyen fëmijët tanë. Komentimet që ata i kanë dëgjuar aty-këtu për terroristët dhe për përkatësinë e tyre në botën arabe dhe muslimane, i preokupojnë dhe i shqetësojnë edhe ata.

Kështu, njëri prej fëmijëve të mi (nën moshën 10 vjeç) më parashtri këto pyetje:

- Babë, a jam unë muslimane?

- Po, je sikur prindërit e tu.

- Dhe jam arabe poashtu?

- Po, ti je arabe, edhe pse nuk e flet këtë gjuhë.

- Por, ti ke parë në televizion se muslimanët janë treguar shumë të këqij, ata kanë vrarë shumë njerëz, unë nuk dua të jem muslimane.

- Ç' do të bësh tani?

- Prej sot e tutje, nuk do të refuzoj më të ha mish derri në kantinën e shkollës.

- Si të duash, por, para se të heqësh dorë të jesh muslimane, duhet të të shpjegoj se këta njerëz të këqinj për të cilët po flet ti, nuk janë muslimanë të vërtetë, sepse njerëz të këqij ka gjithkund.

- Por thuhet se janë arabë...

- Nuk duhet të futen të gjithë (njerëzit) në një thes. Të gjithë arabët nuk janë muslimanë. Ka arabë të krishterë në Liban, në Egjipt, në Palestinë, në Sudan...

- Kam parë një plak me mjekërr, i cili falej si gjyshi im dhe pastaj merrte pushkën dhe shtinte në figura (nishan), është ai musliman?

- Nëse falej si gjyshi yt, po, është musliman.

- Përse pra ata që e kanë bërë këtë, nuk janë muslimanë të vërtetë?

- Allahu, sikur Zoti i çifutëve dhe i krishterëve, e ndalon të vrasësh vetveten, atë që quhet vetëvrasje. Dhe Ai ndalon të vriten të tjerët. Pra, këta njerëz, që kanë drejtuar aparatet (aeroplanët) mbi kullat e Nju-Jorkut, janë injorantë të fesë muslimane dhe këta janë fanatikë.

Ç'është fanatiku?

- Fanatiku është ai që mendon se gjithmonë ka të drejtë, do të jetë më i forti, nëse nuk pajtohesh me të, ai bëhet shumë i keq.

- Amerika nuk pajtohet me ta, për këtë arsye ata i kanë rrëzuar avionët mbi kullë?

- Jo, nuk mund të pajtohet njeriu me ta. Ajo që kanë bërë ata, është e tmerrshme. Askush nuk mund ta pranojë atë.

- Ç'u ka bërë Amerika që ata të jenë aq të pamëshirshëm?

- Amerika, më saktësisht qeveria amerikane, ka bërë shumë gabime dhe padrejtësi. Tash dhjetë vjet ajo bombardon popullsinë irakiane. Shumë fëmijë irakianë kanë vdekur në këto bombardime. Në vitin 1991, armata irakiane pushtoi Kuvajtin, fqinjën e vet. Amerika dhe vendet e tjera intervenuan dhe me forcë e nxorën këtë armatë nga Kuvajti. Pastaj Iraku u dënua nga Kombet e Bashkuara. Por, në të vërtetë u dënua populli e jo kryetari i tij. E sheh, kjo është e komplikuar. Nuk është aq e lehtë siç mendon ti, sidomos kur Amerika është një fuqi e madhe dhe që duhet të ketë kujdes që të jetë e drejtë.

Kjo tregon se asgjë nuk i justifikon masakrat.

- Por, a janë irakianë këta që e kanë sulmuar (Amerikën)?

- Jo, këta janë njerëz që thonë se janë arabë dhe muslimanë. Për mua, këta janë (njerëz) të çmendur.

- Po, përse janë të çmendur ata?

- Kur ata ishin të vegjël dhe kur shkonin në shkollën kuranore, i kanë mësuar se Allahu kërkonte nga ata t'i vrisnin armiqtë e Islamit, dhe se pastaj Allahu do t'i shpërblente duke i çuar në parajsë.

- Nuk po kuptoj, duhet të vrasësh për të shkuar në parajsë?

- Natyrisht se nuk kupton! I kanë bindur.

- Dhe ata e besojnë? Më thuaj si i kanë bindur...

- Duke ua përsëritur disa herë të njejtën gjë. U japin shembuj të ushtarëve të vdekur në luftë dhe citojnë një verset të Kur'anit që thotë: “Për ata që kanë vdekur në rrugën e Allahut, mos thoni se kanë vdekur! Jo!... Ata janë të gjallë...” (Sureja e dytë, verseti 154). Më në fund ata e besojnë atë që ua thonë mijëra herë.

- Por, ata janë shumë të këqinj. Duhet të vrasësh njerëz për të shkuar në parajsë?

- Kjo është gënjeshtër.

- Po përse ua thonë të gjitha këto udhëheqësit?

- Sepse ata janë në luftë kundër atyre me të cilët nuk mendojnë si ata. Ata nuk e duan jetën, ata pranojnë të sakrifikojnë jetën e tyre me kusht që të marrin me vete shumë të vdekur. Këta janë terroristë.

- Babë, çka do të thotë terrorist?

- Në fjalën terrorist, e gjen fjalën “tmerr”, do të thotë frikë shumë e madhe, një frikë shumë e madhe kolektive, një tmerr, diçka që të bën të dridhesh, që shkakton panik. Kjo është e tmerrshme!

- Nuk e kuptoj përse njerëzit që duan të shkojnë në parajsë nuk shkojnë fare vetëm. Përse i vrasin dhe frikësojnë ata që nuk vrasin?

- Nuk e di as unë, bija ime, nuk mund të kuptoj sesi njerëz të rinj, që i kanë kryer studimet, që kanë udhëtuar nëpër botë, që kanë përfutur nga liria dhe konforti i Amerikës, vendosin një ditë të bëjnë masakra duke sakrifikuar jetën e tyre. Ata këtë e bëjnë në emër të Islamit. Ata u bëjnë keq familjeve të tyre, Islamit dhe muslimanëve. Kjo më nuk është fe, sepse asnjë fe nuk i nxit njerëzit të vrasin të pafajshëm dhe Islam do të thotë: Pranoj paqen, ai nuk do të thotë: “të vrasësh të pafajshëm”.. Pra, kjo është çmendi që as unë as ti nuk mund ta kuptojmë.

- Kur ke qenë fëmijë, e dije se ishe musliman?

- Po, kam lindur në një shtëpi në të cilën i shihja përherë nënën dhe babën tim duke u lutur-falur.

- E ti?

- Edhe unë lutesha, por isha përtac, sidomos dimrit kur duhej të zgjohesha herët dhe të pastrohesha me ujë të ftohtë, sepse para çdo

lutjeje është e obligueshme të pastrohesh, ajo që quhet të marrësh abdest.

- Atëherë ti nuk pastrohesh?

- Po, pastrohesh, por babai im vërente se këtë e bëja sipërfaqësisht dhe se nuk e doja ujin shumë të ftohtë.

- Ç'të thoshte?

- Një ditë na thirri mua e vëllanë, dhe na tha: “Bij të mi, ju keni lindur në islam, ju duhet t’u bindeni prindërve tuaj dhe Zotit. Para së gjithash ju duhet të faleni pesë herë në ditë siç duhet të agjëroni Ramazanin. Në Islam, nuk ka detyrim. Askush, as Zoti, as babai juaj, nuk ka të drejtë t’ju detyrojë të faleni. Si thotë proverbi Ditën e gjykimit të fundit, secili lidhet për këmbë të veta. Pra, ju jeni të lirë, ju lë të mendoni, kryesore është të mos vidhni, të mos gënjeni, të mos goditni të dobëtin dhe të sëmurin, të mos tradhtoni, të mos turpëroni atë që nuk ka asgjë, të mos keqtrajtoni prindërit tuaj dhe sidomos të mos bëni padrejtësi. Ja, bij të mi, të tjerat ju takojnë juve t’i shikoni. Unë e kam kryer detyrën time. Ju takon juve të jeni të denjë”.

- Dhe pastaj?

- Pastaj ia putha dorën siç e bëja çdo mëngjes, dhe e ndjeva veten të lirë. Atë ditë kuptova se mund të isha muslimanë pa i zbatuar me një disiplinë të madhe rregullat dhe ligjet islame. Më kujtohet po ashtu ajo që na thoshte mësuesi i shkollës kuranore: “Zoti është i mëshirshëm”! Ai përsëriste: “Lavdërime Zotit Gjithmëshiruesit”, do të thotë se Ai di të falë.

- Po më thuaj, falesh ti apo nuk falesh?

- Këtë pyetje nuk duhet ta shtrosh, nuk duhet t’i përgjigjesh kësaj pyetjeje, sepse ajo prek – cenon lirinë e njeriut. Nëse lutem, unë lutem për vete. Nëse lutem, unë nuk lutem për t’u treguar njerëzve se jam musliman i mirë. Disa shkojnë në xhami për t’u dukur aty, të tjerët shkojnë për ta kryer sinqerisht detyrën e tyre fetare.

- Babë, kam frikë, nuk po mund të fle.

- Mos u shqetëso.

- Kam dëgjuar se do të ketë luftë.

- Çfarë lufte?

- Nuk di. Madje edhe në shkollë na kanë thënë se duhet të kemi kujdes: nëse shohim ndonjë çantë të harruar në një skaj, duhet të thërrasim mësuesen, nuk di, kam frikë.

- Mos u shqetëso, pavarësisht nga të gjitha, jeta është e bukur!

Dita e dytë

E kam marrë me mend se ç' do të kishte dalë nga ky diskutim, sikur ta kisha vazhduar me fëmijë mosha e të cilëve do të sillej në mes dhjetë dhe pesëmbëdhjetë vjeç. Ia qëllova pyetjeve të tyre, shqetësimin e tyre, mosdurimin e tyre. Me këtë rast u shpjegoj Islamin dhe civilizimin arab fëmijëve të mi të lindur muslimanë, të gjithë fëmijëve çfarëdo qofshin vendet e tyre, origjina e tyre, feja e tyre, gjuha e tyre dhe po ashtu shpresat e tyre. Ky nuk është predikim, as pledoaje-ekspoze mbrojtës. Nuk mundohem të bind, unë shpjegoj në mënyrë sa më objektive dhe në mënyrë sa më të thjeshtë që është e mundur historinë e një njeriu që është bërë profet, shpjegoj po ashtu historinë e një religjioni dhe të një civilizimi që aq shumë kanë kontribuar për njerëzimin. E kam rilexuar Kur'anin, kam konsultuar libra specialitetesh, kam hulumtuar në Enciklopedinë e Islamit, dhe jam munduar të reprodukoj në disa faqe pesëmbëdhjetë shekuj historie, me shpresë se do të ndihmoj për të kuptuar sado pak, se ç'po ndodh sot.

- Babë, nuk e kam kuptuar mirë se ç'është Islami! Unë jam muslimane, por ç' do të thotë kjo?

- Përfitoj nga ky rast që të të drejtohem ty dhe të gjithë fëmijëve që kanë dëshirë të dinë.

- Do t'ju tregoj historinë e kësaj feje si një tregim. Para shumë kohësh, para më shumë se një mijë e katër qind e tridhjetë vjetësh, rreth vitit 570 lindi një djalosh i vogël në Mekë, një qytet i vendosur në shkretëtirën e Arabisë. Ai quhet Muhamed. Nuk e ka njohur babanë e vet, se i kishte vdekur para se të kishte lindur ai. Ai nuk do të shkoi në shkollë. Do të rritet pa ditur as shkrim as lexim. Njerëzit jetonin nga kullosat dhe nga tregtia që bënin karvanet që kalonin prej një qyteti në një qytet tjetër. Karvanet që vinin nga veriu, nga lindja, ose nga jugu, kalonin nëpër Mekë. Jo larg prej atje, gjendet qyteti Xheda, një port-liman.

- Si quhen banorët e këtij regjioni?

- Ata quhen arabë. Ata ishin beduinë, karvanë, nomadë. Jetonin nën tenda.

- Ç' do të thotë beduin?

- Beduinët ishin banorët e parë të Arabisë. Në këtë fjalë e gjejmë fjalën arabe bada'a, që do të thotë "shfaqem". Beduinët janë popujt e parë. Ata kanë jetuar në shkretëtirë ose në fusha.

- Po ç' do të thotë fjala nomadë?

- Nomadë janë ata që udhëtojnë, që nuk kanë vendbanim të caktuar. Pikërisht, beduinët ishin bashkësi të vogla që udhëtonin tërë kohën duke hulumtuar kulloso dhe burime uji. Ata udhëtonin me deve.

- Muhamedi i vogël ka lindur aty.

- Ç' bënte nëna e tij?

- Ajo quhej Emine (Amina), ajo vdes gjithashtu kur ai ishte fëmijë, kishte më pakë se dhjetë vjet. Ai pra shumë herët ka mbetur jetim. E ka rritur mëndesha Halime (Halima). Për edukimin e tij është kujdesur gjyshi. Muhamedi rritet në Mekë me xhaxhallarët e vet, të cilët ishin rojtarë të Qabesë (Kaba), një shtëpi e madhe në formë kubi, në të cilën gjendet një gur i njohur. Guri i zi, në të cilin profeti Ibrahim (Abraham), i Dashuri i Zotit do ta ketë vënë këmbën (do të ketë shkelur). Ky është gurë i shenjtë. banorët e Arabisë një herë në vit vinin në Mekë për ta prekur këtë gur. Ky quhet haxhillëk. Por, në këtë regjion kishte të krishterë dhe çifutë, do të thotë beduinë të cilët besonin vetëm në një Zot. Feja çifute, që quhet judaizëm, ekziston që prej 5.762 vjetësh, ndërsa feja e krishterë ekziston që prej 2002 vjetësh. Në atë kohë ata nuk ishin shumë në këtë regjion. Të tjerët i adhuronin statujat, gurët, që quhen "idole (idhuj)". Duket se në Qabe kishte 360 idhuj. Të gjithë arabët nuk i adhuronin ata. Disa prej tyre besonin në fuqinë e natyrës, në fuqinë e dritës, në fuqinë e erës, në mendjen e të parëve, do të thotë në ata që kanë jetuar para tyre...

- Ç' do të bëjë Muhamedi?

- Pas viteve të para të kaluara me mëndeshën, ai pastaj jeton me xhaxhanë Ebu Talib (Abou Talib), një njeri i varfër por shumë i drejtë dhe i mirë. Muhmedi e konsideronte si baba të vetin. Me të ai mëson besnikërinë, ndershmërinë dhe mirësinë. Në moshën 25 vjeç, Muhamedi do të punojë te një grua e pasur dhe e ve Hatixheja (Khadija). Ajo është më e vjetër se ai, i ka katërdhjetë vjet. Ajo posedon disa

karvane. Dhe e merr për grua; ata do t'i kenë tre djem e katër vajza. Për fat të keq, djemtë nuk do të jetojnë.

- Përse martohet me një grua më të vjetër se ai? Është martuar, sepse e ka pasur nafakë-kismet. Ajo ishte pronare e karvaneve dhe gjithnjë e më tepër ia besonte punët Muhamedit të ri. Një ditë ajo i propozon që të jetë në shërbim të saj më tepër sesa burrë. Ai pranon.

- A mbetet i afërt me xhaxhanë i cili e rriti?

- Po. Djali i Abu Talibit (Abou Talib), Aliu i lindur rreth vitit 600, është shumë i afërt me Muhamedin, ai është kushëri i tij, por njashtu mik – shok i tij. Ai do të luajë rol shumë të rëndësishëm pas vdekjes së Muhamedit. Se do të bëhet Muhamedi prijës i një feje, ai nuk e dinte që më parë. Ishte një njeri diskret dhe i ndershëm. Ai duhej të ndihej ndryshe prej të tjerëve. E kishte shprehur të shkonte në male në rrethinën e Mekës (Meque) dhe të tërhiqej në një shpellë për të menduar dhe medituar për jetën, për natyrën, për të mirën, për të keqen. Ai meditonte.

- Ç' do të thotë kjo “meditohj”?

- Kjo do të thotë mendoj thellë, shpresojë t'i gjejë një kuptim jetës.

- Para shumë kohësh, kjo fjalë donte të thoshte “mjekoj të sëmurin”. Muhamedi duhej t'ia gjente në qetësi dhe në vetmi një ilaç-një zgjidhje jetës në të cilën disa janë të varfër, ndërsa të tjerët të pasur, disa me shëndet të mirë, të tjerët të ligshhtë dhe të sëmurë.

- Por, ç'mund të bënte për njerëzit fatkëqij?

- Ai mendonte dhe kërkonte mënyrën që të jenë më pak fatkeq. Një ditë apo një natë në kohën kur gjendej në shpellën e malit Hira (Hira), iu shfaq një përfytyrim, do të thotë ai afër tij pa një dritë të fortë dhe të bukur, ishte një engjell i madh, i cili i urdhëroi të lexojë. I tha: “Lexo!” Por Muhamedi, që në atë kohë i kishte katërdhjetë vjet, iu përgjigj: “Nuk mund të lexoj!” Të mos harrojmë se ai nuk shkonte në shkollë, dhe nuk dinte as shkrim, as lexim. Atëherë engjëlli Xhebrail (Gabriel) kërkoi nga ai që të përsëriste pas tij: “Lexo në emër të Allahut – të Krijuesit! Ai e krijoi njeriun nga ngjizja. Lexo. Sepse Allahu është shumë zemërgjerë. Ai e mësoi njeriun me kalem dhe ia mësoi atë që nuk e dinte”. Muhamedi, i mallëngjyer dhe duke u dri-dhur nga frika, i përsëriti këto fjalë pas engjëllit Xhebrail (Gabriel).

- Ç' do të thotë ngjizje?

- Fjala arabe është alak (alague) që do të thotë “materie – lëndë ngjitëse” (që ngjitet). Disa këtë fjalë e kanë përkthyer “gjak i mpiksur”. Në të vërtetë fjala është për një lëng ngjitës të formuar nga spermatozoidet; që quhet “spermë”. Në saje të spermatozoideve krijohen qeniet njerëzore.

- Ç' do të thotë “kalem” (calame)?

- Kalemi është grafit që shërben për prodhimin e lapsit ose të bishtit të penës për të shkruar.

- Ç'bëri ai pas kësaj vizite? A u frikësua?

- Ishte shumë i shqetësuar. Muhamedi ishte një njeri modest, por shumë inteligjent dhe kishte frikë të binte në kurthë të ngritur nga djalli. Atëherë pasi kthehet në shtëpi i tregon gjëra të fshehta gruas së vet, Hatixhes (Khadija). Ajo shkon te një dijetar i krishterë i Mekës, Varaka Ibn Navfal (Waraka Ibn Nawfal), dhe kërkoi mendimin e tij dhe këshilla për atë që sapo kishte ndodhur. Ky njeri i mençur dhe i kulturuar, i tha se Muhamedi ishte një profet që e pritnin. Zoti duhej t'u dërgonte njerëzve një kumtar – një të dërguar, ky do të ishte i fundit, një njeri i cili do t'u fliste njerëzve të vet dhe t'i njoftonte se ç' do t'i diktonte drita e fortë.

- Përse Zoti nuk u flet drejtpërsëdrejti njerëzve?

- Ai ka dëshiruar më tepër të zgjedhë një njeri modest dhe të mirë që t'ia përcjellë mesazhet e tij dhe ta ngarkojë që t'ua përsëritë njerëzve të vet. Muhamedi, në saje të kësaj drite të fortë dhe të mrekullueshme, e merr Shpalljen.

- Ç' është shpallja?

- Shpallja është diçka që tregohet dhe bëhet e njohur, është si e vërteta kur e kërkojmë dhe kur ajo shfaqet, thuhet “doli e vërteta”. Muhamedi do ta shpallë fjalën e Zotit; ajo do të mblidhet për shumë vjet nga shokë dhe miq që do të krijojnë librin e muslimanëve, Kur'anin.

- Çka do të thotë fjala Kur'an?

- Kjo fjalë vjen nga folja “lexoj, recitoj”. Gjatë njëzet e tri vjetve, Muhamedi e merr fjalë për fjalë këtë libër unik, më vonë do të thuhet verset pas verseti, pastaj sure pas sureje, do të thotë kapitull pas kapitulli. Kjo do të bëhet gjithmonë me ndërmjetësimin e engjëllit Xhe-

brail (Gabriel), i cili i shfaqet atij në formë të një drite të madhe mahnitëse, që mesazhi-porosia-urdhëri i Zotit t'i arrijë Muhamedit.

- Ç'i thoshte Xhebraili Muhamedit?

- Ai i thoshte se s'ka Zot tjetër përveç Allahut të gjithëfuqishëm dhe shumë të mëshirueshëm. I thoshte se duhet t'i jem besnik fjalës së Zotit, se duhet besuar mesazhi i Tij, se pas vdekjes ekziston një jetë tjetër, se njeriu do të gjykohet sipas veprave të tij, dhe çdo pjesë e trupit të njeriut duhet të dëshmojë se ç'ka bërë gjatë jetës së tij, se njerëzit e mirë dhe të drejtë do të shpërblehen duke shkuar (me shkuarje) në Xhenet, dhe se të tjerët, të këqijtë, pabesimtarët, kriminelët, do të gjykohen dhe do të dërgohen në Xhehennem. Ai i thoshte se duhet të bëjmë mirë dhe të largojmë të keqen, se duhet të jemi të urtë (të arsyeshëm), se nuk duhet sidomos t'i adhurojmë gurët dhe të mos mendojmë se ka zota të tjerë përveç Zotit.

- Por mësuesja jonë, që është e krishterë, na mëson të njejtën gjë!

- Ti e di, siç të kam thënë, se para ardhjes së fesë së Muhamedit, ekzistonin dy fe, besimi i çifutëve dhe krishterimi. Që të dyjat adhurojnë vetëm një Zot. Edhe ato kanë pasur profetë. Musën (Moise) dhe Isain (Jesus). Çifutët, të krishterët dhe muslimanët duhet të formojnë “një bashkësi të vetme me besimtarët”. Islami vjen për t'iu bashkuar këtyre dy feve. Quhen fe monoteiste ose fe të librit. Libri i çifutëve është Tora (Thora), ai i të krishterëve është Bibla (Bible); ndërsa ai i muslimanëve është Kur'ani.

- E di ... mono do të thotë, vetëm një!

- Po, ashtu është. Monoteizëm do të thotë vetëm një Zot.

- Atëherë, nëse e kemi të njejtin Zot, përse muslimanët dhe çifutët bëjnë luftë?

- Ti po i ngatërron gjërat, muslimanët dhe çifutët grinden për të njejtën tokë, por kjo nuk është luftë fesh. Islami i njejtë profetët e çifutëve dhe të krishterëve. Si i njejtë ai? Muslimanët të cilët e adhurojnë dhe e duan profetin e tyre Muhamedin, të dërguarin e Zotit, e duan me të njejtin respekt Musain dhe Isain. Mos harro se Islami ka ardhur afro gjashtë shekuj pas Isait. Pra, kjo është feja e fundit monoteiste në historinë e njerëzimit.

- Ç'mendojnë të krishterët për muslimanët?

- Ky do të ishte tregim i gjatë. Por, ta dish se në vitin 1964 në Vatikan, në Romë do të thotë aty ku jeton Papa, është mbajtur një tubim i njerëzve të rëndësishëm të Kishës, të cilët kanë pranuar se në Islam ka vlera të çmueshme”. Ky tubim quhet Konkili-kuvendi Vatikani II”.

- Më shpjego përse ajo që i ka ardhur Muhamedit, është quajtur Islam, ose fe muslimane?

- Në fjalën “Islam” gjendet fjala salam, që do të thotë “paqe”. Islam do të thotë se njeriu i bindet paqes, i bindet një Zoti të vetëm, një Zoti të cilit duhet t’i bindet, t’i qëndrojë besnik dhe lojal.

- Si t’i bindemi dikujt që nuk shihet.

- Kur isha i vogël, më thoshin se Zoti di çdo gjë, dëgjon çdo gjë, sheh çdo gjë. E pyetja nënën time: “edhe mua kaq të vogël, kaq të dobët më vëren dhe më sheh”?

- Ajo më përgjigjej: pikërisht, Ai është i Gjithëfuqishëm, Ai të sheh, dhe nëse bën marrina, Ai nuk do të jetë i kënaqur. Një ditë volda një ëmbëlsirë dhe u mbylla një arkë për ta ngrënë. Mendoja: “Zoti nuk do të më shohë!” Më dhimbti barku, sepse e kisha përpirë ëmbëlsirën pa e përtypur!

- Nëse fshihesh mirë, Zoti nuk mund të të shohë!

- Përkundrazi, Zoti ka fuqi të shohë edhe atë që është e fshehur.

- Njerëzit e këqij, të cilët bëjnë luftë dhe në të njëjtën kohë luten dhe thonë se e adhurojnë Zotin, këta janë gënjeshtarë.

- Zoti i quan “hipokritë”. Zoti i ka dërguar Muhamedit një kapitull të tërë për hipokritët. Ai i dënon.

- Ma shpjego fjalën hipokrit?

- Thuhet se hipokrit është ai i cili është dyfytirësh, ai shkel të vërtetën duke të bindur se e thotë të vërtetën. Hipokriti është tradhtar dhe gënjeshtar.

Dita e tretë

T’i kthehemi historisë së lindjes së Islamit.

Por, para se të vazhdojmë çfarë gjuhe fliste engjëlli, e di ti dritën e mrekullueshme që e rrethonte Muhamedin?

- Gjuhën arabe.

- Pra, Zoti është arab!

- Jo, Ai nuk është as arab, as kinez, as afrikan, as indian. Zoti është Zot i të gjithë njerëzve pa përjashtim. Ai nuk bënë dallim në mes njerëzve. Këtë e thotë mesazhi i tij.

- Atëherë, përse nuk ka folur në gjuhën angleze, meqë kjo është gjuha që e flasin pothuaj të gjithë?

- Ai e ka folur gjuhën e vendit ku gjendej kumtuesi i tij, Muhamedi. Të kam thënë se Muhamedi jetonte në Arabi dhe se fliste gjuhën arabe. Për këtë arsye, arabët konsiderojnë se gjuha e tyre është gjuhë e Zotit.

- Kjo gjuhë është e njëjta si ajo e gjuhëve të mi në Marok?

- Jo, nuk është krejtësisht e njëjtë. Në Marok flitet një gjuhë e quajtur dialektore, në dallim nga gjuha arabe e librave, nga ajo klasike ose letrare. Por kur gjyshërit e tu luten, ata thonë versete nga Kur'ani në gjuhën arabe klasike.

- Po muslimanët që nuk janë arabë, si veprojnë ata?

- Ata lutjet i mësojnë përmendsh dhe i thonë pa i kuptuar të gjitha fjalët që i përdorin. Në parim ata ua dinë kuptimin. Ata që nuk janë arabofonë, Kur'anin e lexojnë të përkthyer në gjuhën e tyre.

- Si ka vepruar Muhamedi që njerëzit t'i besonin ngjarjes së tij?

- Pas gruas së tij, e cila menjëherë e kishte kuptuar se ai e thoshte të vërtetën, ishte kushëriri i tij, të cilit i dha të drejtë dhe u kthye në Islam, pastaj Ebu Bekri (Abou Bakr), miku i tij më i mirë, një njeri shumë i respektuar, pastaj djali i tij i adoptuar (i birësuar-marrë bir në shpirt), Zejdi (Zayd), pastaj Bilalli (Bilal), shërbëtori i zi i Ebu Bekrit.

Bilalli ishte skllav. Muhamedi e lëshoi në liri dhe pasi ai kishte zë shumë të bukur, e caktoi për të thirrë ezanin pesë herë në ditë. Ai është muezini i parë në Islam. Pastaj u desh të pritej disa vjet dhe po ashtu luftohej që pjesëtarët e fisit të tij t'i bashkoheshin.

- A kishte këtu skllavër?

- Po, skllavrimi ka ekzistuar në të gjitha shoqëritë. Duke e liruuar Bilallin, Muhamedi dha shembull në mënyrë që të gjithë ata që kishin skllavër, të vepronin si ai. Për fat të keq, ata nuk e ndoqën shembullin e tij.

- Njerëzit nuk pajtoheshin me të?

- Jo, jo të gjithë njerëzit. Ai do të luftonte, madje edhe brenda fisit të tij.

- Ai nuk bënte keq, apo jo?

- Jo, ai ishte një njeri i mirë, por siç thotë kënga: “njerëzit nuk duan të ndjekin një rrugë tjetër përveç rrugës së tyre”.

- Ai u thoshte që të bënin mirë dhe të mos tradhtonin...

- Po, por duhet të kuptosh, para kësaj ngjarjeje të shpalljes, para se Muhamedi të bëhej kumtues i Zotit, njerëzit e Arabisë bënin ç’të donin, ata nuk kishin rregulla të rrepta që duhej t’i respektonin. Përveç kësaj, ata mendonin se statujat prej guri ishin zota. Muhamedi arrin dhe u thotë: Zoti është e vërteta, Zoti është drejtësia, Zoti është frymë, për të jetuar së bashku na duhet morali, frymëzimi, duhet adhuruar Zoti i Cili nuk materializohet në një objekt, ekziston Xhehneni dhe Xheneti, të mirat e kësaj bote nuk janë me rëndësi, duhet të falemi – lutemi pesë herë në ditë, duhet të meditojmë dhe të besojmë në një Zot, i Cili është shumë i mëshirshëm etj.

- Njerëzit nuk do t’i besojnë...?

- Jo, ata nuk i besojnë menjëherë. Ky është dikush që i ndryshon zakonet e tyre. Atëherë ata e kundërshtojnë. Këtu Zoti i dënon në një verset të Kur’anit (sure IX, verseti 5). *“E kur të kalojnë muajtë e shenjtë: Vrani idhujtarët kudo që i gjeni. Kapini, rrethoni, futini në një ngushticë për t’i zënë. Por, nëse pendohen, nëse janë të vendosur në lutjet e tyre, nëse japin lëmoshë- sadaka, lërini të shkojnë rrugës së tyre. Vërtet Zoti fal Ai shpërblen”*.

- Idhujtarë janë ata që besojnë në shumë zota, u besojnë gurëve, idhujve prej guri.

- Ç’do të bëjë Muhamedi?

- Muhamedi do të përjetojë një moment shumë të vështirë. Në vitin 620, i vdesin gruaja, babai i tij adoptues dhe xhaxhai i tij Ebu Talib (Abou Talib). Ai mbetet vetëm për të luftuar kundër njerëzve të fisit të vet që duan ta vrasin. Me Ebu Bekrin (Abou Bakr) dhe me Aliun, ai lëshon Mekën. Ata strehohen në një shpellë për të shpëtuar nga njerëzit e armatosur që i ndjekin për t’i eliminuar. Në Islam nuk ka mrekulli sikur në dy fetë e tjera, por thuhet se hyrja e kësaj shpelle është mbyllur me pëlhurë të merimangës, e cila arriti të mbronte Muhamedin dhe shokët e tij.

- Tani po e kuptoj përse po më thua që të mos i mbysim merimangat! Kjo është një gjallesë e shenjtë!

- Si do që të jetë, në saje të kësaj pëlhere të thurur, profeti shpëton. Pastaj ai do të shkojë në një qytet tjetër, në Medinë, ku do të jetë i sigurt. Prej kësaj date fillon era muslimane. Ky vit do të thirret viti 1 i Hixhrit. Sot jemi në vitin 1422 të Hixhrit.

- Ç'është Hixhri?

- Fjala rrjedh nga fjala hajara, që do të thotë “emigroj” shkoj në një qytet tjetër ose në një vend tjetër.

- Pra, Muhamedi paska qenë një emigrues!

- Po, ai është detyruar të ikë që të vazhdojë të marrë dhe të dërgojë kumtimet e Zotit. Era muslimane fillon. Kalendari do ta përcjellë daljen (dukjen) e hënës. Për këtë arsye kurrë nuk dihet që më parë data e saktë e fillimit të muajit. Prej Medinës Islami dalëngadalë do të organizohet dhe do t'i vendosë pesë rregullat e veta të quajtura “pesë shtyllat e Islamit”. Shtyllë do të thotë themel që e mban shtëpinë.

- Ç'janë parimet?

- Parimet janë rregulla, udhëzime, urdhra.

- Atëherë, cilat janë rregullat e muslimanëve?

- Ato janë pesë. Kur ato respektohen, ti bëhesh musliman ose muslimane. Rregulla e parë është shahadeti (chahada), dëshmia e besimit, do të thotë se me zemër duhet të pranosh idenë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, dhe se Muhamedi është i dërguar i tij. Duhet të shqiptojmë këtë fjali. Këtë e thotë çdo musliman në çastin e vdekjes. Thuhet: ai dëshmon. Ai ngre gishtin tregues të dorës së djathtë dhe thotë: Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij”.

- A mund të thuash në gjuhën arabe?

- “*Esh hedu en la il-lahe il-la Allah ve esh-hedu enne Muhameden Resulu Allah*”.

- A mund të thuhet edhe atëherë kur njeriu nuk është në çastin e vdekjes?

- Natyrisht.

- Ti e thua shpesh?

- Kjo më ndodh.

- Si duhet vepruar për të qenë të sigurt (të bindur) për këtë?

- Është ajo që quhet besim-bindje, do të thotë ti e ke sigurinë, bindjen, askush nuk arrin të ta dëshmojë të kundërtën për atë që ti beson. Muslimanët duhet ta thonë këtë dhe sidomos pa dyshuar.

- Duhet thënë në gjuhën arabe apo në cilëndo gjuhë?

- S'ka rëndësi gjuha? Ajo që është me rëndësi, është që të bindesh me këto fjalë.

- Supozojmë se nuk jam bindur, ç'ndodh?

- Atëherë, ti nuk je musliman. Asgjë tjetër.

- Rregulla e dytë?

Lutja

Janë pesë lutje në ditë: lutja e parë është lutja e lindjes së diellit (falja e sabahut), lutja e dytë është lutja e diellit, kur dielli është në zenit (falja e drekës); lutja e tretë është lutja e mesit të pasditës (falja e iqindisë); lutja e katërt është lutja e perëndimit të diellit (falja e akshamit) dhe lutja e fundit është lutja e natës (falja e jacisë). Të gjitha këto lutje bëhen në drejtim të Mekes).

- A jemi të obliguar t'i bëjmë lutjet kur thirret ezani për lutje.

- Në parim po. Nëse punojmë, nëse jemi të sëmurë lutjet mund t'i bëjmë më vonë. Nëse njeriu është i hendikepuar, lutjet i bënë në mendje.

- Ti tashmë ke folur për abdest, a mund të saktësosh përse dhe si merret abdesti?

- Kur falemi-lutemi e dimë se i drejtohem Zotit, pra duhet të jemi të pastër, abdesti është pastrim i trupit që bëhet pikërisht para se të falemi. Por, kini kujdes, janë dy lloje të abdestit, abdesti komplet, që konsistojnë në larjen e tërë trupit pas marrëdhënieve seksuale, dhe abdesti i thjeshtë që është larja e fytyrës, kokës, të duarve dhe të këmbëve.

- Nëse duhet të pastrohemi pesë herë në ditë, duhet të jemi kampion të pastërtisë!

- Ke të drejtë. Muhamedi thoshte higjiena e vërtetë është nga besimi

- Ç'thuhet në lutje?

- Madhërohet Zoti dhe profeti i Tij. Thuhet sureja e parë e Kur'anit.

- Ajo kur engjëlli i tha Muhamedit: “Lexo”?

- Jo. Kur’ani është shkruar në radhën e verseteve të shpallura. Kur’ani fillon me një sure të shkurtër, që quhet “El-Fatiha” – “Hapja”. Në çdo lutje i thuren lavdi (lavdërohet) Zotit dhe e madhërojmë jo vetëm profetin Muhamed, por edhe profetët e tjerë: Ibrahimin (Abrahamin), Musain (Moise), Isain (Jezus). Në gjuhën arabe quhen: Ibrahim, Moussa dhe Issa.

- Shtylla e tretë?

- Është agjërimi gjatë muajit të Ramazanit. Muslimani nuk ha dhe nuk pi prej pa lindur dielli e derisa të perëndojë gjatë një muaji. Ai (muslimani) kështu mësohet me urinë, me etjen dhe e vë në sprovë vullnetin e vet për t’i përballuar tentativat dhe aftësinë e vet, që të meditojë mbi jetën dhe më larg. Është muaji kur duhet të sakrifikojë me prehjen e shpirtërave, me lutje edhe me sprovë të sjelljes së tij në jetë. Fundi i Ramazanit shënohet me festën që quhet Bajram i Vogël.

- Të gjithë e ndërpresin të ngrënë dhe të pirët?

- Jo. Fëmijët që nuk e kanë arritur moshën e pubertetit dhe personat e sëmurë, nuk duhet të agjërojnë. As gratë kur kanë menstruacione.

- Lëmosha që quhet Zeqat (Zeka)

- Është një sasi të hollash që besimtari i ka fituar gjatë vitit; ai ua shpërndan të varfërve, nevojlinjve, dhe kjo duhet të bëhet në mënyrë diskrete, për këtë nuk duhet të lavdërohem, as t’i përmendim të varfërit me qëllim që të turpërohen. Duhet t’u ndihmojmë njerëzve që janë në vështirësi (halle).

- Shtylla tjetër, rregulla, parimi është Haxhi në Mekë, i quajtur Al-Hajj. (Ata që nuk kanë mundësi materiale ose fizike mund të mos e bëjnë – nuk janë të detyruar). Muslimani shkon në Mekë dhe në Medinë për t’u kredhur në prehe shpirtërore mbi varrin e profetit Muhamed dhe për t’u sjellë rreth tempullit, Qabes (Kaba) duke u munduar të prekë me dorë Gurin e zi famoz. Haxhi bëhet çdo vit në kohën e Aide al Adha, e njohur më tepër me emrin “Festa e dashit-kurbanit”, me fjalë të tjera festa që i thur lavdi sakrifikimit të Ibrahimit, e kupton ti, i Dashuri i Zotit, ai i cili për pak e sakrifikoi djalin e vet, dhe atëherë Zoti i dërgoi një dash për ta therë në vend të djalit të tij.

Kjo është një festë shumë e popullarizuar. Për shumicën e njerëzve është rasti për të ngrënë mish.

- Islami thotë se nuk duhet ngrënë mish derri, sepse kjo kafshë ushqehet me mbeturina.

- Por, sot derrat rriten në mënyrë të pastër, sikur delet.

- Po, por është shumë vështirë që të shqyrtohet përsëri një ligj fetar. Ndalimi tjetër ka të bëjë me alkoolin. Ekzistojnë tri versete, të shpallura në kohë të ndryshme për të ndaluar përdorimin e pijeve të fermentuara. Njeriu që dehet, e humb vetkontrollin. Pra, Islami insiston në zotërimin e vetvetes dhe po ashtu për lirinë e tjetrit (njeriut), gjë që e bën përgjegjës.

- Të mos pish alkool, a do të thotë se je i lirë?

- Liria konsiston që t'i ofrosh zgjidhje njeriut. Njeriu mund të pijë ose të heqë dorë nga pija. Por, nëse pi dhe dehet, ai është vet përgjegjës për atë që bën.

- A ka gjëra të tjera të ndaluara?

- Po, loja me të holla; realizimi i kamatave me të holla.

Këto ndalime janë të rralla, njerëzit i konsiderojnë më pak të këqia se të tjerat. Por këtyre ndalimeve u duhet shtuar fakti se muslimanja nuk ka të drejtë të martohet me një jomusliman, vetëm nëse ky kthehet në Islam.

- Por supozoj se burrat mund të martohen me jomuslimane!

- Po, ata kanë të drejtë të martohen me jomuslimane.

- Kjo nuk është e drejtë.

- Kjo është kështu për shkak të emrit, i cili përcillet nga babai. Është fjala për një shoqëri ku dominon patriarku, do të thotë kryetari i familjes. Thuhet se kjo është një shoqëri patriarkale. Për këtë arsye gruaja është e nënshtruar, e varur nga burri, pra e ndikuar. Nëse ajo martohet me një jomusliman, ajo rrezikon të mos konsiderohet muslimane, dhe fëmijët e saj mund të edukohen në fenë e babait.

Dita e katërt

- Prej Medinës, ku Muhamedi strehohet, dhe e ndien veten të sigurt, do të organizojë luftën e vet që shumica e njerëzve të bëhen muslimanë, që të ekzistojë një shoqëri solidare e njerëzve të bashkuar rreth besimit në një Zot. Muhamedi do të luftojë kundër fiseve që kërcënonin muslimanët dhe do të bëjë ashtu që më në fund edhe

armiqtë e tij të ktheheshin në Islam, si Ebu Sufjani (Abou Soufyan), udhëheqës i një fisi që e kishte luftuar (kundërshtuar).

Sipas thënieve të dëshmitarëve të kohës, Muhamedi shfaqet si një njeri i aksionit, një prijës ushtarak dhe si një prijës politik. Ai pati dy luftëra të mëdha: në Bedr (Badr), pastaj në Uhud (Ohod). Me të (Muhamedin) nocioni – emri *Umma Islamia (Oumma islamiya)*, Uma është bashkësia, tërë muslimanët. Në vitin 632 Muhamedi vjen në Mekë (Meque) për të kryer haxhin rreth Qabesë (Kaba). Thonë se kur shkoi u kthye nga Qabeja dhe të ketë thënë: “Sa i bukur është ky tempull. Nuk ka gjë më madhështore dhe më të bukur se dinjiteti i njeriut!”

- Ç’është dinjiteti?

- Dinjiteti është respektimi i vetvetes, ndjenja që t’u jesh besnik vlerave dhe cilësive që bëjnë që njeriu të jetë krenar se është njeri. Përkundrazi, jodinjiteti, është ultësia, mungesa e çdo vlere, është fakti të heqësh dorë për të qenë një njeri i drejtë dhe guximtar. Do të thotë rëndësia që i jepet kësaj cilësie që duhet ta ketë çdo qenie njerëzore.

- Çka ndodhë pastaj?

- Ai e ndien se Zoti do ta ftonte atë përsëri dhe se misioni i tij kishte përfunduar. Ai përsëri shkon në Medinë, ku vdes më 8 qershor 632.

- Kush e ka zëvendësuar?

- Askush. Ai ishte profeti, i dërguari i fundit i Zotit në tokë. Zoti ua kishte dërguar njerëzve, pastaj e ka ftuar atë. Miku dhe shoku i tij Ebu Bekr (Abou Bakr) e udhëhoqi lutjen në emër të të gjithë muslimanëve. Atë do ta zgjedhë një pjesë e popullit si halif, do të thotë prijës të muslimanëve që do t’i ndjekë rregullat që i la Muhamedi. Këta janë muslimanë të quajtur suninj. Të tjerët e preferojnë Aliun, kushëririn e Muhamedit. Këta qenë shiinjtë. Ata ishin kundër suninjve kur Aliu desh të bëhej halif. Sot shiinjtë paraqesin 10% të muslimanëve në botë. Ata dallohen prej suninjve për faktin se ata jepen pas përfaqësuesve të quajtur “mulla” (moullahs).

- Kam parë në televizion muslimanë duke goditur gjoksin, është normale kjo?

- Këta janë shiinjtë, vuajtjen – dhembjen e shprehin duke lënduar vetveten.

- Çfarë vuajtjeje-dhembjeje?

- Kur prijësi i tyre Hyseni (Hussein), njëri prej djemve të Aliut, vritet më 10 tetor 680 në betejën e Qerbelasë (Karbala), shiinjhtë e ndien veten fajtorë që nuk mundën ta mbronin dhe shpëtonin. Për këtë arsye çdo vit ata e festojnë këtë ditë për të shprehur zinë-pikëllimin. Disa e teprojnë duke e dënuar vetveten dhe duke e goditur furishëm, nganjëherë deri sa t'u dalë gjaku.

- Prej këtij momenti Islami do të shpallet në regjion dhe më larg. Njëzet vjet pas vdekjes së Muhamedit, Osmani (Othman) halifi i tretë i mblodhi 114 kapitujt – suret që e përbëjnë Kur'anin, libër i shenjtë dhe fjalë hyjnore.

- A e ke lexuar Kur'anin?

- Kur isha në moshën tënde, dhe madje para se të shkoja në shkollën kuranore ku na e mësonin Kur'anin përmendsh. Edhe pse nuk dija ende të lexoja, i mësoja versetet një pas një. Të nesërmen i recitoja, nëse gaboja, haja një thupër.

- Dhe prindërit e tu nuk thoshin asgjë?

- Ata nuk e dinin. Mundohesha çdo mbrëmje të përsëritja versetet që t'i recitoja të nesërmen.

- Ti e kuptoje atë që e mësoje përmendësh?

- Jo krejt. E dija se duhej adhuruar Allahun, Zoti i vetëm, se duhej bërë mirë, të mos gëënjeja, të mos vjedh, të dëgjoj prindërit e mi, të nderoj mësuesin e shkollës, të lutem, se përndryshe Zoti na dënon. Nganjëherë kisha frikë sidomos kur Zoti flet për Ferrin dhe për Ditën e Gjykimit të fundit. Dhe menjëherë pastaj vijnë-pasojnë versetet që na kujtojnë se Zoti është i mëshirshëm dhe i fal ata që kanë gabuar.

- Prej çfarë je frikësuar më së shumti?

- Kur mësuesi i shkollës kuranore na e ka përshkruar se çfarë e pret njeriun që bën vetëvrasje, do të thotë që nuk e përfill vullnetin hyjnor. Ti e di, dikush që e vret veten, duke u djegur, ky gjest e drejton përgjithmonë në ferr. Ai që hidhet nga ndërtesat e larta do të hidhet në pafundësi. Kjo është e tmerrshme! Kjo vlen nëse njeriu është besimtar.

- Pra, nëse flasim për atë se ç'po ndodh sot, Zoti do t'i dënojë ata që i vranë amerikanët.

- Besoj.

- Përse për këtë nuk je i sigurt? Çdo gjë që më ke treguar, nuk duket të jetë e vërtetë.

- Çdo gjë që të kam treguar, është e vërtetë. Kjo bën pjesë në historinë e njerëzimit. Lidhur me Zotin, njeriut i ndodh të parashtrijë pyetje, sidomos kur ai sheh vuajtje, padrejtësi, mjerimin që mbretëron në botë. Të krishterët thonë se “Zoti është dashuri, muslimanët thonë se Zoti është drejtësi; Zoti është vërtetësi”, atëherë kur bota përçahet nga luftërat, kur të rinjtë heqin dorë nga jeta, sakrifkohemi duke vrarë njerëz të pafajshëm, në emër të Islamit, atëherë njerëzit shtrojnë pyetje. Vetëm kafshët nuk dyshojnë.

- Ç’do të thotë të dyshosh?

- Besimi fetar është bindja. Të besosh, do të thotë të pranosh, t’i besosh fjalës së dhënë dhe t’i mbetesh besnik. Fetë nuk durojnë dyshim, por është fakt i mosbesimit verbërisht, do të thotë të futësh arsyen në fushën e besimit. Të dyshosh, do të thotë të parashtrish dhe të shpresosh përgjigje të drejta (të sakta). Por logjika dhe besimi nuk shkojnë së bashku.

- Po ti, a je besimtar?

- Kur njeriu ka një mendim logjik, nuk është lehtë të jetë besimtar si e mendojnë njerëzit që kanë besim. Për shembull, për t’iu përgjigjur pyetjes sate që besoj se ekziston një shpirtëzim, diçka misterioze dhe diçka e bukur në të njejtën kohë dhe e cila më frikëson shumë. Këtë mund ta quajmë Zot. Ndihem fare i vogël para madhësisë së Universit-Gjithësisë dhe nuk jam në gjendje të kuptoj çdo gjë. Siç ka thënë një filozof “inteligjenca (zgjuarësia) është mosnjohje – moskuptim i botës”.

- Asgjë nuk kuptova.

- Duhet t’u ruhemi njerëzve që pretendojnë t’u japin përgjigje të gjitha pyetjeve që i parashtron njeriu. Pikërisht fanatikët thonë se feja u përgjigjet të gjitha pyetjeve të botës. Kjo është e pamundur.

- Po Islami?

- Ti e di se kjo fe i ka dhënë njerëzimit një civilizim të mirë, një kulturë shumë të gjerë. Ajo që është karakteristike për këtë fe, është se këtu nuk ka prift, nuk ka peshkop, nuk ka papë. Nuk ka ndërmjetësues në mes besimtarit dhe Zotit.

- E di se te katolikët ka priftërinj të cilët nuk kanë të drejtë të martohen!

- Po. Më dukej e çuditshme që shokët e mi të liceut shkonin të shtunën të rrëfeshin në kishë përpara priftit.

- Unë u thosha: “Ju me Zotin duhet të bisedoni, dhe atij duhet t’i kërkoni falje, nëse keni bërë diçka të keqe”. Ata më përgjigjeshin se kjo ishte traditë e tyre.

- Pra, në Islam nuk ka rrëfim.

- Jo. Para se të mos jetë fyer, siç është fyer sot nga njerëz të çmendur ose nga injorantët, civilizimi islam gjatë tre shekujve, në mes shek. IX dhe XI ka qenë në nivelin më të lartë të zhvillimit dhe të kulturës në botë.

Dita e pestë

Që ty të rrëfej për këtë epokë të mrekullueshme e quajtur *Koha e artë e arabëve*, dhe para se t’i kthehem gjendjes së sotme, e cila siç e ke vërejtur, është tepër e keqe për vendet arabe dhe muslimane, do të kërkoja nga ti të imagjinosh-mendosh një ëndërr, të hysh në një botë të mrekullueshme ku mbretëron paqja, urtësia, harmonia në mes njerëzve, kureshtja ku çdo gjë është ndryshe, një botë ku fëmijët janë të lumtur që shkojnë në shkollë sepse i mësojnë përmendsh versetet e Kur’anit, por shpejt i marrin njohuritë e para të gjuhëve të huaja, të muzikës, dhe madje të shkencës.

- Unë po i mbyll sytë dhe lejoj të prihem nga rrëfimi juaj!

- Feja muslimane do t’i nxitë arabët që të shkojnë të përhapin urdhrin e Allahut nëpër botë. Ata do të shkojnë në Lindjen e Mesme (Siri, Egjipt, Irak, i quajtur gjysmëhëna e pëlleshme, Mesopotamia), në Azi, në Persi, në Magreb. Këto fitore nuk qenë gjithmonë paqësore. Këtu ndodhën beteja, rezistenca, vdekje. Ko është normale “meqë armatat arabe pushtonin vende pa pëlqimin e popullatave. Ata shpeshherë vendoseshin pranë oazave, lumenjve, nëpër kampe ku përgatitnin ekspeditat e reja. Ka pasur po ashtu konflikte brenda klaneve muslimane. Dalëngadalë, në saje të përhapjes së Islamit, arabët do të kenë perandorinë e tyre. Kultura arabe do të zhvillohet dhe do të pasurohet, sepse ajo do të dijë të hapet në botë. Gjuha e Kur’anit do të zëvendësoj greqishten dhe persishten, në atë masë sa që një historian iranian i

shk. X do të thotë: “Gjuha arabe është gjuhë depozituese-permbajtësore e të gjitha arteve të botës; ajo i pushton thellë zemrat tona, fuqia e saj na magjeps shumë shpirtin tonë.

- Ç’do të thotë depozituese-permbajtësore?

- Në këtë fjali, do të thotë se gjuha arabe ngërthen të gjitha artet, se nga ajo lindin të gjitha veprat artistike, si poezia, shkencat, mjekësia etj.

Çdo gjë që përparon njerëzimin dhe e bën të mirë.

- Atëherë, gjithë bota fliste arabisht!

- Jo, nuk flitnin të gjitha vendet, por gjuha arabe në atë kohë ishte bërë e rëndësishme, sa greqishtja në historinë e lashtësisë.

- Unë nuk e njoh rëndësinë e greqishtes në kohët e lashta, supozoj se arabishtja mësohej në të gjitha shkollat, jo sikur sot.

- Gjithë bota e mësonte arabishten, sepse dijetarët muslimanë arabë fillojnë të bëjnë një punë të madhe të përkthimit të tërë asaj që gjuhët e tjera kishin krijuar të rëndësishme. Kështu ata përkthejnë libra të filozofisë greke, vepra nga persishtja nga indishtja...

- Ma shpjego fjalën filozofi.

- Kjo është dashuria ndaj urtësisë dhe dijes. Në filozofi njeriu mësohet të mendojë duke studiuar atë që tashmë e kanë zbuluar dhe shkruar të vjetrit-të parët. Kjo është përdorim i arsyes për të menduar me logjikë dhe për të mësuar ku-nga shkon jeta.

- Mirë, ta zëmë se e kuptova!

- Insistoj: filozofia është të mësuarit e asaj që mendojmë. Për këtë arsye, kur arabët përkthyen dhe publikuan studimet filozofike të grekëve, njerëzimit i bënë një shërbim të madh. Në sajë të arabëve, gjithë bota e ka zbuluar-mësuar se ç’janë filozofët e mëdhenj grekë. Gjuha arabe bëhet gjuha e parë çdokund.

Dituria, mjekësia, matematika, gjeografia, astronomia, - të gjitha këto mësoheshin në gjuhën arabe. Profeti Muhamed, i cili nuk kishte pasur fat të shkonte në shkollë, thoshte se çdo musliman duhet të shkojë të kërkojë dituri kudo në botë.

- Kur muslimanët okuponin një vend, njerëzit ishin të obliguar të mësonin arabishten?

- Ata nuk ishin të obliguar, por në atë kohë, nëse njeriu donte të studionte të shkonte më tutje në studimet e tij, të mësonte shumë

gjëra, duhej të njihete gjuhën arabe. Gjuha e Islamit u imponua si gjuhë e parë e folur dhe e shkruar në botë.

- Prej shek. IX, dija – shkencë si gjuhë kishte-përdorte arabishten, që nga Spanja deri në Kinë. Hulumtimet shkencore që mundësonin të bëheshin zbulime, bëheshin arabisht, qoftë kjo në Bagdad, në Damask, në Kajro ose në Grenadë, në Palerma ose në Samarkand. Çdokund ndërtoheshin universitete dhe biblioteka që quheshin “Shtëpi Diturie”.

- Ç’është shtëpia e diturisë?

- Kjo ishte një qendër ku mbledheshin njerëzit që dëshironin t’i thellonin studimet e tyre, të diskutonin me njerëz më të ngritur ose me më shumë përvojë se ata, ku çdo gjë ishte bërë për të lehtësuar fitimin e diturisë dhe të njohurive.

- Dhe njerëzit shkonin aty?

- Po, ekzistonte një etje për të mësuar, një zell i madh për të studiuar. Njerëzit zbulonin botën, kultura të ndryshme, gjuhë të ndryshme.

- Kush i nxiste përkthimet dhe studimet?

- Halifët, do të thotë udhëheqësit e shteteve, ata që përhapnin Islam. Por edhe njerëzit e pasur jepnin të holla për të përkthyer vepra të rëndësishme dhe për të ndërtuar Shtëpi të Diturisë, do të thotë shtëpi të kulturës. Nëse të gjithë bota fliste arabisht, njësoj flitnin edhe evropianët?

- Jo. Evropianët përfitonin nga zbulimet dhe nga përkthimet e bëra nga arabët që të përparonin në kulturën e tyre.

- Cili ishte kryeqyteti i kësaj perandorie?

- Ishte Bagdadi, qyteti kryesor i Irakut. Halifi më i njohur quhej Harun El Rashid (Haroun Al Rachid), ai për të cilin flitet në tregimet “Një mijë e një net”.

- Dhe arabët vetëm libra përkthenin?

- Jo, ata shkruanin, bënin hulumtime shkencore, për shembull në mjekësi; ata ndërtonin universitete, medrese do të thotë shkolla fetare, biblioteka, xhami, pallate etj. Përkthimi do të thotë se arabët nuk e konsideronin veten si dijetarë të cilët nuk kishin ç’të mësonin më. Përkundrazi, njeriu i vërtet i kulturës është ai i cili thotë se gjithmonë mëson nga të tjerët. Ata donin të dinin se ç’mendonin dhe se ç’bënin në fushën e shkencës dhe të letërsisë, të arkitekturës, të tregtisë, popujt e tjerë, të cilët nuk ishin as muslimanë as arabë.

- Më shpjego se si përkthehet?

- Të kalosh – të përkthesh prej një gjuhe në një gjuhë tjetër nuk është lehtë. Fjala është që barasvlerën e asaj që është shkruar në një gjuhë, ta transmetosh në një gjuhë tjetër. Përkthimi shpesh është tregues – shenjë e kureshtjes. Po të jap një shembull: arabët, edhe sot vazhdojnë të përkthejnë librat e shkrimtarëve të Evropës, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Latine. Mund të gjesh në libraritë arabe aq shumë ndoshta më shumë libra të përkthyer nga gjuhët e huaja sesa libra të shkruar në gjuhën arabe. Kjo do të thotë se arabët janë të etshëm për të mësuar. Nëse shkon në një librari, për shembull në Amerikë, do të konstatosh se ka shumë pak libra të përkthyer. Një hulumtim i ri ka treguar se prej 100 librave të botuara nga botuesit amerikanë, vetëm tre kanë qenë të përkthyer. Se ç'mendojnë ose ç'shkruajnë popuj të tjerë vërtet amerikanëve nuk u intereson.

- Ata janë të fuqishëm!

- Ata janë të pasur, para së gjithash, dhe mendojnë se nuk kanë nevojë për kulturën e të tjerëve.

- Vazhdo të më flasësh për kohën kur arabët ishin të fuqishëm.

- Fuqia e tyre nuk ishte fuqi fizike. Ata e kishin kuptuar se hulumtimi i vërtetë nuk bëhet me armë, por bëhet me kulturë madje qoftë edhe të kenë hyrë në luftë kundër popujve të tjerë.

- Përcaktoma kulturën?

- Jam i prirur të them atë se ç'na dallon nga kafshët. Fjala kulturë vjen nga fjala kultivoj tokën, punoj dhe aty mbjell farë. Qenia njerëzore ka aq shumë nevojë për të ngrënë dhe për të pirë, të jetë mirë nga shëndeti, aq sa edhe të mësojë se ç'është bota që e rrethon dhe në të cilën jeton.

- Kultura është prodhim i zgjuarsisë, ajo që na mundëson të zhvillojmë mendjen tonë, që të mendojmë më mirë dhe të jemi në kontakt me atë që stërgjyshërit tanë na kanë lënë. Kultura përcillet brez pas brezi. Tërësia e shprehjeve dhe e zhvillimeve të saj quhet “qytetërim-kulturë”.

- Ç'na kanë lënë stërgjyshët tanë?

- Kjo çështje më mundëson të kthehem prapa dhe të flas për diturinë islame. Arabët na kanë lënë, jo vetëm neve arabëve dhe muslimanëve, por gjithë njerëzimit, shumë gjëra të mira: algjebren (kjo

është një fjalë arabe që do të thotë “zbritje”, zeron, po shifren zero, do të më thuash se kjo nuk është asgjë, por kjo është baza, madje e të gjitha matematikave. Në arabisht, zero thuhet sëfër, që do të thotë i “zbr-azët”, gjë kjo ka dhënë po ashtu fjalën “shifer”. Pa hyrë në hollësitë historike, dije se ai që më së shumti i ka nxitur dijetarët, poetët, hulumtuesit, quhet Al Ma'mun (Al Ma'moun), halif i biri i Harun Al Rashidit (Haroun Al Rachid). Ai ka udhëhequr një perandori të madhe, kryeqyteti i së cilës ishte Bagdadi, i cili në atë kohë, do të thotë në shek. IX kishte më shumë se një milion banorë me origjinë dhe me fe të ndryshme. Në të njejtën epokë, Roma qyteti më i banuar i Evropës, kishte vetëm 30.000 banorë. Mbaheshin takime ne mes dijetarëve të ardhur nga India, Kina, Evropa dhe nga Bota arabe. Bagdadi ishte kryeqyteti i kulturës botërore.

Kështu çdo të martë, halifi i ftonte dijetarët dhe njerëzit e kulturës të pranishëm në Bagdad, për të kaluar ditën duke diskutuar, duke medituuar, duke këmbyer ide dhe mendime. Shtëpitë e diturisë shumëfishoheshin. Duhet thënë se letra, e importuar nga Kina, do t'u mundësojë kopjuesve të dorëshkrimeve të punonin gjithnjë e më shumë.

- Librat nuk ishin të botuar?

- Jo. Shtypshkronja do të zbulohet shumë më vonë, në shek. XV (ai që do t'i bëjë provat e para të shtypit, është Gutenbergu, i lindur në Mejansë (Meyance) rreth vitit 1400). Por, ta dish se mulliri i parë i letrës është ndërtuar në Bagdad në vitin 794. Manufakturat e tjera të letrës do të krijoheshin në Egjipt, në Palestinë, në Siri. Me kinezët, arabët e Sicilisë (Sicile) dhe të Andaluzisë (Andalousie) do ta futin në përdorim industrinë e letrës në Evropë.

- vijon -

*Përktheu nga frengjishtja:
Qemal Selishta*

Dr. Jusuf Ramić

MENDIMET E DISA ORIENTALISTËVE EVROPIANË PËR TESAVVUFIN ISLAM

I

Fjala “mistik”, të cilën e hasim tek grekët e vjetër, ka hyrë edhe në letërsinë evropiane, duke ruajtur të njëjtin kuptim. Termi që i përgjigjet këtij plotësisht në gjuhën arabe, turke e persiane – tri gjuhët kryesore të Islamit – është fjala “sufi”. Megjithatë, me shfaqjen e tesavvufit si lëvizje filozofike, lindën edhe kuptime dhe interpretime të ndryshme etimologjike të kësaj fjale. Kështu, disa mendojnë se fjala “tesavvuf” ka prejardhjen nga “saf” shm. “sufuf”. Të tjerët thonë se rrënjën e ka tek “saffa”. Kurse, disa të tjerë shkojnë aq larg dhe argumentojnë se kjo fjalë është marrë nga “suffa”, duke pohuar se sufistët janë sikurse “banorët e sofës”, emër me të cilin janë quajtur muslimanët e varfër në fillim të shfaqjes së Islamit.

Pasi nuk kishin ku të banonin, ata strehoheshin në sofë, të cilën e pati ndërtuar Muhammedi a.s. bashkë me xhaminë në Medinë. Numri i saktë i “banorëve të sofës” nuk dihet, por dihet se ndërmjet tyre ishin: Bilal b. Rebbahu, Amr b. Jasiri, Zejd b. Hattabi – vëllau i Omerit r.a., pastaj Ebu Dherri, Ebu Ubejd b. Abdullah b. Xherrahi etj. Megjithatë, të gjitha këto mendime të lartpërmendura dhe përkufizime eti-

mologjike të fjalës “tesavvuf”, nuk janë në pajtim me gjuhën, siç e pohojnë këtë Kushejri dhe shumë të tjerë.

Disa, mendojnë dhe pohojnë se baza e kësaj fjale është marrë nga “suf” (lesh), duke argumentuar me atë se sufitet e parë e kishin zakon të vishnin pelerinë të bardhë leshi, duke ia mvëshur Aliut r.a. se kishte marrë “suf-in” si shenjë të tesavvufit. Këtë mendim e kanë përkrahur edhe shumë orientalistë evropianë, si: Carra de Vaux¹ dhe Massignoni.²

Carra de Vaux, për saktësinë e këtij mendimi, merr për argument Gazaliun “El-Ihja, vëll.III fq.243”, mirëpo duhet cekur se ndeshemi edhe me një numër jo të vogël të atyre, të cilët kuptimin e tesavvufit ia mvëshin fjalës greke “sophia” (urtësi). Mirëpo, prof. Nöldeke³ konsideron se shkronja greke “s”(sigma) në gjuhën arabe është transkriptuar gjithmonë me “س” (sin) e jo me “ص” (sad). Sipas mendimit të tij, për këtë rregull nuk ka asnjë përjashtim në gjuhën arabe.

Pra, nëse themi se fjala “tesavvuf” rrjedh nga “sophia”, atëherë do ta shkruanim me “س” e jo me “ص”. Dhe në fund, në një artikull për tesavvufin islam, të botuar më 1894, Nöldeke e pranon mendimin e Carra de Vaux-it, Massignonit dhe të tjerëve për kuptimin etimologjik të kësaj fjale.

¹ Baron Carra de Vaux i përket plejadës së orientalistëve francezë, i cili u lind më 1868. Ka diplomuar në gjuhë arabe në Institutin Katolik të Parisit. Kujdes të veçantë u ka kushtuar shkencave matematikore, historisë dhe filozofisë, në të cilat është i popullarizuar.

² Massignon (1883-1962), poashtu francez. Lindi afër Parisit. Pas studimeve të kryera në Paris, një kohë qëndron në Algjeri, ku edhe merr pjesë në kongresin e XIV të orientalistëve, që u mbajt më 1905 dhe aty njihet me Goldziherin dhe me përfaqësuesit e tjerë të orientalistikës evropiane. Më pas, e viziton Kairon, ku prezenton në ligjëratat e Al-Azharit si student i rregullt, kurse nga viti 1912-1913 emërohet profesor i historisë dhe i filozofisë në universitetin e Kairo, e më pas asistent në Katedrën për sociologjinë islame në Institutin e Parisit (1919-1924).

Ka doktoruar në Sorbonë dhe ishte kryeredaktor i revistës “The World of Islam”. Kujdes të veçantë i ka kushtuar tesavvufit në “Enciklopedinë islame”, ku ka qenë njëri prej kryeredaktorëve të saj.

³ Nöldeke (1836-1930), lindi në Hamburg. Është njëri prej përfaqësuesve të orientalistikës gjermane. Një kohë të gjatë qe profesor në Katedrën për gjuhët orientale në Strasburg (1872-1920), e cila më vonë u bë qendër e orientistikës gjermane. Më hollësisht për të, shih: Der Islam, Hamburg, 1932; Studime orientale – 1/2001, Prishtinë.

II

Përprojekja që është bërë deri më tani në studimin e tesavvufit – misticizmit islam – paraqet vetëm fazën fillestare, edhe pse një numër jo i vogël i studiuesve ka punuar mjaft në ndriçimin e kësaj pjese të filozofisë islame, duke filluar që nga fillimi i shek. XIX e deri më sot. Natyrisht, përprojekja e tyre ka dhënë rezultate të mira, por e gjithë kjo është pak nëse merren parasysh fushat e tesavvufit, që s'janë prekur ende.

Me dhjetëra, madje edhe me qindra vepra arabe për tesavvufin, janë ende në dorëshkrim dhe ato presin të nxirren në dritë, të trajtohen e të botohen. Midis këtyre dorëshkrimeve, ka edhe të atilla që flasin për historinë dhe zhvillimin e tesavvufit, andaj ndihet nevojë e domosdoshme që këto dorëshkrime të botohen. Ne, p.sh., nuk dimë se në ç'masë ka ndikuar Islami në misticizëm në periudhën e tij të parë. Pastaj, nuk dimë po ashtu se si dhe në ç'mënyrë janë futur në të idetë e krishterimit, gnosticizmit dhe neoplatonizmit.

Ende e kemi të paqartë se në ç'formë erdhën këto ide dhe kur ndodhi bashkimi i këtyre ideve me misticizmin islam.

Të gjitha këtyre çështjeve nuk u jemi qasur aq sa duhet, andaj edhe kanë ngelur të pashpjeguara. Kështu, lindën kundërshtimet dhe gjykimet e ndryshme për tesavvufin: Ku lindi dhe ku e ka fillin ai?

Disa pohojnë se tesavvufi, si lëvizje filozofike është larg Islamit dhe parimeve të tij, duke konsideruar se muslimanët janë njohur me tesavvufin në Persi gjatë pushtimit të saj, kurse, sa i përket zanafillës së tij të vërtetë, ajo gjendet në idenë mistike indiane. Të tjerët theksojnë se rrënja e tesavvufit gjendet në murgërinë krishtere, që në vete përmban idetë e gnosticizmit dhe neoplatonizmit, por të tjerë mendojnë se tesavvufi në periudhën e krijimit ishte plotësisht në frymën e Islamit dhe se me anë të tij mund të njihet Islami si dhe jeta dhe vepra e Muhammedit a.s.

Të gjithë të lartpërmendurit tesavvufin e shikojnë si një pasqyrim të diçkaje të veçantë e nuk e shikojnë si një lëvizje në tërësi, që është pasqyrim i jetës fetaro - kulturore dhe politiko - shoqërore të muslimanëve, si lëvizje e cila është shfaqur dhe zhvilluar nën hijen e zhvillimit të përgjithshëm, nëpër të cilën ka kaluar historia muslimane në tre shekujt e parë.

Pra, është e pamundur të kërkohet themeli i kësaj lëvizjeje në një burim, por duhen shikuar të gjitha rrethanat, që kanë ndikuar në shfaqjen dhe zhvillimin e kësaj lëvizjeje filozofike.

III

Interesimi i Perëndimit për studimin e mistikës islame daton qysh nga fillimi i shek. XIX, por në këtë kohë ky studim qe drejtuar nga mistika persiane, pra nga poezia mistike persiane. Kështu, u bënë përkthimet e një numri të madh të veprave të poetëve persianë, duke filluar nga Omer Hajjami e deri tek Abdurrahman Xhamiu. Mirëpo, pak më vonë u kalua në studimin e tesavvufit – mistikës në kuptimin e vërtetë të fjalës. Libri i parë që shfaqet në këtë lëmë, është studimi i F. A. G. Tholuck-ut me titullin “*Sufismus sive theosophia persarum pantheistica*”, botuar në Berlin në vitin 1821.

Me sa duket, ky libër nuk ka kurrfarë vlere tjetër përveç asaj historike, po ta krahasonim me punimet e orientalistëve bashkëkohorë. Autori Tholuck pohon se tesavvufi islam është marrë nga zjarrputizmi persian, duke argumentuar se një numër i madh i persianëve patën mbetur në zjarrputizëm madje edhe pas arritjes së Islamit në Persi. Ai, po ashtu, mendimin e vet e mbështet në shfaqjen e një numri të madh të sufive në pjesën veriperëndimore të Persisë, në provincën Horasan, duke cekur se idetë indiane, jehonën e të cilave e dëgjojmë në fjalimet e disa mutesavvifëve islamë, kanë ardhur nëpërmjet kësaj pjese të Persisë.

Dhe në fund, mendimin e vet ai e mbështet tek fakti se themeluesit e parë të tarikateve sufiste ishin zoroastristë apo së paku kanë qenë të njohur për zoroastrizmin.

Të gjitha këto ide, që përmend autori, i kanë flakur dhe i kanë shpallur të pasakta zbulimet e reja shkencore. Do përmendur edhe vetë autori hoqi dorë nga këto të ashtuquajtura “fakte” dhe i pranoi të tjerat, të cilat madje ishin edhe më të pasakta se të parat.

Kështu, ai konsideron se asketizmi i muslimanëve është rezultat i predispozitës së arabëve ndaj jetës së izoluar dhe tesavvufit dhe gjithçkaje që është ekstreme në të, rrënjët i ka në doktrinën e Muhammedit a.s. dhe jetën e tij.

Më pas, në gjysmën e dytë të shek. XIX, Von Kremeri⁴ boton studimin e vet me titull: “*Geschichte der herrschenden ideen des Islam*” (Leipzig, 1868).

Kjo është përpjekja e parë shkencore e shpjegimit të tesavvufit dhe zhvillimit të tij. Midis të tjerash, prof. Kremeri thotë se tesavvufi islam përmban dy elemente të ndryshme:

1. Elementin krishtero-murgëror dhe
2. Indiano-budist;

Të dyja këto elemente i gjejmë tek Muhasibi, Bistami dhe Xhunejdi. Filozofisë religjioze indiano-budiste autori ia mvesh edhe panteizmin⁵, të cilin në mistikën islame e vë në praktikë Hal-laxhi në shek. IX.

Megjithatë, mendimi i shumicës së autorëve evropianë na jep të kuptojmë se panteizmi në misticizmin islam u shfaq shumë më vonë, gjegjësisht në shek. XII me përfaqësuesin e vet - Ibn Arebiu. Më tutje, autori e përmend Suhaverdin, ku thotë se: “Ishraku (shkëlqimi, me anë të të cilit arrihet njohja e botës dhe ekzistenca e Zotit në të) në të vërtetë është sinteza e neoplatonizmit dhe e ideve të Zaratustrës (themeluesit të ideologjisë së persianëve të lashtë).

Nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX njihemi me Brounin, Goldziherin, pastaj me Carra de Vauxin, Massignonin, Nicholsonin dhe me shumë të tjerë.

Megjithatë, nuk mund të shkojmë tutje pa përmendur Nicholsonin dhe serinë e artikujve të tij për tesavvufin, botimin e të cilave e pati filluar më 1914, e më pas e mblodhi dhe e botoi si një vepër të posaçme me titullin “*Islami dhe tesavvufi*”.

Në parathënien e kësaj vepre, Nicholsoni pohon:

“Lexuesit evropianë nuk habiten për marrëzinë dhe luhatshmërinë e autorit të Kur’anit dhe për jokompaktësinë e tij në zgjidhjen e problemeve të mëdha, ngase as vetë autori nuk qe në gjendje t’i vërente këto antiteza dhe kundërthënie, të cilat nuk u paraqitën pengesë shokëve të tij - ashabëve, besimi naiv i të cilëve e pranoi Kur’anin si

⁴ Kremer, A.Von. (1828-1889), lindi në Vjenë. Aty i kreu edhe studimet. Një kohë të gjatë ishte konsull i vendit të vet në Egjipt, e më pas në Liban. Më vonë kthehet në Vjenë dhe punon në Ministrinë e punëve të jashtme deri në fund të jetës.

⁵ Panteizmi – botëkuptim filozofik e fetar, që e sheh natyrën si mishërim të Zotit.

fjalë të Zotit. Kështu, ndodhte përçarja, e cila së shpejti rezultoi me shfaqjen e murxhinjve, kaderinjve, xheberinjve, mu'tezilëve dhe shumë fraksioneve të tjera në Islam".

Ky pohim i autorit të artikullit për tesavvufin islam përmban 4 përkufizime:

1. Nicholsoni pohon se autori i Kur'anit është kontradiktor dhe jokomplet në zgjidhjen e problemeve të mëdha;

2. Se Muhammedi a.s. – si autor i Kur'anit – nuk qe në gjendje t'i kuptonte e t'i vërente këto antiteza dhe kundërtënie;

3. Se shokët e tij – ashabët i shtyri besimi i tyre naiv ta praninin Kur'anin si fjalë të Zotit;

4. Dhe, në fund, se fraksionet e ndryshme, të cilat janë shfaqur në Islam, kanë lindur pikërisht për shkak të kësaj antiteze dhe kundërtënieje të ajeteve kuranore.

Mirëpo, duhet theksuar se çdo lexues pakëz objektiv, mund të vërejë gabimin e prof. Nicholsonit, i cili pohon se autori i Kur'anit është Muhammedi a.s. dhe se ai (Kur'ani) nuk është Libri i Zotit, të cilin Ai ia shpalli Muhammedit a.s. që ky t'ia kumtonte tërë njerëzimit.

Ky mendim, si të thuash, mbizotëron pothuaj tek të gjithë orientalistët që u ngjajnë mushrikëve Benu Kurejsh, të cilët, kur i thirri Muhammedi a.s. në Islam – fenë e shpallur prej Zotit, ata refuzuan ta praninin atë dhe Kur'anin si fjalë të Zotit. E kur All-llahu xh.sh. kërkoi prej tyre të shkruanin diçka të ngjashme si Kur'ani, ata u treguan të pafuqishëm (*El-Isra'*, 88). Pastaj u kërkoi të shkruanin së paku dhjetë kaptina të ngjashme si të Kur'anit (*Hud*, 13).

Prapë asgjë. Dhe në fund, kërkoi prej tyre të sillnin apo të shkruanin bile një kaptinë të vetme, të ngjashme me atë të Kur'anit, mirëpo edhe këtu qenë të pafuqishëm (*Junus*, 38).

Duket e çuditshme se shumica e orientalistëve, të cilët shkruanin për Muhammedin a.s., vinin në përfundimin se ai ishte një njeri i thjeshtë, i cili, sipas mendimit të tyre, nuk posedonte ndonjë talent gjenial.

Shtrohet pyetja, si është e mundur që një njeri kaq i thjeshtë të shkruante një vepër siç është Kur'ani, të cilit i nënshtrohen miliona e miliona (miliarda, J.H) njerëz anekënd botës dhe i cili përmban në vete një sistem të tërë dhe të plotë të jetës së tyre, përfshin norma

themelore në të cilat nuk ka kundërshtime, ndërsa i lë çështjet e dorës së dytë, sa i përket mendjes njerëzore dhe ixhtihadit?

Të dyja këto pohime janë në kundërshtim me njëra- tjetrën.

Një gjë tjetër, që duam të cekim këtu, dhe që do të na dëshmojë se Kur'ani është Shpallje e Zotit, është hadithi, si burim i dytë i Islamit.

Secili që lexon hadithin dhe Kur'anin, do të vërejë dallime të konsiderueshme tek ato: në shprehje, në temën që trajtojnë dhe në mënyrën si e trajtojnë, andaj, po të ishte Kur'ani vepër e Muhammedit a.s., atëherë do të ishte identik me hadithin – së paku në shprehje.

Mirëpo, ekziston dallimi i madh midis tyre. Kur'ani është libër i Zotit. Ai nuk është fjalë e ndonjë njeriu dhe as magji e magjistarit, pavarësisht se armiqtë e Islamit i mbyllin sytë para këtij fakti.

*Shqipëroi:
Jahja Hondozi*

Qemajl Morina

HISTORIKU I HARTIMIT TË FJALORËVE TË GJUHËS ARABE

Gjuha arabe është gjuha më e rëndësishme e gjuhëve të gjalla semite. Ajo i ka ruajtur më së miri veçoritë parasemite. Mu prandaj ajo ka një rëndësi të veçantë dhe për semantikën e gjuhën në përgjithësi.¹

Në gjuhën arabe ka një leksikografi tejet të pasur. Mirëpo, para se të hyjmë në njohjen e historikut të hartimit të fjalorëve të parë si dhe të leksikografisë në përgjithësi, do të ishte me interes të hedhim pak dritë mbi materien e fjalës "ع ج م" si dhe kur është përdorur për herë të parë fjala "mu'xhem" (مُعْجَم). Kjo do të na lehtësonte deri diku qëllimin, mënyrën si dhe hartimin e fjalorëve të parë të gjuhës arabe.

Kuptimi i fjalës mu'xhem

Autori i fjalorit "muhtarul kamus" (مختار للقاموسى) thotë:

العجم بالضم و التحريك خلاف العرب، رجل و قوم أعجم و الاعجم: من لا يفصح، و الاعجم: الاخرس ... و اعجم الكتاب و عجمته و عجمته: نَقَطَهُ ... و حروف المعجم: اي الاعجام مصدر.

¹ Arapsko-bosanski riječnik, Teufik Muftić, El-Kalem, Sarajevo 1997, s. VIII.

(Fjala “el’uxhmu” do të thotë joarab. Thuhet njeri dhe popull a’xhem joarab. El’axhem: ai që nuk flet rrjedhshëm. El-a’xhem: me-mec. Thuhet a’xheme el-kitabe: vendosja e pikave në libër; shkronjat e fjalorit, el’ixhamu është infinitivi).²

Lidhur me të njëjtën materie shohim se autori i fjalorit “Muhtaru Es-sah-hah” (مختار الصحاح) zgjerohet edhe më tepër dhe thotë:

أَلْعَجْمُ ضِدُّ الْعَرَبِ، الْوَاحِدُ "أَعْجَمِيٌّ" وَالْعُجْمُ بِالضَّمِّ ضِدُّ الْعَرَبِ وَ فِي لِسَانِهِ
عُجْمَةٌ، وَ كَلٌّ مَنْ لَا يَقْدِرُ عَلَى الْكَلَامِ أَصْلًا فَهُوَ "أَعْجَمٌ" وَ "مُسْتَعْجَمٌ".

“El-‘axhemu është e kundërta e arabit. Njëjësi është “axhemij-jun” (joarab). Kurse fjala “el-‘uxhmu” është e kundërta e arabëve. Po ashtu thuhet se në gjuhën e tij ka “uxhmetun”, që do të thotë paqartësi. Kushdo që nuk mund të flasë i thuhet “axhemun”, i huaj, joarab apo “must’axhemun”.

Fjala “axhemun” (أَعْجَمٌ) nuk ka të bëjë vetëm me ata, që nuk e kanë arabishten gjuhë të tyre, por ajo mund të përdoret edhe për arabët, që nuk e flasin rrjedhshëm gjuhën arabe, apo fjalët e tyre nuk janë të qarta sa duhet. Për femrën thuhet “axhmae”. “El’axhemu” thuhet për atë që ka vështirësi në të folur edhe pse ai në gjuhën e vet amtare flet rrjedhshëm. Shumësi i saj është “a’xhemune” (أَعْجَمُونَ) dhe “eaxhimi” (أَعَاجِمٌ). Allahu i madhërishtëm në Kur’an thotë:

و لَوْ نَزَّلْنَاهُ عَلَىٰ بَعْضِ الْأَعْجَمِينَ

“E sikur t’ia shpallnim atë (Kur’anin) ndonjë joarabi”. (26: 198).³

Po ashtu për gjuhën joarabe thuhet (لِسَانَ أَعْجَمِيٍّ).⁴

Autori i fjalorit (مختار الصحاح) rreth materies së fjalës (عَجْمٌ) vazhdon e thotë: “el-‘axhemu”: do të thotë vendosja e pikave tek shkronja, siç është rasti me shkronjën (ت), e cila ka dy pika. Thuhet për shembull vendos pikën në shkronjë. Prej kësaj thuhet (حروف المعجم) që ka të bëjë me shkronjat, të cilat kanë pika.

Disa mendojnë se fjala (الْمُعْجَمُ) ka të bëjë me fjalën (الاعْجَامُ) në formën e paskajores, siç janë fjalët "المُخْرِجُ" (dalje) dhe "المُدْخَلُ"

² مختار القاموس: للظاهر الزاوى ص ٤٠٩

³ القرآن الكريم: الشعراء، ١٩٨

⁴ مختار الصحاح: للزاوى ص ٤١٥-٤١٦

(hyrje). Këto shkronja mund të pikësohen. Thuhet اعجم الكتاب që është e kundërta e sqarimit të tij; po ashtu thuhet اِسْتَعَجَمَ عَلَيْهِ الْكَلَامُ do të thotë se fjalët u janë bërë të paqarta.⁵

Ndoshta në mënyrë pak më të qartë këtë e shpjegon ibnu Xhin-ni në librin e tij صِنَاعَةُ الْأَعْرَابِ (ع ج م) ku lidhur me materien (ع ج م), thotë: “axheme” (عَجَمٌ) në gjuhën arabe do të thotë paqartësi dhe fshehje, që është e kundërta e shpjegimit dhe e qartësisë. Kurse (الْعَجْمَةُ) do të thotë pengesë gjatë të folurit. Prej këndj edhe thuhet (رَجُلٌ أَعْجَمٌ وَ إِمْرَأَةٌ أَعْجَمَاءُ) burrë i huaj dhe grua e huaj, nëse ata gjatë të folurit nuk janë të qartë dhe fjalët e tyre nuk janë të kuptuara sa duhet. Po ashtu (الاعجمُ) do të thotë memec; kurse الأعجمُ dhe الأعجميُّ do të thotë joarab, për shkak të moskuptimit të fjalëve të tyre. Ky emërtim pastaj vazhdoi të përdorej edhe në rast se ata janë të qartë në të folurit e tyre”.⁶

Nga tërë koj që u tha më lart, si dhe duke u mbështetur në kuptimet e fjalës (ع ج م), bëhet e qartë se misterioziteti, paqartësia, të memecëria, pengesa në të folur, pamundësia e të shprehurit etj. janë disa prej kuptimeve të saj.⁷

Nëse materia e fjalës (ع ج م) ka kuptimin e asaj që përmendëm pak më lart, atëherë shtrohet pyetja për se thesari i trashëguar arabo-islam si dhe librat që merren me hulumtimin e kuptimit të fjalëve, u quajten معاجم “fjalorë”, dhe përgjigjja mund të jetë për arsye se ata ishin çelësi dhe baza që ua lehtësonte hulumtuesve dhe studiuesve të gjuhës mënyrën e njohjes së miteseriozitetit, si dhe sqarimin e kuptimit të tyre. Për ta tejkaluar këtë pengesë do të gjejmë mbështetje te dijetari i madh ibnu Xhin, i cili thotë “folja أعجمتُ e ka paradigmen e foljes أفعلتُ. Ky lloj i foljeve të shumtën e rasteve tregon përforsim dhe pohim, si për shembull: أَكْرَمْتُ زَيْدًا (E nderova Zejdin) d.m.th. ia obligova atij nderimin. Por, nganjëherë me të dëshirohet mohimi, si për shembull, أَشْكَيْتُ زَيْدًا (E ankova Zejdin), nëse atij ia mënjanon ankesën.⁸

⁵ لسان العرب: لابن منظور مادة (ع ج م)

⁶ سر الصناعات لأبي جني ص ٣٨-٣٩

⁷ رسالة الجهاد، رقم ٣٦، سبتمبر ١٩٨٥ / ن ص ١٠٩

⁸ المعاجم: د. عبد الله العزاري، ص ٢٦، ٢١، ١٨

Kur është përdorur për herë të parë fjala مَعْجَمٌ

Përgjigjja e saktë për këtë pyetje është e vështirë dhe e komplikuar. Për arsye se mungojnë argumentet e plota për kohën se kur është përdorur për herë të parë kjo fjalë. Mirëpo, kjo nuk na pengon që ne të përcjellim historikun e përdorimit të parë të fjalës (مَعْجَمٌ) që arrin në shekullin e tretë apo të katërt të hixhretit. Nga librat, në të cilët është përdorur fjala (معجم), është:

كِتَابُ مَعَانِي الْعُرُوضِ عَلَى حُرُوفِ الْمَعْجَمِ

(Libri kuptimet e arudit (metrikës) sipas shkronjave të fjalorit), autori i të cilit thuhet se është Ibnu Nedimi⁹, si dhe në librin: معجم الادباء për të cilin Jakuti¹⁰ në librin e tij معجم (leksikoni i letrarëve) thotë se autori i tij është Hubejsh ibnu Musir Ed-Dubbi.

Megjithatë, ky nuk mund të merret si argument i prerë, nëse merret parasysh se një pjesë e thesarit arab ka humbur me kalimin e kohës, si dhe mosinteresimit të arabëve në kohët më të hershme për të lënë gjurmë të shkruara, duke u mbështetur vetëm në aftësinë e tyre për të nxënë përmendsh, si dhe për shkak të përhapjes së analfabetizimit të tyre.¹¹

Me gjithë këto vështirësi, një pjesë e thesarit arabo-islam arriti deri në ditët tona, e në veçanti e pas periudhës islame. Kështu mund të thuhet se në periudhën e Pejgamberit a.s. si dhe të katër sunduesve të drejtë që erdhën pas tij, në gjuhën arabe ka ekzistuar një fjalor i pashkruar.¹²

Shkaku i hartimit të fjalorëve

Sa u përket shkaqeve që i shtynë arabët të përpilonin fjalorë, së pari duhet të bëjmë një dallim në mes dy periudhave: periudha para Islamit, e cila është e njohur nga një thesar i pasur në artin poetik dhe të folurit, dhe në periudhën islame, e cila fillon prej kohës së Pejga-

⁹ الفهرست: لابن النديم، ص ٧٢

¹⁰ معجم الادباء: لياقوت الحموى ج ٧ ص ١٢٠-١٢١

¹¹ المعاجم العربية: د. ابراهيم نجار ص ٧

¹² الصحاح و مدارس المعجمات العربية: لاحمد عبد الغفور عطار ص ٤٠

mberit a.s. shtrihet deri në ditët tona. Nëse i bëhet një vështrim secilës prej këtyre dy periudhave veç e veç, do të shohim se periudha paraislame, apo siç quhet edhe periudha e injorancës, ishte shumë e pasur me dialogë, fjalime dhe poezi të një niveli shumë të lartë. Autorë të të gjitha këtyre ishin arabët, të cilët tregonin një interesim shumë të madh për gjuhën e tyre dhe ekzistojnë shumë dëshmi historike se, nëse dikush nuk u përmbahej rregullave të gjuhës arabe, ai kritikohet ashpër nga ata që u përmbaheshin rregullave të gjuhës dhe flisnin gjuhën e pastër arabe. E tërë kjo bëhej në mënyrë gojore nga dëshira e tyre që gjuha arabe të mbetej e pastër pa ndikim nga gjuhët e tjera përreth, për se edhe ata patën sukses.

Në periudhën islame interesimi për gjuhën arabe u shtua edhe më tepër, duke e konsideruar atë në kuadër të kornizës së shenjtë të mësimëve islame. Kjo bëri që të fillohej me shënimin e fjalëve dhe shpjegimin e domethënies së tyre përmes fjalorëve, si dhe nga frika e zhdukjes së një pjese të thesarit për shkak të vdekjes së dijetarëve me kalimin e kohës, të cilët ishin njohës të mirë të gjuhës. “Kështu filloi shkruarja e gjuhës me anën e fjalorëve si dhe librave të gjuhës nga frika e humbjes së lëndës së saj, apo e depërtimit të diçkaje që ishte e huaj për të”.¹³

Përveç kësaj që përmendëm, ekziston edhe një shkak tjetër me rëndësi të veçantë që i shtyri dijetarët t’i rrekeshin përpilimit të fjalorëve, që është numri i madh i popujve joarab, të cilët e pranuan fenë Islame dhe e përdornin gjuhën arabe si mjet komunikimi në jetën e tyre të përditshme, sidomos në kryerjen e ceremonive fetare.¹⁴

Prej shkaqeve të tjera mund të konsiderohen zhvillimi i shpejt i kulturës arabo-islame dhe marrja e një dimensionit të ri të saj për shkak të fesë së re, e cila bëri që një numër i madh i shprehjeve gjuhësore të zhdukej, të atyre që ishin në kundërshtim me parimet e mentalitetit të ri islam, apo nuk i përgjigjeshin filozofisë së fesë së re, e cila kishte për qëllim ngritjen e njeriut të ri me fjalë dhe me vepra.

Po ashtu, këtu vlen të përmendim se feja islame sollti një numër të madh të fjalëve dhe shprehjeve gjuhësore të reja, si dhe ringjalli një numër të konsideruar prej tyre, pasi vërejtji se ato janë të përshtatshme

¹³ المصدر السابق ص ٥٠-٦٠

¹⁴ المصدر السابق ٦٢

për t'u futur në përdorim me kuptim të ri në periudhën islame. Islami bëri po ashtu ndryshimin e kuptimit të shumë fjalëve si dhe ndërrimin e shprehjeve dhe shpjegimin apo përcaktimin e tyre në aspektin gjuhësor, kuptimor dhe në aspektin e Sheriatit. Nga kjo mund të kuptojmë se Islami kontribuoi shumë në pasurimin e gjuhës arabe, stimuloi kulturën arabo-islame dhe zgjeroi horizontet e saj. Për këtë arsye një prej mjeteve për ruajtjen e këtij thesari ishte shpjegimi i kuptimit të fjalëve arabe, shqiptimi i saktë i tyre, përdorimi i shumëfishtë, si dhe kufizimi i tyre.¹⁵ Në këtë mënyrë u paraqitën fjalorët e parë.

Si u bë hartimi i fjalorëve të parë?

Pasi u bëmë një vështrim shkaqeve që çuan në hartimin e fjalorëve, tash do të shohim cila ishte metoda e hartimit të fjalorëve gjuhësorë dhe a kishte një apo më shumë sosh? Si dhe kush është hartuesi i parë i fjalorit të gjuhës arabe?

Nuk ka farë dyshimi në mesin e leksikografëve të gjuhës arabe se ibnu Abasi r.a. konsiderohet themelues i vërtetë i idesë së fjalorit arabo-islam, meqenëse ai ishte i pajisur me kulturë të gjerë, është dijetari më i madh i popullit, komentatori i fjalëve të panjohura të Kur'anit dhe Hadithit, si dhe njohës shumë i mirë i poezisë dhe prozës arabe. Megjithatë, ai nuk mund të konsiderohet hartues i fjalorit, por ai mund të merret si autor i idesë për hartimin e fjalorit. Ndërsa hartues i fjalorit të parë të shkruar në gjuhën arabe është El-Halil ibnu Ahmed El-Ferahidi (vdiq në vitin 786); atë e hartoi sipas metodës logjike të vështrimit duke grumbulluar lëndën e gjuhës dhe fjalët e saj. Pastaj bëri renditjen e shkronjave të alfabetit në mënyrë ushtruese në bazë të përputhshmërisë së fjalëve dhe lëndëve të shkronjave që e formojnë atë. Kjo metodë quhet (metoda e klasifikimit).¹⁶

Pastaj dijetarët nisën të bënin mbledhjen e materies së gjuhës dhe secili prej tyre ndoqi një metodë të veçantë. Disa prej tyre u mbështetën në shkollën e Halil ibnu Ahmedit, ndërsa disa të tjerë ndoqën metodë tjetër, dhe të gjitha ato nuk i tejkalojnë tri shkolla.¹⁷

¹⁵ المراجع العامة دراسة نظرية نوعية: د. سعد محمد الهجرسي ص ١٦

¹⁶ المصدر السابق: للهجرسي ص ٢٥

¹⁷ المعاجم ص ٢٠

E para: Shkolla e përmbysjes, të cilën e themeloi El-Halili ibnu Ahmed, e cila bën kufizimin e fjalëve që formohen prej të njëjtave shkronja nën një kornizë, duke bërë radhitjen e njësisve në mes veti sipas numrit të tingujve dhe natyrës së tyre, pastaj sipas abecesë fonetike, e cila mbështetet në shqiptimin e tingujve prej fytit dhe gojës, duke shikuar daljen e tingullit më të largët. Kësaj shkollë iu përmbajtën edhe një numër i dijetarëve, si El-ez-heri në librin e tij “E-ttehdhib”, Ez-Zubejdi në veprën “Muhtesarul ajn”, Ebu Ali el Kali në librin “El-Bari” si dhe ibnu Sida në veprën e njohur me titullin “El-Muhkem”. Askush nuk mund t’i mohojë vështirësitë dhe të metat e kësaj metode.

E dyta: Shkolla e “Kafijes”, apo si quhet ndryshe shkolla e Xhevherit (vdiq në vitin 1003). Këtu fillohet me lëndën gjuhësore dhe bëhet radhija e saj sipas shkronjave të njohura të abecesë, duke e konsideruar shkronjën e fundit të fjalës “kaptinë” ndërsa shkronjën e parë “kapitull”. Kësaj shkollë iu përmbajt El-Xhevheri në fjalorin e tij Es-sahah, Fejruzjadi në “El-kamus” dhe ibnu Mendhuri në “Lisanul arab”.

E treta: Shkolla e abecesë, e cila quhet edhe shkolla e Zemahsheriu (vdiq më 1144). Kjo shkollë bën radhitjen e fjalëve sipas abecesë duke u nisur prej shkronjës së parë, të dytë dhe të tretë. Kësaj shkollë iu përmbajtën Zemahsheriu, Ahmed ibnu Faris, El-Fejumi, si dhe Luis Malufi e shumë të tjerë.

Kjo ishte një pasqyrë e shkurtër e mënyrës së hartimit të fjalorëve të gjuhës arabe, ndërsa tash po japim në mënyrë tabelare fjalorët e gjuhës arabe që përdorën nëntituj që i përshtaten materies që ata kanë shqyrtuar. Këta fjalorë, natyrisht –nuk i përfshijnë të gjithë fjalorët e gjuhës arabe si dhe librat e thesarit të gjuhës arabe, por vetëm një pjesë të tyre.

E para: Fjalorët e parë

Titulli i fjalorit	Autori	Viti i vdekjes
a) El-‘ajjn	Halil ibnu Ahmed El-Ferahidi	786
b) Xhemheretu El-lugati	Ibnu Durejd	933
c) Tehdhibu El-lugati	El-ez-heri	980
ç) Es-sah-hahu	El-Xhevheri	1003
d) El-muhkem El-Muhasas	Ibnu Sida	1069
dh) El’ubabu, Et-tekmiletu ve dhejlu ve es-siletu	Es-sagani	1252
e) Lisanul arab	Ibnul Mendhur	1312
ë) El-kamus	Fejruz Abadi	1415
f) Taxh El-Arus	Ez-zubejdi	1791
g) El-muhit	El-bustani	1883
h) Ekrebu El-mevarid	Esh-shertuni	1912

E dyta: Fjalorë në lëmin e letërsisë dhe retorikës

a) Esasu el-belagati (Themeli i retorikës)	Zemahsheri	1124
b) Thimarul kulubi fil mudafi vel mensubi	Eth-thealebi	1038
c) Maxhmeu el-emthali	El-mejdani	1124

E treta: Fjalorë në zhvillimin e semantikës

a) Tehdhibu el-elfadhi	Ibnu Es-sekit	858
b) Mekajisu el-lugati	Ibnu Faris	
c) Fikhu el-lugati	Eth-thealebi	1038

E katërta: Fjalor i fjalëve të huaja që kanë depërtuar në gjuhën arabe:

a) El-mureb minel-kelami el-a’xhemijj ala hurufil mu’xhem	El-Xhevaliki	1144
---	--------------	------

E pesta: Fjalorë që tërheqin vërejtjen për gabimet në gjuhë:

a) Lahnu el-av-vam (gabime popullore)	Muhamed ibnul Hasen Ez-Zubejdi	989
b) Muxhemu shimalil Magrib (Fjalori i Magrebit verior)	Sejjid Abdurrahman	1968

E gjashta: Fjalorë të radhitur sipas formave të foljeve “fi’lun dhe ef’ul ose fe’altu dhe ef’alt” فَعَلَ و أَفْعَلْتُ و أَفْعَلْتُ

a) “Fe’ale dhe ef’ale”	El-ismei	202 prej vdekjes së Pejgamberit a.s.
b) “fe’altu dhe ef’altu”	Essigjestani	244 prej vdekjes së Pejgamberit a.s.
c) Fi babil ebnijeti min edebil-katib	Ibnu Kutejbe	265 prej vdekjes së Pejgamberit a.s.
ç) Ma benethu el arabu ala “fi’al”	Es’sagani	1252 e.r.

E shtata: Fjalorë dukurish gjuhësore

a) Kitabul el-ed-dad (Libri i kundërthënieve)	Kurtubi	195 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.
b) Kundërthëniet	El-ferra	195 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.
c) Shexheru ed-duri	El-halebi	962 e.r.
ç) El elfadhu el-kitabije	El-hamedhani	922 e.r.
d) Ma it-tefeka lafdhuhu ve ihtelefe ma’nahu fi-l- kurani mexhid	El-Mberriid	274 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.
dh) Ma ihtlefet esmauhu min kelamil arabi	Ebrejashi	246 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.

E teta: Fjalorë të përmbledhur apo zgjedhja e fjalorëve themelorë

a) Përmbledhja e Ajnit	Ez-Zubejdi	989
b) Tehdhibu es-sah-hah	Ezengjani	1258
c) Muhtaru es-sah-r	Errazi	1261
ç) Muhtaru el-kamus	Ez-zavi	u botua më 1962
d) Kataru el-muhit	El-Bustani	1883
dh) El magrib fi tertibi el Mu'reb	El-Mabrezi	1213
e) El-misbahu el-munir	El-fejjumi	1368
ë) El-muxhem el-vesit	Instituti i gjuhës arabe i Kajros	viti i botimit 1960-61

E nënta: Fjalorë të posaçëm të Kur'anit dhe Hadithit

a) Tefsiru garibi el-Kur'an (Komentim i fjalëve të huaja në Kur'an)	Ibnu Kutejbe	265 pas vdekjes së Pejgamberit a.s. u bota më 1958
b) El-mufredat fi garibi el-Kur'an (Fjalët e huaja në Kur'an)	El-isfahani	1109
c) Garibu el-hadith	Ibnu Kutejbe	u botua më 1977
ç) El-fariku fi garibi el-hadithi vel-etheri	Ez-zemsheri	1124

Në këtë lëmi kanë shkruar edhe shumë dijetarë të tjerë; prej tyre: El-ahfesh (210 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.), El-isme'i (202 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.), El-Xhumehi (220 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.), Tha'leb (280 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.) Fjalët e huaja në Kur'an, Nadr ibn Shemil (192 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.), Ibnu el-Mudhen-na (199 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.), Esh-Shejbani (195 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.), El-fura (196 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.), Ebu Zejd el-Ensari (204 pas vdekjes së Pejgamberit a.s.), Fjalët e huaja në hadith.¹⁸

¹⁸ مجلة المورد: المجلد التاسع العدد الرابع ١٣٩٠هـ، وما وضع في اللغة عند العرب الى نهاية العرب الثالث: د. محمد حسين آل بايين

E dhjeta: Fjalorë me karakter tematik

a) El-metar (Shiu)	Ebu Zejd El-Ensari	830
b) Halku el-insan (Krijimi i njeriut)	Thabit ibnu Ebi Thabit	shekulli i nëntë i e.r.
c) Esmaun li a' dai el-insan (Emrat e gjymtyrëve të njeriut)	Ibnu Faris	shek dhjetë i e.r.
ç) En-nebat (bota bimore)	Ebu Hanife Edinuri	895
d) Sherhu esmai el-akkar (Shpjegimi i emrave të barnave)	Musa bin Mejmun El-Kurtubi	1024

E njëmbëdhjeta: Fjalorë shkencorë

a) El-xhami' limufredati el-elvijeti ve el-agdhijeti (Përmbledhësi i fjalëve të barërave dhe ushqimeve)	(Ibnu Bejtes)	1248
b) El-mu' xhem et-tibbi es-sajdili el-hadith (Fjalori mjekësor dhe farmaceutik bashkëkohor)	Mahmud Avidha	u botua më 1970
c) Mefatihul ulumi (Çelësat e shkencave)	Muhamed ibnu Ahmed El-Havarzini	997
ç) Et-ta' rifat (definicionet)	El-Gjurgjani	1412
d) Kesh-shafu istalahati el-fununi	Et-Tehavuni	1745

E dymbëdhjeta: Fjalor i shprehjeve ushtarake

Ai është fjalor ushtarak, të cilin e botoi Liga Arabe në vitin 1970. Po ashtu ekzistojnë fjalorë në lëmin e mjekësisë, shkencës dhe gjuhësisë në dy, tri apo katër gjuhë.

*Mustafa Imamoviq**

PASQYRA E GJENOCIDIT MBI MYSLIMANËT NË TOKAT JUGOSLLAVE

Bosnja dhe Hercegovina qysh nga mesjeta e hershme si vend kufitar ndërmjet Bizantit dhe shtetit frëng, ka qenë trevë e përlëshjeve të përhershme të Kishës ortodokse dhe asaj katolike. Ndërmjet tyre ndër shekuj ka ekzistuar kisha heretike boshnjake, ithtarët e së cilës në fund të shekullit XIV dhe gjatë shekullit XV, me ardhjen e osmanlinjve, pranuan Islamin. Andaj në themelet e entitetit të gjuhës sllavo-boshnjake, me asimilimin e kulturës islame, u formua etnosi, populli ose kombi boshnjako-mysliman, krahas sllavëve të tjerë të Jugut (serbëve, kroatëve dhe malazezve) me të njëjtën gjuhë por me përvojë të ndryshme fetare dhe politiko-kulturore.

Në pushtimet e mëtejshme të osmanlinjve në Ballkan dhe në Evropën e Mesme, myslimanët e Bosnjës u vendosën nëpër shumë vende përreth, në Serbi, në pjesën verilindore dhe perëndimore të Malit të Zi të sotëm, në Sllavoni, Dalmaci dhe Hungari... Këtu është me rëndësi të theksohet se Perandoria Osmane, si shtet islam, gjatë pushtimeve të veta nuk ka bërë kurrfarë shkatërrimesh as shfarosjesh fetare, as fizike të popullatës së nënshtruar. Në përputhje me parimin e Sheriatit, sipas të cilit popujt që kanë pasur “libër hyjnor të shpallur”

* Autori është profesor i rregullt në Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës.

(çifutët dhe të krishterët) në shtetin islam gëzonin statusin e pakicave të mbrojtura. Popujt e bindur në forma të ndryshme inkuadroheshin në sistemin ekonomik, ushtarak dhe juridik të shtetit osman dhe në këtë mënyrë mbroheshin dhe ruanin pikëpamjet e veta fetare dhe kulturore.

Në disa vjetët e fundit në hapësirën jugosllave shpeshherë flitet për gjenocidin. Ky term në mënyrë joprofesionale e sipas realitetit të dhënë historik, pa përgjegjësi në çdo moment po zgjerohet lehtë në parim dhe në funksion të qëllimeve e llogarive politike momentale, por edhe afatgjatë të dikujt. Me një fjalë, me numrin dhe tragjedinë e viktimave të gjenocidit, sidomos në Luftën e Dytë Botërore, manipulohet pa skrupullë për qëllime të politikës ditore. Shtohen viktimat e popullit të vet në Luftën e Dytë Botërore, duke i fajësuar në të njëjtën kohë të gjithë popujt e tjerë për gjenocid të lindur dhe immanent. Në anën tjetër, me minimizimin e viktimave dhe vuajtjeve të të tjerëve, mbulohen dhe mohohen krimet e veta. Lojërat e tilla të papërgjegjshme dhe të rrezikshme politike, kërkojnë përgjigje precize shkencore me fakte të vërtetuara historike.

Në regjimin komunist, i cili në praktikën e përditshme shpesh kufizohej në hegjemonizmin dhe agresionin serbo-malazias, kalohej në heshtje fati tragjik i myslimanëve. Mbi gjenocidin që është zbatuar në Luftën e Dytë Botërore në Jugosllavi, gjatë 45 vjetve të pasluftës, kryesisht nuk është folur në mënyrë të posaçme. Fitohet përshtypja se, gjithnjë me qëllim që të mbulohet nga harresa, viktimat myslimane sikur janë më pak të vlefshme, më pak tragjike dhe më pak njerëzore nga tragjeditë e njëjta dhe viktimat e pjesëtarëve të popujve të tjerë jugosllavë.

Në shumicën dërrmuese të vendpushkatimeve, në të cilat janë vrarë mizorisht me qindra e mijëra myslimanë të të gjitha moshave, nga fëmijët e gratë deri tek pleqtë, as sot nuk ka kurrfarë shenje as shprehje të nderimit ndaj atyre viktimave të pafajshme tragjike të privuara nga jeta vetëm sepse kanë qenë tjetërfare nga ekzekutorët e tyre. Pa përmendore dhe shënime ata, si viktima, edhe për së vdekuri kanë mbetur të cenuar. Mirëpo ashtu sikur nuk vjetroheshin krimet e luftës kundër njerëzimit, poashtu nuk është dobësuar e nuk është

vjetruar kujtesa, as nuk kanë humbur dokumentet që flasin mbi dimensionet dhe natyrën e atij gjenocidi.

Andaj në fund të vitit 1990 “Svjetlost” i Sarajevës ka botuar në përmbledhjen të vëllimshme të elementeve dhe dëshmime mbi gjenocidin ndaj myslimanëve në vitet 1941-1945, të cilat i kanë mbledhur dhe përgatitur për shtyp Vladimir Dedijer dhe Artun Miletiç. Ky libër jep kontribut vendimtar për njohjen e së vërtetës për myslimanët si viktima të krimit gjenocidal gjatë Luftës së Dytë Botërore. Siç është vërtetë borxhi i të gjallëve ndaj të vdekurve, ashtu pa paragjykime dhe kalkulime politike, qetë e me respekt, në atë përmbledhje flitet për viktimat deri tash shpesh të harruara të gjenocidit si krim më i rëndë. Pas hartimit të këtij libri, në shtypin mysliman dhe në atë jugosllav në përgjithësi, u paraqitën shumë autorë, të cilët, si viktima të mbijetuara ose historianë hulumtues, amatorë dhe profesionistë, dëshmojnë në mënyrë autentike për gjenocidin kundër myslimanëve.

Dokumentet dhe kujtimet tregojnë bindshëm se numri më i madh i muslimanëve nuk kanë pësuar në llogore ose në operacionet e luftës, veçse si viktima të terrorit në vendbanime, nëpër gropat e ndryshme në ura dhe në brigje të lumenjve, në pragun e shtëpisë së tyre, shpesh nga dora e fqinjëve të parë të tyre, pjesëtarë të lëvizjes çentike. Këtu qëndron monstrizmi i posaçëm i gjenocidit ndaj muslimanëve, ngase xhelati dhe viktima në shumicën e rasteve njiheshin mirë, prandaj mund të thuhet se viktima ka pësuar mu për shkak se vrasësi e ka njohur. Në llogoret naciste si industri e vdekjes, viktima ka qenë e depersonalizuar. Ka ekzistuar vetëm numri i regjistrit, dhe është shkaktëruar si një send i vjetër. Ndryshe, prej tij, gjenocidi ndaj muslimanëve ishte krim i epshit, i kryer nga motive të ulëta, të cilat rrënjët i kanë të largëta, të thella dhe të errëta. Gjenocidi mbi myslimanët në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Sanxhak në luftën e viteve 1941-1945, ka qenë vetëm një finale e tërbimit 250-vjeçar, e historinsë së gjatë të dëbimeve të menduara sistematike, të depersonalizimit historik e kulturor dhe shfarosjes etnike.

Dëbimet e myslimanëve në kuptimin e gjenocidit fizik dhe kulturor, kryesisht fillojnë me luftërat e zhvilluara nga fundi i shekullit XVII dhe gjatë shekullit XIX ndërmjet Austrisë e Republikës së Venedikut në një anë dhe Osmanlinjve në anën tjetër. Në këto luftëra

në të dy anët merrnin pjesë një numër i madh i pjesëtarëve të të gjithë popujve jugosllavë. Në anën osmane myslimanët e Bosnjës, kurse në anën tjetër shumë serbë e kroatë, si kufitarë të Mbretërisë dhe Monarkisë Austriake, madje edhe hajdutët venedikas. Nga këto luftëra e ka burimin sintagma për Kroacinë si “parallmer i krishterimit”, si një burim ideologjik i gjenocidit mbi myslimanët.

Gjenocidi mbi myslimanët ka filluar në të ashtuquajturën Luftën e madhe e Vjenës në vitet 1683-1699, në të cilën Osmanlinjtë i humbin pronat e tyre në Hungari, Sllavoni, Likë, Dalmaci dhe në Bokën e Kotorrit. Të gjithë muslimanët që nuk kishin arritur të tërhiqeshin me kohë nga këto treva në Bosnjë e Hercegovinë dhe të tjerat në jug të Savës e Danubit, qenë konvertuar shumë shpejt në katolicizëm. Mbi këtë krishterim të dhunshëm, fakte precize ofrojnë arkivat françeskanë në Dalmaci dhe Sllavoni. Kështu si p.sh. vetëm në Likë – krahinë e mëvonshme kroate, rreth vitit 1680 kanë jetuar shtatë mijë familje myslimane me më tepër se 30.000 anëtarë. Gjatë luftës së Vjenës kanë humbur të gjithë, ose janë krishteruar ose kanë ikur në Bosnjë. Në Likë dhe Dalmaci këtë na e kujtojnë ende vetëm disa toponime dhe patronime.

Tërë kjo ka ndodhur në kohën e mosdurimit fetar në Evropën e krishterë dhe katolike, po vuajtjet e myslimanëve të Bosnjës vazhduan edhe në shekullin e tolerancës fetare, të lirive qytetare dhe njerëzore. Burimet e gjenocidit ndaj myslimanëve në kohën moderne gjenden në dëshirën e strukturave sunduese ballkanike, para së gjithash serbe dhe malaziasë, që me shfarosjen e myslimanëve të krijojnë territore të veta të pastra etnike.

Dëbimet e myslimanëve në kuptimin e fjalës gjenocid kanë filluar në historinë moderne, në realitet me të ashtuquajturat hetime të turqëzuarëve-të muslimanizuarëve në Malin e Zi qysh në fillim të shekullit XVIII. Ngjarjen e ka kënduar Vlladika dhe poeti Petar, Petrović Njegosh në “Kurora e Maleve”, me të cilën u jepte mbështetje të ideologjizuar poetike të gjitha dëbimeve të mëvonshme të myslimanëve nga ana e serbëve dhe malazezve. Njegoshi veprën e tij ia kushtonte Karagjorgjit, prijësi suprem i kryengritjes së parë serbe, në të cilën kanë vazhduar dëbimet e myslimanëve. Me Hatisherifin e vitit 1830, me të cilin Serbia fitoi statusin e principatës autonome vazale të Mbretërisë

Osmane, parashihej shpërngulja e banorëve myslimanë, e cila është intensifikuar gjatë viteve gjashtëdhjetë të shekullit XIX. Gjatë viteve pesëdhjetë të atij shekulli gjithashtu është kryer krishterimi i dhunshëm i myslimanëve të Vasojeviçëve në Malin e Zi.

Myslimanët, pastaj janë shpërngulur nga trevat që pas luftërave të viteve 1876-1878, i takuan Serbisë dhe Malit të Zi. Gjithashtu me okupimin e Austro-Hungarisë ka filluar shpërngulja masive e myslimanëve të Bosnjës e Hercegovinës në Turqi. Presioneve të reja të rënda dhe sulmeve ndaj jetës dhe pasurisë, myslimanët iu nënshtruan gjatë luftërave ballkanike dhe luftës së parë botërore 1912-1918 dhe viteve të para të ekzistimit të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene. Gjendja më tragjike për myslimanët është paraqitur në luftën e viteve 1941-1945, në të cilën më tepër se 100.000 myslimanë kanë humbur jetën, në masë të madhe në bazë të gjenocidit nga ana e kasapëve dhe vrasësve çetnikë e ustashë, por edhe nga ana e okupatorëve të ndryshëm. Me një fjalë, çdo tronditje e madhe a e vogël politike në këto hapësira në periudhën prej fundit të shekullit XVII e deri në mesin e këtij shekullit XX popullatës myslimane, u ka sjellë, mund të thuhet, masën e zakonshme të therjes, krishterimit të dhunshëm dhe shfarosjen masive, përkatësisht ikjet dhe dëbimet.

Kronologjikisht më e vjetra e në letërsi më e lavdishmja ndodhi, është “ndjekja e turkoshakëve”, gjegjësisht ndjekja e myslimanëve nga Mali i Zi i vjetër, i cili atëherë përbëhej vetëm prej katër nahive: Katunit (Cetinës) Rekës, Cermnikës dhe Leshankës. Sipas Njegoshit ngjarja është zhvilluar në kalimin nga shekulli XVII në shekullin XVIII. Në historinë letrare përmenden vjetët e ndryshëm në të cilat është bërë “ndjekja” që prej vitit 1702 deri në vitin 1708. Këta vjet sigurisht nuk kanë baza të forta në burimet historike. Me siguri, ndjekja nuk ka mundur të ndodhë p.sh. në vitin 1706, sepse faktikisht atëherë pushteti osman përgatitej t’i shpërngulte malazeztë për shkak të hajdutërisë së vazhdueshme, po ata i morën në mbrojtje dhe pamundësuan atë veprim paria myslimane e Podgoricës dhe Spuzhit. Disa mendojnë se “Ndjekja” thjesht nuk është ngjarje e vërtetë, por fikcion poetik. Hulumtimet e reja tregojnë se shfarosje megjithatë ka pasur dhe se ato sigurisht janë kryer në vitin 1711 ose 1712. Sipas të gjitha burimeve historike, në gjysmën e dytë të shekullit XVII në Malin e Zi

kanë jetuar 800-1000 muslimanë të cilët, pas vitit 1712, në atë hapësirë nuk ekzistonin më. Në Malin e Zi të vjetër, muslimanët na i kujtojnë 52 toponime. Kishte gjashtë xhami, nga të cilat asnjë nuk është ruajtur, mirëpo ekzistojnë lokacionet dhe emrat e tyre. Muslimanët që arritën t'i shpëtonin shfarosjes ose konvertimit në krishterim, kryesisht kishin ikur në Nikshiq dhe në fshatin Tugjemile, afër Tivarit, ku pasardhësit e tyre jetojnë edhe sot.

Sipas disa vlerësimeve në pashallëkun e Beogradit para Kryengritjes së parë serbe jetonin rreth 20.000 muslimanë, pa llogaritur pjesëtarët e garnizoneve. Tërë popullata muslimane në Serbi quheshin turq. Në realitet aty ka pasur pak turq të vërtetë etnikë. Kryesisht kishte muslimanë boshnjakë dhe një numër i vogël shqiptarësh. Luftërat austriake-osmane gjatë shekullit XVIII të përcjella me kryengritjet serbe, tek banorët muslimanë të fshatrave krijuan pasiguri të plotë në pashallëkun e Beogradit. Për këtë shkak muslimanët qenë të detyruar të grumbulloheshin nëpër qytete dhe qendra, ku kishte garnizone ose nga demoralizimi apo frika ta lëshonin vendin tërësisht.

Kryengritësit serbë në fillim, parimisht bënë dallim në mes turqve të qetë të “mbretit” dhe jeniçerëve tiranë e të arratisur nga pushteti qendror, duke theksuar se luftonin vetëm kundër këtyre të fundit. Në të vërtetë kryengritësit nuk bënë dallim në mes popullatës muslimane dhe që të gjithë ata i quanin armiq. Kryengritësit vetëm në disa qytete ose qendra që çliruan (Valevë, Shabac, Rudnik, Smederevë dhe Jagodinë) për shkaqe taktike i lanë të qetë turqit e mbretit - në realitet muslimanët boshnjakë të ashtuquajtur të moçëm (jerli-vendës), ndërsa të tjerët i vranë ose i dëbuan. Sipas tregimeve të mëvonshme të disa kryengritësve, për ta të gjithë turqit, pa dallim, ishin armiq të përbetuar. Gjatë tërë nëntë vjetve të kryengritjeve në pashallëkun e Beogradit, të përdorim fjalët e historianit dhe politikanit të vjetër serb, Stojan Novaković, është bërë “shfarosja e përgjithshme e turqve nga populli”.

Kjo shfarosje është realizuar posaçërisht egërsisht dhe nga themeli me dëbimin dymujor të muslimanëve të Beogradit në të cilin kryengritësit përfundimisht hynë me 8 janar 1807. Beqarët e tërbuar të Miloje Petroviç Tërnavacit, të etshëm për plaçkë, me pëlqimin e heshtur të udhëheqësit të qytetit Mladen Milovanoviçit, krahas muslimanëve, nuk i kursyen as çifutët, grekët, cincarët, madje as disa serbe, tregtarë

dhe zejtarë të Beogradit. Disa qindra çifutë me gra e fëmijë u dëbuan në Sremin dhe Banatin fqinj. Masakrat dhe dëbimet në Beograd arritën kulmin në fillim të marsit të vitit 1807. Veziri i Beogradit, Sylejman pasha, në marrëveshje me pushtetin serb, me përcjelljen e tij më 7 mars u nis në drejtim të Nishit, nën mbrojtjen e një njësi serb. Me të dalë nga qyteti, te Çeshmja e pashës në Vračar, Sulejman pasha dhe përcjellja e tij u sulmuan dhe u vranë. Ky ishte sinjal për sulmin e përgjithshëm mbi “turqit” në Beograd. Shumë u vranë, shumë u kryqan me dhunë, sidomos gra dhe fëmijë, ndërsa të gjithë pasanikëve iu mor pasuria. Një numër i grave dhe fëmijëve u ngarkuan me dhunë në anije dhe përmes Danubit u drejtuan për Vidin. Lufta në mes udhëheqësve serbë rreth ndarjes së pronave dhe pasurisë së myslimanëve në Beograd, për të cilën është kujdesur një këshill drejtues ka zgjatur shumë kohë.

Politika e ndjekjes së “turqve” në realitet të myslimanëve, do të vazhdonte edhe gjatë Kryengritjes serbe. Llogaritet se në prag të Hatisherifit të vitit 1830 në Serbi jetonin nëntë deri dhjetë mijë myslimanë (Beograd 4000, Uzhicë 2000, Çupri 1500, Smederevë 800 dhe në Hasan Pashë d.m.th. në Pashllankën e Smederevës 200). Me Hatisherif, përveç të tjerash, ishte caktuar që popullata myslimane të shpërngulej nga Serbia (Pashallëku i Beogradit) brenda një viti. Siç u tregua, kjo kohë ishte shumë e shkurtër për rregullimin e të gjitha çështjeve të së drejtës pronësore, andaj në vitin 1833 afati për shpërngulje u zgjat për pesë vjet. Megjithatë, edhe pas këtij afati në Serbi mbetën disa mijëra myslimanë, qëndrimi i të cilëve u kufizua në vende të garnizoneve: Shabac, Beograd, Smederevë, Kladovë, Uzhicë dhe Soko. Në kohën e qeverisë së kushtetutës mbretërve dhe të knjaz Aleksandër Karagjorgjeviç, 1842-1858, të cilët mbanin marrëdhënie të mira, po jo të sinqerta, me Portën e Lartë, u krijua një qetësi relative dhe u ndërpre dëbimi i myslimanëve.

Kthimi në pushtet dhe qeveria e dytë e Milosh dhe Mihajl Obrenoviçit (1858-1867) shënuan përpjekjet për të zgjidhur përfundimisht çështjen e të ashtuquajturve turq, prania e të cilëve, sidomos në Beograd konsiderohej e padurueshme. Qeverisë serbe shpejt iu dha rasti që këtë problem, thënë me gjuhën moderne, ta internacionalizonte dhe, sipas qëndrimit të tyre, ta shpejtonin zgjidhjen e tij. Në Beograd

më 3 qershor ndodhi incidenti i ashtuquajtur Çukur Çestame kur nizamët – ushtarët osmanë vranë një djalë të ri serb. Sapo u dëgjua për këtë rast në Çarshinë e Beogradit, shpërthyen demonstrata antiturke, dhe popullata myslimane u strehua në kështjellë nën mbrojtjen e garnizonit osman. Pastaj nga kështjella u bombardua qyteti i Beogradit. Me qëllim të rregullimit të kësaj çështjeje në Kanligje u mbajt konferenca ndërkombëtare, në të cilën me 22 shtator 1862 u vendos që popullata myslimane ta lëshonte Serbinë, ku do të qëndronin vetëm katër garnizone të osmanlinjve në kështjellat: Shabac, Beograd, Smederevë dhe Kladovë, ndërsa kështjellat në brendi - në Soko dhe Uzhiçë duheshin rrënuar.

Në fund të vitit 1862 filloi shpërngulja e myslimanëve nga Uzhica dhe Sokoja për në Bosnjë, ku pushteti osman kishte ndërtuar dy vendbanime në Savë, Azizinë e Epërme dhe të Poshtme (sipas sulltan Abdulazizit), - Bosanksi Shamac dhe Orashja e sotme. Posaçërisht është ilustrative ngjarja e Uzhiçës, e cila në gjysmën e parë të shekullit XIX, pas Beogradit, me të drejtë ka qenë qyteti më i madh turk (mysliman) në Serbi. Themeluesi i teatrit serb, shkrimtari dhe artisti Joakim Vujiç në “udhëpërshkrimet” e tij ka shënuar se Uzhica në tridhjetë vjetët e shekullit (XIX) kishte 2000 shtëpi myslimane, 20 xhami dhe 80 shtëpi serbe. Muslimanët e Uzhiçës kanë qenë tepër krenarë në qytetin e tyre; ata e këndonin: “Oj Uzhiçë, Stambolli i vogël. Sa ishe i mirë ishe, nëpër ty s’ka pasur mundësi të kalohet, nga sokaqet dhe qepengat, nga djemtë dhe vajzat”.

Sipas burimeve zyrtare serbe, Uzhiçën e kanë lëshuar 2966 myslimanë, të cilët kanë qenë të detyruar të shitnin pa kurrfarë çmimi ose thjesht të braktisnin pasurinë e tyre të patundshme. Muslimanët nga fshatrat e Uzhiçës u shpërngulën në Bosnjë qysh në vitin 1834. Të njëjtin fat e patën, por me numër më të vogël, edhe myslimanët e qytetit - kështjellë – Soko, i cili gjendej afër Krupnjës në Serbinë Jugperëndimore. Në fillim të vitit 1863 janë rrënuar me mina dhe si objektet ushtarake janë paaftësuar plotësisht, kështjellat e Uzhiçës dhe të Sokos. Në minim ishin të pranishëm zyrtarisht komesarët ushtarakë rusë e anglezë, gjenerali serb Ranko Alimpiç dhe koloneli turk Mehmet Ali bej. Në mbledhjen e Kuvendit më 17 gusht 1864, knezi Mihajl me kënaqësi konstatoi: “Muslimanët që kanë jetuar në Uzhiçë

dhe Soko, janë shpërngulur, ndërsa qytetet Uzhiçë dhe Soko janë rrënuar”. Në kundërshtim me këtë konstatim dhe ngadhënjim bosh, kronisti serb Miladin Radoviç shënonte se ndarja e myslimanëve me Uzhiçën dhe Sokon ka qenë e pikëllueshme dhe tepër e rëndë! Të gjithë shkuan duke qarë”.

Llogaritet se në fillim të viteve gjashtëdhjetë Serbinë e lëshuan 8000 myslimanë. Në Serbi mbetën një numër i konsiderueshëm i myslimanëve romë, të cilët nuk konsideroheshin turq dhe i myslimanëve që janë quajtur romë, për të mos i lënë vatrat e lindjes. Myslimanët në fshatrat e Zvornikut të Vogël dhe në Sakar, pavarësisht nga presionet e mëdha dhe shtyrjet me pushtetin serb, thjesht refuzuan të shkonin dhe deri më sot kanë mbetur aty. Kjo periudhë përfundon më 24 prill 1867, kur komandanti i fundit osman i kështjellës së Beogradit, Ali Riza pasha, ia dorëzoi simbolikisht knez Mihajlit çelësat e qyteteve serbe: Shabac, Beograd, Smederevë dhe Kladovë, të cilat sulltani ia “besoi” knezit për “ruajtje”. Të nesërmen Ali Riza pasha lëshoi Beogradin me njësitin e fundit të ushtrisë osmane. Njëkohësisht në kështjellën e Kalemegdanit, pos flamurit të sulltanit, u ngrit edhe flamuri serb. Nga ky moment disa mijëra myslimanë të tjerë të mbetur, ranë plotësisht nën përgjegjësinë dhe varësinë e pushtetit serb. Knez Mihajli në vitin 1868 urdhëroi të meremetohej e vetmja xhami e mbetur në Beograd, Bajrakli xhamia, “për të mos mbetur myslimanët që jetonin aty, pa ngushëllim religjioz”. Bashkësia e vogël myslimane në vitin 1874 kishte 6176 anëtarë. Bashkësi me numër më të madh ishin në Aleksinac (1242), Knjazhevac (1101), Shabac (688) dhe në regjionin e Podrimjes (973) anëtarë. Bashkësia Islame e Beogradit kishte vetëm 36 anëtarë.

Ndërkohë në vitin 1852 në Malin e Zi u bë krishterim i organizuar i myslimanëve të Vasojeviçëve nga ana e shtetit. Krishterimi masiv i afër tetëqind myslimanëve u bë në fshatrat Konjus, Bozhiç, Rezhanicë e Ulët dhe në grykën e lumit të Rëzhanjicës. Në kundërshtim me rregullat kanonike të Kishës ortodokse, sipas të cilave Krishterimi është akt individual që e kryen kleriku në kishë, ky krishterim u bë në grupe në fushë të hapur, në praninë e kapitenëve e bajraktarëve të fiseve dhe të rojtarëve të gardës, xhandarëve dhe përfaqësuesve të tjerë të pushtetit. Historianët malazez e arsyetojnë këtë krishterim “me

arsyet klasore, fetare dhe politike”, dhe me argumentimin e posaçëm kinse procesi i islamizimit kishte shkaktuar “desllavizimin e trevave”. Në kundërshtim me këtë, është vërtetuar historikisht që p.sh. shqiptarët që kanë jetuar rreth Rozhajës pas kalimit në Islam janë sllavizuar. Islami askund, as në Bosnjë dhe as në Sanxhak nuk ka sjellë desllavizimin e popullatës.

Gjatë krizës së madhe lindore 1875-1878, gjegjësisht në luftërat 1876-1878, principatave autonome të Serbisë dhe Malit të Zi me vendimin e Kongresit të Berlinit iu pranua statusi i shteteve të pavarura dhe sovrane me zgjerime të dukshme territoriale. Serbia u zgjerua duke fituar katër rrethe të reja: të Nishit, Pirotit, Toplicës dhe Vranjës. Sipas të dhënave nga viti 1874, në këtë hapësirë jetonin gjithsej 6566 Myslimanë. Një nga kushtet që Fuqitë e Mëdha, të mbledhura në Kongresin e Berlinit, ia vunë Serbisë për njohjen e pavarësisë, ka qenë që në territorin e saj të garantonte lirinë e predikimit të fesë. Shkak i kësaj ka qenë ankesa drejtuar Kongresit nga ana e Aleancës Universale Izraelite (Aliance Israelite Universlle), Organizatës ndërkombëtare me seli në Paris, për diskriminimin e hebrenjve në Serbi. Në nenin e marrëveshjes së Berlinit është paraparë se në Serbi “Nuk do të mund të jetë arsye për askënd që dallimi në fe dhe në predikimin e fesë ta përjashtojë ose ta konsiderojë të paaftë për të gëzuar të drejtat politike dhe qytetare, të mos jetë i pranuar në detyrat publike, titujt dhe nderimet ose të mos kryejë artizanate dhe industri të ndryshme, pavarësisht në cilin vend të jetë. Liria dhe kryerja publike e ceremonive kishtare do të jenë të garantuara për të gjithë qytetarët serbë si dhe për të huajt, dhe asnjë pengesë nuk mund t’i bëhet rendi hierarkik të predikimeve të ndryshme fetare as marrëdhëniet e tyre me prijësat e vet kishtarë”.

Këtë dispozitë qeveria serbe menjëherë pas vitit 1878 e përfundoi në nenin 77 të ligjit mbi rregullimin e viseve të çliruara, me të cilin “qytetarëve të fesë muhamedane si dhe qytetarëve të çdo feje tjetër të pranuar me ligj” u garantohej e drejta dhe liria që në mënyrë të barabartë të kryejnë “ceremonitë fetare të predikimit fetar të tyre”. Përveç kësaj u emërua edhe myftiu si udhëheqës fetar i muslimanëve me seli në Nish. Në realitet popullata myslimane nga katër rrethet e bashkëngjitura rishtas gati në tërësi, me dashje a me dhunë, ishte

shpërngulur. Disa vise, si Toplica dhe pjesët e rrethit të Vranjës, në të cilat banonte kryesisht popullata shqiptare myslimane mbetën tërësisht shkrete. Pasi nuk ishte e mundur të bëhej kolonizimi i brendshëm i shpejtë, shumë toka nuk u punuan për shumë vjet dhe për të nuk paguhej tatimi. Për këtë shkak, siç ka shkruar ministri i atëhershëm i ekonomisë popullore, Kosta Stojanović, shteti serb pati humbje të mëdha.

Situata në Malin e Zi, i cili gjithashtu me Kongresin e Berlinit fitoi pavarësinë, ka qenë e ngjashme me atë në Serbi. Me luftëra dhe me vendimin e Kongresit, Malit të Zi i takuan qendrat e njohura muslimane: Nikshiqi, Podgorica, Berani, Kollashini, Tivari dhe Ulqini. Këto qytete si dhe fshatrat myslimane në luginat e plleshme, iu nënshtruan valës së migracionit të madh të popullatës së varfër sllave nga malet përreth. Shumica e popullatës myslimane ndërkohë iku në Bosnjë e Hercegovinë, në Sanxhak, në Kosovë dhe në Shqipëri. Që nga ajo kohë filloi bredhja e shumë familjeve myslimane nga Mali i Zi i tanishëm jo vetëm në Ballkan, por në të njëjtën kohë deri në Azinë e Vogël dhe në Amerikë. Ata që mbetën përbënin një bashkësi të vogël myslimane me myftiun e Malit të Zi në krye, selia e të cilit së pari ishte në Tivar e pastaj kaloi në Podgoricë.

Kriza e madhe lindore dhe Kongresi i Berlinit sollën përmbyesje të vërtetë në jetën e Bosnjës dhe Hercegovinës, kështjellave kryesore të myslimanëve sllavë, në Evropën Juglindore”. Me vendimin e Kongresit të Berlinit, Austro-Hungarisë iu besua administrimi i Bosnjë dhe Hercegovinës, pa cenimin formal të të drejtave sovrane të sulltanit. Ajo e drejtë e sulltanit ishte “nudum ilis” ndërsa pushtetin e vërtetë në Bosnjë e Hercegovinë fuqimisht e mbante Austro-Hungaria. Vetëm pas luftimeve tremujore dhe angazhimit të një të tretës së forcave të veta të armatosura, në fund të tetorit 1878, Austro-Hungaria arriti ta okuponte tërë Bosnjën e Hercegovinën. Dëbimi i myslimanëve filloi qysh gjatë luftës së armatosur. Në ditën e parë pas okupimit të Sarajevës 19 gusht 1878, filloi punën gjyqi sipas të cilit aty për aty shumë persona u dënuan për vdekje me varje. Më tepër se 600 kryengritës myslimanë të zënë robë, u internuan në llogore në Olomou në Moravë (Çekosllavaki) ku qëndruan deri në fund të vitit 1879.

Përmbysja historike në jetën e myslimanëve të Bosnjës, e cila ndodhi me okupimin e vitit 1878, mund të krahasohet vetëm me ato kthesat vendimtare që ndërprejnë rrjedhën historike dhe orientojnë në një drejtim tjetër, me pak ose shumë pasoja dramatike, për ekzistencën e përditshm të njerëzve. Ardhja e Austro-Hungarisë në Bosnjë e Hercegovinë për myslimanët do të thoshte kalimi prej një civilizimi në një tjetër, tërësisht me kulturë dhe mënyrë tjetër të jetës, që nuk mund të përballohej thjesht, as pa dhembje dhe as shpejt. Lidhjet e shumta dhe shekullore me orientin islam, me okupimin pothuaj përnjëherë u ndërpreu. Me vite pas okupimit, myslimanët e ndienin veten tërësisht të humbur, të lënë vetëm, prandaj ata u detyruan të pranonin ndryshimet që u solli okupimi, ose të shkatërroheshin.

Lëvizja e vetme që vazhdonte në vetë popullatën myslimane, ishte shpërngulja në Turqi për shkak të kushteve të vështira ekonomike, e cila në tri hove: pas aplikimit të obligimit ushtarak 1882, në kohën e lëvizjes së Xhabiqit për autonominë e vakëfit – mearif 1899-1902 dhe pas aneksimit 1908, do të merrte përmasa të mëdha.

Shpërngulja pas aneksimit mori aq shumë përmasa, sa që flitej për “një ndjekje të vërtetë popullore”, e cila ishte vështirë të ndalej. Stacioni hekurodhor i Beogradit për çdo natë para nisjes së trenit të Selanikut ishte i stërmbushur me muhaxherë të Bosnjës. Duke shikuar përditë këtë panoramë, Jovan Cvijiq në vitin 1910 shkruante se, nëse kjo vazhdon, as gjysma e myslimanëve nuk do të mbeten në Bosnjë. Jovan Cvijic konsideronte se shpërngulja e myslimanëve të Bosnjës, “nuk ishte provokuar nga shkaqe ekonomike, por sidomos nga gjendja psikologjike”. Për shkaqe të tilla edhe qeveria austrohungareze zyrtarisht për opinion – e shpjegonte shpërnguljen. Në kundërshtim me këtë antropogjeografi francez, Caston Grasier, i cili është marrë me çëshjet politike të trevave tona në vitin 1911, kishte kuptuar pikërisht se shkakut themelor i shpërnguljes ishte varfërimi i popullit dhe se Austrohungaria me qëllim u mundësonte shpërnguljen myslimanëve për ta zbatuar sa më shpejt kolonizimin e Bosnjës e Hercegovinës. Organet austrohungareze në shkresat e tyre të besueshme, vetëm për nevojat interne, shënonin se shkakut i shpërnguljes më së shpeshti është varfëria, përkatësisht “kalimi” nga ekonomia natyrale në ekonominë financiare”.

Masën kryesore të të shpërngulurve e përbënin fshatarët, varfërimi i të cilëve në vitet e para pas okupimit kudo ishte i qartë. Të dyshimtët e ndryshëm “Kulturträgerët” të cilët gazeta ushtarake austrohungareze “Vedette” në një artikull më 1880 i cilësonte si “Vagabunden in Bosnien”, bënin agjitacion për shpërngulje dhe blinin shumë lirë tokat nga fshatarët e frikësuar. Nxitjet dhe shpërngulje nganjëherë vinin edhe nga udhëheqësit politikë serbo-kroatë, të cilët shpresonin se në këtë mënyrë do të forconin elementin e tyre. Ka pasur edhe nga myslimanët që shkretëronin shumë vise të pastra myslimane duke i bindur popullin për shpërngulje, nga e cila kishin interes material si ndërmjetsues, me rastin e shitblerjes së tokës dhe vendbanimeve. Kishte edhe njerëz të urtë dhe përgjegjës që u përpoqën të prapësonin njerëzit nga shpërngulja. Hafiz Muhamed ef. Haxhijahiç botoi një seri artikujsh në vitin 1884 kundër shpërnguljes, në revistën turko-boshnjake “Vatan” (Atdheu). Dy vjet më vonë, gjithashtu në gjuhën turke ai botoi disertacionin kundër shpërnguljes, Muhamed Teufik Abazagiq, më vonë Reisul Ulema (1893-1909). Mirëpo në tërësi udhëheqësia e atëhershme myslimane nuk është angazhuar, siç ka shkruar më 1927 Ed-hem Mullabdiq, në mënyrë ekspresive dhe haptazi në çështjen e shpërnguljes, e cila atëherë kishte marrë përmasa dhe e cila e godiste ndjeshëm bashkësinë myslimane.

Presioni i pushtetit ndaj popullatës myslimane deri diku u dobësua vetëm nga mesi i viteve tetëdhjetë, kur pushteti kuptoi se me shpërnguljen masive të popullatës myslimane po prishej dukshëm ekuilibri etnik dhe konfesional i Bosnjës e Hercegovinës në dobi të elementit serb, që do ta vështirësonte dukshëm pozitën e Monarkisë në Ballkan. Si duket, pushteti, siç ka shkruar një autor austriak, e kishte kuptuar se “në pajtimin me myslimanët e bindur duhej kërkuar e vetmja mundësi për sigurimin e përparimit të përhershëm të vendit”...

Shumë vështirë është të thuhet në saktësi se sa myslimanë janë shpërngulur gjatë katërdhjetë vjetëve të sundimit austrohungarez në Bosnje e Hercegovinë. Në publicistikën e popullarizuar dhe rrëfimet gojore të myslimanëve, manipulohet me shifrat prej 300.000 deri në 700.000, madje edhe deri në një milion të shpërngulur, që i përket fushës së fantazisë. Sipas të dhënave zyrtare austrohungareze, të cilat edhe vetë pushteti i ka shpallur si “mjaf të sigurta”, në periudhën

1878-1918, janë shpërngulur gjithsej 61.114 myslimanë. Kjo i përgjigjet përafërsisht numrit prej 63.736 personave të vendosur përkatësisht të kolonizuar nga Monarkia austrohungareze në tokat që i lëshuan muhaxhirët. Se sa kontradiktore janë burimet mbi numrin e të shpërngulurve, më së miri tregon fakti se Këshilli i Stambollit për vendosjen e refugjatëve e pati lajmëruar shkrimtarin Hifzi Bjellevac se prej 1900 deri më 1905, nga Bosnja janë shpërngulur 72.000 veta. Burimet zyrtare austrohungareze për periudhën e tillë pranojnë vetëm 13.750 të shpërngulur.

Shifra zyrtare austrohungareze prej 61.114 të shpërngulurve është tepër e vogël dhe thjeshtë e pavërtetë. Pas okupimit, përqindja e myslimanëve në numrin e përgjithshëm të banorëve të Bosnjës dhe Hercegovinës vazhdimisht është zvogëluar. Okupimi, sipas regjistrimit të vitit 1879, ka gjetur 448.613 myslimanë, që përbënin 38,73% të banorëve të Bosnjës e Hercegovinës. Edhe pse popullata myslimane absolutisht ka qenë me shtim të mirë, pjesëmarrja e saj në popullatën e gjithmbarshme është zvogëluar. Regjistrimi i vitit 1885 ka shënuar 492.710 myslimanë, do të thotë 36,88%, ndërsa më 1895 548.632, d.m.th. 34,99%. Kjo përqindje në vitin 1910 ka rënë në gjithsej 32,25% ose në shumën absolute 612.137 myslimanë. Për këtë depopullizim të myslimanëve, Austro-Hungaria ka cekur shkaqe të ndryshme, por është vështirë të merret seriozisht ndonjë shkak tjetër pos shpënguljes së madhe në Turqi. Vlerësimi real në shkencë ishte shifra prej 150.000 deri 180.000 të shpërngulur. Për komunitetin relativisht të vogël boshnjako-myslimanë ky numër ka qenë tejet i madh, pasojat demografike e të tjera të të cilit u ndien me decenie. Megjithatë, nga kjo nuk duhet përfunduar kurrëse se Austro-Hungaria ka ushtruar politikë gjenocidale ndaj myslimanëve.

Luftërat Ballkanike u sollën sprovë të reja myslimanëve sidomos atyre në Sanxhakun e Novi Pazarit. Psa disfatës së turqve ky sanxhak më 1912-13, u nda në mes Serbisë dhe Malit të Zi. Mbi hyrjen e njërive serbe në Novi Pazar është ruajtur dokumenti që ka lënë nëpunësi turk Omer Koniçanin. Ai shkruan se ushtrinë serbe “e pritën solemnisht” serbët nga qyteti dhe masa myslimane. Gratë serbe kanë qenë të veshura me petka solemne me vargjet e stolive rreth kokës dhe qafës. Në bisedë me ta komandanti lokal në shaka i paska pyetur: “A

ky është zullumi turk që e kenë duruar a?" duke shikuar vargjet e duketëve. Në të njëjtën ditë ushtria serbe që sistemuar nëpër të gjitha rrugët e qytetit. Qëndrimi i tyre ndaj myslimanëve ka qenë korrekt, sjelljet e tyre linin përshtypje të shkëlqyeshme tek myslimanët në qytet... Të gjitha shtëpitë myslimane që i kishin braktisur pronarët gjatë luftimeve rreth Novi Pazarit, me ndërrime i ruanin ushtarët serbë. Kur pronari kthehej, rojtari ia dorëzonte shtëpinë me procesverbal, me të cilin konstatohej gjendja e shtëpisë dhe inventari. Për shkak të tërë kësaj, ushtria serbe arriti besim të madh dhe gëzoi autoritet të fortë tek myslimanët".

Në anën tjetër të Sanxhakut, andej nga hyri ushtria malazeze, situata ishte krejtësisht tjetër. Ajo i qëroi hesapet egërsisht sidomos me myslimanët në Sjenicë dhe Peshter; aty u bënë plaçkitje dhe djegie të shtëpive myslimane. Nga myslimanët së pari në mënyrë perfide merrshin armët e pastaj fillonte therja e njerëzve duarthatë. Vetëm në fshatin Doliq janë vrarë 58 myslimanë. Plaçkitje, vrasje dhe keqpërdorime ka pasur posaçërisht në Bjello Polje dhe rethinë, ku ato veprime shkaktuan frikë të madhe dhe mosbesim në popullatën myslimane. Vetëm deri në fillim të Luftës së Parë Botërore nga pjesa e sanxhakut të Malit të Zi janë shpërngulur 12.302 myslimanë.

Sidomos një fat dramatik kanë përjetuar myslimanët e Plavës dhe Gucisë. Marrëdhëniet e qeta të popullatës me pushtetin e ri i çrregulltoi ardhja e grupeve të parregullta nën komandën e Avra Cemoviçit. Njerëzit e tij filluan t'i plaçkitnin e t'i digjin shtëpitë, të merrnin kafshët, të ushtronin dhunë ndaj grave myslimane dhe të vrisnin njerëzit e qetë". Llogaritet se pa farë shkakut janë vrarë 550 qytetarë (sipas disa të dhënave tërësisht 800), dhe pastaj ka filluar kryqëzimi me dhunë. Në këtë situatë myftiu i Gucisë i këshilloi popullatën që përkohej formalisht, për ta shpëtuar jetën, të pranonin ortodoksizmin, e më vonë të riktheheshin në Islam. Njerëzit e dëgjuan, andaj popi i Gucisë, Gjorgje Shekullarac kryqëzoi 12000 myslimanë. Në të njëjtën kohë në fillim të majit të vitit 1913, një delegacion i myslimanëve autoritativë pati sukses të arrinte në Cetinje ku e njoftuan kral Nikollën për ngjarjet pikëluese në Plavë dhe Guci. Me intervenimin energjik të kralit menjëherë u hapën të gjitha xhamitë, kurse të kryqëzuarve me dhunë iu lejua rikthimi në Islam. Përveç tri familjeve, të gjithë të

tjerët në të njëjtën ditë iu rikthyen fesë së tyre islame dhe i mbushën të gjitha xhamitë ekzistuese.

Me bashkimin, gjegjësisht formimin e shtetit jugosllav të monarkisë serbo-kroato-slllovene, politika e gjenocidit ndaj myslimanëve ka vazhduar në forma të ndryshme si në Sanxhak ashtu edhe në Bosnjë e Hercegovinë dhe në përgjithësi ndaj popullatës myslimane në Kosovë dhe Maqedoni. Vetëm në Hercegovinën Lindore në vitet e para pas bashkimit, janë vrarë pa gjyq e pa ligj më tepër se tre mijë myslimanë, më së tepërmi nga banditë të njohur të Majo Vujoviçit dhe Petar Roganit. Mbi gjendjen e vështirë, dhunën shtetërore dhe kushtet e myslimanëve në Kosovë, Sanxhak dhe Maqedoni, në mënyrë impulsive dëshmon reagimi që i dërgoi qeverisë Reisul-ulemaja i atëhershëm, Ibrahim ef. Maglajiç në janar të vitit 1931, pas udhëtimit inspektues të tij nëpër të ashtuquajturën Serbi të Jugut.

Gjenocidi më i tmerrshëm mbi myslimanët në Jugosllavinë monarkiste është kryer në fillim të nëntorit 1924 në fshatrat Shahoviq dhe Pavino Pole në rrethin e Bjello Poles. Afër Kolashinit me 7 nëntor u vra ish naçellniku i rrethit Boshko Boshkoviç. Për këtë vrasje, siç është dokumentuar më vonë në gjyq, shteti pati fajësuar disa myslimanë. Në varrimin e Boshkoviçit, masën e nxitën për hakmarrje kundër myslimanëve naçellniku i Bjello Poles Nikodim Cemoviç, kreu i Bjello Poles Lazo Bogiçeviç etj. Natën në mes 9 e 10 nëntorit u nisën afër 2000 malazet të armatosur për në Shahoviq dhe Pavino Pole, ku i vranë dhe masakruan afër 600 myslimanë të rritur, gra dhe fëmijë. Në Shahoviq “është lozur një dramë e tmerrshme dhe e përgjakshme”, të cilën në mënyrë plastike e ka përshkruar Milovan Gjilasi në librin “Toka pa drejtësi” (Londër 1958). Mbi atë dramë të tmerrshme Gjilasi kishte dëgjuar nga babai i tij, Nikolla Gjilas, major rezerv i xhandarmërisë, që ishte njëri nga komandantët e ekspeditës së përgjakshme në Shahoviq dhe Pavino Pole. Për krimin u informua menjëherë dhe Reisul-Ulema Xhemaluddin Çausheviç i cili dërgoi protestë të ashpër shtetit, ndërsa deputetët e partive të ndryshme në parlament lidhur me këtë kritikuan qeverinë. Edhe kral Aleksandrit i dërguan memorandum, por tërë ngjarja, me kalimin e kohës, u harrua. Banorët e mbetur gjallë të Shahoviqit dhe Pavino Poles, tërësisht u shpëngulën në Plevle, Sarajevë, Turqi, ndërsa 140 familje me afër 400 anëtarë

erdhën si refugjatë në Gornji Rahiç afër Bërçkos, dhe aty u vendosën përgjithmonë. Në vendin e dikurshëm të Shahoviqit sot është fshati ortodoks Tomashevo.

Në vitet tridhjetë, në Jugosllavinë monarkiste janë hartuar plane të ndryshme për shpërnguljen e popullatës myslimane, sidomos shqiptare nga e ashtuquajtura Serbi Jugore. Disertacionet kinse shkencore për këtë, të cilat i kishin inicuar Qeveria dhe Shtabi i Përgjithshëm, janë diskutuar në klubin kulturor serb. Në atë klub janë lexuar dy referate. Njërin e kishte hartuar profesori universitar Dr. Vasa Çubriloviç, ndërsa tjetrin shkrintari dhe diplomati i shquar, akademik Ivo Andriç. Çubriloviçi në rend të parë ankohej pse pas vitit 1918 nuk u vepruan ashtu siç kishin bërë dikur Karagjorgji, Miloshi, Mihajli dhe Jovan Ristiçi, të cilët “spastruan Serbinë nga elementi i huaj dhe e banuan me popull të vet”. Krahas konstatimeve tejet diskriminuese madje edhe fyese për “Arnautë - (shqiptarë)” Qubriloviç mendonte se e vetmja zgjidhje është shpërngulja: “Kur Gjermania mund t’i shpërngulë me dhjetëra mijësh çifutë, Rusia t’i dislokojë me miliona njerëz prej një pjese të kontinentit në tjetrën, për shkak të disa qindra mijëra arnautëve të shpërngulur nuk do të pëlcasë lufta botërore”.

Ivo Andriç në referatin e tij ka qenë shumë më i kujdesshëm, më analitik dhe inteligjent. Ai, pas një analize të gjerë historike, përfundonte se Jugosllavisë më së shumti i përgjigjej Shqipëria e pavarur, ndërsa ndarja e saj eventuale me Italinë dhe Greqinë, paraqet një të keqe të domosdoshme e të pashmangshme. Nga dy të këqija, Andriç në fund theksoi se duhet zgjedhur e vogla.

Në Athinë, më 9 shkurt 1934 u lidh aleanca ballkanike ndërmjet Jugosllavisë, Turqisë, Greqisë dhe Rumanisë, me qëllim të mbajtjes së rendit territorial ekzistues përpara politikës revizioniste të vendeve që kapitulluan në Luftën e Parë Botërore, në rend të parë Bullgarisë, pas të cilës qëndronte Gjermania. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Jugosllavia lidhi një konventë të posaçme me Turqinë mbi shpërnguljen e popullatës myslimane, kryesisht shqiptare, atje, me kompensim përkatës financiar. Kjo do të thotë se qeveria monarkiste nuk ka mundur të gjejë zgjidhje të çështjes myslimane, përkatësisht shqiptare, në zhvillimin e gjithanshëm të atij populli, por në shpërnguljen e tij. Plani mbi këtë nuk u realizua, sepse Qeveria Jugosllave, e frikësuar

nga skandali publik nuk pati guxim t'ia paraqiste Konventën Parlamentit për ratifikim. Pa marrë parasysh këtë, ishte e paraparë që të shpërnguleshin në perudhën 1939-44 afro 40.000 familje. Vetëm mungesa e mjeteve financiare e shtyri realizimin e këtij plani, e pastaj erdhi lufta e prillit dhe kapitullimi i Jugosllavisë monarkiste në vitin 1941.

Në luftën tejet të komplikuar çlirimtare dhe qytetare në Jugosllavi në vitet 1941-45, myslimanët, siç është theksuar në fillim, i nënshtruan gjenocidit më të egër në historinë e tyre. Ky gjenocid vinte nga dy drejtime: nga ana e shtetit ustash të pavarur kroat dhe nga ana e çetnikëve të Drazha Mihajloviçit. Gjenocidi mbi myslimanët është ushtruar në dy aspekte: Në një anë u është mohuar dhe u është marrë subjektiviteti kulturor-historik dhe identiteti kombëtar e, në anën tjetër, është bërë shfarosja masive-fizike e tyre. Në dispozitën e ligjit ustash mbi karakterin e racës ariane të ithtarëve të fesë islame në Bosnjë e Hercegovinë, datë 30 prill 1941, Myslimanëve haptazi u mohoj dhe u merrej subjektiviteti kombëtar me shpalljen e njëanshme të tyre kroatë. Shteti ustash nuk qe mjaftuar vetëm me kaq, por shumë myslimanë i mobilizoi dhe i vrau në llogoret e tyre të koncentrimit në Gospiç, në Staro Gradishtë, Jasenovac dhe në Bosanski Dube. Nën udhëheqjen e Maks Lukuriçit, ustashët një numër të madh myslimanësh i vranë mizorisht në kohën e fazës së fundit të qeverisjes së tyre, në mars të vitit 1945, në Sarajevë.

Në tjetrën anë, çetnikët qysh nga fillimi i hynë likuidimit sistematik fizik të myslimanëve. Kjo qe si një moto e përhershme e programit, e formuluar haptazi në shkresat e ideologut kryesor çetnik Stevan Moleviç, posaçërisht në artikullin e tij "Homogena Srbija – Serbia Homogjene", dhe në letrën e ideologut të dytë çetnik, Dragisha Vasiç, në shkurt të vitit 1942. Sipas Moleviçit vendi duhej spastruar nga "të gjithë elementet joserbe". Për këtë qëllim fajtorët duhet të dënohen në vend, ndërsa të tjerëve duhet t'u hapet rruga, - kroatëve në Kroaci, kurse muslimanëve në Turqi (ose në Shqipëri). Vetë Drazha Mihajloviç ka lënë shumë shënime dhe urdhëresa për komandantët e tij, për likuidimin e myslimanëve.

Rrënjët e gjenocidit të përbashkët kroato-serb dhe të shfarosjes së përgjithshme të myslimanëve qëndrojnë në rrethet e pushtetmbajtësve ballkanikë që në këtë mënyrë synonin të krijonin territore të pastra.

Për këtë qëllim çetnikët e Drazha Mihajloviçit në tri raste kanë kryer masakra në masë të popullatës myslimane në Hercegovinën Lindore, në Bosnjën Lindore e Perëndimore dhe në disa pjesë të Sanxhakut. Vala e parë e gjenocidit çetnik mbi myslmanët përfshinte kohën nga qershori 1941 deri më shkurt 1942; e dyta gjatë gushtit 1942, kryesisht në Foqë, ndërsa e treta ka ndodhur në fillim të vitit 1943. Në këto masakra të masave kanë pësuar myslimanët në trevën e Lubinjës, Avrtovcit, Bileçes, Kulen Vakufit, Korajës, Vishegradit, Rogoticës, Gorazhdës, Sjenicës, Vlasenicës, Srebrenicës, Nevesinjes, Foçës, Prozorit, Jablanicës, Plevles, Ustikolnit etj. Ky gjenocid i paparë mbi myslimanët, mori me dhjetëra mijëra jetë.

Në verën dhe vjeshtën e vitit 1941 popullata myslimane, sidomos fshatarësia nga viset që ishin përfshirë nga gjenocidi çetnik, kërkuar shpëtim duke i lëshuar shtëpitë e tyre, andaj një numër i madh i muhaxhirëve vërshuan Sarajevën, Visokon, Mostarin, Banjallukën, Tuzllën, Derventen dhe vende të tjera në Bosnjën Qendrore dhe në Posavinë. Tërë kjo i vuri para sprovave dhe detyrimeve të reja e të rënda masat e gjera të popullatës myslimane. Pas masakrës së dytë të myslimanëve në Foqë, në verën e vitit 1942, në Sarajevë u formua Këshilli i shpëtimit kombëtar, anëtarët e të cilit, bashkë me shoqatën humanitare “Merhamet”, pa kursim dhe me përkushtim punuan për shpëtimin dhe kujdesin ndaj një numri gjithnjë më të madh të muhaxherëve. Mjerisht, anëtarët e keshillit të shpëtimit nacional, në vend të mirënjohjes për punën e tyre, pas luftës qenë dënuar me burg pa bazë.

Përmes shoqatës Ilmije “El-Hidaje” është organizuar tubimi i materialit dokumentar mbi masakrat dhe krimet e çetnikëve dhe ustashëve. Lidhur me këtë është punuar elaborati i posaçëm dhe i është dërguar fshehtazi premierit të Egjiptit, Nahas pashës, në Kajro. Për të njëjtin qëllim një delegacion i myslimanëve në të cilin ka qenë edhe Reis-Ulemaja i mëvonshëm, Ibrahim ef. Fijjiçi shkoi në Romë në vitin 1943. Nahas pasha nga ana e tij protestoi tek britanezët kundër çetnikëve, ndërsa përmes gjysmëhënës egjiptiane “Fuad I” u ndërmor aksioni për ndihmën popullatës myslimane në Bosnjë e Hercegovinë dhe Sanxhak. Për këtë gjërisht shkruante “Al-Ahram” në numrin e 29 qershorit 1944.

Në vitet pas 1945-ës janë ndjekur dhe dënuar aktivistët fetarë myslimanë. Me decenie janë rrënuar objektet sakrale e të tjera myslimane, janë rrafshuar varrezat, janë rrënuar qendrat arkitektone dhe urbane të qyteteve të vjetra boshnjako-muslimane dhe janë ndërruar emrat myslimanë të rrugëve. Me një fjalë, është tentuar në vepër shfarosja e plotë dhe asimilimi i myslimanëve në të ashtuquajturën bazë kulturo-politike jugosllave, në realitet serbomadhe. Myslimanët, sipas mundësive dhe kushteve ekzistuese, këtë e kundërshtuan vendosmërisht dhe iu kundërvunë.

Pas tërë kësaj, sot jo plot një vit pas zgjedhjeve të para shumëpartiake dhe të lira në Bosnjë e Hercegovinë dhe në vise të tjera të Jugosllavisë, nga parti të caktuara myslimanët kërcënohen haptazi me një gjenocid të ri.

*Marrë nga "Glasnik"
i Riasetit Bashkësisë Islame në SFRJ, nr. 6, viti 1991.*

*Përktheu dhe përshtati:
Hajrullah Hoxha*

VRASJA E HALIFIT HAZRETI OMER r.a.
sipas gazetës së asaj kohe “JETHRIB”

Historianët janë të ndarë rreth motivit të vrasjes së halifit Omer r.a. Përderisa një grup mendojnë se halifin e mbyti robi i Mugirit me emrin Ebu Lulu, për shkak të mosuljes së rentës, grupi tjetër mbështet mendimin se halifi ishte viktimë e një intrige që e përgatitën persiani Hurmuzi, i krishteri Xhefine dhe Ebu Lulu Firuzi.

“JETHRIB” ka qenë gazeta më e përhapur e asaj kohe. Kjo gazetë 26 dhu’l-hixhxe viti 23, me rastin e vrasjes së hazreti Omerit r.a. shkruante.

“Një persian në xhami e sulmoi halifin dhe e plagosi së bashku me 13 persona të tjerë dhe pastaj bëri vetëvrasje”. Më tej, shkruan gazeta, sapo përfunduar me përgatitjen e gazetës, ne u nisëm në xhami për namazin e sabahut, kur na arriti një lajm i dhembshëm për tentim atentati ndaj halifit në momentin kur ai përgatitej për faljen e namazit.

Populli arab nuk njeh këso vepra të ulët, por as që pranon një trimëri të tillë. Sikur ta sulmonin halifin në një fushëbetejë të hapur me qindra kësi horrash, ai me siguri do t’ua thyente eshtrat. Por ky sulm dhe kjo vepër ndaj halifit ndodhi tradhtisht, pas shpine, mu në kohën kur i ngrinte duart lart për të kënduar tekbinin fillestar.

Ne edhe më herët, vazhdon gazeta ‘Jethrib’, e kemi paralajmëruar qeverinë që të jenë të kujdesshëm me disa persona të dyshimtë, të

cilët kanë ardhur në Medinë nga vende të largëta, dhe vetëm Zoti e di se me çfarë idesh janë të frymëzuar. Gjithashtu e kemi sinjalizuar edhe vetë halifin që të mos dalë pa armë dhe pa mbrojtje, sepse edhe Medina është përplot me persona të dyshimtë”.

Numri tjetër i gazetës ‘Jethrib‘ sjell këto lajme:

“Halifi hyri në xhami që, sipas zakonisht të falet me xhemat. Në dorë mbante shkopin me të cilin tregonte se si duhet të rregullohen salfat, pasi në çdo punë donte të kishte rend dhe rregull. Xhemati e priti shumë mirë duke i mundësuar kalimin deri te mihrabi. Pastaj, duke u kthyer nga Kibla, i ngriti duart lart për të kënduar tekbinin. Mirëpo, ende pa e kryer tekbinin, një njeri që qëndronte prapa tij, e goditi me thikë në shpinë. Duke mos e pritur këtë sulm të befasishëm, nga një goditje mjaft e rëndë, halifi rrëshqiti dhe me atë rast edhe vrasësi për pak u rëzua, por arriti që me dorën e majtë të mbahej për krahun e halifit dhe vazhdoi me tërë forcën që kishte, ta therte Omerin r. a. Halifi u kthye dhe bëri rezistencë. Duke e goditur në gjoks kriminelin, i tha : A dëshiron të më vrasësh, or rezil? Krimineli rrëshqiti, por shpejt u ngrit dhe e sulmoi prapë me thikë duke e goditur shumë ashpër. Këtë herë Omeri. r.a . u rëzua. Me atë rast i tërë xhemati i pranishëm sikur u step dhe menzi u këndell për t’iu vërsulur kriminelit. Krimineli, si i tërbuar vrapoi për të dalë jashtë duke bërë lëvizje të shpejta me thikë në dorë, dhe duke plagosur edhe 13 njerëz të tjerë. Kur pa se nuk kishte shpëtim dhe se nuk mund të ikte, bëri vetëvrasje.

Xhemati u kthye i hutuar në drejtim të halifit, i cili në atë moment pyeti se a gjendet aty diku Abdurahman bin Avfi. Abdurahmani u përgjigj: Po sundimtar, këtu jam. Kalo këndeje dhe falja namazin xhematit,- këto qenë fjalët e halifit. Edhe pse në këtë moment gjendjen e kishte tepër të rëndë, Omeri r.a. mbeti Omer, ai edhe me këtë rast nuk e harroi obligimin e tij si fetar dhe si udhëheqës.

Derisa Abdurahmani i printe xhematit që falej, Omeri r. a. duke u mbështetur ngadalë në bërryla, u shtri në tokë dhe me lëvizjen e buzëve përcillte xhematin në namaz. Pas namazit, të pranishmit dëshiruan ta dërgonin në shtëpi, për se halifi, duke buzëqeshur, tha: Ma jepni shkopin, vallë a mos e keni parë ndonjëherë udhëheqësin pa shkop. Nga këto fjalë të tij të gjithë të pranishmit qeshën, por nga sytë e tyre rrodhën lotët, të cilët binin në duart e halifit që ishin të mbuluara me

gjak. Të pranishmit, duke e mbajtur halifin, e dëgjuan të ketë thënë: E falënderoj Allahun që këtë veprim nuk e kreu ndonjë nga muslimanët.

Korrespondenti ynë, shkruan “Jethrib”, kupton se vrasësi ishte një persian nga Nihavenda me emrin Ebu Lulu Firuz, i cili ishte rob i Mugire bin Shubetit, dhe vazhdon: “Para disa ditësh Ebu Lulu vjen te halifi dhe e akuzon Mugiren për rritjen e pagës për rentën. Biseda në mes halifit dhe Ebu Luluit u zhvillua në këtë mënyrë:

Halifi e pyeti Ebu Luluin: Sa e ke rentën?

- Çdo ditë nga dy dërhemë- ishte përgjigja e Ebu Luluit.

- E konsideroni ju këtë çmim të lart?- i thotë halifi.

- Po, -u përgjigj Ebu Lului.

- Me çfarë pune merresh? e pyeti halifi.

- Jam farkëtar, latues dhe kazanxhi,- u përgjigj Ebu Lului.

- Merresh me tre zanate dhe ankoresh se janë shumë 2 dërhemë në ditë. Jo, sipas fitimit, renta jote nuk është e lartë. Në këtë mënyrë Omeri r. a. e refuzoi ankesën e Ebu Luluit.

Mendohet se pas kësaj bisede mes halifit dhe Ebu Luluit, ai vendosi ta vriste, gjë që edhe e bëri.

Abdurahmani, i biri i Ebu Bekrit r. a., rrëfen se si, një natë para se të ndodhte sulmi ndaj Omerit r. a. i kishte parë Hurmuzanë, Xhefinën dhe Ebu Luluin, që pëshpëritnin diçka. Ata, me të vërejtur Abdurahmanin, u larguan, dhe njërit prej tyre i ra thika dytëhëshe. Abdurahmani, duke vazhduar rrëfimin, thotë: Ishte po ajo thikë me të cilën është goditur Omeri r. a. Më parë thamë se ky kriminel i ndyrë, me rastin e vrasjes së Omerit r. a., plagosi edhe 13 veta të tjerë, sepse ata e sulmuan dhe e penguan të ikte. Prej tyre 7 veta kishin marrë plagë vdekjeprurëse. Ata u varrosën me ikindi. Namazin e xhenazes ua fali Suhejbi, i cili me atë rast zëvendësoi halifin e plagosur rëndë. Ndërsa për 6 të plagosurit e tjerë Omeri r. a. menjëherë e dërgoi të birin, Abdullahun, që t’i vizitonte dhe ta informonte për gjendjen e tyre shëndetësore.

Për këtë interesim dhe kujdes të madh të halifit ndaj të plagosurve, të gjithë të pranishmit u mallëngjyen dhe iu drejtuan Allahut me lutje që sa më parë të shërohej. Mirëpo komisioni i mjekëve prej gjashtë anëtarësh konstatoi se halifi kishte marrë gjashtë goditje, kishte humbur sasi të mëdha të gjakut dhe se i tërë organizmi i brendshëm në

stomak ishte shqyer, saqë, kur e ushqyen me qumësht, qumshti i rrodhi nga vrima e plagës fare i pa ndryshuar. Allahu na mëshiroftë!

“Jethrib” në numrin vijues njofton për vdekjen e halifit, duke dhënë në hollësi një përshkrim për jetën e tij para dhe pas pranimit të Islamit e deri tek meritat e mëdha për përhapjen e tij.

Në xhenazen e Omerit r. a. ishte e pranishme tërë Medina. Varrimi i tij u bë në afërsi të Resulullahut dhe pranë H. Ebu Bekrit. Namazit të xhenazes i priu Suhejbi. U bë e njohur se në ç’mënyrë halifi Omer r. a. përcaktoi këshillin për zgjedhjen e udhëheqësit të ri. Abdullahut, birit të vet, ia la porosinë, se cili të zgjidhej halif i ri, atij t’i pëcilte selami dhe t’i dorëzohej letra.

Për Omerin r. a. është shkruar dhe akoma vazhdon të shkruhet, por ky ishte një shkrim i shkurtër rreth fundit të jetës së tij të cilin, qysh në vitet e tridhjeta të shekullit të kaluar e botoi Abdullkadir El-Mazini në të përmuajshmen egjiptase “ER-RRISALE”. Autorit në fjalë i kishin ra në dorë disa nga gazetatat e asaj kohe, si “JETHRIB” dhe “DARU’L-HIXHRE”.

*Marrë nga “EL- HIDAJE”, nr. 3,
shkurt, 1937 Sarajevë*

Përgatiti: Shevki Voca

*Gazetat që dilnin në atë kohë ishin “JETHRIB” dhe “DARU’L- HIXHRE”. Gazeta “Jethrib” ishte më e lexuara dhe më e përhapura. Bashkëpunëtorë të saj ishin njerëz të famshëm, shokët e Pejgamberit a. s., të cilët bashkë me të dhe të tjerët, Ebu Ubejdi, Halid bin Velidi etj., luftuan për Islam. “Jethrib” dilte menjëherë pas namazit të sabahut, në mënyrë që sa më shpejt t’u arrinte lexuesve në dorë. Është meritë e “Jethribit” për udhëheqjen e fushatës që të niste shtypja e monedhës arabe, dhe në këtë mënyrë të bëhej heqja e monedhës persiane dhe greke, të cilat i përdornin arabët. Kështu gjatë kohës së halifatit të Omerit r.a. nisi farkimi i monedhës arabe. Si model i farkimit të monedhës u morë monedha persiane. Në njërën anë u gdhendën shkronjat “El hamdu li’l-lahi”, kurse në anën tjetër: “Muhammedun resulull-llah”. Në fillim farkimi i monedhës bëhej nga bakri, kurse më vonë filloi të punohej edhe nga ari.

Nexhat Ibrahim

FUNDAMENTALIZMI DHE KISHA ORTODOKSE SERBE

Hyrje

Duke u nisur nga maksima tashmë e njohur se *sulmi është mbrojtja më e mirë*, Bota Perëndimore katolike sikur edhe ajo lindore pravoslave - ortodokse *fundamentalizmin* ia atribuojnë fesë islame dhe muslimanëve.¹ Bota islame, inerte dhe në defensivë konstante fetare, morale, politike dhe ekonomike, ende nuk ka arritur që cilësisht dhe vëllimisht t'i përgjigjet këtij provokimi serioz me pasoja fatale.

Për këtë arsye, por edhe për arsye objektive (faktori kohë, faktori material, po edhe mungesa e punës institucionale ndër ne), ende nuk është arritur një qasje konstruktive dhe e hollësishme në studimin dhe hulumtimin e çështjes së *fundamentalizmit në përgjithësi* dhe ndër ortodoksët në veçanti, as në rrafshin teorik dhe as në atë praktik. Andaj pretendimi ynë me këtë punim të shkurtër është modest.

¹ Shih për këtë çështje: N. Ibrahim, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, Shkup, 1998.

Burimet shpirtërore dhe historike të fundamentalizmit ortodoks serb

1. Burimet shpirtërore të fundamentalizmit ortodoks serb.

Nëse e miratojmë faktin se *fundamentalizmi* si term teknik përdoret si shenjë që shënon çdo qëndrim shpirtëror që insiston në jondryshueshmërinë e disa parimeve ose që synon t'i përcaktojë parimet themelore për një fushë të mendimit ose të veprimit, atëherë ky term mbulon edhe atë që quhet ortodokse në cilëndo fushë.² Shembull tipik i qëndrimit të tillë ortodoks, për të cilin mund të përdorim edhe termin fundamentalist, është çështja e besnikërisë, lojalitetit të ortodoksëve ndaj qëndrimeve të etërve të Sinodit të Nikesë (Izniku i sotëm në Turqi) më 325 dhe të Konstantinopolit më 381 mbi çështjet e dogmave të Kishës, për ç'arsye ndodhi skizma, çarja në Kishën kristiane përfundimisht në vitin 1054. Atëbotë ortodoksët (pravosllavët) refuzuan të pranonin dogmat e reja mbi emanuimin e Shpirtit të Shenjtë edhe nga i Biri e jo vetëm nga Ati i Shenjtë, pastaj dogmën mbi purgatorin, mbi zënien virgjërore të Krishtit³ etj.

Fundamentalizmi ortodoks serb, me natyrën e vet të mirëfilltë të mbështetur në mitin grek mbi *Antean*⁴ dhe me vetëdijen tribale, virtut ky që e ka përcjellë popullin serb deri në ditët e sotme, drejtpërdrejt hyn në fushën gjenocidale gjatë pushtimit të vendit të huaj.

Kjo ideologji/vetëdije mbrapshtane në vend të *kombit*, thekson popullin e vet në kuptimin e 'popullit qiellor', madhësia e të cilit nuk është *raca*, por 'Dhurata e Zotit', e cila, nuk dihet përse, popujve të tjerë u është privuar, kurse u është dhënë serbëve në Kosovë. Në këtë

² Disa *fundamentalizmin islamik* e shohin si 'konfirmim të sërishëm të religjionit në politikë dhe shoqëri', që shpesh 'barazohet me aktivizmin politik, ekstremizmin, fanatizmin, terrorizmin dhe antiamerikanizmin'. Qasja e këtillë perëndimore është tepër e ngarkuar me 'supozime kristiane dhe stereotipe perëndimore, që implikon kërcënimin monolit' ndaj Perëndimit, i cili në realitet nuk ekziston. Shih: John L. Esposito, *Islamska prijetnja - mit ili stvarnost?*, Živinice, 2001, fq. 23, 24.

³ Muhamed Filipovic, *O genezi, dimenzijama, sadržaju i implikacijama optuzbi za islamski fundamentalizam u nasoj idejnoj i politickoj praksi*, në: N. Cancar, *Islamski fundamentalizëm – sta je to?* (Më tej: IF), Sarajevë, 1990, fq. 54.

⁴ Shih: Vojtech Zamarovsky, *Heronjtë e miteve antike. Leksikon i mitologjisë greke dhe romake*, Prishtinë, 1985, fq. 46.

mënyrë, teoria ia lëshoi vendin mitologjisë dhe religjionit, që ky të transformohet në ‘svetosavlje’ që ta konfirmojë këtë lajthitje.⁵

2. Burimet historike të fundamentalizmit ortodoks serb-

Fundamentalizmin ortodoks (pravosllav) serb e kemi aktiv gjatë tërë historisë së tij, që nga fillimi në shekullin IV, në vitin 325, me Sino-din e Nikesë, në fund të shekullit X me shën Vladimirin (herë-herë brenda teologjisë ortodokse, e herë-herë në rrafshin religjioz-nacional-historik), kurse me bekimin e Ruisë cariste. Që të dyja këto komponente i kemi aktivë edhe gjatë shekullit XX, sidomos në Kongresin gjithëslav të mbajtur në Beograd më 1946.⁶

Edhe në vitet nëntëdhjetë të shekullit XX kemi disa takime gjithëslave të karakterit politiko-kulturor e tregtaro-ekonomik. Madje, Kisha ortodokse serbe është mjaft aktive në idenë gjithëortodokse në trojet ish-jugosllave. Tubimet komemorative nën direktivat e drejtpërdrejta të Kishës ortodokse në përvjetorin e 600-të të Betejës së Kosovës, car Lazarin e paraqisnin si Jezu Krishtin me nxënësit e tij, kështu që ‘konflikti’ ngrihet nga kategoria e hak/gjakmarrjes, në nivel kozmik të së mirës dhe së keqes⁷.

Burimet kryesore për tërë këtë propagandë ishin *kronikat e murgjve serbë*, të cilat këta i shkruan pas dëshpërimit dhe apatisë që përjetonte popullit serb, duke e ngritur Lazarin në *mesi* të ngarkuar prej të Madhit Zot dhe për ta kthyer popullin serb në Kosovë,⁸ pastaj

⁵ Rasim Muminovic, *Filozofija ideologije*, II, Sarajevë, 1421 / 2000, fq. 328.

Miranda Vickers në veprën me titull “*Mes serbëve dhe shqiptarëve, një histori e Kosovës*” (New York, 1998) thotë se serbët pas humbjes në *Betejën e Kosovës* u zhytën në dëshpërim. Murgjit për ta luftuar dëshpërimin e masës, shkruan panegjirike, lutje me lëvddata për Lazarin ... Këto kronika e përshkruanin Lazarin si shërbëtorin e favorizuar të Perëndisë dhe të popullit serb, kurse popullin serb si popullin e zgjedhur të Testamentit të Ri.” Cituar sipas: Sherif Delvina, *Kosova një mit serb apo një realitet historik shqiptar*, Tiranë, 2000, fq. 76.

⁶ Halid Causevic, *Politicko-pravni aspekti islamskog fundamentalizma u Jugoslaviji*, në: N. Cancar, IF, op. cit., fq. 47.

⁷ Sipas: Fikret Karcic, *Muslimani Balkana – Istocno pitanje u XX vijeku*, Tuzla, 2001, fq. 146 dhe gjerësisht: 115 -152.

⁸ Sherif Delvina, *Kosova ...* op. cit., fq. 76. Kronikat e murgjve serbë kishin rëndësi të madhe për serbët, sepse serbët ishin popull injorant, me shkallë të ulët të arsimimit dhe edukimit. Sipas statistikave, edhe në vitin 1866, serbët paraqisnin një popull që vetëm 4.2 % nga numri i gjithmbarshëm dinin shkrim-lexim. Andaj kronikat për ta ishin fe, histori. Ibid.

pohimet e krerëve serbë, si p. sh. të Stefan Nemanjës: “*Perëndia u ka dhënë bizantinëve dinjitetin e perandorit, hungarezëve atë të mbretit dhe serbëve atë të zhupanit.*”⁹

Këto tubime në arsenalin propagandistik kryesisht përdornin dy ‘maskota’, dy frymëzuesit kryesorë: *car Lazarin dhe Petar Petroviç Njegoshin*. Kjo propagandë kishte mbështetje në politikën panserbe dhe pansllave.¹⁰

Gjatë periudhës së gjatë historike *fundamentalizmi ortodoks serb* apo ideologjia serbe kryesisht karakterizohet për këto tipare:

1) Misticizmi iracional i tipit mitoman svetosavian

(Serbomëdhenjt me gënjeshtat e tyre mitomane dhe me veprat e këqija të projektuara në ideologjinë destruktive krijuan pamundësinë që të jetojnë së bashku me fqinjët e tyre joserbë. Në këtë mënyrë, nën ndikimin e mitomanisë (e miti serb është Kosova!) pravosllavja e tyre bëhet krivosllavlje (kuazisllavlje) dhe burim i mosmarrëveshjeve dhe konflikteve permanente)¹¹

2) Hegjemonizmi dhe konservatizmi

(Gënjeshtat serbe u shndërruan në fuqi demoniane, që sollën për vetë serbët jopaqe, kurse për të tjerët të këqija gjenocidale. Si gënje-

⁹ Ibid. fq. 80.

¹⁰ Michael Sells, shkencëtar amerikan, pohon: “Nacionalistët radikalë, klerikët serbë dhe një pjesë e Partisë komuniste të Jugosllavisë filluan në vitin 1986 fushatën e madhe kundër shqiptarëve për ‘gjenocid’ kundër serbëve. Në janar të vitit 1986, dyqind intelektualë beogradas nënshkruan “Memorandumin”, dokumentin famëkeq, frymëzuesin kryesor për të gjitha që ndodhën në pesëmbëdhjetëvjetëshin e fundit. (Michael Sells, *Vjera, historija i genocid u BiH*, në: Fikret Karcic, *Muslimani Balkana op. cit.*, fq. 155. I këtij mendimi është edhe historiani amerikan Norman Cigar, *Genocide in Bosna. The Policy of Ethnic Cleansing*, Texas, 1995; dhe F. Karcic, *Muslimani Balkana ... op. cit.*, fq. 21. Një shekull e gjysmë më herët, më saktë më 1844, në Beograd, kryeministri serb, filorus dhe pansllavist, Ilija Garashanin, hodhi parullën ‘Ballkani ballkanasve’, me se kristalizoi idenë deri atëherë jo edhe aq të qartë, të *panballkanizmit*, nëpërmjet të cilit synonte *sllavizimin* e popujve fqinjë, *ortodoksizimin* e tyre dhe *luftimin e armikut të përbashkët*, i cili tradicionalisht ishte Turqia dhe atëbotë Austro-Hungaria dhe shndërrimin e Serbisë në qendër rreth së cilës të mblidheshin sllavët e tjerë të Jugut dhe popujt e tjerë ballkanikë. Shih lidhur me këtë analiza të shkëlqyeshme dhe të dhëna faktike në: Husamedin Feraj, *op. cit*

¹¹ Rasim Muminović, *op. cit.*, fq. 352 dhe 269.

shtarë të mirëfilltë, serbët janë shndërruar në robër të dëshirave vetjake dhe këtë të vërtetë ua ofrojnë edhe fqinjëve të tyre si garancë për hegjemonizmin ndaj tyre. Krahas ngjashmërisë me nacizmin, “velikoserbizmi” manifeston edhe çmenduri nacionale në vend të biologjizmit të nacizmit, të aspiratave hegjemoniste në vend të pretendimeve raciste. “Velikoserbizmi” pretendon të drejtën historike, kurse nacizmi të drejtën raciale.)¹²

3) Tradicionalizmi i shprehur në mistifikimin historik të serbizmit kinse si faktori i vetëm që iu kundërvu invadimit osman

(Fryma e zotimit /përgjërimit kosovar është dëshmi e pakontestueshme e çrregullimit të trurit, i cili e ka prodhuar sikur që është realizimi i tij më i keq i fëlliqësirës morale. Këtë e bëjnë nëpërmjet ‘ego-centrizmit fisnor’ dhe ‘mitomanisë’, të cilën e publikojnë me infantilitet sikur që deformitetin gjenetik e dëftojnë si lavdidashja ashtu edhe pushtetdashja e bartësve të tyre ultra-ekstremë.)¹³

Konsekuencat e fundamentalizmit ortodoks serb

Politika serbe, e frymëzuar në fundamentalizmin ortodoks, duke mistifikuar realitetin, përpiket të realizojë synimin e vetëmashtimit të vet, duke u bërë faktor determinues në shumicën e konflikteve shoqërore në hapësirat ballkanike. Bartësit e kësaj *vetëdijeje të përveturuar*, janë psikopatë, të cilët në humbjet e historisë së tyre shohin fitoret dhe kështu, duke iu robëruar ‘zotimit / përgjërimit të Kosovës’ ndërmarrin luftëra gjenocidale.¹⁴

¹² Ibid., fq. 259 dhe 334.

¹³ Ibid., fq. 335 dhe 259. Gjerësisht fq. 251-365.

Konsiderohet me të drejtë se Kisha dhe kleri ortodoks, në përgjithësi, luajti rol negativ kundrejt interesave të popullit shqiptar. Dhunën dhe presionin në procesin e asimilimit sllavo-greko-bizantin e kemi në përmasa jashtëzakonisht të mëdha edhe gjatë shekujve XII, XIII dhe XIV. Në “Kodin” e vet Stefan Dushani në shekullin XIV shpalli sllavizimin dhe ortodoksizimin e dhunshëm të të gjithë besimtarëve e të besimeve të tjera. H. Feraj, op. cit., fq. 41, 42, 43.

¹⁴ Kjo vetëdije e përveturuar e ideologjisë serbomadhe ka bërë aq vepra shoviniste dhe destruktive, saqë nuk mund të kategorizohen në nocionet e njohura të ideologjisë. Shih: R. Muminovic, op. cit., fq. 258 dhe 259.

Në rrafshin historik kjo politikë fundamentaliste pan-serbe-sllave rezultoi që D. Paviq, A. Popoviq, D. Tanaskoviq, M. Jevtiq, D. Kalajiq e shumë të tjerë Islamin ta identifikojnë si *të huaj* në tokën evropiane, kurse peshkopi ortodoks Atanasije “*rrethojat e shtëpive muslimane prej Bagdadit deri në Bihaç t’i quajë primitivizëm të zakonshëm dhe diç edhe më të thellë.*”¹⁵ Për realizimin e synimeve fundamentaliste serbët apeluan te vëllezërit sllavë dhe aleatët sllavë që t’i ndihmonin, kështu që Rusia, Bullgaria, Greqia, Rumania, Ukraina, por edhe vende të tjera, si Franca, Italia e pjesërisht edhe Anglia etj., në mënyra të ndryshme (politiko-diplomatike, ekonomike) u solidarizuan me serbët. Në fillim të vitit 1993 disa qindra rusë luftuan në anën serbe, kurse qarkullojnë të dhëna se armata ruse e furnizonte Serbinë.¹⁶

Pastrimi etnik në Bosnjë (1992-1995) dhe në Kosovë (1998-1999) nuk është i rastit, veçse vazhdim i luftës serbe për dominim, plaçkitje dhe vrasje. Ashtu siç dëfton edhe thënia e Radovan Karaxhiqit serb, janar të vitit 1992, se strategjia serbe është të luftojnë “*derisa nuk e arrijnë synimin e Karagjorgjes – bashkimin e të gjithë serbëve dhe derisa nuk e përfundojnë luftën.*”¹⁷

Në vitet tridhjetë të shekullit XX, Klubi kulturor serb i propozoi mbretit Aleksandër që *me djegien e fshatrave shqiptare, me inicimin e vrasjeve dhe konflikteve, me shkeljen e shenjtrive fetare e të tjera, të krijohen kushtet për persekutimin e shqiptarëve nga Kosova dhe kështu ta kolonizojë Kosovën.*¹⁸

Kurse në vitet nëntëdhjetë të shekullit XX, aparati shtetëror serb dhe Kisha ortodokse serbe, duke këmbëngulur tek popujt e tjerë sllavë apo tek ata në fqinjësi, siç janë shqiptarët, që t’i ktheheshin fesë, përkatësisht të përqafonin fenë e stërgjyshëve të serbëve, apo të ko-

¹⁵ F. Karcic, *Muslimani Balkana ...* op. cit., fq. 21 – 22.

¹⁶ Samuel P. Huntington, *Sukob civilizacija*, në: Haris Silajdzic, *Albanski nacionalni pokret*, Sarajevë, 1995; F. Karcic, *Muslimani Balkana ...*, op. cit., fq.28-29. Gjerësisht për raportet serbe- sllave dhe serbe-Perëndim shih: Husamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, ribotimi I, Shkup, 1999.

¹⁷ N. Cigar, op. cit., sipas F. Karcic, op. cit., fq. 25. Po ashtu, shih rreth fundamentalizmit serb: Sherif Delvina, *Kosova ...op. cit.*

¹⁸ Nusret Sehic, *Cetnistvo u Bosni i Hercegovini 1918-1941*, fq. 166, sipas: R. Muminovic, op. cit. Fq. 307.

nvertojnë në ortodoksizëm, manifesto vetëdije arkaike, konservative, morbide dhe fundamentaliste. Ndërsa për mobilizim të vetëdijes, serbët shfrytëzuan të gjitha mjetet, madje edhe ekshumacionin e varrezave dhe varrosjen e tyre (viktimave) organizuan nga Kisha ortodokse serbe me patrikun Pavle në krye, e përcjellë me TV kanale e mjete të tjera elektronike e të shkruara. Ekshumacioni dhe shëtitja e eshtrave të car Lazarit¹⁹ nëpër Kosovë dhe Bosnjë me patrikun Pavle në krye, ishte një nxitje dhe provokim për muslimanët dhe motivim i serbëve për gjenocid ndaj popujve të tjerë. Më në fund, ekstremizmi serb i ditëve tona heq prejardhjen nga lëvizja çetnike, kurse lëvizja çetnike nga lëvizja hajdute,²⁰ e këta të fundit, siç theksuam, nga kronikat dhe epika mesjetare serbe.²¹

Në vend të përfundimit

Fundamentalizmi ortodoks serb dhe ai pansllav në përgjithësi është një çështje komplekse dhe shumëdimensionale. Studimi i suksesshëm i tij nënkupton një qasje historike, religjioze, sociologjike, psikologjike e kështu me radhë. Qasja jonë synon ta aktualizojë këtë problem, të shenjojë burimet shpirtërore, teorike dhe historike, praktike të tij, të dëftojë natyrën e tij dhe konsekuencat që i shkaktoi ai gjatë historisë. Trojet shqiptare dhe ato ballkanike si shembull karakteristik të një vetëdijeje të shtrembëruar për arkaizëm dhe izolim, karakteristike për konservatizmin mental²², tipike për ‘velikoserbizmin’²³, dëfton se sa larg mund të shkojë një popull me *gjen* dhe *mendje* të çoroditur.

Hulumtimet shkencore shumëdimensionale të deritashme dhe sotitjet në rrafshin fetar, historik, sociologjik, çojnë në përfundimin se në trojet ballkanike shqiptarët dhe boshnjakët nuk poseduan ideologji tjetër pos ideologjisë nga domosdoshmëria, e cila u përket utopive

¹⁹ Mehmedalija Bojic, op. cit., fq. 91.

²⁰ R. Muminovic, op. cit., fq. 264-265.

²¹ Sherif Delvina, *Kosova ...op. cit.*, fq. 76.

²² Shih: R. Muminovic, op. cit., fq. 356.

²³ Sipas R. Muminoviqit nocioni ‘velikoserbizëm’ përfshin të këqijta e përsosura të shquara për paaftësinë e fjalës që t’i shprehin ato dhe pamundësinë njerëzore që bërësve të tyre t’ua kthejnë në të njëjtën mënyrë. Sipas tij as fashizmi, as nacizmi, as stalinizmi, as barbarizmi nuk mund t’i shprehin në tërësi veprat e këqija të maniakëve serbo-malazez. Op. cit., fq. 260.

abstrakte ... Në vend të ideologjisë, ata kanë vuajtje konstante, që është shenjë e tretjes ideologjike, fatkeqe për pasardhësit e tyre në mjedisin e madh kristian.²⁴

Natyrisht, në këtë shkrim nuk kemi synuar hollësitë.²⁵ Mbetet obligim shkencor hulumtimi i mëtejme teorik dhe praktik i kësaj teme.

Literatura:

1. Bojić, Mehmedalija, *Uzroci genocida u Bosni*, Sarajevë, 2001.
2. Čančar, N. – Karić, Enes., *Islamski fundamentalizam – šta je to?*, Sarajevë, 1990.
3. Delvina, Sherif, *Kosova një mit serb apo një realitet historik shqiptar*, Tiranë, 2000.
4. Delvina, Sherif, *Pa pavarësi fetare nuk ka pavarësi kombëtare*, Tiranë, 1998.
5. Esposito, John L., *Islamska prijetnja mit ili stvarnost?*, Živinice, 2001.
6. Feraj, Husamedin, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, ribotimi I, Shkup, 1999.
7. Ibrahim, Nexhat, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, Shkup, 1998.
8. Karčić, Fikret, *Muslimani balkana - Istočno pitanje u XX vijeku*, Tuzla, 2001.
9. Muminović, Rasim, *Filozofija ideologije*, II, Sarajevë, 1421/2000.
10. Silajdžić, Haris, *Albanski nacionalni pokret*, Sarajevë, 1995.
11. Zamarovsky, Vojtech, *Heronjtë e miteve antike. Leksikon i mitologjisë greke dhe romake*, Prishtinë, 1985.

²⁴ Shih: Ibid., fq. 257.

²⁵ Për disa aspekte të kësaj teme, shih: Sherif Delvina, *Pa pavarësi fetare nuk ka as pavarësi kombëtare*, Tiranë, 1998; Sherif Delvina, *Kosova një mit serb...* op. cit..

Sadri Fetiu

ROMANI “TRËNDAFILI I MËNGJESIT” VEPËR E DALLUAR E LETËRSISE SË SOTME ARABE

Këto ditë doli nga shtypi botimi i dytë i romanit “*Trendafili i mëngjesit*” i autorit arab Adil Ebu Sheneb, të cilin e ka përkthyer në gjuhën shqipe orientalisti dhe historiani ynë i shquar, mr. Shemsi Ajvazi. Libri është botim i Shtëpisë Botuese “Dija” të Prishtinës.

Adil Ebu Shenebi është autor i njohur në letërsinë bashkëkohore të Sirisë dhe të Botës arabe në përgjithësi, Është dalluar sidomos në fushën e prozës, e në mënyrë të veçantë shquhet si autor i tregimeve. Ka lindur në Damask më 1931. Është shkolluar në vendlindjen e tij dhe qysh në vitet pesëdhjetë ka filluar të merret me krijimtari letrare,

Në vitin 1956 Adil Ebu Shenebi ka botuar përmbledhjen e parë të tregimeve me titull “*Botë, por tepër e vogël*”. Përmbledhjen e tij të parë e pasojnë edhe mbi pesëmbëdhjetë vepra të tjera. Midis veprave të tij shquhet sidomos ajo me titull “*Mersina e bukur*”, e botuar në Damask, më 1979.

Nga veprat e Adil Ebu Shenebit interesim të veçantë ka zgjuar sidomos romani i tij “*Trëndafili i mëngjesit*”, që, pos në arabishte, është përkthyer edhe në gjuhë të tjera e, madje, edhe është dramatizuar dhe luajtur në skenat e teatrove arabe. Një version i këtij romani me tema-

tikë interesante sociale, erotike dhe filozofike, i shndërruar në dramë është përkthyer edhe në gjuhën angleze.

Adil Ebu Shenebi është shkrimtar aktiv që shkruan edhe sot e kësaj dite. Në vitin 2001 në Siri është botuar përmbledhja e tij e fundit e tregimeve me titull "*Hololoja*", e cila është shitur për një kohë relativisht të shkurtër dhe, siç na ka informuar kohët e fundit studiuesi i mirëfilltë i traditës arabe, dr. Muhamed Mufaku - Arnauti, tash pritet edhe botimi i dytë i saj.

Për lexuesin shqiptar, që është mësuar ta shijojë dhe çmojë letërsinë arabe pothuajse vetëm nëpërmjet përrallave të "*Një mijë e një netve*", të cilat të mahnisin me bukurinë e tyre të veçantë, me shkathëtsinë e rrëfimit dhe me paraqitjen e një bote dhe një morali të veçantë me krejt veçoritë e ekzotikës orientale, romani. "*Trëndafili i mëngjesit*" do të jetë një mundësi e befasishme për ta njohur një përvojë krejtësisht të panjohur të një bote që lufton për ta siguruar ekzistencën dhe identitetin e vet të veçantë gjatë përpjekjeve të vazhdueshme për të ecur krahas me ndryshimet e mëdha në botën bashkëkohore. Romanin "*Trëndafili i mëngjesit*" të Adil Ebu Shenebit, sa i përket strukturës rrëfimore e karakterizon gërshetimi artistik i formave të rrëfimit tradicional të prozës fetare dhe laike të orientit në përgjithësi, me format e reja të shprehjes së drejtpërdrejtë si komunikim në veten e dytë ose në disa raste edhe si rrjedhë e "*përroit të ndërrijes*", që lexuesi evropian është mësuar t'i quajë "*rrëfim modern*" i strukturave alternative të tekstit dhe funksioneve të tij të veçanta kuptimore. Trajtat e një rrëfimi të këtillë në romanin e Adil Ebu Shenebit kanë funksion të veçantë artistik në sajë të përmbajtjes krejtësisht të re, sepse rrëfimi i tërësishëm i romanit është konceptuar brenda mozaikut të tregimeve të veçanta për fatin jetësor dhe koncepcionet e veçanta ekzistenciale dhe filozofike të shtresave të ndryshme të shoqërisë arabe.

Në qendër të vëmendjes së autorit janë kryesisht njerëzit nga shtresat më të varfra dhe më të shfrytëzuara të shoqërisë siriane, që luftojnë për ekzistencën e tyre të thjeshtë, duke kryer punë të rënda dhe të mundimshme nga të cilat përfitime të drejtpërdrejta nxjerrin udhëheqësit e ndryshëm të klaneve dhe grupeve, që brenda traditës orientale këtu paraqiten si pari, kryepleq të lagjeve dhe vazhdojnë ngritjen nëpër shkallët e hierarkisë deri në nivelet më të larta të

shtetit. Veçori karakterizuese e prozës tregimtare të Adil Ebu Shenebit është edhe mjeshtëria e veçantë e autorit për të depërtuar deri në fshehtësitë më të thella të botës shpirtërore të këtyre njerëzve, që shquhen për ndjeshmëri të theksuar, por edhe për preokupimin e veçantë në luftë për të ekzistuar, ose thënë me qartë, për të siguruar minimumin e domosdoshëm ekzistencial, bukën e gojës dhe strehën e nevojshme për të pushuar gjatë natës në rrëmujën e përgjithshme të kryeqytetit sirian, në të cilin gërshetoheshin e vjetra dhe e reja në luftë të përheshme për të mbizotëruar duke i konservuar marrëdhëniet tradicionale të shfrytëzimit ose për t'i flakur ato dhe për të ecur përpara.

Lufta e njeriut të vogël, e punëtorit të krahut, në kuptimin klasik të kësaj fjale, që nuk mund të posedonte si mjet pune as veglat më të thjeshta për punën e lustraxhiut të rrugës, ishte shumë e vështirë, sepse në atmosferën e krijuar brenda traditës shfrytëzuese të botës orientale, krahas formave të reja, ishin ruajtur edhe mënyrat më të vjetra, më drastike, të shfrytëzimit të njeriut, i cili në rrethanat e këtilla ishte shndërruar plotësisht në send, gati krejtësisht të pavlefshëm, që barazohet me nivelin zero në duart e shfrytëzuesve të pamëshirshëm, që nuk zgjidhnin mjete dhe metoda për ta shfrytëzuar deri në fund, ndonëse shpesh në sy të botës bënin përpjekje për t'u paraqitur edhe si njerëz të mëshirshëm, që vepronin në bazë të ligjeve të Islamit. Dhe më e keqja e kësaj situatë, siç del nga rrëfimet tronditëse të personazheve të romanit, ishte e vërteta e hidhur se në luftën për ekzistencë të shtresave të varfra të shoqërisë arabe në anën e shfrytëzuesve të pamëshirshëm të traditës së trashëguar shekullore të shfrytëzimit në shoqërinë arabe, ishte edhe pushteti, që mëtonte të jetë liberal e demokratik, i konstituuar pas çlirimit të Sirisë nga sundimi kolonial i të huajve.

Njeriu që nuk ka njohuri për traditën e botës arabe dhe për jetën e saj bashkëkohore, duke lexuar me kujdes romanin e Adil Ebu Shenebi "*Trëndafili i mëngjesit*" ka mundësi të depërtojë në sferat më të ndjeshme të botës shpirtërore të njeriut të këtij mjedisi dhe t'i njohë edhe marrëdhëniet e përgjithshme shoqërore të botës arabe, në përgjithësi, e të shoqërisë siriane, pas epokës koloniale, në veçanti. Nëpërmjet rrëfimit të gërshetuar tradicional dhe modern, si edhe të formave të veçanta retrospektive sa herë që i duhet ta ruajë interesimin e lexuesit për rrjedhën e ngjarjeve dhe dramatizimin e konflikteve, autori

me anë të botës së lustraxhinjve dhe të punëtorëve të tjerë të profesioneve të ngjashme shërbyese në kryeqytetin e Sirisë, Damask, në mënyrë fare të paimponueshme arrin të sjellë përgjithësime të thella të mendësisë arabe plotë konflikte dhe kundërthënie shoqërore, të cilat e brejnë së brendshmi shoqërinë siriane. Është kjo shoqëri me veçori karakteristike të individualizmit tradicional të Orientit, që mbështetet në themelet e psikologjisë religjioze me të gjitha pasojat e tolerancës dhe të kompromiseve, të kthesave të papritura, shpesh të kushtëzuara nga rrethanat e rastit, e herë - herë edhe pa perspektivë të dukshme afatgjatë.

Duke u bazuar në përgjithësimin e botëkuptimeve, të cilat kanë pikëmbështetje në psikologjinë individualiste të njeriut të kthyer kryesisht kah vetvetja dhe interesi i tij parësor, del qartë se romanin e përshkon që nga faqet e para të fillimit një simbolikë e veçantë, e cila i sintetizon kundërthëniet më të thella të shoqërisë arabe, i bën edhe më të kuptueshme, madje edhe kthesat e shumta dhe të shpeshta në marrëdhëniet ndërarabe në kuadër të shteteve të Lindjes së Afërme, në të cilat janë konfrontuar qoftë drejtpërdrejtë, qoftë edhe tërthorazi, shpesh në mënyrë gati të pahetueshme, interesat e të huajve që tradicionalisht e kanë lakmuar dhe, madje, edhe e kanë përvetësuar një pjesë të pasurisë së Botës arabe.

Simbolika e këtyllë me funksion të dyfishtë zë fill që nga vetë titulli i romanit. Prandaj, mund të pohohet me të drejtë se "*Trëndafili i mëngjesit*" nuk është vetëm simbol i drejtpërdrejtë i dashurisë ndërmjet Selmasë dhe Esadit, që janë edhe protagonist të romanit, por me anë të një titulli të këtyllë shkrintari sikur i ka paralajmëruar simbolikisht edhe raportet e reja që kanë zënë fill në shoqërinë arabe të kohës. Dhe këto marrëdhënie kanë zënë të lëvizin me vetë fillimin e protestave individuale dhe të përbashkëta të njerëzve të shfrytëzuar pa kurrëfarë mëshire dhe të përpjekjeve të shfrytëzuesve tradicionalë që me të gjitha mjetet, duke gëzuar edhe përkrahjen e forcës së shtetit, ta ruajnë të drejtën e shfrytëzimit të tyre. Megjithëse duket se protestat dhe demonstrimet janë të pasukesshme, dhe pasojë e tyre janë tragjeditë individuale të njerëzve të shtypur, megjithatë ato paralajmërojnë zgjimin e vetëdijës dhe japin shpresën për ndryshime në të ardhmën, ndonëse ngjarjet e romanit nuk sjellin një përfundim të këtyllë, por

përkundrazi e sjellin heroin e lodhur, të zhgënjyer e të dëshpëruar të romanit në pikën e vet nistore të ikjes nga rrëmuja e kryeqytetit drejt fshatit të lindjes.

Romani "*Trëndafili i mëngjesit*" si tërësi e përgjithshme tregimtare shquhet për saktësinë dhe organizimin e vet strukturor. Sa i përket motivimit të veprimeve të personazheve kjo vepër mund të konsiderohet si moster (gjedhe) e veçantë e veprës realiste. Përpikëria e strukturës tregimtare realiste vërehet edhe brenda detajeve të veçanta në tërësinë e romanit. Autori kur është fjala për hollësitë e ndryshme të njëjësive përmbajtësore dhe lidhjen e tyre kuptimore, pothuajse e ka zbatuar me përpikëri parimin e njohur realist, që në traditën e përgjithshme të kritikës evropiane quhet shpesh "*gozhda e Çehovit*", për të cilën thuhet se duhet të ngulet në fillim të rrëfimit me qëllim që në të të varet heroi në fund të këtij tregimi. Prandaj, në romanin e Adil Ebu Shenebit, jo vetëm që kemi një shpërpjestim shumë të hetueshëm, ndërmjet vëllimit dhe vlerës artistike ose të themi më konkretisht, ndërmjet strukturës së fjalëve si tërësi dhe atyre të kuptimeve dhe të përjetimeve të lexuesit, por këtu nuk ka asnjë veprim, asnjë detaj, nga fillimi i romanit që ka mbetur pa funksionin e vet të veçantë artistik dhe pa pasojat përkatëse për shtjellimin e veprimeve në krejt strukturën e romanit. Edhe në këtë aspekt kjo vepër është model për fuqinë e veçantë kreative të fjalës artistike dhe për strukturimin e saj brenda tekstit letrar të një lloji të madh tregimtar, siç është romani.

Duke u mbështetur në metodën e këtyllë të konceptimit të romanit autori veprimet e tërësishme të personazheve i kushtëzon nga rrethanat e caktuara të luftës së tyre për ekzistencë, mbi të cilat zë fill motivacioni i plotë psikologjik për shumicën e personazheve të shtjelluara në mënyrë më të plotë, por edhe për ata që kanë role të veçanta episodike. Aspektet më të gjera psikologjike që lidhen edhe me persiatjet brenda të cilave zgjerohen edhe botëkuptimet e madje edhe filozofia e përgjithshme jetësore e personazheve kryesore në roman, janë bërë edhe modele përcaktuese për format e veçanta të rrëfimit, që në shumë raste shkojnë deri në shkallën më të zhvilluar të prozës poetike.

Pjesa kryesore e romanit të Adil Ebu Shenebit është realizuar me anë të rrëfimit në vetën e dytë. Kjo formë duket fort e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë, por bart edhe rreziqet që të thjeshtësohet deri në shka-

llën e një teksti të liruar nga konvencat stilistike, mirëpo komunikimi me vetveten në mënyrë aktive duke iu drejtuar unit - si vete e dytë, i jep mundësi prozorit që ta zbrazë tërësinë e talentit të vet krijues dhe ta mbajë të gjallë dhe gjithnjë aktive figurën e personazhit të tij kryesor brenda tërësisë së mjedisëve në të cilat vepron ai. Kjo formë e rrëfimit e gërshetuar herë-herë edhe me rrëfimin në vetën e tretë nga pozita e narratorit të gjithdijshëm, krijon përshtypje se indin e rrëfimit themelor e përbën teksti i një lloji monologu të brendshëm, që në vepërën e Adil Ebu Shenebit karakterizohet si komunikim krejtësisht i veçantë për dy arsye. Së pari rrëfimi në vetën e dytë, i realizuar nëpërmjet protagonistit, që bëhet njëkohësisht dhënës dhe marrës i mesazheve të veçanta të strukturave rrefimore, motivohet në aspektin psikologjik dhe merr edhe formën e retrospeksionit në situatat e veçanta, që paraqesin edhe nyjet kompozicionale të romanit, ato të shkallëzimit të natyrshëm të thurjes së veprimit kryesor brenda episodeve të shumta dhe numrit relativisht të madh të personazheve epizodike që kanë funksionin e rëndësishëm brenda tërësisës së veprës. Së dyti, kjo trajtë e rrëfimit, në roman, e zbatuar me invencion të veçantë si komunikim i dyanshëm edhe me lexuesin e veprës, ka një mbështetje të fuqishme në traditën klasike të poetikës së prozës tregimtare arabe dhe përgjithësisht orientale, duke filluar që nga librat e shenjta të feve monoteiste. Prandaj, duke u bazuar në aspektet e gërshetimit të veçantë të tërësive tekstuale dhe përvojës së përgjithshme tregimtare në këtë vepër, mund të pohohet lirisht se romani "*Trëndafili i mëngjesit*", që në bazë të kriterëve të sotme të kritikës letrare evropiane i përket komunikimit artistik modern, përmban në vetvete indet e veçanta të lidhjeve thelbësore me prozën klasike të orientit. Këto veçori nuk janë të hetueshme vetëm në strukturën e tërësishme të veprës, por edhe në segmentet e saja më të ngushta, që shkojnë deri te veçoritë stilistike të lidhjeve të fjalive dhe strukturës së tyre karakteristike bashkërenditëse, të cilën e hasim përgjithësisht brenda mënyrës së komunikimit të botës orientale, duke filluar që nga zanafilla e veprave të shkruara të kësaj tradite.

Romani "*Trëndafili i mëngjesit*" i Adil Ebu Shenebit, megjithatë, në thelb është roman realist, në të cilin, shikuar nga aspekti sociologjik, vlerësohet në mënyrë kritike shoqëria arabe. Dhe ky vlerësim,

kuptohet krejtësisht i liruar nga sociologjizmi, bëhet nga këndi i veçantë i vrojtimit, që i jep mundësi autorit të mos anojë as kah tradita përgjithësisht e mbështetur në ndjeshmërinë e veçantë shumë të theksuar të rrëfimeve të ndjeshme të botës orientale. Sado që ngjarja e drejtpërdrejtë që e përbën syzheun e romanit, rrugën nëpër të cilën kalojnë personazhet kryesore, është fort e dhimbshme dhe madje edhe thellësisht tragjike, autori i ka tejkaluar me shumë sukses jo vetëm format e veçanta stilistike, por edhe zgjidhjet e bazuara në traditën sentimentaliste me anë të *hepy end-it* apo të situatave melodramatike.

Kështu, vepra ka mbetur roman i tipit të hapur, sepse rrjedha e zhvillimit të syzheut, pas kthesave të shumta dramatike, kthehet pothuajse në pikën nistore të fillimit. Fati i personazheve brenda hapësirës së caktuar të kryeqytetit të Sirisë, Damaskut, dhe kohës relativisht të shkurtër, si kuptimësi e kohës aktive të zhvillimit të syzheut, e bënë veprën si sintezë të gërshetimit të tipareve të romanit të personazhit me atë të mjediseve të caktuara, sado që vija e rrëfimit për individin është përcaktuar qartë brenda një trekëndëshi të marrëdhënieve të ndërlikuara, që marrin tharmin në tematikën e theksuar erotike dhe sociale brenda atmosferës së krijuar në mjedise ekskluzive të qytetit të madh, në të cilat sillen kategoritë e caktuara të shoqërisë arabe, përfaqësuesit e shtresave më të shfrytëzuara siç janë: lustraxhinjtë e rrugëve, shërbëtorët, prostitutat, të rrebeluarit, të burgosurit, ardhacakët nga mjediset fshatare, të papunët, si edhe shfrytëzuesit e drejtpërdrejtë të tyre. Edhe mjediset e caktuara të këtyre kategorive janë në sidomos ato të kryepelqve, udhëheqës tradicionalë të lagjeve të Damaskut, pastaj edhe përfaqësuesve të tjerë brenda hierarkisë së shtresave të pushtetarëve, janë pjesë e koloritit të përgjithshëm që paraqitet me fukion të caktuar artistik, pa e ngarkuar fare rrëfimin me përshkrime të panevojshme. Në sajë të formës së rrëfimit në vetën e dytë autori krijon mundësi për depërtime më të thella në psikologjinë e individit, që në rrethana të turbullta të një ambienti të shfrytëzimit të pamëshirshëm që mundohet të mbulohet me një vello fort të tejdukshme të mëshirës hipokrite, në thelb mbetet pjesëtar i një bote të papërspektivë në shoqërinë arabe, të ngarkuar me kundërthënie të mëdha, që kanë rrënjë të thella tradicionale.

Brenda situatave tragjike që e përcaktojnë veprën si tërësi dhe fatin e personazheve, në veçanti, autori ka krijuar me mjeshtri të rrallë profilet e veçanta të përfaqësuesive tipikë të personazheve, duke kombinuar fort bukur individualen e veçantë të shpirtit të njeriut me karakteristikat që atij ia ka imponuar mënyra e veçantë e jetesës, gjallërimit, e edukimit dhe formimit të karakterit. Midis tyre dallohen sidomos Esadi, Selmaja dhe Hamdiu, rreth fatit të të cilëve gërshe-tohet tërësia strukturore e veprës. Midis tyre krijohet trëkëndëshi i marrëdhënieve të ndërsjella, i synimeve, preokupimeve dhe ndjenjave të dashurisë dhe përgjithësisht luftës së tyre për ekzistencë. Është, pra, kjo luftë e mirëfilltë për t'i mposhtur vështirësitë e shumta të jetës që zhvillohet nëpërmjet alternativave e dilemave të vazhdueshme ndër-mjet pajtimeve plot kompromise joparimore të imponuara me fatin si paracaktim i fuqisë së padukshme dhe "zgjdhjeve" që ata në shumicën e rasteve i presin nga "mëshira" dhe interesi i shfrytëzuesve të tyre. Ndërmjet dilemave dhe kompromiseve shpesh në shpirtin e të shfrytëzuarve ngrit kryet edhe revolta, por ajo është afatshkurtër dhe brenda ecurisë së ngjarjeve të romanit fillon të marrë trajtat e një proteste të organizuar, si pasojë e një vetëdijeje më të avancuar. Ky pozicion në romanin e Adil Ebu Shenebit realizohet me anë të figurës shumë simpatike të Ahmet Kerimit, që ka fituar përvojën e luftëtarit për të drejta sociale të të shtypurve dhe të shfrytëzuarve. Mirëpo, shembulli i skajshmërive të dilemave dhe alternativave të luftë për ekzistencë dhe për të drejta sociale, për të krijuar një mundësi jetese brenda Damaskut të skajshmërive ekstreme sociale, është figura e Hamdiut. Ky protagonist i vërtetë tragjik i kësaj vepre është edhe bartës i idesë se brenda luftës së individit për të siguruar ekzistencën e thjeshtë fillon procesi i tjetërsimit të njeriut, i shlyerjes së kufijve të normave morale, sepse e keqja në përgjithësi, brenda dëshirës së fuqishme për realizimin e botës personale plot pasione të vullshme në kohën e rinisë, në shumë raste i kushtëzon edhe veprimet e pavullnetshme të individit, të cilat në thelb janë veprime me pasoja të dëmshme për vetë atë. Kështu, Hamdiu me përvojën e një njeriu pa identitet të caktuar në aspektin e origjinës, të rritur në rrugët e Damaskut, në shumë raste vepron si vegël e verbët e padronit të tij, Ebu Dijabit, i shtyp të tjerët jo vetëm kur shfaqin shenja të mosnënshtrimit ose të

revoltës, por, madje, edhe në rastet kur me veprime krejt të matura përpiqen t'u shpëtojnë kthetrave të shfrytëzuesve të tyre. Mirëpo, në shpirtin e tij ende nuk është shuar njerëzorja si kuptim i përgjithshëm, prandaj sjelljen e tij e karakterizojnë në shumë raste edhe sinqeriteti, ndjeshmëria e veçantë për hallet e varfënjakëve e madje edhe dashuria ndaj shokëve dhe përgjithësisht ndaj njerëzve të shtypur. Përvoja e hidhur e jetës se tij pa cak, sot për nesër, pasojat e rënda të mungesës së edukimit, lufta për ekzistencë që nga hapat e parë të fëmijërisë, e kanë bërë këtë njeri jo vetëm shumë dinak e të nënshtruar, por edhe arrogant e të rrëmbyeshëm. Shpirtin e tij mund ta kthejë në gjendje të veçantë, brenda përmasave të sjelljes shumë fisnike, vetëm fuqia magjike e ndjenjës së dashurisë ndaj Selmasë. Kjo dashuri sikur e vetëdijeson mendjen e tij, e bën që ta kuptojë kurthën në të cilën ka rënë, i nxjerrë nga thellësia e tij parimet e caktuara të një morali tradicional për nderin e burrërinë, e zgjon damarin e revoltës në shpirtin e skllavit të pavullnetshëm dhe kështu bëhet përcaktues i fatit tragjik të tij. Të gjitha këto, tërësia e veprimeve kunërthënëse deri në çastet e vdekjes së tij tragjike, e bëjnë figurën e Hamdiut të jetë në pozitën qendrore të ngjarjeve të romanit si bashkëhero, së bashku me Esatin, i cili pos rolit të veçantë në trekëndëshin e dashurisë, ka edhe funksionin e përcaktuar në procesin e rrefimit, sidomos të asaj pjese të rrefimit në veten e dytë, si një nga veçoritë e poetikës së romanit "*Trëndafili i mëngjesit*" të Adil Ebu Shenebit.

Personazhet më interesante të romanit, Esadi dhe Selmaja, të dashuruar sinqerisht në njeri tjetrin me një dashuri të pafat, të ardhur që të dy nga fshatrat në tollovinë e pamëshirëshme të kryeqytetit të Sirisë, Damask, sjellin jone të gëzueshme dhe atmosferë shpresëdhënëse brenda romanit. Ata që të dy luftojnë jo vetëm për të ekzistuar dosido, por edhe për të gjetur ngohësi brenda ëndrrës së tyre për ta realizuar dashurinë.

Në figurën e Selmasë autori me invencion të fuqishëm estetik e ka projektuar bukurinë tragjike, të hendikepuar që nga fillet e lulëzimit të saj. Jeta e saj në Damask është një poezi e bukur e gërshetimit të dhunës, të dashurisë, të dhembjes dhe të dëshpërimit. Ajo që nga fillimi ishte si një lodër, si një send, që mund të shitej dhe u shit si shërbëtoreshë nga vetë babai i saj, pastaj kur filloi të rritet u përdhunua dhe u

shfrytëzua nga padroni i saj, por gjeti përsëri arsye shpresëdhënëse për gëzimin e jetës në ndjenjën e fuqishme të dashurisë së sinqertë ndaj Esadit. Kjo ndjenjë shtoi edhe guximin e veçantë që të vepronte për ta kërkuar lumturinë e humbur. Por fati i saj sikur ishte paracaktuar, njësoj si i shumë vajzave të tjera që kishin mbetur rrugëve të kryeqytetit si trëndafille të këputura e të vyshkura, që i bart era andej e këndeje për t'i humbur më në fund në grumbullin e mbeturinave.

Edhe Esati, protagonist dhe bartës i rolit specifik brenda poetikës së romanit, me tërë pafajësinë dhe pastërtinë e shpirtit të fshatarit të pahile, rropatet midis realitetit shumë të hidhur dhe ëndrrës së bukur për t'i ngjitur në ato shkallët e imagjinuara të lumturisë njerëzore. Me përvojën e hidhur si lustraxhi, që me djersën e ballit e siguron bukën e vet, ai ka mundësi që t'i shijojë vetëm "ferrat e Damaskut", ndërsa "ëmbëlsira" e kryeqytetit si ajo e *sabareve* mbetet për të vetëm fantazi e perealizueshme. Edhe në shpirtin e tij dashuria është ndjenjë që sjellë shpresa dhe fuqi për ta përballuar të keqen, që e nxit të veprojë edhe për çlirim nga prangat e shfrytëzimit, që ia hap shtegun ëndrrave për lumturi. Kjo ndjenjë e sublimon plotësisht shpirtin e tij në të cilin nuk mund të zë vend as hija e së keqes ndaj të tjerëve. Por, në fund, i dëshëpruar, sidomos pas vdekjes tragjike të shokut të tij, Hamdiut, pas dështimit të dashurisë me Selmanë, duke mos gjetur fuqi për t'i përballuar kraijatat e shumta të jetës, duke u përpjekur ta ruajë shpirtin e tij dhe parimet e caktuara morale që e kanë mburjtur karakterin e tij, i zhgënjyer, midis dilemave zgjedh të vetmen rrugë të mundshme, atë që mbetet vazhdimisht e hapur për të gjithë ardhacakët në qytetet e mëdha, rrugën e kthimit të sërishëm në fshatin e lindjes.

Përveç tre heronjve të romanit, autori ka krijuar me sukses edhe shumë personazhe të tjera, disa nga të cilat edhe janë tipizuar me një ndjeshmëri shumë të theksuar realiste. Midis ambienteve të paraqitura për bukuri me një vërtetësi të habitshme nga jeta e Damaskut, sidomos e lagjeve me të njohura të kryeqytetit të Sirisë është paraqitur edhe një galeri e tërë e figurave përfaqësuese të të gjitha shtresave shoqërore. Midis tyre shquhen Ebu Dijabi dhe Ebu Hatimi, kryepleqtë e lagjeve, shfrytëzuesit e punës dhe djersës së lustraxhinjve dhe varfënjakëve të tjerë, që me sjelljet e tyre tradicionale të burrave hijerëndë të lagjes, me sedrën e theksuar si pjesëtarë "të nderuar" të parisë,

herë-herë edhe me "mëshirën" hipokrite të sheqerosur edhe me fraza të thata fetare ndaj bonjakëve dhe të mjerëve, arrijnë ta fshehin nga "sytë e botës" sadopak jetën e tyre të shfrenuar e, madje, edhe me devijime seksuale, e në këtë mënyrë edhe t'i kamuflojnë nën maskën e të "drejtave" të veta të veçanta edhe metodat e tyre të shfrytëzimit. Ata, bashkë me atmosferën e përgjithshme të mjedisëve të tyre jetësore, me sjelljet e veçanta edhe në mjediset familjare, janë figura tipike të feudalëve të vegjël me mendësi orientale, që i gjejmë edhe në literaturën tonë, sidomos në prozën realiste të disa autorëve shqiptarë. Një ngjashmëri e këtillë është e hetueshme edhe në figurat e grave, sidomos të atyre "të mbuluara" e të mbyllura brenda mureve të shtëpisë, gjë që flet për veçoritë e përbashkëta të traditës islame, pa marrë parasysh shkallën e pranisë së fesë, si të këtillë, dhe atë të dallimeve etnike ndërmjet popujve.

Në romanin e Adil Ebu Shenebit është paraqitur me mjeshtri morali i dyfishtë i shtresave të larta të shoqërisë siriane. Është ironizuar sidomos pushteti që veprimet e veta në vazhden e traditës prapanike, përpiqte ta maskojë me fraza pseudodemokratike dhe me sistemin e zgjedhjeve, që organizohen brenda fushatave të vrullshme plot premtime që nuk do të realizohen kurrë. Midis figurave të pushtetarëve shquhet në mënyrë të veçantë ministri El-Zilzali, që është tipizuar mirë si përfaqësues i shtresave më të larta të pushtetit edhe në aspektin e veçantë të gjuhës, sepse fjalori i tij është i stërngarkuar me fraza pseudopatriotike. Midis koloritit të përgjithshëm të kryeqytetit të Sirisë shquhen edhe shumë figura të tjera që, krahas paraqitjes së theksuar individualiste, kanë edhe veçoritë tipike të përfaqësuesve të shtresave të ndryshme shoqërore. Midis tyre duhet t'i veçojmë për veprime të motivuara me sukses dhe për veçori tipike si karaktere të ndërtuara me sukses të plotë sidomos. Shejh Eminin, Ahmet Kerimin, El Butunxhiun, Sadijen etj.

Shikuar në përgjithësi, romani "Trëndafili i mëngjesit" i Adil Ebu Shenebit, si për tematikën, ashtu edhe për prosedeun artistik, është vepër e realizuar plotësisht në aspektin estetik, prandaj përfaqëson në mënyrë të denjë letërsinë e sotme arabe dhe i afron lexuesit shqiptar jo vetëm mundësi për ta shijuar bukurinë e artit letrar, por edhe për ta njohur më thellë një botë të veçantë, që nuk është fort e largët si pro-

jekSION I PARAFYTYRIMIT TË SË KALUARËS SË TIJ. Vlera themelore e romanit mbetet në realizimin e tij me mjetet e gërshetuara të poetikës së prozës klasike orientale dhe të shprehjes moderne për kuptimin e kritikës letrare bashkëkohore. Të përfundojmë me një konstatim më të drejt-përdrejtë: ky roman përfaqëson sintezën e veçorive karakteristike të disa llojeve dhe tipeve të romaneve të letërsisë së përbotshme të shekullit XX.

Më në fund e shohim të arsyeshme ta veçojmë edhe përpjekjen dhe angazhimin e përkthyesit të romanit, mr. Shemsi Ajvazit. Përkthimi i tij gjithsesi është një ndihmesë e veçantë për ta shijuar bukurinë e kësaj proze. Ai ka bërë përpjekje të konsiderueshme, që duke ruajtur me besnikëri mënyrën e shprehjes artistike dhe nuancat karakteristike të stilit dhe të gjuhës së origjinalit, t'i japë lexuesit tonë një vepër me të cilën dëshmohet edhe mundësia shprehëse dhe pasuria frazeologjike e gjuhës shqipe. Në sajë të këtij kujdesi për gjuhën, përkthyesi, në një anë, e ka ruajtur në përgjithësi koloritin oriental të atmosferës së përgjithshme të romanit, por, në anën tjetër, nuk e ka ngarkuar gjuhën tonë me orientalizma të panevojshëm.

Essejid Ali Ismail

UDHËTIMI I MARTIRIZIMIT

Ngrohtësia e jetës kaploi trupin e tij, derisa po ecte me hapa të sigurt drejt cakut të tij.

Këmbët e tij sikur ia kishte lënë gravitacioni të thata.

I lëshoi një shikim qiellit dhe iu duk sikur ai të ishte mbi kokën e tij, i duhej vetëm pak ta prekte.

Ndërmjet tij dhe “cakut” nuk qëndronte asgjë tjetër...

Tërë ajo që ai dëshironte, ishte të ngrihej lart.

Në atë moment iu rëndua trupi sa filloi të kujtonte të kaluarën e “jetës” së tij...

Po, ai kishte një familje në të cilën jetonte, me gjithë maltretimet e njëpasnjëshme, përbuzjen dhe nënçmimin e tij dhe të familjes së tij...

Me gjithë peripecitë e shumta për ta fituar kafshatën e bukës, ndiente një ngrohje të veçantë kur ulej pranë sofrës me vëllanë e tij pak më të madh se ai, me nënën e tij plakë, në ballin e së cilës ishin të vizatuara rrudhat, të cilat tregonin për peripecitë dhe mundimet e ditëve të kaluara, dhe gjyshit të tij, një plak i paralizuar, nga gjymtyrët e të cilit nuk lëviz asnjë, përveç gjuhës dhe syve. Ata i bashkon dashuria, butësia dhe respekti i ndërsjellë.

Ata e shijojnë shijen e jetës vetëm në rrethin e tyre më të ngushtë, sepse ajo jashtë rrethit të tyre nuk ka kurrfarë kuptimi. Në ambientin më të gjerë që i rrethon ata, në çdo hap ballafaqohen me cenimin e të

drejtave të tyre, me frenimin e lirive të tyre. “Jeta nuk ka kuptim veçse kur njeriu është i lirë, krenar, i sigurt në vendin e tij.” Këtë sintagmë nëna e tij e përsëriste në veshët e tij dhe vllait të tij për çdo mëngjes dhe për çdo mbrëmje. Kur ata dilnin dhe kur ktheheshin. Kur uleshin për të ngrënë bukë rreth sofrës së tyre. Kur uleshin pranë gjyshit të tyre, i cili u tregonte historinë e trimërive të tij dhe të babait të tyre, i cili kishte rënë dëshmor në mbrojtje të pragut të shtëpisë, nderit dhe tokës së tij, të cilën nuk e kishte lëshuar asnjëherë, me gjithë maltretimet dhe mundimet që kishin pësuar.

Ajo është një “jetë” e mundimshme... Aty kishte “dashuri”, “familje”. Rezistoi, rezistoi dhe pastaj u shpartallua. Ra dëshmor vllai, dhe vdiq pas një kohe edhe nëna. Dhe një ditë, kur u kthye fshehtazi si zakonisht nga njëri prej aksioneve të tij, u tmerrua kur e pa shtëpinë e tij se ishte kthyer në gërmadhë. Atë e kishin rrënuar buldozerët e mallkuar me “zhurmën e tyre tmerruese si për të vegjlit dhe të rriturit...”. Klithi, klithi për gjyshin e tij, të cilin e kishin harruar fqinjët e tij në brendi të asaj që quhej shtëpi, sepse ishte i paralizuar, nuk lëvizte. Nuk e kishin parë ushtarët, apo ndoshta e kishim parë, por nuk kishin çarë kokën për të kur rrënuan shtëpinë.

Përfundoi jeta “e qetë”, e cila i jepte ngrohtësi atij. Pa shtëpi... Pa familje... Anëtarët e familjes së braktisur... Gradualisht filloi të harr-ojë shijen e asaj “jete” me angazhimet e tij të njëpasnjëshme në aksione luftarake, të cilat nuk kishin mbarim... Preokupimi i tij i vetëm ishte t’ua fuste tmerrin dhe të përhapte frikën në mesin e tyre... Në këtë mision e ndihmuan guximi, trimëria, mençuria dhe fuqia e tij... Shpirti i tij sakrifikues, që e shquante.

Në momentin kur e pa, ideja e tij madhështore në mendjen dhe zemrën e tij dhe u zhvillua në gjymtyrët e trupit të tij. I bëri një vështrim kësaj bote të kalueshme. Cila është vlera e jetës nëse ajo është pa dinjitet? Pa liri në tokën e tyre, që është pronë dhe pasuri e tyre. Nëse krenaria e tyre duhet të përkulet para armiqve të tyre, cili është atëherë kuptimi i kësaj “jete”? Më në fund e gjeti atë. E gjeti atë “vlerë” të qartë tek ata trima, të cilët i flijonin shpirtrat e tyre me tërë lirinë e tyre që t’u kthehej familjeve të tyre “jeta e ndershme” mbi ata derra të egër, të cilët popullit të tij i shkaktajnë vuajtje të shumta që ata t’i kthejë në popull pa identitet.

Për këtë shkak, ai nuk ngurroi për asnjë moment, atëherë kur vendosi ta sakrifikoje “vetveten” për hir të All-llahut, që me këtë të errësohej dita e atyre qenve të qartur, të cilët kafshonin trupat e popullit dhe të dashurëve të tij.

Shkoi rrugës së luftëtarëve të mëdhenj. E theu qetësinë e të vdekurve... Mori frymë nga fryma e Ahiretit... I numëroi orët e tij të mbetura... Të cilat kishin nisur të pakësoheshin. Të pakësoheshin, pasi kishte veshur rripin e martirizimit (shehidit), të cilin e kishin fshehur rrobat e tij kur i kishte veshur ato. Atij nuk i kishte mbetur tjetër përveç t’i përcillte hapat e tij me të njëjtin besim që buron nga imani i tij i fortë. Me të njëjtin besim që kaloi para ushtarëve të tyre dhe ata u frikësuan prej tij sikur ai të ishte zotëriu i tyre. Dhe ai vazhdoi. Vazhdoi dhe në gjuhën e tij nuk kishte asgjë tjetër, përveç një lagësi, të cilën ai e ndiente duke e falënderuar dhe madhëruar All-llahun që ai kaloi para tyre.

Ëndrra e tij do të realizohet... Ëndrra që ai të shohë babanë, vllanë, gjyshin dhe të hidhet në kraharorin e nënës, në një gjithësi të qetë, të gjerë, të gjelbër. Vetëm të tyre... Në një qetësi dhe begati, e cila nuk ka ngjashmëri në dynja... Aty nuk ka mundime... Aty nuk ka okupim... Por, ai do t’i takojë të dashurit e vet, të cilët i kanë paraprirë dhe e kanë mësuar se si duhet të shkojë në rrugën e xhihadit të tyre, dhe si duhet të jetojë i lirë që t’i bashkohet karvanit të tyre të shumëpritur... Atje ku do të shohë atë që nuk e ka parë syri, nuk e ka dëgjuar veshi dhe as që i ka rënë ndërmend zemrës së njeriut.

Sa të ngadalshëm ishin ata minuta, që e ndanin nga kjo ëndërr për të cilën kishte jetuar dhe për të cilën kishte luftuar... E shikoi orën që kishte në dorën e vet, pasi ishte ulur në njërën prej karrigeve, dhe e priti “autobusin” e vet që të shihte se edhe sa kohë i kishte mbetur... Disa minuta i dukeshin të gjata si të ishin shekuj të tërë... Sikur dëshironte ta zgjaste dorën dhe ta sillte vetë “akrepin” e orës... Megjithatë, ai priste... Bëhej fjalë vetëm për disa mintua, të cilat ishin të ndaluara, por megjithatë ata po ecnin.

Dhe, më në fund, e pa se ai ishte “autobusi”.

Të rrahurat e zemrës iu shpeshatuan... Trupi i dridhej... Megjithatë, ai përmbahej, përmbahej...Dhe ai po shkonte me hapa të sigurt kur ndjeu se ngrohtësia e jetës po depërtonte në trupin e tij...

Mirëpo, kur i kujtohej se ai kishte pasur familje... Jetonte në mesin e saj, ecte me hapa edhe më të sigurt dhe ngrihej. Ngrihej nga “qëllimi” i tij. Nuk u rënduan hapat e tij të fundit... Por, ndjeu një lehtësi kur ai u ngrit...

Trupi i tij u bë i lehtë dhe shpirti i tij u bë i lehtë. Dëshironte të fluturonte... Fluturonte – Ngrihej lart në qiell.

Muhamed Salih Junus

Ne kishim dikur një atdhe

*Kur isha i vogël
në vendim tim
Isha sikur lulja në kulmin e saj
unë kisha një shtëpi
si dhe kopshte dhe një fqinj
Unë kisha nënë dhe baba
shokë dhe xhaxha
si dhe shokë tjerë...
Kur isha i vogël
unë kisha një atdhe*

*Unë u përzura, por
nuk e di
se cili mëkat është mëkati im.
Tërë atë që kam mundur ta kuptoj
në atë ditë të tmerrshme
se unë u bëra i huaj
Nën një tendë
si një re
në mesin e mijëra jetimëve dhe refugjatëve.*

*U vra nëna ime pas babait tim
 me plumbin e sulmuesit të huaj
 u lig dhe vdiq, bërtima ime
 Ku e çojnë këmbët e mia, disfatën tonë
 Ata ma mbytën xhaxhanë tim
 si dhe vëllezërit e tjerë*

*U plaçkitit toka dhe shkelën xhaminë e shenjtë
 Pastaj u nisëm si një kope delesh.
 E tërë kjo ndodhi para syve të botës
 E ne me miliona ishim si të dehur
 Ajo nuk e di përse
 ne u kthyem në “të huaj”
 Të huaj... Përse, përse
 Një mijë përse, në zemrën time vlojnë
 A më sheh mua, e përmend... A më sheh mua, e di
 Si u humbëm... Përse u kthyem në refugjatë?*

*Ne u shitëm ashtu si shiten delet
 dhe para syve të të gjithëve
 Xhelatit ia dhuruan shtëpinë time
 Pastaj “të vegjëlit”
 i gjuajtën nëpër tenda të tradhtisë në mes të baltës.*

*A më sheh mua sot a po e kujtoj ditën e pikëllimit tim
 Atë ditë kur humbëm... Atë ditë kur u kthyem në refugjatë.*

*Çdo plagë prej plagëve të mia flet
 Si u bëmë të huaj?!
 Dhe përse ne jetojmë të huaj?!*

Muhamed Salih Junus

Brezi i nderit

Prej cilës minare vjen zëri
 “Ejani në xhihad!”
 këndelluni
 ngrihuni - zgjohuni
 ... dhe bashkohuni
 ... u mbushën sheshet me njerëz
 ta ndezim fenerin
 dikush tha:
 Mbi çdo xhami
 kërceni muret
 shembini murin e internimit
 sepse lindi Hëna e Re.

I morën fenerët
 dhe u nisën...
 u shpërndanë nëpër ara
 dhe hipën mbi xhami
 kaluan në një periudhë të re

Kaluan vitet
 u bënë të njëjta netët dhe ditët
 u bënë të njëjtë të vdekurit dhe vitet
 të gjithë muajt...
 Mirëpo ata u kthyen... pasi kishin munguar
 dhe një zë vinte nga lart
 - Nuk je në ëndërr
 prej çdo minareje vjen...
 - “Ejani në xhihad!!”

Ja, kjo është Aksaja...
 Ajo është xhamia El-Xhezzar në Akka...
 Atje është xhamia Safed!!
 Ky është atdheu im, e shoh
 në mesin e shokëve të fëmijërisë sime
 ata fluturojnë... si xixëllonjat
 me vete bartin fenerët e kthimit
 për në Atdhe
 U kthyen ashtu si kthehet pranvera
 dhe u liruan prej disfatës.
 Ata kërcënuan murin e vdekjes dhe thyen prangat
 U kthyen... pa termin
 ashtu si vijnë tërmetet
 U kthyen në Fshatin tonë të vjetër
 me fenerët e tyre të vegjël
 për t'u gëzuar
 sa vjet që ata bënë përpjekje për t'u gëzuar
 po nuk patën sukses
 Nata ua shuante
 Erdhi një vit i kobshëm... i shoi
 fenerët e vegjël
 dhe ata u shpërndanë si populli sebe
 Ah, vite në të cilat u përziën të vdekurit
 dhe u përziën vitet
 kaloni... dhe silluni!!!
 që të depërtojë Zëri.
 "Ejani në xhihad!"
 dhe zëri edhe më i prekshëm
 këndelluni
 ngrihuni – zgjohuni
 dhe bashkohuni!

*Kjo është një ëndërr e re
po ringjallja jonë fisnike
dhe ëndrra e vjetër sjell ide të reja*

*Kush u mësoi fëmijëve kalimin e lumit
në errësirën e natës dhe në vapën e mesditës?*

dhe “burrat” trima

janë të dehur

janë të tretur

janë të humbur

nga ekzodi në ekzod

Kaloni dhe tretuni, o netët e humbura

Ma kthe mua një grusht dhe

apo një gur

Të shoh se si po ngulfatesh në retë e errëta në ekzod

Unë shpalova dheun e varrezave,

por ata nuk u këndellën

dhe unë shëtita prej ekzodi në ekzod

Më kthe në vendin e lindjes sime

që të mos plakem e të tretim

Sillu, o vit i lindjes sime

sepse ne jemi brezi i gurëve

dhe ne jemi brezi i nderit.

Përktheu nga arabishtja:

Q. M.

PËRMBAJTJA

<i>Qemajl Morina</i> <i>Për mësimin e fesë në shkolla.....</i>	<i>5</i>
<i>Sabri Bajgora</i> <i>Tefsiri në kohën e sahabëve.....</i>	<i>11</i>
<i>Nexhat Ibrahim</i> <i>Planprogrami i përgjithshëm për përhapjen e mësimin islam.....</i>	<i>39</i>
<i>Muhidin Ahmeti</i> <i>Edukimi dhe arsimimi në Islam.....</i>	<i>47</i>
<i>Dr. Abdullah Hamiti</i> <i>Nezim Frakulla – jeta dhe divanet e tij – (2)</i>	<i>59</i>
<i>Hasan Hasani</i> <i>Dy figura të shquara letrare dhe kombëtare</i>	<i>75</i>
<i>Shevki Ebu Halil</i> <i>Orientalistja Laura Veccia Vaglieri në mbrojtje të Islamit.....</i>	<i>87</i>
<i>Tahir Ben Jellun</i> <i>Si ua shpjegova Islamit fëmijëve.....</i>	<i>99</i>
<i>Dr. Jusuf Ramic</i> <i>Mendimet e disa orientalistëve evropiane për tesavvufin Islam</i>	<i>123</i>
<i>Qemajl Morina</i> <i>Historiku i hartimit të fjalorëve të gjuhës arabe</i>	<i>131</i>

Mustafa Imamoviq

Pasqyra e gjenocidit mbi myslimanët në tokat jugosllave..... 143

Vrasja e halifit Hazreti Omer r.a. 163

Nexhat Ibrahim

Fundamentalizmi dhe kisha ortodokse serbe 167

Sadri Fetiu

***Romani "Trëndafili i mëngjesit" vepër e dalluar
e letërsisë së sotme arabe..... 175***

Essejid Ali Ismail

Udhëtimi i martirizimit 187

Poezi..... 191

Përmbajtja 197